**TABELA E PËRPUTHSHMËRISË**

| Prokurimi Publik<br>CELEX 32014L0024[1], Parlamenti dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, 28.03.2014, Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 26 Shkurt 2014, për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 94/65. | | **1. LIGJI 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”**<br>**2. VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 285, DATË 19.05.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”**<br>**3. VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 384, DATË 30.06.2021 “PËR FORMËN E KOMUNIKIMIT NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK”**<br>**4. VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 768, DATË 15.12.2021 “PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA SPECIFIKE, LLOJEVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA, PËR TË CILAT MUND TË REZERVOHET E DREJTA E PJESËMARRJES SË ORGANIZATAVE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK, SI DHE RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR PROKURIMIN E TYRE”**<br>**5. PROJEKTLIGJ “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 162, DATË 23.12.2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”**<br>Përputhshmëri e pjesshme | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| **Neni (Direktiva)** | **Teksti** | **Refe renc a** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| Objekti dhe fusha e zbatimit (1) | Kjo direktivë përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet kontraktore në lidhje me kontratat publike dhe konkurset e projektimit, vlera e të | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Objekti<br>(1) | Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoriteftet dhe entet kontraktore në lidhje me kontratat publike, dhe konkurset e projektimit. | E plotë | |

[1] CELEX 32014L0024

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | cilëve parashikohet të jetë jo më e vogël se sa kufiri monetar i përcaktuar në nenin 4. | | | | | |
| 1 (2) | Prokurimi, sipas kuptimit të kësaj direktive është blerja e punëve, furnizimeve ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete kontraktore pavarësisht nëse punët, furnizimet ose shërbimet synohen të përdoren për qëllime publike. | | 1 (2) | Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike. | E plotë | |
| 1 (3) | Zbatimi i kësaj direktive i nënshtrohet nenin 346 të TFBE-së. | | | | E papërputhur | Kjo pike i referohet TFBE , i cili nuk është i zbatueshëm për Shqipërinë në këtë faze duke mos qenë vend anëtar i BE |
| 1 (4) | Kjo direktivë nuk prek lirinë e shteteve anëtare për të përcaktuar, në | | | | E papërputhur | Dispozita i referohet vendeve anetare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | pajtim me të drejtën e Bashkimit Evropian, se çfarë ata konsiderojnë si shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik, si duhet të organizohen dhe të financohen këto shërbime në përputhje me rregullat për ndihmë nga shteti dhe cilave detyrime specifike duhet t'u nënshtrohen ato. Gjithashtu, kjo direktivë nuk ndikon në vendimin e autoriteteve publike për t'i kryer vetë funksionet publike, për mënyrën dhe masën e kryerjes së tyre sipas nenit 14 të TFBE-së dhe Protokollit nr. 26. | | | | | dhe eshte e pazbatueshme per Shqiperine |
| 1 (5) | Kjo direktivë nuk ndikon në mënyrën se si shtetet anëtare organizojnë sistemin e tyre të sigurimeve shoqërore | | | | E papërputhur | Dispozita i referohet vendeve anetare dhe eshte e pazbatueshme per Shqiperine |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 (6) | Marrëveshjet, vendimet ose instrumente të tjera ligjore që organizojnë transferimin e kompetencave ose përgjegjësive për zbatimin e detyrave publike ndërmjet autoriteteve kontraktore ose grupimeve të autoriteteve kontraktore dhe të cilat nuk parashikojnë dhënien e kompensimit për zbatimin E detyrimeve kontraktuale konsiderohen se janë çështje e organizimit të brendshëm të shtetit anëtar në fjalë dhe si të tilla nuk preken në asnjë mënyrë nga kjo direktivë. | | | | E papërputhur | Dispozita i referohet vendeve anetare dhe eshte e pazbatueshme per Shqiperine |
| Përkufizime 2.1. (1) | Për qëllimet e kësaj direktive përdoren përkufizimet e mëposhtme: | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Përkufizime<br>4 (1) | Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:<br>"Autoritet kontraktor" është çdo ent, që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | "autoritete kontraktore" janë autoritete shtetërore, rajonale ose lokale, organe që rregullohen nga e drejta publike ose organizatat e formuara nga një ose më shumë autoritete të tilla ose një ose më shumë organe të tilla që rregullohen nga e drejta publike; | | | a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;<br>b) çdo ent:<br>i) themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar;<br>ii) i cili ka personalitet juridik;<br>iii) i financuar kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale apo vendore, ose nga ente të tjera publike apo i administruar prej tyre ose me një bord administrativ, manaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga entet e tjera publike;<br>c) organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete apo nga një ose disa nga këto organe publike. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** | Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për menaxhimin e fondeve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Përgjegjësia e autoritetit ose entit kontraktor<br>1 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>1 (2) | publike të përcaktuara për përdorim në prokurimet publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", (më poshtë "LPP"), të këtyre rregullave, dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (më poshtë "APP"), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij dhe fondet publike respektive, dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi | | |
| 2.1. (2) | "autoritete të qeverisjes qendrore" janë autoritetet kontraktore që paraqiten në shtojcën I, dhe deri në masën që janë bërë korrigjime dhe ndryshime në nivel kombëtar, subjektet e tyre pasuese; | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Përkufizime<br>4 (1) | "Autoritet kontraktor" është çdo ent, që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë:<br>a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore; | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1. (3) | "autoritete kontraktore nën-qendrore" janë të gjitha autoritetet kontraktore që nuk janë autoritete të qeverisjes qendrore; | | Përkufizime<br>4 (1) | “Autoritet kontraktor” është çdo ent, që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë:<br>a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore; | E plotë | Ndarja administrative e territorit të Republikës së Shqipërisë nuk parashikon termin “organ i qeverisjes nën-qendrore” |
| 2.1. (4) | "organe që rregullohen nga e drejta publike" janë organet që kanë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:<br>(a) janë krijuar për qëllimin specifik të përmbushjes së nevojave në interesin e përgjithshëm, që nuk kanë karakter industrial ose tregtar;<br>(b) kanë personalitet juridik; dhe<br>(c) financohen, kryesisht, nga shteti ose autoritetet lokale ose rajonale, ose organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike; ose i nënshtrohet mbikëqyrjes administrative të këtyre | | Përkufizime<br>4 (1) | Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:<br>“Autoritet kontraktor” është çdo ent, që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë:<br><br>b) çdo ent:<br>i) themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar;<br>ii) i cili ka personalitet juridik;<br>iii) i financuar kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale apo vendore, ose nga ente të tjera publike apo i administruar prej tyre ose me një bord administrativ, manaxherial | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | autoriteteve ose organeve; ose kanë një bord administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, më shumë se gjysma e anëtarëve të të cilit emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose lokale ose nga organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike." | | | apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga entet e tjera publike; | | |
| 2 .1. (5) | "kontrata publike" janë kontratat me shpërblim që lidhen me shkrim ndërmjet një ose më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore dhe që kanë si objekt të tyre kryerjen e punëve, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve; | | 4 (14) | “Kontratat publike” janë kontratat me shpërblim, të lidhura me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj. | E plotë | |
| 2 .1. (6) | "kontrata publike për punë" janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre sa më poshtë: | | 4 (19) | “Kontrata publike për punë" janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre sa më poshtë:<br><br>a) kryerje, ose projektim dhe kryerje të punëve në lidhje me një ose më tepër | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | a) zbatimin, ose projektimin dhe zbatimin e punëve që lidhen me një nga veprimtaritë e përmendura në shtojcën II;<br>b) realizimin, ose projektimin dhe realizimin, e një pune;<br>c) realizimin, me anë të çdo mjeti, të një pune që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës; | | | aktivitete ndërtimore, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik;<br><br>b) realizimin, ose projektimin dhe realizimin, e një pune;<br><br>c) realizimin, me anë të çdo mjeti, të një pune që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës. | | |
| 2 .1. (7) | "punë" është rezultati i ndërtimit ose veprave civile inxhinierike, të marra së bashku, i cili është i mjaftueshëm në vetvete për të përmbushur një funksion ekonomik ose teknik; | | 4 (35) | "Punë" është rezultati i ndërtimit ose veprave civile inxhinierike, të marra së bashku, i cili është i mjaftueshëm në vetvete për të përmbushur një funksion ekonomik ose teknik. | E plotë | |
| 2 .1. (8) | "Kontrata publike furnizimi" janë kontratat publike që kanë si objekt blerjen, | | 4 (18) | “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhënien ose marrjen me qira ose blerjen me këste, me ose pa mundësi blerjeje të produkteve. Një kontratë publike furnizimi mund të përfshijë në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin; | | | ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike furnizimi, mund të përfshijë në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin. | | |
| 2 .1. (9) | "kontratat publike të shërbimit" janë kontratat publike që kanë si objekt ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga ato që përmenden në pikën 6; | | 4 (20) | "Kontratat publike për shërbime" janë kontratat publike që kanë objekt kryerjen e shërbimeve të tjera nga ato që përfshihen pikën 19 të këtij neni. | E plotë | |
| 2.1. (10) | "operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik ose autoritet kontraktor ose një grup i këtyre personave dhe/ose subjekteve, duke përfshirë organizime të përkohshme të sipërmarrjeve, të cilat ofrojnë kryerjen e punëve dhe/ose punës, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve në treg; | | 4 (32) | " Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 .1. (11) | "ofertues" është një operator ekonomik, i cili ka paraqitur një ofertë; | | 4 (31) | "Ofertues" është operatori ekonomik, që paraqet një ofertë në një prokurim publik. | E plotë | |
| 2 .1. (12) | "kandidat" është një operator ekonomik që ka kërkuar një ftesë ose është ftuar për të marrë pjesë në një procedurë të kufizuar, në një procedurë konkurruese me negocim, në një procedurë me negocim pa shpallje paraprake, në një dialog konkurrues ose në një partneritet për novacion; | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>2 (13) | "Kandidat" është operatori ekonomik, që kërkon të marrë pjesë ose është i ftuar të marrë pjesë në procedurat e prokurimit me faza. | E plotë | |
| 2.1. (13) | "dokument prokurimi" është çdo dokument i prodhuar ose i përmendur nga autoriteti kontraktor për të përshkruar ose përcaktuar elementet e prokurimit ose të procedurës, duke përfshirë njoftimin e kontratës, njoftimin paraprak të informacionit, kur përdoret si mjet për ftesë në konkurrim, | | 4 (5) | "Dokumentat e tenderit" janë dokumentat e prodhuar ose të përmendur nga autoriteti ose enti kontraktor për të përshkruar ose përcaktuar elementet e prokurimit ose të procedurës, të nevojshme për përgatitjen e ofertave duke përfshirë njoftimin e kontratës, njoftimin paraprak ose periodik të informacionit, kur përdoret si mjet për ftesë në konkurrim, specifikimet | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | specifikimet teknike, dokumentin përshkrues, kushtet e propozuara të kontratës, formatet për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët dhe ofertuesit, informacionin për detyrimet e përgjithshme të zbatueshme dhe çdo dokument shtesë; | | | teknike, dokumentin përshkrues, kushtet e propozuara të kontratës, formularët për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët dhe ofertuesit, informacionin për detyrimet e përgjithshme të zbatueshme dhe çdo dokument shtesë. | | |
| 2.1. (14) | "veprimtari të blerjes së përqendruar" janë veprimtaritë që kryhen gjithmonë në një nga format e mëposhtme:<br>(a) blerja e furnizimeve dhe/ose shërbimeve të synuara për autoritetet kontraktore,<br>(b) dhënia e kontratave publike ose lidhja e marrëveshjeve kuadër për punë, mallra ose shërbime të destinuara për autoritetet kontraktore | | 4 (43) | “Veprimtari të blerjes së përqendruar” janë aktivitete që kryhen në vazhdimësi në një prej formave vijuese:<br>a) blerja e mallrave dhe shërbimeve për disa autoritete ose ente kontraktore,<br>ose:<br>b) dhënia e kontratave publike ose lidhja e marrëveshjeve kuadër për mallra, shërbime ose punë të dedikuara për disa autoritete ose ente kontraktore. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1. (15) | "veprimtari blerëse ndihmëse" janë veprimtaritë që konsistojnë në ofrimin e mbështetjes për veprimtari blerëse, në veçanti në format e mëposhtme:<br>(a) infrastrukturë teknike që u mundëson autoriteteve kontraktore që të japin kontrata publike ose të lidhin marrëveshje kuadër për punë, furnizime ose shërbime;<br>(b) këshilla për kryerjen ose hartimin e procedurave të prokurimit publik;<br>(c) përgatitja dhe menaxhimi i procedurave të prokurimit në emër ose për llogari të autoritetit kontraktor në fjalë; | | **5. Projektligj**<br><br>(1) | h) Pas pikës 43, shtohet pika 43/1 me këtë përmbajtje:<br>*"Veprimtari ndihmëse" për prokurimin publik janë veprimtaritë që konsistojnë në ofrimin e mbështetjes për autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti në format e mëposhtme:*<br>*(a) platforme elektronike, që u mundëson autoriteteve ose enteve kontraktore që të japin kontrata publike ose të lidhin marrëveshje kuadër për punë, furnizime ose shërbime;*<br>*(b) konsulencë për përgatitjen e procedurave të prokurimit publik;*<br>*(c) përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoritetit ose entit kontraktor në fjalë".* | E plotë | |
| 2 .1. (16) | "organ qendror blerës" është një autoritet kontraktor që ofron veprimtaritë e blerjes së përqendruar dhe | | 4 (33) | "Organ qendror blerës" është autoriteti ose enti kontraktor, i cili: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mundësisht, veprimtari blerëse ndihmëse; | | | a) siguron për autoritetet ose entet kontraktore mallra dhe/ose shërbime;<br>b) përzgjedh fituesit për kontrata publike për punime, mallra ose shërbime, të caktuara për autoritetet ose entet kontraktore. | | |
| 2 .1. (17) | "ofrues i shërbimit të prokurimit" është një organ publik ose privat që ofron veprimtari blerëse ndihmëse në treg; | | **5. Projektligj**<br><br>(1) | Në nenin 4 "Përkufizime" , bëhen shtesat si më poshtë:<br><br>a) Pas pikës 31, shtohet pika 31/1 me këtë përmbajtje:<br>"Ofrues i shërbimit të prokurimit" është një subjekt publik ose privat që ofron veprimtari ndihmëse për prokurimin publik;" | E plotë | |
| 2 .1. (18) | "E shkruar" ose "me shkrim" është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, duke përfshirë informacionet, që transmetohen ose ruhen nëpërmjet mjeteve elektronike; | | 4 (28) | "Me shkrim" ose "në formë të shkruar" është secila shprehje që përbëhet prej fjalëve ose shifrave që mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë informacionin që transmetohet dhe ruhet në mënyrë elektronike. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1. (19) | "Mjete elektronike" janë pajisjet elektronike për përpunimin dhe ruajtjen (duke përfshirë përpunimin digjital) e të dhënave që transmetohen, jepen dhe merren përmes kabllove, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik; | | 4 (29) | “Mjet elektronik” është pajisje elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave (përfshirë këtu edhe përpunimin dixhital) që transmetohen, jepen e merren përmes kabllove, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik. | E plotë | |
| 2 .1. (20) | "cikël jetësor" janë të gjitha fazat e njëpasnjëshme dhe/ose të ndërlidhura, duke përfshirë kërkimin dhe zhvillimin që do të kryhet, prodhimin, tregtimin dhe kushtet e tij, transportin, përdorimin dhe mirëmbajtjen, gjatë gjithë ekzistencës së produktit ose punëve ose ofrimit të shërbimit, që nga blerja e lëndës së parë ose gjenerimi i burimeve deri në asgjësimin, pastrimin, përfundimin e shërbimit ose të përdorimit; | | 4 (4) | “Cikli jetësor” përfshin fazat e njëpasnjëshme dhe/ose të ndërlidhura, duke përfshirë kërkimin dhe zhvillimin që do të kryhet, prodhimin, tregtimin dhe kushtet e tij, transportin, përdorimin dhe mirëmbajtjen, gjatë gjithë ekzistencës së produktit ose punëve ose ofrimit të shërbimit, që nga blerja e lëndës së parë ose gjenerimi i burimeve deri në asgjësimin, pastrimin, përfundimin e shërbimit ose të përdorimit. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1. (21) | "konkurse projektimi" janë ato procedura që i mundësojnë autoritetit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt të përzgjedhur nga një juri pasi është futur në konkurs me ose pa dhënie çmimi; | | 4 (21) | "Konkurse projektimi" janë ato procedura që i mundësojnë autoritetit ose entit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt të përzgjedhur nga një juri, pasi është futur në konkurs me ose pa dhënie çmimi. | E plotë | |
| 2 .1. (22) | "novacion" është zbatimi i një produkti, shërbimi ose procesi të ri ose të përmirësuar dukshëm, duke përfshirë por jo i kufizuar me proceset e prodhimit, ndërtimit ose ristrukturimit të një metode të re tregtimi ose një metode të re organizative në praktikat e punës, organizimin e vendit të punës ose marrëdhëniet me jashtë, ndër të tjera, me qëllim për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave të shoqërisë | | 4 (12) | "Inovacion" është realizimi i një produkti, shërbimi ose procesi të ri ose të përmirësuar dukshëm, duke përfshirë, por jo i kufizuar me proceset e prodhimit, ndërtimit ose ristrukturimit të një metode të re tregtimi ose një metode të re organizative në praktikat e punës. | E pjesshme | Ligji nuk mund te referoje tek Strategjia Evropa 2020 duke qene se Shqiperia nuk eshte nje vend anetar i BE. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ose në mbështetje të strategjisë Evropa 2020, për rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe përfshirëse; | | | | | |
| 2 .1. (23) | "etiketë" është çdo dokument, certifikatë ose vërtetim që konfirmon se punët, produktet, shërbimet, proceset ose procedurat në fjalë plotësojnë disa kërkesa të caktuara; | | 4 (8) | "Etiketë" është çdo dokument, certifikatë ose vërtetim që tregon se punët, mallrat shërbimet, proceset apo procedurat përkatëse përmbushin kritere të caktuara . | E plotë | |
| 2 .1. (24) | "kërkesat e etiketës" janë kërkesat që duhet të plotësojnë punët, produktet, shërbimet, proceset ose procedurat në fjalë për të marrë këtë etiketë. | | 5. Projektligj<br><br>1 (a) | Pas pikës 13 shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:<br><br>13/1."Kërkesat e etiketës" janë kërkesat që duhet të plotësojnë punët, produktet, shërbimet, proceset ose procedurat në fjalë për të marrë këtë etiketë". | E plotë | |
| 2 .2. | Për qëllimin e këtij neni "autoritete rajonale" përfshin autoritetet e paraqitur në një listë jo shteruese në NUTS 1 dhe 2, siç përmenden në Rregulloren (KE) nr. 1059/2003 të Parlamentit Evropian | | | | E papërputhur | Kjo është e lidhur me nomenklaturën e ndarjeve administrative të vendeve të BE-së dhe nuk eshte relevant per Shqiperine ne kete moment |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe të Këshillit, ndërsa "autoritete lokale" përfshin të gjitha autoritetet e njësive administrative që përfshihen në NUTS 3 dhe njësive administrative më të vogla, siç përmenden në Rregulloren (KE) nr. 1059/2003. | | | | | |
| Prokurimi i përzier<br>3 (1) | Paragrafi 2 zbatohet për kontratat e përziera që kanë si objekt lloje të ndryshme prokurimi, të cilat mbulohen të gjitha nga kjo direktivë. Paragrafët 3 deri në 5 zbatohen për kontratat e përziera që kanë si objekt prokurimin e mbuluar nga kjo direktivë dhe prokurimin e mbuluar nga regjime të tjera juridike. | | | | E papërputhur | Nuk është e nevojshme të transpozohet pasi është paragraf shpjegues mbi zbatimin e paragrafeve pasardhes |
| 3 (2) | Kontratat që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë lloje prokurimi (punët, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | Kontratat që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë lloje prokurimi për punë, shërbime ose furnizime, jepen në përputhje me | E plotë | Nenet 5 dhe 6 te ligjit jane hartuar duke kombinuar nenin 3 te |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shërbimet ose furnizimet) jepen në përputhje me dispozitat e zbatueshme sipas llojit të prokurimit që karakterizon objektin kryesor të kontratës në fjalë.<br><br>Në rastin e kontratave të përziera që përbëhen pjesërisht nga shërbimet sipas kuptimit të kapitullit I të titullit III dhe pjesërisht nga shërbime të tjera ose kontrata të përziera që përbëhen pjesërisht nga shërbimet dhe pjesërisht nga furnizimet, objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse. | | Kontratat e përziera<br>5 (1)<br><br>5 (2) | dispozitat e zbatueshme, sipas llojit të prokurimit që karakterizon objektin kryesor të kontratës në fjalë.<br><br>Në rastin e kontratave të përziera që përbëhen pjesërisht nga shërbimet e parashikuara në Kreun XII të këtij ligji dhe nga shërbime të tjera, ose kontrata të përziera që përbëhen pjesërisht nga shërbimet dhe pjesërisht nga furnizimet, objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse. | | direktives 2014/24 me nenet 5 dhe 6 te direktives 2014/25 duke qene se ky ligj i transpozon te dyja keto direktiva. |
| 3 (3) | Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë objektivisht të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | Për kontratat publike që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë veprimtari, prokurimi i të cilave rregullohet në regjime të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ndashme, zbatohet paragrafi 4. Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë objektivisht të pandashme, zbatohet paragrafi 6.<br><br>Kur një pjesë e një kontrate të caktuar mbulohet nga neni 346, TFBE-ja ose Direktiva 2009/81/KE, zbatohet neni 16 i kësaj direktive. | | Prokurim i përzier që mbulon disa veprimtari<br>6 (1)<br><br>6 (3) (c) | ndryshme, kur pjesë të ndryshme të saj janë objektivisht të ndashme autoritetet ose entet kontraktore mund të zgjedhin të japin disa kontrata të ndara për secilën prej tyre ose të japin një kontratë të vetme, kur për arsye objektive, është i pamundur prokurimi në kontrata të ndara.<br><br>Në çdo rast, zgjedhja midis prokurimit të një kontrate të vetme dhe prokurimit të disa kontratave ndara nuk bëhet me qëllimin për ta përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të këtij ligji<br><br>Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për dhënien e kontratës do të zbatohen rregullat e mëposhtme:<br>c) Në rastin e kontratave të përziera që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. | | |
| 3 (4) | Në rastin e kontratave që kanë si objekt prokurimin që mbulohet nga kjo direktivë si edhe prokurimin që nuk mbulohet nga kjo direktivë, autoritetet kontraktore mund të zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta ose të japin një kontratë të vetme. Kur autoritetet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi se cili regjim juridik zbatohet për secilën nga këto kontrata të veçanta merret mbi bazën e karakteristikave të | | 6 (2)<br><br>6 (3) (b) | Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të ndara, vendimi për rregullat që zbatohen për secilën prej tyre merret mbi bazën e karakteristikave të veprimtarisë së veçantë përkatëse<br><br>Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për dhënien e kontratës do të zbatohen rregullat e mëposhtme:<br><br>b) Në rastin e kontratave të përziera që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe ligjit të koncesioneve, kontrata e vetme jepet në përputhje me këtë ligj, nëse vlera e parashikuar e pjesës | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | pjesës së veçantë përkatëse.<br>Kur autoritetet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, kjo direktivë zbatohet për kontratës e përzier vijuese, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në nenin 16, pavarësisht vlerës së pjesëve që në rast të kundërt do t'i ishin nënshtruar një tjetër regjimi juridik dhe pavarësisht regjimit juridik së cilit këto pjesë do t'i nënshtroheshin në kushte të tjera.<br>Në rastin e kontratave të përziera që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve dhe të koncesioneve, kontrata e përzier jepet në | | | së kontratës që mbulohet nga ky ligj, e llogaritur në përputhje me parashikimet e këtij ligji, është e barabartë ose më e madhe se kufiri i lartë monetar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përputhje me këtë direktivë, nëse vlera e parashikuar e pjesës së kontratës e cila përbën një kontratë që mbulohet nga kjo direktivë, e llogaritur në përputhje me nenin 5, është e barabartë me ose më e madhe se kufiri monetar përkatës i përcaktuar në nenin 4. | | | | | |
| 3 (5) | Në rastin e kontratave që kanë si objekt prokurimin që mbulohet nga kjo direktivë dhe prokurimin për kryerjen e një veprimtarie që i nënshtrohet Direktivës 2014/25/BE, pavarësisht paragrafit 4 të këtij neni, rregullat e zbatueshme përcaktohen sipas neneve 5 dhe 6 të Direktivës 2014/25/BE. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Prokurim i përzier që mbulon disa veprimtari<br>6 (3) (a) | Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për dhënien e kontratës do të zbatohen rregullat e mëposhtme:<br><br>a) Në rastin e kontratave që kanë si objekt prokurimin që mbulohet nga sektori klasik dhe prokurimin për kryerjen e një veprimtarie sektorale, rregullat e zbatueshme përcaktohen sipas dispozitave që rregullojnë sektorin klasik; | E plotë | Neni 6 (3) (a) eshte hartuar ne perputhje me parashikimet e neneve 5 dhe 6 te Direktives 2014/25 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 (6) | Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë objektivisht të pandashme, regjimi juridik i zbatueshëm përcaktohet mbi bazën e objektit kryesor të asaj kontrate. | | 6 (4) | Kur pjesë të ndryshme të një kontrate publike të përzier është e pamundur të ndahen, kontrata e vetme do të jepet në bazë të rregullave të zbatueshme për objektin kryesor të saj. | E plotë | |
| Kufijtë monetarë<br>Shumat e kufijve monetarë<br>4 (1) | Kjo direktivë zbatohet për prokurimet, vlera me TVSH e të cilëve parashikohet të jetë e barabartë me ose më e madhe se kufijtë monetarë të mëposhtëm:<br>(a) 5 186 000 euro për kontratat publike për punë;<br>(b) 134 000 euro për kontratat publike të furnizimit dhe shërbimit që jepen nga autoritetet e qeverisjes qendrore dhe konkurset e projektimit të organizuara nga këto autoritete; kur kontratat publike të furnizimit jepen nga autoritetet kontraktore që veprojnë | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Kufijtë monetarë<br>33 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>33 (2) | Për qëllime te këtij ligji zbatohen kufijtë monetarë, si më poshtë:<br><br>a) kufiri i lartë monetar;<br><br>b) kufiri i ulët monetar;<br><br>c) kufiri monetar për prokurime me vlerë të vogël.<br><br><br>Kufijtë monetarë, përcaktohen në rregullat e prokurimit publik, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e legjislacionit europian në fushën e prokurimit publik. | E pjesshme | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në fushën e mbrojtjes, ky kufi monetar zbatohet vetëm për kontratat që lidhen me produktet e mbuluara nga shtojca III;<br>(c) 207 000 euro për kontratat publike të furnizimit dhe shërbimit që jepen nga autoritetet kontraktore nënqendrore dhe konkurset e projektimit të organizuara nga këto autoritete; ky kufi monetar zbatohet edhe për kontratat publike të furnizimit që jepen nga autoritetet e qeverisjes qendrore që veprojnë në fushën e mbrojtjes, kur këto kontrata përfshijnë produkte që nuk mbulohen nga shtojca III;<br><br>(d) 750 000 euro për kontratat publike të shërbimit për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike të paraqitura në shtojcën XIV. | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Kufijtë monetarë 12 (1) | Në përputhje me nenin 33 të LPP, kufijtë monetarë janë:<br>a) Kufiri i lartë monetar:<br>- 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milion) për kontratat e punëve publike lekë;<br>- 40 000 000 (dyzet milion) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave;<br><br>b) Kufiri i ulët monetar:<br>- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;<br>- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.<br><br>Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektoriale. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 12 (2)<br><br>12 (3) | c) Kufiri monetar për prokurime me vlerë të vogël:<br>Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1,000 000 (njëmilion) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlerë të vogël, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën prokurim me vlerë të vogël, siç përshkruhet në nenin 57 të këtyre rregullave.<br><br>Në cdo rast, nëse autoriteti kontraktor ka realizuar prokurimin e gjithë vlerës së parashikuar prej 1,000 000 lekësh, por gjatë vitit kalendarik, i lindin nevoja shtesë që janë në kufirin e prokurimit me vlerë të vogël, dhe nuk ka qenë e mundur të parashikoheshin në fillim të vitit, mund të përdorë përsëri këtë lloj procedure. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 12 (4) | Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur.<br><br>Për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, si dhe për artikuj dhe shërbime protokollare, sipas legjislacionit në fuqi, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 12 (5) | përcaktohen rregulla të posacme me vendim të Këshillit të Ministrave.<br><br>Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Metodat për të llogaritur vlerën e parashikuar të prokurimit<br>5 (1) | Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti kontraktor, duke përfshirë çdo formë opsioni dhe çdo rinovim të kontratave siç përcaktohet qartë në dokumentet e prokurimit.<br>Kur autoriteti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit<br>34 (1) | Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo formë opsioni dhe çdo rinovim të kontratave siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Rregulla të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës 13 (1) | Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit. | | |
| 5 (2) | Kur një autoritet kontraktor përbëhet nga njësi operacionale të ndara, merret në konsideratë vlera e plotë e të gjitha njësive | | | | E papërputhur | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | operacionale individuale.<br>Pavarësisht nënparagrafit të parë, kur një njësi operacionale e veçantë mban përgjegjësi në mënyrë të pavarur për prokurimin e saj ose kategori të caktuara të tij, vlerat mund të përllogariten në nivelin e njësisë në fjalë. | | | | | |
| 5 (3) | Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit e kësaj direktive, përveçse kur kjo justifikohet nga arsye objektive. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit<br>34 (2) | Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit e këtij ligji, përveçse kur kjo justifikohet nga arsye objektive.<br><br>Metodat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit parashikohen në rregullat e prokurimit publik | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>13 (3) | Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë. | | |
| 5 (4) | Vlera e përllogaritur është e vlefshme në momentin kur dërgohet ftesa për konkurrim, në rastet kur nuk parashikohet një ftesë për konkurrim, në momentin kur autoriteti kontraktor nis procedurën e prokurimit, për shembull, aty ku është e mundur, duke kontaktuar operatorët ekonomikë në lidhje me prokurimin. | | | | E papërputhur | |
| 5 (5) | Për marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | Për marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes, vlera që do të merret parasysh është vlera | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | vlera që do të merret parasysh është vlera maksimale e parashikuar pa TVSH e të gjitha kontratave të parashikuara për të gjithë afatin e marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes. | | 34 (4) | maksimale e parashikuar pa TVSH, e të gjitha kontratave të parashikuara për të gjithë afatin e marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>13 (5) | Për marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes, vlera që do të merret parasysh është vlera maksimale e parashikuar pa TVSH, e të gjitha kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë afatit të marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes. | | |
| 5 (6) | Në rastin e partneriteteve për novacion, vlera që duhet marrë në konsideratë është vlera maksimale pa TVSH e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit që do të kryhen gjatë të gjitha fazave të partneritetit të parashikuar si edhe të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që do të zhvillohen ose | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>35 (6) | Në rastin e partneriteteve për inovacion, vlera që duhet marrë në konsideratë është vlera maksimale pa TVSH, e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit që do të kryhen gjatë të gjitha fazave të partneritetit të parashikuar, si edhe të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që do të zhvillohen ose prokurohen në përfundim të partneriteteve të parashikuara. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** | Në rastin e partneriteteve për inovacion, vlera që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | prokurohen në përfundim të partneriteteve të parashikuara. | | 13 (6) | duhet marrë në konsideratë është vlera maksimale pa TVSH, e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit që do të kryhen gjatë të gjitha fazave të partneritetit të parashikuar, si edhe të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që do të zhvillohen ose prokurohen në përfundim të partneriteteve të parashikuara. Vlera e parashikuar e mallrave, shërbimeve ose punëve, që synohen të përfitohen në këtë rast, duhet të jetë në proporcion me investimin që kërkohet për realizimin e tyre. | | |
| 5 (7) | Në lidhje me kontratat publike për punë, llogaritja e vlerës së parashikuar merr në konsideratë koston e punëve dhe vlerën totale të parashikuar të furnizimeve dhe shërbimeve që vihen në dispozicion të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>34 (6) | Në lidhje me kontratat publike për punë, llogaritja e vlerës së parashikuar merr në konsideratë koston e punëve dhe vlerën totale të parashikuar të furnizimeve dhe shërbimeve që vihen në dispozicion të kontraktorit nga autoriteti ose enti kontraktor, nëse ato janë të nevojshme për kryerjen e punëve. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kontraktorit nga autoriteti kontraktor, nëse ato janë të nevojshme për kryerjen e punëve. | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>13 (7) | Në lidhje me kontratat publike për punë, llogaritja e vlerës së parashikuar merr në konsideratë koston e punëve dhe vlerën totale të parashikuar të furnizimeve dhe shërbimeve që vihen në dispozicion të kontraktorit nga autoriteti ose enti kontraktor, nëse ato janë të nevojshme për kryerjen e punëve. | | |
| 5 (8) | Kur një punë ose një shërbim i propozuar mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.<br><br>Kur vlera e agreguar e loteve është e barabartë ose e tejkalon kufirin monetar të përcaktuar në nenin 4, atëherë kjo direktivë zbatohet për prokurimin e secilit lot. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>34 (7) | Kur një punë, mall ose një shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>13 (8) | Kur një punë, mall ose një shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, për qëllim të përllogaritjes së vlerës së kontratës duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 (9) | Kur një propozim për blerjen e mallrave të ngjashme mund të rezultojë në prokurimin e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve kur zbatohet neni 4 germat b dhe c.<br><br>Kur vlera e agreguar e loteve është e barabartë ose e tejkalon kufirin monetar të përcaktuar në nenin 4, atëherë kjo direktivë zbatohet për prokurimin e secilit lot. | | | | E papërputhur | |
| 5 (10) | Pavarësisht paragrafit 8 dhe 9, autoritetet kontraktore mund të japin kontrata për lote individuale pa zbatuar procedurat e parashikuara nga kjo direktivë, nëse vlera e parashikuar pa TVSH e | | | | E papërputhur | Këto dispozita janë të aplikueshme në kontekstin e vendeve anëtare dhe nuk jane relevante per Shqiperine ne kete moment |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | këtyre loteve është më pak se 80 000 euro për furnizimet ose shërbimet ose 1 milion euro për punët. Megjithatë, vlera agregate e loteve të dhëna në këtë mënyrë pa zbatuar këtë direktivë nuk tejkalon 20% të vlerës agregate të të gjithë loteve në të cilët është ndarë puna e propozuar, blerja e propozuar e furnizimeve të ngjashme ose ofrimi i propozuar i shërbimeve. | | | | | |
| 5 (11) | Në rastin e kontratave publike të furnizimit ose të shërbimit që kanë natyrë të rregullt ose që pritet të rinovohen brenda një periudhe të caktuar, përllogaritja e vlerës së kontratës bazohet në sa më poshtë: | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>34 (8) | Në rastin e kontratave publike të furnizimit ose të shërbimit, që kanë natyrë të vazhdueshme ose me mundësi ripërtëritje brenda një periudhe të caktuar, përllogaritja e vlerës së kontratës bazohet si më poshtë:<br><br>a) në vlerën e përgjithshme reale të kontratave pasuese | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (a) ose në vlerën e përgjithshme reale të kontratave pasuese të të njëjtit lloj, të dhëna gjatë vitit ushtrimor ose gjatë 12 muajve paraardhës, vlerë e përshtatur, nëse është e mundur, në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në sasi ose vlerë që mund të ndodhin gjatë 12 muajve pas kontratës fillestare;<br>(b) ose në vlerën e përgjithshme të kontratave pasuese të dhëna gjatë 12 muajve pas dorëzimit të parë ose gjatë vitit ushtrimor, nëse është më i gjatë se 12 muaj. | | | të të njëjtit lloj, të dhëna gjatë vitit ushtrimor ose gjatë 12 muajve paraardhës, vlerë e përshtatur, nëse është e mundur, në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në sasi ose vlerë që mund të ndodhin gjatë 12 muajve pas kontratës fillestare;<br>ose<br><br>b) në vlerën e përgjithshme të kontratave pasuese të dhëna gjatë 12 muajve pas dorëzimit të parë ose gjatë vitit ushtrimor, nëse është më i gjatë se 12 muaj. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>13 (9) | Në rastin e kontratave publike të furnizimit ose të shërbimit, që kanë natyrë të vazhdueshme ose me mundësi ripërtëritje brenda një periudhe të caktuar, përllogaritja e vlerës së kontratës bazohet në:<br>a) në vlerën e përgjithshme reale të kontratave të njëpasnjëshme të të njëjtit lloj, të dhëna gjatë vitit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kalendarik ose gjatë 12 muajve paraardhës, vlerë e përshtatur, nëse është e mundur, në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në sasi ose vlerë që mund të ndodhin gjatë 12 muajve pas kontratës fillestare; ose<br>b) në vlerën e përgjithshme të kontratave të njëpasnjëshme të dhëna gjatë 12 muajve pas dorëzimit të parë ose gjatë vitit ushtrimor, nëse është më i gjatë se 12 muaj. | | |
| 5 (12) | Për kontratat publike për furnizime në lidhje me marrjen dhe dhënien me qira ose blerjen e produkteve me këste, vlera që | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>34 (9) | Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë me ose pa mundësi blerje të mallrave, vlera e kontratës llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë | E pjesshme | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | duhet marrë si bazë për llogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës është si vijon:<br><br>(a) në rastin e kontratave publike me afat të përcaktuar që zgjasin 12 muaj ose më pak, vlera e përgjithshme e parashikuar për afatin e kontratës ose kur afati i kontratës zgjat më shumë se 12 muaj, vlera e përgjithshme, duke përfshirë pagesat e mbetura;<br>(b) në rastin e kontratave publike me afat të pacaktuar ose afati i të cilave nuk mund të përcaktohet, vlera mujore e shumëzuar me 48. | | | të cilëve do të zgjasë kontrata. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>13 (9) | Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë me ose pa mundësi blerje të mallrave, fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilëve do të zgjasë kontrata. | | |
| 5 (13) | Për kontratat publike të shërbimit, baza për përllogaritjen e vlerës së kontratës është si më poshtë, sipas rastit: | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>34 (10) | Për kontratat publike të shërbimit, baza për përllogaritjen e vlerës së kontratës është si më poshtë, sipas rastit: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (a) shërbime sigurimi: primi që duhet paguar dhe çdo formë tjetër pagese;<br>(b) shërbime bankare ose shërbime të tjera financiare: tarifat, komisionet që duhet të paguhen, interesi dhe forma të tjera të pagesës;<br>(c) kontratat e projektimit: tarifat, komisionet që duhen paguar dhe format e tjera të pagesës; | | | a) shërbime sigurimi: primi që duhet paguar dhe çdo formë tjetër pagese;<br><br>b) shërbime bankare ose shërbime të tjera financiare: tarifat, komisionet që duhet të paguhen, interesi dhe forma të tjera të pagesës;<br><br>c) kontratat e projektimit: tarifat, komisionet që duhen paguar dhe format e tjera të pagesës. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>13 (12) | Për kontratat publike të shërbimit, baza për përllogaritjen e vlerës së kontratës është si më poshtë, sipas rastit:<br>a) shërbime sigurimi: primi që duhet paguar dhe çdo formë tjetër pagese;<br>b) shërbime bankare ose shërbime të tjera financiare: tarifat, komisionet që duhet të paguhen, interesi dhe forma të tjera të pagesës;<br>c) kontratat e projektimit: tarifat, komisionet që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | duhen paguar dhe format e tjera të pagesës. | | |
| 5 (14) | Për kontratat publike të shërbimit, të cilat nuk tregojnë çmimin total, baza për përllogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës është si më poshtë:<br><br>(a) në rastin e kontratave me afat të përcaktuar, kur ky afat është më i shkurtër ose i barabartë me 48 muaj: vlera e përgjithshme për afatin e tyre të plotë;<br>(b) në rastin e kontratave me afat të pacaktuar ose me afat më të madh se 48 muaj: vlera mujore e shumëzuar me 48. | | | | E papërputhur | |
| Rishikimi i kufijve monetarë dhe lista e organeve të qeverisjes qendrore 6 (1) | Çdo vit duke nisur nga data 30 qershor 2013, Komisioni verifikon nëse kufijtë monetarë të përcaktuar në nenin | | | | E papërputhur | Shqipëria nuk eshte ende anetare e GPA. Aktualisht eshte rilancuar procesi i anetaresimit ne |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 4 germa a, b, dhe c, përkojnë me kufijtë monetarë të përcaktuar në Marrëveshjen për Prokurimin Publik ("GPA") të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe, aty ku është e nevojshme, i rishikon ato kufij në përputhje me këtë nen.<br><br>Në përputhje me metodën e llogaritjes të përcaktuar në GPA, Komisioni llogarit vlerën e kufijve monetarë mbi bazën e vlerës ditore mesatare të euros, në lidhje me të drejtat e veçanta të tërheqjes (SDR) përgjatë një periudhe prej 24 muajsh që përfundon më datën 31 gusht e i paraprin rishikimit që nis nga data 1 janar. Ndaj vlera e kufijve monetarë të rishikuar, aty ku është e | | | | | kete marreveshje. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nevojshme, do të rrumbullakoset në mijë euro për të garantuar që kufijtë monetarë në fuqi, të parashikuar nga GPA-ja, shprehur në SDR, të respektohen. | | | | | |
| 6 (2) | Kur rishikimi kryhet sipas paragrafit 1 të këtij neni, Komisioni gjithashtu rishikon:<br>(a) kufirin monetar të përcaktuar në germën a të paragrafit të parë të nenin 13 duke e harmonizuar atë me kufirin monetar të rishikuar që zbatohet për kontratat publike të punës;<br>(b) kufirin monetar të përcaktuar në germën b të paragrafit të parë të nenin 13 duke e harmonizuar atë me kufirin monetar të rishikuar, që zbatohet për kontratat publike të shërbimit që jepen nga autoritete kontraktore nënqendrore; | | | | E papërputhur | Pavaresisht se Shqiperia nuk eshte anetare e GPA duke parashikuar qe vlera e kufijve monetare do te percaktohet ne rregullat e prokurimit , do te behet e mundur pershtatja e tyre me cdo ndryshim te miratuar nga Komisioni Europian. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 (3) | Çdo dy vjet që nga data 1 janar 2014 Komisioni përcakton vlerat, në monedhat kombëtare të shteteve anëtare, monedha e të cilëve nuk është euro, e kufijve monetarë të përmendur në germën a, b dhe c të nenit 4, të rishikuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.<br>Në të njëjtën kohë Komisioni përcakton vlerat, në monedhat kombëtare të shteteve anëtare, monedha e të cilëve nuk është euro, e kufirit monetar të përmendur në germën d të nenit 4.<br>Në përputhje me metodën e llogaritjes të përcaktuar në GPA, përcaktimi i këtyre vlerave bazohet në vlerat ditore mesatare | | | | E papërputhur | Shih komentin e mësipërm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të atyre monedhave, të cilat korrespondojnë me kufirin monetar të zbatueshëm të shprehur në euro, përgjatë 24 muajve që përfundojnë më datën 31 gusht që paraprin rishikimin, i cili hyn në fuqi nga data 1 janar. | | | | | |
| 6 (4) | Komisioni shpall kufijtë monetarë të rishikuar që përmenden në paragrafin 1, vlerat e tyre përkatëse në monedhën vendase, që përmenden në nënparagrafin e parë të paragrafit 3, vlerën e përcaktuar në përputhje me nënparagrafin e dytë të paragrafit 3 në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* në fillim të muajit nëntor që pason rishikimin e tyre. | | | | E papërputhur | Shihni komentin e mësipërm |
| 6 (5) | Komisioni ka autoritetin që të miratojë akte të deleguara në përputhje | | | | E papërputhur | Shihni komentin e mësipërm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | me nenin 87 për të përshtatur metodologjinë e përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 të këtij neni me çdo ndryshim në metodologjinë e parashikuar në GPA për rishikimin e kufijve monetarë të përmendur në germat a, b dhe c të nenit 4 dhe për përcaktimin e vlerave përkatëse në monedhat vendase të shteteve anëtare, monedha e të cilëve nuk është euro, siç përmendet në paragrafin 3 të këtij neni.<br>Komisioni ka kompetencë të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 87 për të rishikuar kufijtë monetarë që përmenden në germat a, b dhe c të nenit 4, | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe për të rishikuar kufijtë monetarë që përmenden në germat a dhe b të paragrafit të parë të nenit 13 sipas paragrafit 2 të këtij neni. | | | | | |
| 6 (6) | Aty ku është e nevojshme që të rishikohen kufijtë monetarë që përmenden në germat a, b dhe c të nenit 4 dhe kufijtë monetarë që përmenden në germat a dhe b të paragrafit të parë të nenit 13 dhe kufizimet kohore pengojnë përdorimin e procedurës së përcaktuar në nenin 87 dhe kur kërkohet për arsye emergjence detyruese, procedura e parashikuar në nenin 88 zbatohet për aktet e deleguara të miratuara | | | | E papërputhur | Shihni komentin e mësipërm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | sipas nënparagrafit të dytë të paragrafit 5 të këtij neni. | | | | | |
| 6 (7) | Komisioni ka kompetencën të zbatojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 87 për të ndryshuar shtojcën I, me qëllim përditësimin e listës së autoriteteve kontraktore pas njoftimeve nga shtetet anëtare, kur këto ndryshime janë të nevojshme për të identifikuar saktë autoritetet kontraktore. | | | | E papërputhur | Shihni komentin e mësipërm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përjashtime 7 | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, të cilat, në zbatim të Direktivës 2014/25/BE, jepen ose organizohen nga autoritetet kontraktore që ushtrojnë një ose më shumë nga veprimtaritë e përmendura në nenet 8-14 të asaj direktive dhe jepen për kryerjen e këtyre veprimtarive, për kontratat publike që përjashtohen nga fusha e zbatimit të asaj direktive në zbatim të neneve 18, 23 dhe 34 ose, kur jepen nga një autoritet kontraktor i cili ofron shërbime postare sipas kuptimit të germës b të nenit 13, paragrafi 2 të asaj direktive, për kontratat që jepen për kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:<br>(a) shërbime me vlerë të shtuar që lidhen me dhe ofrohen tërësisht nëpërmjet | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Përjashtimet e veçanta<br>7 (1) (j)<br><br>Shërbimet postare<br>65 (3) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit për:<br><br>j. Rastet e parashikuara në nenet 65, 67, 68, 69,70 të këtij ligji<br><br>3. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike të lidhura nga operatori publik postar në lidhje me prodhimin, emetimin dhe vënien në qarkullim të pullave postare në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi. | E pjesshme | Ky ligj zbatohet edhe per prokurimet e zhviilluara nga entet kontraktore te cilat ushtrojne aktivitete sektorale te parashikuara nga Direktiva 2014/25<br><br>Ne perputhje me nenin 7, pika c) te Direktives 2014/24, ne piken 3 te nenit 65 eshte parashikuar perjashtimi nga zbatimi i ketij ligji i kontratave qe lidhen me sherbimet filatelike per te cilat Ligji per sherbimet postare i ka dhene ekskluzivitetin operatorit publik postar. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mjeteve elektronike (duke përfshirë transmetimin e sigurt të dokumenteve të koduara nëpërmjet mjeteve elektronike, shërbimet e menaxhimit të adresës dhe transmetimin e postës elektronike të regjistruar);<br><br>(b) shërbime financiare që mbulohen nga kodet e FPP-së 66100000-1 deri në 66720000-3 dhe nga germa d e nenit 21 të Direktivës 2014/25/BE dhe duke përfshirë në përgjithësi mandat pagesat nga zyra postare dhe transferimet financiare nga zyrat postare;<br><br>(c) shërbime filatelike; ose<br><br>(d) shërbime logjistike (shërbime që kombinojnë lëvrimin fizik dhe/ose | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | magazinimin me funksione të tjera jo-postare) | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përjashtime specifike në fushën e komunikimeve elektronike<br>8 | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që kanë si qëllim kryesor lejimin e autoriteteve kontraktore që të ofrojnë ose të shfrytëzojnë rrjetet publike të komunikimit ose që t'i ofrojnë publikut një ose më shumë shërbime të komunikimeve elektronike.<br>Për qëllimet e këtij neni "rrjet i komunikimeve elektronike" dhe "shërbim i komunikimeve elektronike" kanë të njëjtin kuptim si në Direktivën 2002/21/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. | | | | E papërputhur | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kontratat publike të dhëna dhe konkurset e projektimit të organizuara sipas rregullave ndërkombëtare<br>9 (1) | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit të cilat autoriteti kontraktor është i detyruar të japë ose të organizojë në përputhje me procedura prokurimi të ndryshme nga ato që përcaktohen në këtë direktivë, të cilat përcaktohen nga një nga instrumentet e mëposhtme:<br>(a) një instrument ligjor që krijon detyrime sipas të drejtës ndërkombëtare, si një marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur në përputhje me traktatet, midis një shteti anëtar dhe një ose më shumë vendeve të treta dhe nënndarje të tyre, që mbulojnë punët, furnizimet ose shërbimet që janë krijuar për zbatimin ose | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Detyrimet ndërkombëtare<br>8 (1) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, të cilat autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të japë ose të organizojë në përputhje me procedura prokurimi të ndryshme nga ato që përcaktohen në këtë ligj, procedura të cilat përcaktohen në një nga instrumentet e mëposhtme:<br><br>a) në një marrëveshje ndërkombëtare, që mbulon punët, furnizimet ose shërbimet që janë krijuar për zbatimin ose shfrytëzimin e përbashkët të një projekti;<br><br>b) një organizatë ndërkombëtare. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shfrytëzimin e përbashkët të një projekti nga shtetet nënshkruese;<br>(b) një organizatë ndërkombëtare.<br>Shtetet anëtare i komunikojmë të gjithë instrumentet ligjore, të<br>përmendur në germën a të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, Komisionit, i cili mund të konsultohet me Komitetin Këshillimor për Prokurimet Publike që përmendet në nenin 89. | | | | | |
| 9 (2) | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit të cilat autoriteti kontraktor jep ose organizon në përputhje me rregullat e prokurimit që | | 8 (2) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurseve të projektimit, të cilat autoriteti ose enti kontraktor jep në përputhje me rregullat e prokurimit që parashikohen nga një organizatë ndërkombëtare | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | parashikohen nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, kur kontratat publike dhe konkurset e projektimit në fjalë financohen plotësisht nga kjo organizatë ose institucion; në rastin e kontratave publike dhe konkurseve të projektimit që bashkëfinancohen në shumicën e tyre nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit. | | | ose një institucion financiar ndërkombëtar, kur kontratat publike në fjalë financohen plotësisht nga kjo organizatë ose institucion.<br><br>Në rastin e kontratave publike dhe konkurseve të projektimit që bashkëfinancohen në shumicën e tyre nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit. | | |
| 9 (3) | Neni 17 zbatohet për kontrata publike dhe konkurse projektimi që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë, të cilat jepen ose organizohen sipas rregullave ndërkombëtare. | | 8 (3) | Ky ligj nuk zbatohet për kontrata publike dhe konkurset e projektimit që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë, të cilat jepen ose organizohen sipas rregullave ndërkombëtare si më poshtë: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për këto kontrata dhe konkurse projektimi. | | | a) marrëveshjeve ndërkombëtare për punë, furnizime apo shërbime me qëllim zbatimin apo përdorimin e përbashkët të një projekti nga palët;<br><br>b) marrëveshjeve ndërkombëtare apo rregullimeve që lidhen me dislokimin e trupave sipas angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në një vend të tretë;<br><br>c) organizatave ndërkombëtare. | | |
| Përjashtime specifike për kontratat e shërbimit<br>10 | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike të shërbimit për:<br>(a) blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjeti financiar, të tokës, ndërtesave ekzistuese ose pronave të tjera të paluajtshme, ose për të drejtat mbi to;<br><br>(b) blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Përjashtimet e veçanta<br>7 (1) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit për:<br><br>a. Blerjen ose qiranë me çdo mjet financiar të pasurive të paluajtshme apo të të drejtave mbi to. Bëjnë përjashtim kontratat për shërbime financiare, të lidhura në atë çast, para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë së çdo forme, të cilat i nënshtrohen këtij ligji. | E plotë | Me miratimin e fjalorit te perbashket te prokurimit (kodeve CPV) do te saktesohen edhe perjashtimet ne perputhje me kodet e percaktuara nga neni 10 i direktives |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | materialit të programit të synuar për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike që jepen nga ofruesit e shërbimit të medias audiovizive ose medias radiofonike ose kontratat për kohën e transmetimit ose ofrimin e programit, që u jepen ofruesve të shërbimit të medias audiovizive ose radiofonike. Për qëllimet e kësaj pike "shërbime të medias audiovizive" dhe "ofrues të shërbimit mediatik" përkatësisht kanë të njëjtin kuptim si në germat a dhe d të nenit 1 paragrafi 1 të Direktivës 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (24). "Program" ka të njëjtin kuptim si në germën b të nenit 1, paragrafi 1 të asaj direktive, por gjithashtu përfshin programet radiofonike dhe materialet e | | | b. Blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e materialit të programit të synuar për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike që jepen nga ofruesit e shërbimit të medias audiovizive ose medias radiofonike ose kontratat për kohën e transmetimit ose ofrimin e programit, që u jepen ofruesve të shërbimit të medias audiovizive ose radiofonike<br><br>c. Shërbime arbitrazhi dhe pajtimi, si më poshtë:<br><br>(i) përfaqësimi ligjor i autoritetit ose entit kontraktor nga një avokat, seancë arbitrazhi ose pajtim; procedime gjyqësore përpara gjykatave, trupave gjykues ndërkombëtare.<br><br>ii) konsulenca ligjore që jepet në përgatitje të njërit prej procedimeve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | programeve radiofonike. Gjithashtu, për qëllimet e kësaj dispozite, "material për programin" ka të njëjtin kuptim si "program";<br><br>(c) shërbime arbitrazhi dhe pajtimi;<br><br>(d) një nga shërbimet ligjore të mëposhtme:<br>(i) përfaqësimi ligjor i një klienti nga një avokat, sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës së Këshillit 77/249/KEE (25) në:<br>— seancë arbitrazhi ose pajtim që mbahet në një shtet anëtar, në një shtet të tretë ose përpara një organi ndërkombëtar arbitrazhi ose pajtimi; ose<br><br>— procedime gjyqësore përpara gjykatave, trupave gjykues ose | | | përmendur në paragrafin "i" të kësaj shkronje, ose kur ka një tregues të qartë dhe shumë mundësi që çështja, me të cilën lidhet konsulenca të bëhet objekti i këtyre procedimeve, me kusht që konsulenca të jepet nga një avokat.<br><br>ç. Shërbime noteriale për verifikim dhe njehsim dokumentesh me origjinalin.<br><br>d. Shërbime ligjore që ofrohen nga administratorë ose kujdestarë të emëruar ose shërbime të tjera ligjore, ofruesit e të cilave emërohen nga një gjykatë ose trup gjykues, ose emërohen me ligj, për të kryer detyra specifike nën mbikëqyrjen e këtyre trupave gjykues ose gjykatave.<br><br>dh. Shërbime përmbarimi dhe shërbime të tjera ligjore, të cilat lidhen, qoftë edhe rastësisht, me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | autoriteteve publike të një shteti anëtar ose një vendi të tretë ose përpara gjykatave, trupave gjykues ose institucioneve ndërkombëtare;<br><br>(ii) konsulenca ligjore që jepet në përgatitje të njërit prej procedimeve të përmendur në pikën (i) të kësaj pike ose kur ka një tregues të qartë dhe shumë mundësi që çështja me të cilën lidhet konsulenca të bëhet objekti i këtyre procedimeve, me kusht që konsulenca të jepet nga një avokat sipas kuptimit të nenit 1 të direktivës 77/249/KEE;<br><br>(iii) shërbime për noterizim dhe njehsim dokumentesh me origjinalin që duhet të ofrohen nga noterët; | | | ushtrimin e autoritetit zyrtar.<br><br>e. Shërbime financiare për shitjen, blerjen apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare, veçanërisht veprimet e autoritetit kontraktor për akumulimin e vlerave monetare apo të kapitalit, si dhe shërbimet e bankës qendrore.<br><br>ë. Shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit, rezultatet e, të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit ose entit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme, dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet ose ent kontraktor.<br><br>f. Kontratat e punësimit.<br><br>g) Shërbimet e mbrojtjes civile, emergjencave civile dhe shërbimet e parandalimit të rreziqeve që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (iv) shërbime ligjore që ofrohen nga administratorë ose kujdestarë të emëruar ose shërbime të tjera ligjore, ofruesit e të cilave emërohen nga një gjykatë ose trup gjykues në shtetin anëtar në fjalë ose emërohen me ligj për të kryer detyra specifike nën mbikëqyrjen e këtyre trupave gjykues ose gjykatave;<br><br>(v) shërbime të tjera ligjore të cilat në shtetin anëtar në fjalë lidhen, qoftë edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar;<br><br>(e) shërbime financiare në lidhje me lëshimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumente të tjera financiare, sipas kuptimit të Direktivës | | | ofrohen nga organizata apo shoqata jo fitimprurëse, përvec shërbimeve të transportit me ambulancë;<br><br>gj) Shërbimet e transportit hekurudhor ose metro;<br><br>h) Shërbimet e fushatave politike kur jepen nga partitë politike në kuadër të fushatave elektorale.<br><br>i) Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve për nevojat e përfaqësive diplomatike konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit;<br><br>j) Rastet e parashikuara në nenet 65, 67, 68, 69, 70 të këtij ligji.<br><br>2. Shërbimet e parashikuara në gërmat ”ë”, ”g” dhe ”h” do të përcaktohen në rregullat e prokurimit publik | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (26), shërbime të bankës qendrore dhe operacionet që kryhen me Instrumentin Evropian të Stabilitetit Financiar dhe Mekanizmin Evropian të Stabilitetit;<br><br>(f) kreditë, të lidhura ose jo me emetimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumenteve të tjera financiare.<br><br>(g) kontrata punësimi;<br><br>(h) shërbime të mbrojtjes, mbrojtjes civile dhe parandalimit të rrezikut, që ofrohen nga organizata ose shoqata jofitimprurëse dhe që mbulohen nga kodet e FPP-së 75250000-3, 75251000-0, | | | 26. “Material i programit” në kuptim të pikës 1, gërma “b”, neni 7 të këtij ligji janë informacionet, idetë, shprehje mendimesh, si dhe vepra të autorësisë në formë audio, ose në formën e imazheve të lëvizshme, me ose pa tinguj, që përbën një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, i cili bëhet i disponueshëm për publikun përmes mediave elektronike, me qëllim për të informuar, argëtuar, edukuar. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Përjashtimet e veçanta<br>8 (2) | Shërbimet sipas përcaktimit në pikën 1, gërma “g” të nenit 7 të LPP-së, janë:<br>a) Shërbimet e shpëtimit dhe ato të zjarrfikëses;<br>b) Shërbimet e zjarrfikëses;<br>c) Shërbimet e parandalimit të zjarrit;<br>d) Shërbimet zjarrfikëse të pyjeve; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 75251100-1,<br>75251110-4,<br>75251120-7,<br>75252000-7,<br>75222000-8,<br>98113100-9 dhe<br>85143000-3, përveç shërbimeve të transportit të pacientit me ambulancë;<br><br>(i) shërbime për transportin publik të pasagjerëve me tren ose metro;<br><br>(j) shërbime të fushatës politike që mbulohen nga kodet e FPP-së 79341400-0, 92111230-3 dhe 92111240-6, kur jepen nga një parti politike në kontekstin e një fushate zgjedhore. | | 8 (3) | e) Shërbimet e shpëtimit;<br>f) Shërbimet e mbrojtjes civile;<br>g) Shërbimet e sigurisë bërthamore;<br>h) Shërbime ambulance.<br><br>Shërbimet sipas përcaktimit në pikën 1, gërma “h” të nenit 7 të LPP-së, janë:<br>a) Shërbime të fushatës reklamuese;<br>b) Prodhimi i filmit propagandistike;<br>c) Prodhimi i videokasetës/videoregjistrimeve propagandistike. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(2) | Në nenin 7 “Përjashtimet e veçanta”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:<br>a. gërma “i” e pikës 1, ndryshon me këtë përmbajtje:<br>i) prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, me vlerë nën kufirin e lartë monetar, për nevojat e përfaqësive diplomatike | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”.<br>b. Pas gërmës “j” shtohet gërma “k” me këtë përmbajtje:<br>“k. lejimin e ofrimit ose të shfrytëzimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike ose ofrimin publikut një ose më shumë shërbime të komunikimeve elektronike,<br>Për qëllimet e kësaj gërme “rrjeti i komunikimeve elektronike publike" dhe "shërbim i komunikimeve elektronike" kanë të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi”. | | |
| Kontratat e shërbimit të shpallura fituese në bazë të së drejtës ekskluzive<br>11 | Kjo direktivë nuk zbatohen për kontratat publike të shërbimit që janë dhënë nga një autoritet kontraktor për një autoritet tjetër kontraktor ose një grupim autoritetesh kontraktore, bazuar në një të drejtë ekskluzive, të cilën ata e gëzojnë sipas një ligji, rregulloreje ose dispozite | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Kontratat e shërbimit, të shpallura fituese në bazë të së drejtës ekskluzive<br>9 | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike të shërbimit dhënë nga një autoritet kontraktor për një autoritet tjetër kontraktor ose bashkim autoritetesh kontraktore, bazuar në një të drejtë ekskluzive, të cilën ata e gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | administrative të botuar, e cila pajtohet me TFBE-në. | | | | | |
| Kontratat publike ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik<br>12 (1) | Një kontratë publike që një autoritet kontraktor i jep një personi juridik dhe që rregullohet nga e drejta private ose publike nuk përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj direktive kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(a) autoriteti kontraktor ushtron mbi personin juridik në fjalë një kontroll që është i ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e veta;<br>(b) më shumë se 80% të veprimtarive të personit juridik të kontrolluar kryhen për zbatimin e detyrave që i janë besuar atij nga autoriteti kontraktor kontrollues ose nga persona juridikë të tjerë | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Kontrata ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik<br>11 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor mund t'i jape një kontratë publike një personi juridik që rregullohet nga e drejta private ose publike, duke mos zbatuar dispozitat e këtij ligji, kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>a) autoriteti ose enti kontraktor ushtron mbi personin juridik kontroll, i cili është i ngjashëm me atë që ushtron mbi departamentet e veta ku më shumë se80% e aktiviteteve të personit juridik të kontrolluar kryhen në zbatim të detyrave që i janë besuar nga autoriteti kontraktor kontrollues ose nga persona të tjerë juridikë që kontrollohen nga ai autoritet kontraktor;<br>b) nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të kontrolluar, por edhe nëse ka, ateherë kjo pjesëmarrje nuk duhet të ketë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | që kontrollohen nga ai autoritet kontraktor; dhe<br>(c) nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të kontrolluar, me përjashtim të formave jokontrolluese dhe jobllokuese të pjesëmarrjes në kapitalin privat, siç kërkohet nga dispozitat ligjore të brendshme, në përputhje me traktatet, të cilët nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar.<br>Një autoritet kontraktor konsiderohet se ushtron mbi një person juridik një kontroll të ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e tij sipas kuptimit të | | | kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij dhe nuk duhet të ushtrojë ushtrojë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar.<br>Një autoritet ose ent kontraktor konsiderohet se ushtron mbi një person juridik një kontroll të ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e tij sipas kuptimit të gërmës “a” të kësaj pike, në rastet kur ai ushtron një ndikim vendimtar si në objektivat strategjike, ashtu edhe në vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar. Ky kontroll mund të ushtrohet edhe nga një person juridik tjetër, i cili në vetvete kontrollohet në të njëjtën mënyrë nga ky autoritet ose ent kontraktor. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | germës a të nënparagrafit të parë, në rastet kur ai ushtron një ndikim vendimtar si në objektivat strategjike ashtu edhe në vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar. Ky kontroll mund të ushtrohet edhe nga një person juridik tjetër, i cili në vetvete kontrollohet në të njëjtën mënyrë nga një autoritet kontraktor. | | | | | |
| 12 (2) | Paragrafi 1 gjithashtu zbatohet për rastet kur një person juridik i kontrolluar, i cili është një autoritet kontraktor, jep një kontratë për autoriteti<br>n kontraktor kontrollues, ose për një person juridik tjetër që kontrollohet nga i njëjti autoritet kontraktor, nëse nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me | | 11 (2) | Pika 1 e këtij neni, zbatohet edhe për rastet kur një person juridik i kontrolluar, i cili është një autoritet ose ent kontraktor, jep një kontratë për autoritetin kontraktor kontrollues, ose për një person juridik tjetër që kontrollohet nga i njëjti autoritet ose ent kontraktor, nëse nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik, të cilit i jepet kontrata publike, me përjashtim të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kapital privat në personin juridik të cilit i jepet kontrata publike, me përjashtim të formave jokontrolluese dhe jobllokuese të pjesëmarrjes me kapital privat që kërkohet nga dispozitat e legjislacionit të brendshëm, në pajtim me traktatet, të cilët nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar në personin juridik të kontrolluar. | | | formave jokontrolluese dhe jobllokuese të pjesëmarrjes me kapital privat që kërkohet nga dispozitat e legjislacionit të në fuqi, të cilët nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar në personin juridik të kontrolluar. | | |
| 12 (3) | Një autoritet kontraktor që nuk ushtron kontroll sipas kuptimit të paragrafit 1 mbi një person juridik që rregullohet nga e drejta private ose publike, gjithsesi, mund të japë një kontratë publike për këtë person juridik pa zbatuar këtë direktivë kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme. | | 11 (3) | Një autoritet ose ent kontraktor që nuk ushtron kontroll sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, mbi një person juridik që rregullohet nga e drejta private ose publike, gjithsesi, mund të japë një kontratë publike për këtë person juridik pa zbatuar këtë ligj, kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme.<br><br>a) autoriteti ose enti kontraktor, së bashku me autoritete ose ente | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Një autoritet kontraktor që nuk ushtron kontroll sipas kuptimit të paragrafit 1 mbi një person juridik që rregullohet nga e drejta private ose publike, gjithsesi, mund të japë një kontratë publike për këtë person juridik pa zbatuar këtë direktivë kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:<br><br>(a) autoriteti kontraktor, së bashku me autoritete kontraktore të tjera ushtron mbi atë person juridik një kontroll të ngjashëm me atë që ata ushtrojnë mbi departamentet e tyre;<br><br>(b) më shumë se 80% të veprimtarive të personit juridik kryhen për zbatimin e detyrave që i janë besuar atij nga autoritetet kontraktore kontrolluese ose nga persona juridikë të tjerë | | | kontraktore të tjera ushtron mbi atë person juridik një kontroll të ngjashëm me atë që ata ushtrojnë mbi departamentet e tyre;<br>b) ku më shumë se 80% të veprimtarive të personit juridik kryhen për zbatimin e detyrave që i janë besuar atij nga autoritetet ose entet kontraktore kontrolluese ose nga persona juridikë të tjerë që kontrollohen nga të njëjtët autoritete ose ente kontraktore; dhe<br>c) nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të kontrolluar, por edhe nëse ka ateherë kjo pjesëmarrje nuk duhet të ketë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij dhe nuk duhet të ushtrojë ushtrojë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | që kontrollohen nga të njëjtët autoritete kontraktore; dhe<br><br>(c) nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të kontrolluar, me përjashtim të formave jokontrolluese dhe jobllokuese të pjesëmarrjes në kapitalin privat, siç kërkohet nga dispozitat ligjore të brendshme, në përputhje me traktatet, të cilët nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar.<br>Për qëllimet e germës a të nënparagrafit të parë, autoritetet kontraktore ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi një person juridik në rastet kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(i) organet vendimmarrëse të | | | Për qëllimet e germës “a” të kësaj pike, autoritetet ose entet kontraktore ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi një person juridik, në rastet kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | personit juridik të kontrolluar përbëhen nga përfaqësues nga të gjitha autoritetet kontraktore pjesëmarrëse. Përfaqësuesit individualë mund të përfaqësojnë disa ose të gjithë autoritetet kontraktore pjesëmarrëse;<br><br>(ii) këto autoritete kontraktore janë në gjendje që bashkërisht të ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi objektivat strategjike dhe vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar; dhe<br><br>(iii) personi juridik i kontrolluar nuk kërkon të përmbushë asnjë interes që bie ndesh me interesat e autoriteteve kontraktore kontrolluese. | | | a) organet vendimmarrëse të personit juridik të kontrolluar përbëhen nga përfaqësues nga të gjitha autoritetet ose entet kontraktore pjesëmarrëse. Përfaqësuesit individualë mund të përfaqësojnë disa ose të gjithë autoritetet ose entet kontraktore pjesëmarrëse;<br>b)këto autoritete ose ente kontraktore janë në gjendje që bashkërisht të ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi objektivat strategjike dhe vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar; dhe<br>c) personi juridik i kontrolluar nuk kërkon të përmbushë asnjë interes që bie ndesh me interesat e autoriteteve kontrolluese. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 (4) | Një kontratë e lidhur ekskluzivisht ndërmjet dy ose më shumë autoritete kontraktore nuk përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj direktive kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(a) kontrata vendos ose zbaton një bashkëpunim ndërmjet autoriteteve kontraktore pjesëmarrëse, me qëllim që të garantojë që shërbimet publike që ato duhet të ofrojnë, të ofrohen për të arritur objektivat e përbashkëta që ata kanë;<br><br>(b) zbatimi i këtij bashkëpunimi rregullohet vetëm nëpërmjet faktorëve që lidhen me interesin publik; dhe<br><br>(c) zbatimi i këtij bashkëpunimi rregullohet vetëm | | 11 (4) | Një kontratë e lidhur ekskluzivisht ndërmjet dy ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nuk përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:<br><br>a) kontrata vendos ose zbaton një bashkëpunim ndërmjet autoriteteve ose enteve kontraktore pjesëmarrëse, me qëllim që të garantojë që shërbimet publike që ato duhet të ofrojnë, të ofrohen për të arritur objektivat e tyre të përbashkëta;<br><br>b) zbatimi i këtij bashkëpunimi rregullohet vetëm nëpërmjet faktorëve që lidhen me interesin publik; dhe<br><br>c) autoritetet ose entet kontraktore pjesëmarrëse kryejnë në tregun e hapur më pak se 20% të veprimtarive që lidhen me bashkëpunimin. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nëpërmjet faktorëve që lidhen me interesin publik; dhe | | | | | |
| 12 (5) | Për përcaktimin e përqindjes së veprimtarive të përmendur në germën b të nënparagrafit të parë të paragrafit 1, germën b të nënparagrafit të parë të paragrafit 3 dhe germën c të paragrafit 4, merret në konsideratë xhiroja totale mesatare ose një veprimtari alternative e përshtatshme që bazohet në masa të tilla si kostot që mbulohen nga personi juridik ose autoriteti kontraktor në lidhje me shërbimet, furnizimet dhe punët për tre vitet që paraprijnë dhënien e kontratës.<br>Kur, për shkak të datës në të cilën personi juridik ose autoriteti | | 11 (5) | Për përcaktimin e përqindjes së veprimtarive të përmendur në gërmën “a” të pikës 1, gërmën “b” të pikës 3 dhe gërmën “c” të pikës 4, merret në konsideratë xhiroja totale mesatare ose një veprimtari alternative e përshtatshme që bazohet në masa të tilla si: kostot që mbulohen nga personi juridik apo autoriteti ose kontraktor në lidhje me shërbimet, furnizimet dhe punët për tre vitet që paraprijnë dhënien e kontratës.<br><br>Nëse xhiroja totale mesatare ose një veprimtari alternative referuar paragrafit të mësipërm nuk janë të disponueshme për tre vitet para dhënies së kontratës ose nuk janë më të vlefshme, për shkak të dates së krijimit të autoritetit ose entit kontraktor, dates së fillimit | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kontraktor përkatës është krijuar ose ka filluar veprimtarinë ose për shkak të një riorganizimi të veprimtarive të tij, xhiroja ose një masë e bazuar mbi një veprimtari alternative, si kostot, nuk janë të disponueshme për tre vitet e fundit ose nuk janë më të rëndësishme, mjafton që të tregohet se matja e veprimtarisë është e besueshme, në veçanti nëpërmjet projektimeve të biznesit. | | | të aktivitetit ose për shkak të riorganizimit të veprimtarisë së tij, mjafton të vërtetohet që përllogaritja e veprimtarisë është e besueshme, sidomos nëpërmjet planeve/projeksioneve të biznesit. | | |
| Kontratat e subvencionuara nga autoritetet kontraktore<br>13 (1) | Kjo direktivë zbatohet për dhënien e kontratave të mëposhtme:<br>(a) kontrata pune që subvencionohen direkt nga autoritetet kontraktore për më shumë se 50% dhe vlera e parashikuar e të | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Kontratat e subvencionuara nga autoritetet kontraktore<br>13 (1) | Ky ligj zbatohet për dhënien e kontratave të mëposhtme:<br><br>a) kontrata pune ku më shumë se 50% e vlerës përballohet nga buxheti i autoriteteve kontraktore dhe vlera e parashikuar e të cilave, pa TVSH, është e barabartë me ose më e madhe se kufiri i ulët monetar, kur këto kontrata | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | cilave, pa TVSH, është e barabartë me ose më e madhe se 5 186 000 euro, kur këto kontrata përfshijnë një nga veprimtaritë e mëposhtme:<br><br>(i) veprimtari të inxhinierisë së ndërtimit, siç paraqiten në shtojcën II,<br><br>(ii) punë ndërtimi për spitale, ambiente sportive, argëtimi dhe për kohën e lirë, ndërtesa shkolle dhe universiteti dhe ndërtesa që përdoren për qëllime administrative;<br><br>(b) kontrata shërbimi që subvencionohen direkt nga autoritetet kontraktore për më | | | përfshijnë një nga veprimtaritë e mëposhtme:<br><br>i. veprimtari të inxhinierisë së ndërtimit, sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik;<br>ii. punë ndërtimi për spitale, ambiente sportive, argëtimi dhe për kohën e lirë, ndërtesa shkolle dhe universiteti, dhe ndërtesa që përdoren për qëllime administrative.<br><br>b) kontrata shërbimi ku më shumë se 50% e vlerës përballohet nga buxheti i autoriteteve kontraktore dhe vlera e parashikuar e të cilave, pa TVSH, është e barabartë ose më e madhe se kufiri i ulët monetar dhe të cilat janë të lidhura me një kontratë për punë, siç përmendet në gërmën “a” të ketij neni.<br><br>Autoritetet kontraktore që përmenden në gërmën “a” dhe “b” të këtij neni garantojnë pajtueshmërinë me këtë ligj, kur ato vetë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shumë se 50% dhe vlera e parashikuar e të cilave, pa TVSH, është e barabartë me ose më e madhe se 207 000 euro dhe të cilat janë të lidhura me një kontratë për punë siç përmendet në germën a.<br><br>Autoritetet kontraktore që ofrojnë subvencionet që përmenden në germën a dhe b të nënparagrafit të parë garantojnë pajtueshmërinë me këtë direktivë kur ato vetë nuk japin kontratën e subvencionuar ose kur ata e japin këtë kontratë për dhe në emër të subjekteve të tjera. | | | nuk japin kontratën e subvencionuar, ose kur ata e japin këtë kontratë, për dhe në emër të subjekteve të tjera. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Kontratat e subvencionuara nga autoritetet kontraktore<br>9 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>9 (2) | Autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat e përcaktuara në LPP dhe këto rregulla, kur vendos të bashkëfinancojë në masën 50% ose më shumë, kontrata pune për:<br>a) veprimtari të inxhinierisë së ndërtimit, sipas sipas kodeve përkatëse në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;<br>b) punë ndërtimi për spitale, ambiente sportive, argëtimi dhe për kohën e lirë, ndërtesa shkolle dhe universiteti, dhe ndërtesa që përdoren për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 9 (3)<br><br>9 (4)<br><br>9 (5) | qëllime administrative.<br><br>Autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat e përcaktuara në LPP dhe këto rregulla, kur vendos të bashkëfinancojë në masën 50% ose më shumë, kontrata shërbimi të lidhura me kontratat e punës të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.<br><br>Vlera e parashikuar e kontratave sipas pikës 1 dhe 2, pa TVSH, duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se kufiri i ulët monetar.<br><br>Procedurat e prokurimit mund të zhvillohen nga autoriteti kontraktor ose nga subjekti që bashkëfinancon.<br><br>Në çdo rast, autoriteti kontraktor është përgjegjës për pajtueshmërinë e procedurave me LPP dhe këto rregulla. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në rastin kur, kontrata e punës përballohet nga buxheti i autoriteteve kontraktore për më pak se 50% e fondit, dhe vlera e parashikuar e të cilave, pa TVSH, është e barabartë ose më e vogël se kufiri i ulët monetar, autoritetet kontraktore detyrohen që në dhënien e këtyre kontratave të respektojnë parimet e përzgjedhjes të parashikuara në nenin 3 të LPP-së.<br><br>Në këtë rast, autoriteti kontraktor duhet të kujdeset që të paktën:<br>a) Të përfshijë parashikimin për bashkëfinancimin në regjistrin e parashikimit;<br>b) Të publikojë njoftimin për dhënien e kontratës sipas parashikimit në LPP dhe këto rregulla;<br>c) Të respektojë parimet e parashikuara në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | LPP për trajtimin e operatorëve ekonomikë;<br>d) Të mbajë evidenca të plota për zbatimin e kontratës. | | |
| Shërbime për kërkim-zhvillim 14 | Kjo direktivë zbatohet vetëm për kontratat publiketë shërbimit për kërkim-zhvillim, që mbulohen nga kodet e FPP-së 73000000-2 deri në 73120000-9, 73300000-5, 73420000-2 dhe 73430000-5 nëse përmbushen të dy kushtet e mëposhtme:<br><br>(a) përfitimet i kreditohen ekskluzivisht autoritetit kontraktor për t'u përdorur prej tij për punët e veta; dhe<br>(b) shërbimi i ofruar paguhet plotësisht nga autoriteti kontraktor. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Përjashtimet e veçanta<br>7 (1) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit për:<br><br>ë. Shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit, rezultatet e, të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit ose entit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme, dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet ose ent kontraktor. | E pjesshme | Këto shërbime do të listohen tek nomenklatura e prokurimit (kodet CPV) që do të miratohen në zbatim të ligjit të ri |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Përjashtimet e veçanta<br>8 (1) | Shërbimet sipas përcaktimit në pikën 1, gërma "ë" të nenit 7 të LPP-së, janë:<br>a) Shërbimet e kërkimit e të zhvillimit, si dhe shërbimet e konsulencës të lidhura me to; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | b) Shërbimet e zhvillimit eksperimental;<br>c) Projektimi dhe ekzekutimi i kërkimeve dhe zhvillimit;<br>d) Studimi i fizibilitetit dhe demonstrimi teknologjik;<br>e) Testimi dhe vlerësimi. | | |
| Mbrojtja dhe siguria<br>15 (1) | Kjo direktivë zbatohet për dhënien e kontratave publike dhe për konkurset e projektimit të organizuara në fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë, me përjashtim të kontratave të mëposhtme:<br>(a) kontratat që përfshihen në fushën e zbatimit të Direktivës 2009/81/KE;<br>(b) kontratat për të cilat Direktiva 2009/81/KE nuk zbatohet sipas neneve 8, 12 dhe 13. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Prokurimet në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë<br>12 (1) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 (2) | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që nuk përjashtohen në zbatim të paragrafit 1, nëse mbrojtja e interesave thelbësore të sigurisë së një shteti anëtar nuk mund të garantohet nga masa më pak shtrënguese, për shembull, duke vendosur kërkesa që synojnë mbrojtjen e informacionit konfidencial që autoriteti kontraktor vë në dispozicion gjatë procedurës së prokurimit të kontratës, siç parashikohet nga kjo direktivë. Gjithashtu dhe në pajtim me germën a të nenit 346, paragrafi 1 të TFBE-së, kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e | | 12 (2)<br><br>12 (3) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, që edhe pse nuk përjashtohen nga zbatimi i pikës 1, në rast se interesat thelbësore të shtetit nuk mund të garantohen me mënyra më pak ndërhyrëse si vendosja e kritereve që synojnë mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit.<br><br>Në rastin e kontratave të përziera që kanë si objekt të tyre prokurimin që mbulohet nga ky ligj dhe prokurimin që mbulohet nga legjislacioni në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë, zbatohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | projektimit që nuk përjashtohen në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, deri në masën që zbatimi i kësaj direktive do të detyronte një shtet anëtar që të jepte ato informacione, publikimi i të cilave konsiderohet në kundërshtim me interesat thelbësore të sigurisë së tij. | | | | | |
| 15 (3) | Kur prokurimi dhe zbatimi i kontratës publike ose konkursit të projektimit deklarohen se janë sekrete ose duhet të shoqërohen nga masa të veçanta sigurie në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi në një shtet anëtar, kjo direktivë nuk zbatohet nëse shteti anëtar ka përcaktuar që interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen nga masa më pak | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Kontrata sekrete, kontrata që kërkojnë masa të veçanta sigurie. 10 | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset projektimit në rast se prokurimi ose zbatimi i tyre është klasifikuar si sekret shtetëror, apo kërkon masa të veçanta sigurie, sipas legjislacionit në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësorë të shtetit me kusht që të jetë përcaktuar që interesat thelbësore në fjalënuk mund të garantohen me vendosjen e kritereve që synojnë mbrojtjen e natyrës të klasifikuar të informacionit | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shtrënguese, si ato që përmenden në nënparagrafin e parë të paragrafit 2. | | | që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit. | | |
| Prokurim i përzier që lidhet me aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë<br>16 (1) | Në rastin e kontratave të përziera që kanë si objekt të tyren elemente prokurimin që mbulohet nga kjo direktivë dhe prokurimin që mbulohet nga neni 346 i TFBE-së ose Direktiva 2009/81/KE, zbatohet ky nen. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Prokurimet në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë<br>12 (3) | Në rastin e kontratave të përziera që kanë si objekt të tyre prokurimin që mbulohet nga ky ligj dhe prokurimin që mbulohet nga legjislacioni në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë, zbatohet legjislacioni në fushën e mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë. | E plotë | |
| 16 (2) | Kur pjesë të ndryshme të një kontrate publike të caktuar janë objektivisht të ndashme, autoritetet kontraktore mund të zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta ose të japin një kontratë të vetme.<br><br>Kur autoritetet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Prokurim i përzier që mbulon disa veprimtari<br>6 (2) | Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të ndara, vendimi për rregullat që zbatohen për secilën prej tyre merret mbi bazën e karakteristikave të veprimtarisë së veçantë përkatëse. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | veçanta, vendimi se cili regjim juridik zbatohet për secilën nga këto kontrata të veçanta merret mbi bazën e karakteristikave të pjesës së veçantë në fjalë.<br><br>Kur autoritetet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për të përcaktuar regjimin juridik të zbatueshëm, zbatohen kriteret e mëposhtme:<br><br>(a) kur një pjesë e një kontrate të caktuar mbulohet nga neni 346 i TFBE-së kontrata mund të jepet pa zbatuar këtë direktivë, me kusht që dhënia e një kontrate të vetme të justifikohet me arsye objektive;<br><br>(b) kur një pjesë e një kontrate të caktuar mbulohet nga Direktiva | | 6 (3) | Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për dhënien e kontratës do të zbatohen rregullat e mëposhtme:<br><br>c) Në rastin e kontratave të përziera që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2009/81/KE kontrata mund të jepet në përputhje me këtë direktivë, me kusht që dhënia e një kontrate të vetme të justifikohet me arsye objektive. Kjo pikë nuk cenon kufijtë monetarë dhe përjashtimet që parashikon kjo direktivë.<br><br>Megjithatë, vendimi për të dhënë një kontratë të vetme nuk mund të merret me qëllimin për të përjashtuar kontratat nga zbatimi i kësaj direktive ose i Direktivës 2009/81/KE. | | | | | |
| 16 (3) | Germa a e nënparagrafit të tretë të paragrafit 2 zbatohet për kontratat e përziera për të cilat do të mund të zbatohen germat a dhe b të atij paragrafi. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare dhe zbatimit te nenit 346 TFBE |
| 16 (4) | Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë | | 6 (4) | Kur pjesë të ndryshme të një kontrate publike të përzier është e pamundur të ndahen, kontrata e vetme | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | objektivisht të pandashme, kontrata mund të jepet pa zbatuar këtë direktivë, kur ajo përfshin elemente për të cilat zbatohet neni 346 i TFBE-së; përndryshe ajo mund të jepet në përputhje me direktivën 2009/81/KE. | | 6 (5) | do të jepet në bazë të rregullave të zbatueshme për objektin kryesor të saj.<br><br>Për kontratat e përziera, të cilat është e pamundur të ndahen, dhe për të cilat është e pamundur të përcaktohet se cila veprimtari është objekti kryesor rregullat e zbatueshme përcaktohen si më poshtë:<br><br>d. Në rastin e kontratave të përziera që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. | | |
| Kontrata publike dhe konkurse projektimi që kanë të bëjnë me aspekte të | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që përfshijnë aspekte të mbrojtjes ose sigurisë, | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Detyrimet ndërkombëtare | Ky ligj nuk zbatohet për kontrata publike që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë, të cilat jepen ose organizohen sipas rregullave | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| mbrojtjes ose të sigurisë, të cilat jepen ose organizohen sipas rregullave ndërkombëtare 17 (1) | të cilat autoriteti kontraktor është i detyruar të japë ose të organizojë në përputhje me procedura prokurimi të ndryshme nga ato që përcaktohen në këtë direktivë, të cilat përcaktohen nga një nga instrumentet e mëposhtme:<br>(a) një marrëveshje ndërkombëtare e lidhur në përputhje me traktatet, midis një shteti anëtar dhe një ose më shumë vendeve të treta dhe nënndarje të tyre që mbulojnë punët, furnizimet ose shërbimet që janë krijuar për zbatimin ose shfrytëzimin e përbashkët të një projekti nga shtetet nënshkruese;<br>(b) një marrëveshje ndërkombëtare ose marrëveshje për stacionimin e trupave dhe për angazhimet e një shteti anëtar ose një vendi të tretë; | | 8 (3) | ndërkombëtare si më poshtë:<br><br>a) marrëveshjeve ndërkombëtare për punë, furnizime apo shërbime me qëllim zbatimin apo përdorimin e përbashkët të një projekti nga palët;<br><br>b) marrëveshjeve ndërkombëtare apo rregullimeve që lidhen me dislokimin e trupave sipas angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në një vend të tretë;<br><br>c) organizatave ndërkombëtare. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (c) një organizatë ndërkombëtare.<br>Të gjitha marrëveshjet dhe mekanizmat e përmendur në germën a të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi i komunikohen Komisionit, i cili mund të konsultohet me Komitetin Këshillimor për Prokurimet Publike që përmendet në nenin 89. | | | | | |
| 17 (2) | Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që përfshijnë aspekte të mbrojtjes ose sigurisë të cilat autoriteti kontraktor i jep në përputhje me rregullat e prokurimit të parashikuara nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, kur këto kontrata publike dhe konkurse projektimi financohen plotësisht nga ajo organizatë ose | | Detyrimet ndërkombëtare<br>8 (2) | Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, të cilat autoriteti ose enti kontraktor jep në përputhje me rregullat e prokurimit që parashikohen nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, kur kontratat publike në fjalë financohen plotësisht nga kjo organizatë ose institucion.<br><br>Në rastin e kontratave publike dhe konkurset e projektimit që bashkëfinancohen në shumicën e tyre nga një | E plotë | . |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ai institucion. Në rastin e kontratave publike dhe konkurseve të projektimit shumica e të cilëve bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit. | | 8 (3) | organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit.<br><br>Ky ligj nuk zbatohet për kontrata publike që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë, të cilat jepen ose organizohen sipas rregullave ndërkombëtare si më poshtë:<br><br>a) marrëveshjeve ndërkombëtare për punë, furnizime apo shërbime me qëllim zbatimin apo përdorimin e përbashkët të një projekti nga palët;<br><br>b) marrëveshjeve ndërkombëtare apo rregullimeve që lidhen me dislokimin e trupave sipas angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në një vend të tretë;<br><br>c) organizatave ndërkombëtare. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Parimet e prokurimit 18 (1) | Autoritetet kontraktore i trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe veprojnë me transparencë dhe në mënyrë proporcionale. Prokurimi nuk përgatitet me qëllim për të shmangur fushën e zbatimit të kësaj direktive ose për të ngushtuar në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Parime te përgjithshme<br>3 (1)<br><br><br><br><br>3 (2) | Autoritetet dhe entet kontraktore i trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese, veprojnë me transparencë, e në mënyrë proporcionale.<br><br>Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht, kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. | E plotë | |
| 18 (2) | Shtetet anëtare marrin masat e përshtatshme për të garantuar që në zbatimin e kontratave publike operatorët ekonomikë veprojnë në | | 3 (3) | Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social dhe të punës,dhe | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | pajtim me detyrimet e zbatueshme në fushat e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës i përcaktuar nga e drejta e Bashkimit Evropian, legjislacioni i brendshëm, kontratat kolektive ose nga dispozitat e legjislacionit ndërkombëtar mjedisor, social dhe të punës, që paraqiten në shtojcën X. | | | dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. | | |
| Operatorët ekonomikë<br>19 (1) | Operatorët ekonomikë, të cilët sipas legjislacionit të shtetit anëtar në të cilin janë themeluar, gëzojnë të drejtën të ofrojnë shërbimet përkatëse, nuk duhet të refuzohen vetëm për shkak se u kërkohet të jenë persona fizikë ose juridikë sipas legjislacionit të shtetit anëtar në të cilin është dhënë kontrata. Megjithatë, në rastet e kontratave publike të shërbimit dhe të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Operatorët ekonomikë<br>4 (32)<br><br><br><br><br><br>14 (1)<br><br><br><br>14 (3) | "Operator ekonomik" është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre.<br><br><br>Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.<br><br>Rregullat mbi mënyrën e e plotësimit të kritereve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi, | E plotë | Ligji nuk parashikon asnje kufizim per operatoret ekonomike pavaresisht vendit te themelimit apo regjistrimit te tyre.<br><br>Te gjithe personat fizike dhe juridike vendas apo te huaj kane te drejte te marrin pjese ne |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | punëve, si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë ose veprimtari të vendosjes dhe të instalimit, personave juridikë mund t'u kërkohet të paraqesin, në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje, emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë. | | | përcaktohen në rregullat e prokurimit publik | | procedurat e prokurimit ne Republiken e Shqiperise. |
| 19 (2) | Grupet e operatorëve ekonomikë, duke përfshirë organizimet e përkohshme, mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit. Autoritetet kontraktore nuk i kërkojnë atyre që të kenë një formë të veçantë ligjore për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.<br>Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktore mund të sqarojnë në | | 14 (2) | Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.<br><br>Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dokumentet e prokurimit mënyrën se si grupet e operatorëve ekonomikë plotësojnë kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësitë teknike dhe profesionale që përmenden në nenin 58, nëse kjo justifikohet nga arsye objektive dhe është proporcionale. Shtetet anëtare mund të përcaktojnë kushte standarde për mënyrën se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet t'i plotësojnë këto kërkesa.<br>Çdo kusht për zbatimin e një kontrate nga këto grupe të operatorëve ekonomikë që është i ndryshëm nga ato që janë vendosur për pjesëmarrësit individualë gjithashtu justifikohet me arsye objektive dhe është proporcional. | | | operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë, në dokumentat e tenderit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 (3) | Pavarësisht paragrafit 2, autoritetet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike pasi të marrin kontratën, nëse ky ndryshim është i nevojshëm për zbatimin e kënaqshëm të kontratës. | | 14 (2) | Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë, në dokumentat e tenderit. | E plotë | |
| Kontratat e rezervuara<br>20 (1) | Shtetet anëtare mund të rezervojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik për organizatat që punësojnë persona me aftësi të kufizuar dhe operatorët ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuar dhe personave në nevojë ose mund të parashikojnë që këto kontrata të zbatohen në kontekstin e programeve për punësimin e personave | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Kontratat e rezervuara<br>15 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik, operatorëve ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuara ose personave në nevojë ose të parashikojnë që këto kontrata të zbatohen në kontekstin e programeve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me kusht që të paktën 30 % e punonjësve të këtyre operatorëve ekonomikë ose programeve janë punëtorë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | me aftësi të kufizuara me kusht që të paktën 30% e këtyre organizatave, operatorëve ekonomikë ose programeve të jenë punonjës me aftësi të kufizuar ose punonjës në nevojë. | | | me aftësi të kufizuara ose punonjës në nevojë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** Kontratat e rezervuara 10 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik, operatorëve ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuara ose personave në nevojë, ose të parashikojnë që këto kontrata të zbatohen në kontekstin e programeve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me kusht që të paktën 30 % e punonjësve të këtyre operatorëve ekonomikë ose programeve janë punëtorë me aftësi të kufizuara ose punonjës në nevojë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. | | |
| 20 (2) | Në ftesën për konkurrim përmendet ky nen. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** 15 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor, i cili do të kryejë një procedurë sipas parashikimeve të këtij neni, duhet ta përcaktojë në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>10 (2)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>10 (3) | Autoriteti ose enti kontraktor, kur vendos të përdorë këtë parashikim, do të vendosë këtë kriter pjesëmarrje për operatorët ekonomikë, duke u rezervuar kontratën vetëm kësaj kategorie operatorësh. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të njoftojë për këtë në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor do të respektojë proceduat e parashikuara në LPP dhe në këto rregulla, për dhënien e këtyre kontratave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Konfidencialitet i<br>21 (1) | Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë direktivë ose në legjislacionin e brendshëm të cilit i nënshtrohet autoriteti kontraktor, në veçanti legjislacioni që lidhet me aksesimin e informacionit dhe pa cenuar detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave të dhëna dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve që përcaktohet në nenet 50 dhe 55, autoriteti kontraktor nuk bën publike informacionet e dërguara nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidencialë, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Konfidencialiteti<br>16 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>16 (2)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>16 (3) | Një operator ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione të caktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare, dhe veçoritë konfidenciale të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje.<br><br>Nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike, mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.<br><br>Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publik dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 16 (4)<br><br>16 (5) | konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në legjislacionin e brendshëm, në veçanti legjislacionin që lidhet me aksesimin e informacionit, dhe pa cënuar detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave të dhëna dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve sipas parashikimeve në këtë ligj, autoriteti ose enti kontraktor nuk bën publike informacionet e dërguara nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor nuk do të bëjë publike informacionin konfidencial të dhënë nga kandidati ose ofertuesi që merr pjesë në negociata ose | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dialog, në një procedurë konkurruese me negocim, procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, dialog konkurrues ose partneritet për inovacion, pa dhënien e pëlqimit të këtij të fundit, me anë të një deklarate me shkrim. Kjo deklaratë nuk mund të përdoret si pengesë për aksesimin e të gjitha informacioneve, por duhet të lidhet vetëm me informacionin në fjalë. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** Deklarimi i informacioni konfidencial 29 (1) | Nëpërmjet listës së informacionit konfidencial, kandidati/ofertuesi deklaron informacionin ose dokumentet që kërkon të mbahet konfidencial dhe argumentet për këtë. Një operator ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione tëcaktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare dhe veçoritë konfidenciale të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 29 (2)<br><br>29 (3) | Nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike, mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.<br><br>Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi. | | |
| 21 (2) | Autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë kërkesa për operatorët ekonomikë, të cilat kanë si qëllim të mbrojnë natyrën konfidenciale të informacionit që autoritetet kontraktore | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>16 (6) | Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë, të ruajnë natyrën konfidenciale të informacionit që autoriteti ose enti kontraktor vë në dispozicion përgjatë procedurës së prokurimit. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | vënë në dispozicion përgjatë procedurës së prokurimit. | | | | | |
| Rregullat e zbatueshme për komunikimin 22 (1) | Shtetet anëtare garantojnë që gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të kësaj direktive, në veçanti dorëzimi elektronik, të kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit në përputhje me kërkesat e këtij neni. Mjetet dhe pajisjet që duhet të përdoren për të komunikuar nëpërmjet mjeteve elektronike dhe karakteristikat e tyre janë jodiskriminuese, përgjithësisht të disponueshme dhe ndërvepruese me produktet TIK që përdoren përgjithësisht dhe nuk kufizojnë hyrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Format e komunikimit<br>17 (1)<br><br><br><br>17 (2) | I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji, kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit.<br>Pwrjashtimisht, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mund të kryhen në formë shkresore, sipas parashikimeve nw rregullat e prokurimit publik.<br>Rastet kur mund tw pwrdoret komunikimi në rrugë shkresore, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.<br><br>Pa cënuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe parashikimet e këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si vijon: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pavarësisht nënparagrafit të parë, autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të kërkojnë mjetet elektronike të komunikimit gjatë procesit të dorëzimit, në situatat e mëposhtme:<br>(a) për shkak të natyrës së specializuar të prokurimit, përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit do të kërkonte vmjete, pajisje ose formate specifike të skedarëve që nuk janë gjerësisht të disponueshme ose që nuk mbështeten nga aplikacionet gjerësisht të disponueshme;<br>(b) aplikacionet që mbështesin formatet e skedarëve që janë të përshtatshëm për përshkrimin e ofertave përdorin formate skedarësh që nuk mund të trajtohen nga asnjë aplikacion tjetër i hapur | | 17 (3) | a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, duhet të jenë në dispozicion të palëve të interesuara.<br><br>b) mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës.<br><br>Në rastet kur, autoriteti ose enti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese,të disponueshme dhe të ndëroperueshme me produkte te teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ose gjerësisht i disponueshëm ose mbrohen nga skema e licencimit të pronësisë dhe nuk mund të bëhen të disponueshme për shkarkim ose përdorim në distancë nga autoriteti kontraktor;<br>(c) përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit do të kërkonte pajisje zyre të specializuara që nuk janë përgjithësisht të disponueshme për autoritetet kontraktore;<br>(d) dokumentet e prokurimit kërkojnë dorëzimin e modeleve ose maketeve, të cilët nuk mund të transmetohen nëpërmjet mjeteve elektronike.<br>Në lidhje me komunikimet për të cilat mjetet elektronike të komunikimit nuk përdoren sipas nënparagrafit të dytë, komunikimi kryhet me postë ose një | | | Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen me Vendim te Këshillit te Ministrave. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>Format e komunikimit<br>11 (1) | Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit si rregull bëhet në përputhje me nenin 17 të LPP-së.<br>Autoriteti ose enti kontraktor mund të komunikojë në formë shkresore, vetëm në rastet e mëposhtme:<br>a) kur për shkak të natyrës së vecantë të prokurimit, për komunikimin elektronik do të nevojiteshin pajisje, mjete apo formate të posacme, të cilat nuk janë të disponueshme gjerësisht apo nuk suportohen nga aplikacione të disponueshme gjerësisht;<br>b) kur aplikacionet që suportojnë formatet e dokumentave që janë të përshtatshme për përshkrimin e ofertave përdorin formate që nuk mund të trajtohen nëpërmjet aplikacioneve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | transportues tjetër i përshtatshëm ose nga një kombinim i postës ose një transportuesi tjetër të përshtatshëm dhe mjeteve elektronike. Pavarësisht nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, autoritetet kontraktore nuk janë të detyruar të kërkojnë mjetet elektronike të komunikimit gjatë procesit të dorëzimit, nëse nevojitet përdorimi i mjeteve joelektronike të komunikimit për shkak të një shkeljeje të sigurisë së mjeteve elektronike të komunikimit ose për mbrojtjen e natyrës veçanërisht sensitive të informacionit, i cili kërkon një nivel mbrojtjeje aq të lart sa nuk mund të garantohet sa duhet duke përdorur vegla dhe pajisje elektronike që janë | | 11 (2) | hapura apo të disponueshme gjerësisht ose janë të regjistruara si pronësi intelektuale dhe nuk mund të vihen në dispozicion për t'u shkarkuar apo përdorur në distancë nga ana e autoritetit ose entit kontraktor;<br>c) kur për përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit nevojiten pajisje zyre të posacme që nuk janë gjerësisht të disponueshme për autoritetet ose entet kontraktore;<br>ç) për procedura prokurimi ose faza të tyre, të cilat kërkojnë dorëzimin e modeleve, projekteve ose maketeve, të cilët nuk mund të transmetohen nëpërmjet mjeteve elektronike.<br><br>Rastet kur mund të përdoret komunikimi në rrugë shkresore sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përgjithësisht të disponueshme për operatorët ekonomikë ose mund të bëhen të disponueshme për ta nëpërmjet mjeteve alternative të aksesit, sipas kuptimit të paragrafit 5.<br>Është përgjegjësia e autoriteteve kontraktore, të cilët në përputhje me nënparagrafin e dytë të këtij paragrafi, gjatë procesit të dorëzimit kërkojnë mjete komunikimi të ndryshme nga mjetet elektronike, që të tregojnë në raportin individual që përmendet në nenin 84 të gjitha arsyet për këtë kërkesë. Aty ku është e zbatueshme autoritetet kontraktore tregojnë në raportin individual arsyet se pse, në zbatim të nënparagrafit të katërt të këtij paragrafi, përdorimi i mjeteve të komunikimit të | | | | | |
| | | | **3. VKM nr. 384, datë 30.06.2021**<br>(1)<br><br>(2) | Të gjitha procedurat e prokurimit publik zhvillohen me mjete elektronike. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ndryshme nga mjetet elektronike është konsideruar i nevojshëm. | | (3) | Në procedurat e prokurimit "Dialog konkurrues", "Partneritet për Inovacion", "Konkurruese me Negocim" dhe Konkurs Projektimi, zhvillohet me mjete elektronike, vetëm faza e parë e procedurës, faza parakualifikuese.<br><br>Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet përkatëse në zbatim të pikës 1, të këtij vendimi.<br><br>Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare". | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(3) | a) Në pikën 1, fjalia e parë ndryshon me këtë përmbajtje:<br><br>*"I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit për zhvillimin e procedurave të prokurimit, kryerjen e ankesave, nënshkrimin dhe zbatimin e kontratës, kryhet duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit".* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Të gjitha veprimet proceduriale të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat të cilat zhvillohen në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, sipas parashikimeve në legjislacionet respektive kryhen vetëm në SPE. Autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë shkëmbejnë komunikim elektronik me anë të këtij sistemi, përmes nënshkrimit elektronik dhe vulës elektronike".*<br><br>b)Paragrafi 2 i pikës 1 shfuqizohet. | | |
| 22 (2) | Pavarësisht paragrafit 1, për komunikime të ndryshme nga ato që lidhen me elementet thelbësore të procedurës së prokurimit, mund të përdoret komunikimi me gojë nëse përmbajtja e komunikimit me gojë dokumentohet deri në | | | | E papërputhur | Direktiva e parashikon kete menyre komunikimi si nje prej alternativave qe mund te perdoren nga Shtetet anetare te BE por nuk eshte nje disppozite e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | një shkallë të mjaftueshme. Për këtë qëllim, elementet thelbësore të një procedure prokurimi përfshijnë dokumentet e prokurimit, kërkesat për pjesëmarrje, shprehjet e interesit dhe ofertat. Në veçanti, komunikimet me gojë me ofertuesit që mund të kenë një ndikim thelbësor në përmbajtjen dhe vlerësimin e ofertave të dokumentohen deri në një shkallë të mjaftueshme dhe me anë të mjeteve të përshtatshme, si procesverbale ose regjistrime audio ose përmbledhje të elementeve kryesore të komunikimit. | | | | | detyrueshme per zbatim.<br><br>Ligji parashikon se format e vetme te komunikimit jane elektronike dhe, vetem ne raste te caktuara, shkresore. |
| 22 (3) | Në të gjitha komunikime, shkëmbimet dhe ruajtjet e informacionit, autoritetet kontraktore garantojnë që të ruhet integriteti i të dhënave | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>17 (4) | Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe konfidencialiteti i ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje. Ata shqyrtojnë përmbajtjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor për dorëzimin e tyre. | | | për pjesëmarrje. Forma e përdorur për komunikim, shkëmbim dhe ruajtjen e informacionit duhet të garantojë se, autoriteti ose enti kontraktor mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor ligjor për dorëzimin e tyre, i përcaktuar nga ky ligj. | | |
| 22 (4) | Për kontratat publike të punëve dhe konkurset e projektimit shtetet anëtare mund të kërkojnë përdorimin e veglave elektronike specifike, si p.sh. mjetet elektronike të modelimit të informacionit ose mjete të ngjashme me to. Në këto raste autoritetet kontraktore ofrojnë mjete alternative aksesi, të parashikuar në paragrafin 5, derisa këto vegla të bëhen përgjithësisht të disponueshme sipas kuptimit të fjalisë së | | | | E papërputhur | Direktiva parashikon nje sere alternativash per vendet anetare per te perzgjedhur llojin e sistemit apo te mjeteve elketronike qe do te perdorin per zhvillimin e procedurave te prokurimit.<br><br>Procedurat e prokurimit ne Shqiperi zhvillohen nepermjet nje |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dytë të nënparagrafit të parë të paragrafit 1. | | | | | sistemi qendror elektronik. |
| 22 (5) | Autoritetet kontraktore, aty ku është e nevojshme, mund të kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që nuk janë përgjithësisht të disponueshme, nëse autoritetet kontraktore ofrojnë mjete alternative aksesi. Autoritetet kontraktore duhet të ofrojnë mjete alternative të përshtatshme aksesi në secilën prej situatave të mëposhtme, kur ato:<br>(a) ofrojnë akses të pakufizuar dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë nëpërmjet mjeteve elektronike për ato mjete dhe pajisje që nga data e shpalljes së njoftimit në përputhje me shtojcën VIII ose që nga data kur dërgohet ftesa për shprehje interesi. Teksti i njoftimit ose ftesës për | | | | E papërputhur | Direktiva parashikon nje sere alternativash per vendet anetare per te perzgjedhur llojin e sistemit apo te mjeteve elketronike qe do te perdorin per zhvillimin e procedurave te prokurimit.<br><br>Procedurat e prokurimit ne Shqiperi zhvillohen nepermjet nje sistemi qendror elektronik. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shprehje interesi specifikon adresën e internetit ku mund të gjenden këto mjete dhe pajisje;<br>(b) garantojnë që ofertuesit që nuk kanë akses në këto vegla dhe pajisje ose asnjë mundësi për t'i marrë ato brenda afateve kohore përkatëse, nëse mungesa e aksesit nuk i atribuohet këtij ofertuesi, të mund të kenë akses në procedurën e prokurimit nëpërmjet përdorimit të dekoratave të përkohshme që vihen në dispozicion pa pagesë në internet; ose<br>(c) mbështesin një rrugë alternative për dorëzimin elektronik të ofertave. | | | | | |
| 22 (6) | Përveç kërkesave të përcaktuara në shtojcën IV, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për veglat dhe pajisjet për | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Format e komunikimit | Pa cënuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe parashikimet e këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen | E plotë | Neni 17 (2) i ligjit parashikon parimet kryesore, nderkohe qe detajet e tjera |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | transmetimin elektronik dhe marrjen e ofertave dhe për marrjen elektronike të kërkesave për pjesëmarrje:<br>(a) informacioni për specifikimet për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, duke përfshirë kodimin dhe vulën ku shënohet ora, u vihet në dispozicion palëve të interesuara.<br>(b) Shtetet anëtare ose autoritetet kontraktore që veprojnë brenda një kuadri të përgjithshëm të përcaktuar nga shteti anëtar në fjalë specifikojnë nivelin e sigurisë që kërkohet për mjetet elektronike të komunikimit në faza të ndryshme të procedurës specifike të prokurimit; niveli është proporcional me rreziqet që e shoqërojnë; | | 17 (2) | e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si vijon:<br><br>a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, duhet të jenë në dispozicion të palëve të interesuara.<br><br>b) mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës.<br><br>Në rastet kur, autoriteti ose enti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese,të disponueshme dhe të ndëroperueshme me | | mbi rregullat e komunikimit do te percaktohen ne rregullat e prokurimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (c) kur shtetet anëtare ose autoritetet kontraktore që veprojnë brenda një kuadri të përgjithshëm të përcaktuar nga shteti anëtar në fjalë, dalin në përfundimin se niveli i rreziqeve, i shqyrtuar sipas germës b të këtij paragrafi është i tillë që kërkohen nënshkrimet elektronike të avancuara siç përcaktohen nga Direktiva 1999/93/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (27), autoritetet kontraktore pranojnë nënshkrime elektronike të avancuara të mbështetura nga një certifikatë e kualifikuar, duke marrë parasysh që këto certifikata të jenë ofruar nga një ofrues i shërbimeve të certifikatës, i cili është pjesë e një liste të besuar të parashikuar në Vendimin e | | 17 (3) | produkte te teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht.<br><br>Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Komisionit 2009/767/KE (28), krijuar me ose pa një pajisje të sigurt për krijimin e nënshkrimit, në pajtim me kushtet e mëposhtme:<br>(i) autoritetet kontraktore përcaktojnë formatin e kërkuar të nënshkrimit të avancuar mbi bazën e formateve të përcaktuara në Vendimin e Komisionit 2011/130/BE (29) dhe caktojnë masat e nevojshme për të përpunuar teknikisht këto formate; në rast se përdoret një format i ndryshëm i nënshkrimit elektronik, transportuesi i dokumentit elektronik përfshin informacione për mundësitë ekzistuese të miratimit, që do të jenë nën përgjegjësinë e shtetit anëtar. Mundësitë e miratimit i lejojnë autoritetit kontraktor që | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të miratojë në internet, pa pagesë dhe në një mënyrë të kuptueshme për folësit joamtarë, nënshkrimin elektronik që ka marrë si nënshkrim elektronik të avancuar, të mbështetur nga një certifikatë e kualifikuar.<br>Shtetet anëtare i përcjellin Komisionit informacionin mbi ofruesin e shërbimit të miratimit, i cili informacionet e marra nga shtetet anëtare, i bën të disponueshme për publikun në internet;<br>(ii) kur një ofertë është nënshkruar me mbështetjen e një certifikate të kualifikuar, që është përfshirë në një listë të besuar, autoritetet kontraktore nuk zbatojnë kërkesa shtesë që mund të pengojnë përdorimin e këtyre nënshkrimeve nga ofertuesit. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në lidhje me dokumentet që përdoren në kontekstin e një procedure prokurimi e që janë nënshkruar nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar ose nga një subjekt tjetër lëshues, autoriteti ose subjekti lëshues kompetent mund të përcaktojnë formatin e nënshkrimit të avancuar në përputhje me kërkesat që përcaktohen në nenin 1, paragrafi 2 të Vendimit 2011/130/BE. Ata marrin masat e nevojshme për të përpunuar këtë format nga ana teknike, për të përfshirë në të informacionin që kërkohet për qëllimet e përpunimit të nënshkrimit në dokumentin përkatës. Këto dokumente përmbajnë në nënshkrimin elektronik | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ose në transportuesin elektronik të dokumentit, informacion për mundësitë ekzistuese të miratimit, që lejojnë miratimin në internet të nënshkrimit elektronik të marrë, pa pagesë dhe në një mënyrë të kuptueshme | | | | | |
| 22 (7) | Komisioni ka autoritetin të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 87 për të ndryshuar detajet teknike dhe karakteristikat e përcaktuara në shtojcën IV, për të marrë në konsideratë zhvillimet teknike.<br>Komisioni ka autoritetin të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 87 për të ndryshuar listën e përcaktuar në germat a-d të nënparagrafit të dytë të paragrafit 1 të këtij neni, kur zhvillimet teknologjike e bëjnë të | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet Komisionit Europian. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | papërshtatshëm përjashtimin e vazhdueshëm nga përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit, ose, në veçanti, kur duhet të parashikohen përjashtime të reja për shkak të zhvillimeve teknologjike.<br>Për të garantuar ndërveprimin e formateve teknike si edhe të standardeve të përpunimit dhe dërgimit të mesazheve, në veçanti në një kontekst ndërkufitar, Komisioni ka kompetencë të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 87 për të përcaktuar përdorimin e detyrueshëm të këtyre standardeve teknike specifike, në veçanti në lidhje me përdorimin e dorëzimit elektronik, katalogëve elektronik dhe mjeteve për njehsimin elektronik, | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | vetëm pasi standardet teknike të jenë testuar krejtësisht dhe efektshmëria e tyre të jetë vërtetuar në praktikë. Komisioni, përpara se të bëjë të detyrueshëm përdorimin e një standardi teknik, shqyrton me kujdes edhe kostot që mund të shkaktohen, në veçanti në lidhje me përshtatjet me zgjidhjet ekzistuese të prokurimit elektronik, duke përfshirë infrastrukturën, proceset ose softuerët. | | | | | |
| Nomenklatura 23 (1) | Çdo referencë për nomenklatura, në kontekstin e prokurimit publik, bëhet duke përdorur "Fjalorin e Përbashkët të Prokurimeve" (FPP), të miratuar nga Rregullorja (KE) nr. 2195/2002. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Fjalori i Përbashkët i Prokurimit<br>20 | Në procedurat e prokurimit publik do të përdoret Fjalori i Përbashkët i Prokurimit, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. | E plotë | VKM e miratuar ne zbatim te ketij neni do te transpozoje Rregulloren 2195/2002 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 23 (2) | Komisionit i jepen kompetenca për miratimin e akteve të deleguara, në përputhje me nenin 87, për të përshtatur kodet e FPP-së që përmenden në këtë direktivë, sa herë që ndryshimet në nomenklaturën e FPP-së duhet të pasqyrohen në këtë direktivë dhe kur nuk nënkuptojnë modifikim të fushës së zbatimit të kësaj direktive. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet kompetencave te Komisionit Europian |
| Konfliktet e interesit<br>24 | Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet kontraktore të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe korrigjuar siç duhet konfliktet e interesit që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Konflikti i interesit<br>19 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi rastet e konfliktit të interesit që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | operatorëve ekonomikë.<br>Koncepti i konflikteve të interesit mbulon të paktën çdo situatë ku punonjës të autoritetit kontraktor ose të ofruesit të shërbimit të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktor, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit ose mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal që mendohet se mund të komprometojë paanësinë dhe pavarësinë e tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit. | | | Personat e angazhuar në procesin e prokurimit dhe ekzekutimin e kontratës nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.<br><br>Situata për konfliktin e interesit vlerësohet sipas parashikimeve të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në kuptim të këtij ligji, mbulonçdo situatë, ku punonjës të autoritetit ose entit kontraktor ose ofruesit të shërbimit të prokurimit që vepron në emër të autoritetit ose entit kontraktor, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit, ose mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal që mund të cënojë paanësinë dhe pavarësinë e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 19 (2) | tyre në vendimmarjen e procedurës së prokurimit.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në tender nëse:<br><br>a) kandidati ose ofertuesi i jep ose premton t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë, që ndërmerr autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit;<br><br>b) kandidati ose ofertuesi është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave.<br><br>c) kandidati ose ofertuesi në të njëjtën procedurë janë në rrethin e personave të lidhur sipas legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë duhet të dokumentohen dhe i komunikohen, menjëherë dhe zyrtarisht, kandidatit ose ofertuesit në fjalë. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>Deklarimi i konfliktit të interesit<br>28 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br>28 (2) | Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë gjendjen mbi konfliktin e interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.<br>Ky deklarim garanton autoritetin/entin kontraktor që ofertuesit/kandidatët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.<br><br>Deklarimi i konfliktit të interesit përmban të dhënat personale të ofertuesit/kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt interesi, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. | | |
| Kushtet që lidhen me GPA- | Deri në masën që ato mbulohen nga shtojcat | | | | E papërputhur | Kjo eshte nje dipozite qe i |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| në dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare<br>25 | 1, 2, 4 dhe 5 dhe Shënimet e Përgjithshme të shtojcës I të Bashkimit Evropian për GPA-në dhe nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare që janë detyruese për Bashkimin Evropian, autoritetet kontraktore u akordojnë punëve, furnizimeve, shërbimeve dhe operatorëve ekonomikë të nënshkruesve të atyre marrëveshjeve një trajtim jo më pak të favorshëm nga ai që u akordohet punëve, furnizimeve, shërbimeve dhe operatorëve ekonomikë të Bashkimit Evropian. | | | | | referohet Bashkimit Europian.<br><br>Per me teper, Shqiperia nuk eshte ende anetare e GPA. |
| Zgjedhja e procedurave<br>26 (1) | Kur japin kontrata publike autoritetet kontraktore zbatojnë procedurat e brendshme që janë rregulluar në pajtim me këtë direktivë, nëse, pa cenuar nenin 32, është shpallur një ftesë për | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Procedurat standarde të prokurimit<br>41 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj. Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:<br>h) procedurë e hapur e thjeshtuar;<br>i) shërbim konsulence. | E plotë | Ne perputhje me kete dispozite ligji ka parashikuar procedurat e hapura te thjeshtuara dhe sherbimin e konsulences si |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | konkurrim në përputhje me këtë direktivë. | | 41 (2) | Për prokurimet me vlerë nën kufirin e ulët monetar, të mallrave, shërbimeve apo punëve, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. | | procedura te brendshme<br><br>Gjithashtu pika 2 u jep autoritetve kontraktore mundesine per te perdorur procedura te thjeshtuara per ato prokurime vlera e te cilav eshte me e vogel se kufirin e ulet (procedurat me vere me te vogel) |
| | | | **5. Projektligj** (13) | Në nenin 41 ” Procedurat standarde të prokurimit”, gërma “f” e pikës 1, me këtë përmbajtje: “f. shërbim konsulence”, shfuqizohet. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>Llojet e procedurave të prokurimit<br>47 (1) | Në përzgjedhjen e kontratave publike, autoriteti/enti kontraktor zbaton konkurset e projektimit dhe procedurat standarde të prokurimit publik, të përcaktuara në nenin 41 të LPP. | | |
| 26 (2) | Shtetet anëtare parashikojnë që autoritetet kontraktore mund të zbatojnë procedura të hapura ose të kufizuara, të rregulluara nga kjo direktivë. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Procedurat standarde të prokurimit<br>41 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj. Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:<br><br>a) procedurë e hapur;<br>b) procedurë e kufizuar; | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>47 (2) | Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:<br>a) procedurë e hapur;<br>b) procedurë e kufizuar; | | |
| 26 (3) | Shtetet anëtare parashikojnë që autoritetet kontraktore mund të zbatojnë partneritete për novacion, të rregulluara nga kjo direktivë. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>41 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj. Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:<br><br>c) partneritet për inovacion; | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>47 (2) | Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:<br><br>c) partneritet për inovacion; | | |
| 26 (4) | Shtetet anëtare parashikojnë që autoritetet kontraktore mund të zbatojnë një | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | Autoritetet kontraktore mund të përdorin një procedurë konkurruese me negocim ose dialog | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | procedurë konkurruese me negocim ose një dialog konkurrues në situatat e mëposhtme:<br>(a) në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet që përmbushin një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:<br>(i) nevojat e autoritetit kontraktor nuk mund të përmbushen pa përshtatjen e zgjidhjeve të gatshme;<br>(ii) ato përfshijnë projektimin ose zgjidhjet novatore;<br>(iii) kontrata nuk mund të jepet pa negocim paraprak për shkak të rrethanave specifike që lidhen me natyrën, kompleksitetin ose përbërjen juridike dhe financiare ose për shkak të rreziqeve që shoqërojnë ato;<br>(iv) specifikimet teknike nuk mund të përcaktohen me përpikëri të | | Rastet e përdorimit të procedurës konkurruese me negocim dhe dialogut konkurrues<br>51 (1) | konkurrues, në rastet e mëposhtme:<br><br>Për kontratat e punëve, mallrave ose shërbimeve që përmbushin një ose disa nga kriteret e mëposhtme:<br>a) kur për të përmbushur nevojat e autoritetit kontraktor është e nevojshme që të përshtaten zgjidhjet ekzistuese qe autoritetet kontraktore i kane në dispozicion;<br>b) kur ato përfshijnë projektim ose zgjidhje inovatore;<br>c) kontrata nuk mund të jepet pa negocim paraprak për shkak të rrethanave specifike që lidhen me natyrën, kompleksitetin, kuadrin juridik dhe financiar ose për shkak të rreziqeve që shoqërojnë ato;<br>ç) specifikimet teknike nuk mund të përcaktohen me saktësinë e duhur nga autoriteti kontraktor bazuar në standarde të miratuara apo duke ju referuar specifikimeve të caktuara, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mjaftueshme nga autoriteti kontraktor duke iu referuar një standardi, shqyrtimit teknik evropian, specifikimit të përbashkët teknik ose referencës teknike sipas kuptimit të pikave 2 deri në 5 të shtojcës VII;<br><br>(b) në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet, kur, në përgjigje të një procedure të hapur ose të kufizuar, dorëzohen vetëm oferta jo të rregullta ose të papranueshme. Në këto situata autoriteteve kontraktore nuk u kërkohet që të shpallin një njoftim kontrate ku ato përfshijnë në procedurë të gjithë dhe vetëm ata ofertues që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenet 57 deri në 64 dhe që, gjatë procedurës paraprake të hapur ose të kufizuar, | | 51 (2) | në përputhje me parashikimet e këtij ligji.<br><br>Për kontratat e punëve, mallrave ose shërbimeve, kur, gjatë një procedure të hapur ose të kufizuar, janë dorëzuar vetëm oferta të parregullta apo te papranueshme. Në këto rrethana, autoritetet kontraktore nuk kanë detyrim që të shpallin një njoftim kontrate për sa kohë që përfshijnë në procedurë të gjithë ofertuesit që përmbushin kriteret për kualifikim të përcaktuara në këtë ligj dhe që, gjatë një procedure të mëparshme të hapur ose të kufizuar, kanë dorëzuar oferta në përputhje me kërkesat formale të procedurës së prokurimit.<br><br>Konsiderohen oferta të parregullta, ato oferta, të cilat nuk janë në përputhje me dokumentat e tenderit si dhe nuk respektojnë detyrimet ligjore që vijnë nga legjislacioni i posaçëm | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kanë dorëzuar oferta në përputhje me kërkesat zyrtare të procedurës së prokurimit.<br>Si të parregullta konsiderohen veçanërisht ato ofertat që nuk janë në pajtim me dokumentet e prokurimit, që janë marrë në dorëzim me vonesë, kur ka prova për marrëveshje të fshehta ose korrupsion, ose për të cilat autoriteti kontraktor ka zbuluar se janë anomalisht të ulëta. Si të papranueshme konsiderohen veçanërisht ato oferta që dorëzohen nga ofertuesit që nuk kanë kualifikimet e kërkuara dhe ofertat çmimi i të cilave tejkalon buxhetin e autoritetit kontraktor, të përcaktuar dhe të dokumentuar përpara fillimit të procedurës së prokurimit. | | | në varësi të objektit të prokurimit.<br>Konsiderohen oferta të papranueshme ato oferta, të cilat:<br><br>a) janë dorëzuar me vonesë;<br>b) janë anomalisht të ulëta dhe të pargumentuara;<br>c) tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të përcaktuar dhe të dokumentuar përpara fillimit të procedurës së prokurimit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 (5) | Ftesa për konkurrim bëhet me anë të një njoftimi të kontratës sipas nenit 49.<br>Kur kontrata jepet me anë të procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim, shtetet anëtare, pavarësisht nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, parashikojnë që autoritetet kontraktore nënqendrore ose kategoritë specifike të tyre mund të bëjnë ftesë për konkurrim nëpërmjet një njoftimi paraprak të informacionit sipas nenit 48, paragrafi 2.<br>Kur ftesa për konkurrim bëhet me anë të një njoftimi paraprak të informacionit sipas nenit 48, paragrafi 2, operatorët ekonomikë, pasi kanë shprehur interesin e tyre në vijim të shpalljes së njoftimit paraprak të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Llojet e njoftimeve<br>55<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>Njoftimi paraprak i informacionit<br>57 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>57 (2) | Njoftimet që përdoren në procedurat e prokurimit publik janë si më poshtë:<br><br>d) Njoftim i kontratës dhe i konkursit të projektimit<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>Autoritetet kontraktore mund të japin informacion për prokurimet e planifikuara nëpërmjet shpalljes së një njoftimi paraprak. Këto njoftime përmbajnë informacionin, i cili përcaktohet në rregullat e prokurimit publik dhe shpallen në sistemin e prokurimit elektronik, sipas parashikimeve në këtë ligj.<br><br>Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negocim, autoritetet kontraktore mund të përdorin njoftimin paraprak si një ftesë për ofertë sipas parashikimeve në këtë ligj, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | informacionit ftohen për të shprehur interesin e tyre me shkrim me anë të një ftese për shprehje interesi, në përputhje me nenin 54. | | | nëse ky njoftim përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:<br><br>a) përmend specifikisht furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës;<br><br>b) përcakton se, kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim, pa shpallje të mëtejshme të një ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të shprehur interesin e tyre;<br><br>c) përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik;<br><br>d) është shpallur nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës, në të cilën është dërguar ftesa.<br><br>Periudha që mbulohet nga njoftimi paraprak i informacionit është maksimumi 12 muaj nga data e shpalljes së njoftimit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Megjithatë, në rastet e kontratave për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, njoftimi paraprak i informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 muaj. | | |
| 26 (6) | Në rastet dhe rrethanat specifike të parashikuara shprehimisht në nenin 32, shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore mund të zbatojnë procedurën e negociuar pa shpallje paraprake të ftesës për konkurrim. Shtetet anëtare nuk lejojnë zbatimin e asaj procedure në asnjë rast tjetër përveç rasteve të përmendura në nenin 32. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>41 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj. Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:<br><br>g) procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; | E plotë | |
| | | | **VKM nr. 285, datë 19.05.2021**<br><br>47 (2) | Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:<br>;<br>f) procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Procedura e hapur<br>27 (1) | Në procedurat e hapura çdo operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë një ofertë në përgjigje të ftesës për konkurrim.<br>Afati minimal për pranimin e ofertave është 35 ditë nga data në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës.<br>Oferta shoqërohet nga informacioni për përzgjedhjen cilësore, që kërkohet nga autoriteti kontraktor. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Procedurë e hapur<br>42 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>42 (2) | Procedura e hapur është procedurë me një fazë, ku mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.<br><br>Në procedurën e hapur, autoriteti ose enti kontraktor shpall një njoftim, sipas përcaktimeve në nenin 56 të këtij ligji, i cili përmban një përshkrim të objektit që do të prokurohet, në përputhje me parashikimet në rregullat e prokurimit publik.<br><br><br>Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 35 ditë nga data, në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Procedura e hapur<br>48 (1) | Procedura e hapur, sipas nenit 42 të LPP, është procedura e prokurimit me një fazë, që mund të përdoret nga çdo | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 48 (2)<br><br>48 (3)<br><br>48 (4) | autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, me një vlerë mbi kufirin e ulët monetar.<br><br>Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me nenin 56 të LPP dhe me këto rregulla.<br><br>Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 42 të LPP. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.<br><br>Pas mbarimit të afatit për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e kontratës, në përputhje me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rregullat e përcaktuara në nenin 42 të LPP, autoriteti/ enti kontraktor hap ofertat, vlerëson dokumentacionin e ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenet 76 e 77 të LPP dhe këtyre rregullave dhe përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87 të LPP. | | |
| | | | Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit<br>16 (1)<br><br>16 (2) | Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.<br><br>Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:<br>- njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit<br>- njoftimin e kontratës; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);<br>- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;<br>- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/ pjesëmarrjes;<br>- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;<br>- deklaratën e konfliktit të interesit;<br>- deklaratën e informacionit konfidencial;<br>- formular i ofertës ekonomike;<br>- sigurimin e ofertës;<br>- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;<br>- njoftimin e fituesit;<br>- formularin e ankesës;<br>- modelin e marrëveshjes kuadër; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 16 (3) | - njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;<br>- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;<br>- sigurimin e kontratës;<br>- njoftimin e lidhjes së kontratës;<br>- njoftimin e anulimit të procedurës;<br><br>Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.<br>a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:<br>- projektin dhe specifikimet;<br>- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;<br>- grafikun e zbatimit; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:<br>- specifikimet teknike;<br>- grafikun e lëvrimit;<br>- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:<br>- termat e referencës;<br>- grafikun e ekzekutimit;<br>- kërkesat për personelin kryesor;<br>kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit. | | |
| 27(2) | Kur autoritetet kontraktore kanë shpallur një njoftim paraprak të informacionit që në | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>42 (3) | Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, kur autoriteti ka shpallur një njoftim paraprak, ose në rastin e kontratave | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | vetvete nuk është përdorur si një mjet për të bërë ftesën për konkurrim, afati kohor minimal për pranimin e ofertave, i përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 të këtij neni, mund të shkurtohet në 15 ditë, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(a) njoftimi paraprak i informacionit përfshin të gjithë informacionin që kërkohet për njoftimin e kontratës në seksionin I të pjesës B të shtojcës V, nëse ai informacion është i disponueshëm në momentin kur shpallet njoftimi paraprak i informacionit;<br>(b) njoftimi paraprak i informacionit është dërguar për publikim nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës në | | | sektoriale kur enti kontraktor ka shpallur një njoftim periodik të informacionit, që në vetvete nuk është përdorur si mjet për të bërë ftesën për konkurrim, afati kohor minimal për pranimin e ofertave, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të shkurtohet në 15 ditë, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:<br><br>a) njoftimi paraprak i informacionit ose periodik i informacionit përfshin të gjithë informacionin e kërkuar sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, në rast se ai informacion është i disponueshëm në momentin kur shpallet njoftimi paraprak;<br><br>b) njoftimi paraprak i informacionit ose periodik i informacionit shpallet nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës së shpalljes së njoftimit të kontratës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të cilën është dërguar njoftimi i kontratës. | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Njoftimi paraprak i informacionit<br>17 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>17 (2) | Pasi autoriteti kontraktor ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim paraprak të informacionit. Njoftimi paraprak i informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.<br><br>Në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimet paraprake të të informacionit qëndrojnë të publikuara:<br>a) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;<br>b) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem dinamik blerjeje, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (3) | Njoftimi paraprak i informacionit përmbantë paktën :<br>- emrin, adresën dhe kontaktet e autoritetit kontraktor;<br>- emrin dhe kontaktet e Personit përgjegjës të prokurimit;<br>- objektin e kontratës dhe kodi përkatës në Fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV);<br>- llojin e procedurës së prokurimit;<br>- tip i kontratës;<br>- vlerën limit të përllogaritur të kontratës; /vlerën limit të përllogaritur për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;<br>- kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;<br>- një përshkrim të shkurtër të kontratës | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (4) | dhe/ose lotet nëse përdoren;<br>- llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;<br>- kohën e përafërt të zhvillimit të procedurës së prokurimit;<br>- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti ose enti kontraktor.<br>Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negocim, kur autoritetet kontraktore e përdorin njoftimin paraprak të informacionit si një ftesë për ofertë sipas parashikimeve në LPP, ky njoftim, veç informacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përmban edhe:<br>- Një përshkrim specifik për furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (5)<br><br>17(6) | - përcaktimin se, kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim, pa shpallje të mëtejshme të një ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të shprehur interesin e tyre.<br>Autoriteti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim si njoftim paraprak të informacionit, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në LPP dhe në këtë nen, dhe është publikuar jo më larg se 12 muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj.<br><br>Për njoftimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 57 të LPP-së dhe pikës 3 të këtij neni, afati i përcaktuar në pikën 5, përllogaritet nga | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (7) | data kur dërgohet ftesa për ofertë.<br><br>Nga afati i përcaktuar në pikën 5, bëjnë përjashtim njoftimet për kontratat për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, ku njoftimi paraprak i informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 muaj. | | |
| 27 (3) | Kur për arsye urgjente të vërtetuara siç duhet nga autoriteti kontraktor, afati kohor i përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 është i pamundur, autoriteti kontraktor mund të caktojë një afat kohor prej jo më pak se 15 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>42 (6) | Përjashtimisht, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor argumenton se për shkak të një gjendje urgjence e ka të pamundur respektimin e afatit te përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, afati i pranimit të ofertave mund të shkurtohet deri në 15 ditë nga data, në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës. Në çdo rast, argumentimi mbi arsyet e shkurtimit të këtij afati do të jepen nga autoriteti ose enti | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kontraktor në njoftimin e kontratës.<br>. | | |
| 27 (4) | Autoriteti kontraktor mund të ulë me pesë ditë afatin kohor për marrjen e ofertave, të përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 të këtij neni, kur ai pranon se ofertat mund të dorëzohen nëpërmjet mjeteve elektronike në përputhje me nënparagrafin e parë të nenit 22, paragrafi 1 dhe nenit 22, paragrafët 5 dhe 6. | | 42 (4)<br><br>42 (5) | Afati për dorëzimin e ofertave, përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të shkurtohet me 5 ditë kur ofertat paraqiten me mjete elektronike.<br><br>Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë. | E plotë | |
| Procedura e kufizuar<br>28 (1) | Në procedurat e kufizuar çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një ftese për konkurrim që përmban informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesët B ose C, sipas rastit, duke | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Procedurë e kufizuar<br>43 (1) | Procedura e kufizuar është procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhënë informacionin për përzgjedhjen cilësore që kërkohet nga autoriteti kontraktor.<br><br>Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës ose, kur përdoret njoftimi paraprak i informacionit si një mënyrë për të ftuar në konkurrim, ftesa për të shprehur interesin. | | 43 (2) | Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data, në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.<br><br>Në rastin e kontratave sektoriale, kur entet kontraktore kanë shpallur një njoftim periodik të informacionit, që është përdorur si mjet për të bërë ftesën për konkurrim, ky afat është jo më pak se 15 ditë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Procedura e kufizuar<br>49 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br>49 (6)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>Përmbajtja e dokumenteve | Procedura e kufizuar, sipas nenit 43 të LPP-së, është procedurë prokurimi me dy faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.<br><br>Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 43 të LPP. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.<br><br><br><br>Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | standarde të tenderit<br>16 (1)<br><br>16 (2) | Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:<br>- njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit<br>- njoftimin e kontratës;<br>- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);<br>- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;<br>- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/ pjesëmarrjes;<br>- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;<br>- deklaratën e konfliktit të interesit;<br>- deklaratën e informacionit konfidencial; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 16 (3) | - formular i ofertës ekonomike;<br>- sigurimin e ofertës;<br>- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;<br>- njoftimin e fituesit;<br>- formularin e ankesës;<br>- modelin e marrëveshjes kuadër;<br>- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;<br>- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;<br>- sigurimin e kontratës;<br>- njoftimin e lidhjes së kontratës;<br>- njoftimin e anulimit të procedurës;<br><br>Informacioni specifik përmban informacion për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.<br>d) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:<br>- projektin dhe specifikimet;<br>- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;<br>- grafikun e zbatimit;<br>- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>e) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:<br>- specifikimet teknike;<br>- grafikun e lëvrimit;<br>- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>f) Informacioni specifik për kontratat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimeve përfshin të paktën:<br>- termat e referencës;<br>- grafikun e ekzekutimit;<br>- kërkesat për personelin kryesor;<br>kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit. | | |
| 28 (2) | Ofertë mund të paraqesin vetëm ata operatorë ekonomikë që ftohen për ta bërë | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | këtë nga autoriteti kontraktor, pasi ky i fundit ka vlerësuar informacionin e paraqitur. Autoritetet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me nenin 65.<br><br>Afati minimal për pranimin e ofertave është 30 ditë që nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë. | | 43 (3) | përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj.<br><br>Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor, për pranimin e ofertave, është 30 ditë nga data, në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.<br><br>Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është të paktën 10 ditë nga data, në të cilën është shpallur ftesa për ofertë. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>49 (2)<br><br><br><br><br><br><br><br><br>49 (3)<br><br><br><br><br>49 (4) | Autoriteti/enti kontraktor në përzgjedhjen e kësaj procedure duhet të mbajë parasysh:<br>a) komplekstitetin e objektit të kontratës;<br>b) gjendjen e tregut;<br>c) numrin e pritshëm të ofertuesve.<br><br>Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 78 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.<br><br>Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 49 (5) | me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.<br><br>Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal. | | |
| 28 (3) | Kur autoritetet kontraktore kanë shpallur një njoftim paraprak të informacionit që në | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>43 (4) | Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, kur autoritetet kontraktore kanë shpallur një njoftim paraprak të informacionit, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | vetvete nuk është përdorur si një mjet për të bërë ftesën për konkurrim, afati kohor minimal për pranimin e ofertave, i përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 2 të këtij neni, mund të shkurtohet në 10 ditë, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(a) njoftimi paraprak i informacionit përfshin të gjithë informacionin që kërkohet në seksionin I të pjesës B të shtojcës V, nëse ai informacion është i disponueshëm në momentin kur shpallet njoftimi paraprak i informacionit;<br>(b) njoftimi paraprak i informacionit është dërguar për publikim nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës. | | | që nuk është përdorur si mjet për të bërë ftesën për pjesëmarrje, afati kohor minimal për pranimin e ofertave apo kërkesave për pjesëmarrje, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, bëhet 10 ditë, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:<br><br>a) njoftimi paraprak i informacionit përfshin të gjithë informacionin që kërkohet sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, në rast se ai informacion është i disponueshëm në momentin kur shpallet njoftimi paraprak i informacionit;<br><br>b) njoftimi paraprak i informacionit është shpallur nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës së shpalljes të njoftimit të kontratës. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Njoftimi paraprak i informacionit<br>17 (1) | Pasi autoriteti kontraktor ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim paraprak të informacionit. Njoftimi paraprak i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (2)<br><br>17 (3) | informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.<br><br>Në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimet paraprake të të informacionit qëndrojnë të publikuara:<br>c) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;<br>d) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem dinamik blerjeje, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes.<br>Njoftimi paraprak i informacionit përmbantë paktën :<br>- emrin, adresën dhe kontaktet e autoritetit kontraktor;<br>- emrin dhe kontaktet e Personit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përgjegjës të prokurimit;<br>- objektin e kontratës dhe kodi përkatës në Fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV);<br>- llojin e procedurës së prokurimit;<br>- tip i kontratës;<br>- vlerën limit të përllogaritur të kontratës; /vlerën limit të përllogaritur për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;<br>- kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;<br>- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;<br>- llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;<br>- kohën e përafërt të zhvillimit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (4) | procedurës së prokurimit;<br>- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti ose enti kontraktor.<br>Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negocim, kur autoritetet kontraktore e përdorin njoftimin paraprak të informacionit  si një ftesë për ofertë sipas parashikimeve në LPP, ky njoftim, veç informacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përmban edhe:<br>- Një përshkrim specifik për furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës;<br>- përcaktimin se, kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim, pa shpallje të mëtejshme të një | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (5)<br><br>17(6)<br><br>17 (7) | ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të shprehur interesin e tyre.<br>Autoriteti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim si njoftim paraprak të informacionit, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në LPP dhe në këtë nen, dhe është publikuar jo më larg se 12 muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj.<br><br>Për njoftimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 57 të LPP-së dhe pikës 3 të këtij neni, afati i përcaktuar në pikën 5, përllogaritet nga data kur dërgohet ftesa për ofertë.<br><br>Nga afati i përcaktuar në pikën 5, bëjnë përjashtim njoftimet për kontratat për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, ku njoftimi paraprak i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 muaj. | | |
| 28 (4) | Shtetet anëtare mund të parashikojnë që të gjitha ose disa kategori specifike të autoriteteve kontraktore nënqendrore mund të caktojnë afatin kohor për pranimin e ofertave nëpërmjet një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor caktohet të paktën 10 ditë nga data e dërgimit të ftesës për ofertë. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>43 (5) | b) afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është jo më pak se 10 ditë nga data, në të cilën është shpallur ftesa për ofertë. | E plotë | |
| 28 (5) | Afati kohor për pranimin e ofertave që | | 43 (6) | Autoriteti kontraktor mund të shkurtojë me 5 ditë afatin | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | parashikohet në paragrafin 2 të këtij neni mund të ulet me pesë ditë kur autoriteti kontraktor pranon që ofertat mund të dorëzohen nëpërmjet mjeteve elektronike në pajtim me nenin 22 paragrafi 1, 5 dhe 6. | | | kohor për marrjen e ofertave, në rast se, ofertat paraqiten me mjete elektronike.<br><br>Në rast se dokumentat e tenderit nuk janë të disponueshme nëpërmjet mjeteve elektronike sipas parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji, afati për dorëzimin e ofertave zgjatet me 5 ditë. | | |
| 28 (6) | Kur nevoja urgjente e vërtetuar siç duhet nga autoritetet kontraktore, i bën të pazbatueshme afatet kohore të përcaktuara në këtë nen, ata mund të caktojnë:<br>(a) një afat kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, i cili është jo më pak se 15 ditë nga data në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës;<br>(b) një afat kohor për pranimin e ofertave, i cili është jo | | | | E papërputhur | Shprehja “nevoja urgjente e vertetuar sic duhet” mund te perbeje shkak per subjektivitet dhe abuzivitet nga autoritetet kontraktore ne kushtet qe do u duhet te pershtaten me nje ligj te ri per procedurat e prokurimit. Ne keto kushte, me qellim shmangien e sjelljeve |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | më pak se 10 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë. | | | | | abuzive, eshte vendosur qe kjo dispozite te transpozohet ne nje moment te mevonshem . |
| Procedura konkurruese me negocim<br>29 (1) | Në procedurat konkurruese me negocim çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një ftese për konkurrim që përmban informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesët B dhe C, duke dhënë informacionin për përzgjedhjen cilësore që kërkohet nga autoriteti kontraktor.<br>Në dokumentet e prokurimit, autoritetet kontraktore identifikojnë objektin e prokurimit duke ofruar një përshkrim të nevojave të tyre dhe karakteristikave të kërkuara për furnizimet, punët ose shërbimet që do të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Procedurë konkuruese me negocim<br>44 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>44 (2) | Procedura konkuruese me negocim është procedurë me faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi që përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.<br><br>Rastet e përdorimit të procedurës konkuruese me negocim përcaktohen në nenin 51 të këtij ligji.<br><br>Në dokumentat e tenderit, autoritetet kontraktore identifikojnë objektin e prokurimit, duke bërë një përshkrim të nevojave të tyre dhe karakteristikave të kërkuara për mallrat, punët ose shërbimet që do të prokurohen, si dhe specifikojnë kriteret e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | prokurohen dhe specifikojnë kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Ata gjithashtu tregojnë se cilët elemente të përshkrimit përcaktojnë kërkesat minimale që duhet të plotësojnë të gjitha ofertat.<br>Informacioni i dhënë duhet të jetë aq i saktë sa t'i mundësojë operatorëve ekonomikë që të identifikojnë natyrën dhe objektin e prokurimit dhe të vendosin nëse do paraqesin kërkesë për pjesëmarrje në procedurë.<br>Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës ose, kur përdoret njoftimi paraprak i informacionit si një mënyrë për të ftuar në konkurrim, ftesa për të | | 44 (3) | përcaktimit të ofertës fituese.<br><br>Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentat e tenderit të gjitha kërkesat që ofertat duhet të plotësojnë.<br><br>Informacioni i dhënë duhet t'i mundësojë operatorëve ekonomikë të identifikojnë natyrën dhe objektin e prokurimit dhe të vendosin nëse do paraqesin kërkesë për pjesëmarrje në procedurë.<br><br>Në procedurat konkuruese me negocim mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data, në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.<br><br>Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shprehur interesin.<br>Afati minimal për pranimin e ofertave fillestare është 30 ditë që nga data në të cilën është dërguar ftesa.<br>Zbatohet neni 28, paragrafi 3 deri në 6. | | | nga autoriteti kontraktor mund të paraqesin ofertë fillestare, e cila shërben si bazë për negocimet vijuese.<br>Autoritetet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Procedurë konkuruese me negocim, në rastet e kontratave të sektorit klasik<br>50 (1)<br><br>50 (2)<br><br>50 (3) | Procedura konkuruese me negocim, është procedura e prokurimit me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet kontraktor, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 51 të LPP.<br><br>Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 78 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.<br><br>Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 44 të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit<br>16 (1)<br><br>16 (2) | LPP. Autoriteti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.<br><br>Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.<br><br>Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:<br>- njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit<br>- njoftimin e kontratës; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);<br>- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;<br>- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/ pjesëmarrjes;<br>- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;<br>- deklaratën e konfliktit të interesit;<br>- deklaratën e informacionit konfidencial;<br>- formular i ofertës ekonomike;<br>- sigurimin e ofertës;<br>- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;<br>- njoftimin e fituesit;<br>- formularin e ankesës;<br>- modelin e marrëveshjes kuadër; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 16 (3) | - njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;<br>- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;<br>- sigurimin e kontratës;<br>- njoftimin e lidhjes së kontratës;<br>- njoftimin e anulimit të procedurës;<br><br>Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.<br>g) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:<br>- projektin dhe specifikimet;<br>- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;<br>- grafikun e zbatimit; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>h) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:<br>- specifikimet teknike;<br>- grafikun e lëvrimit;<br>- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>i) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:<br>- termat e referencës;<br>- grafikun e ekzekutimit;<br>- kërkesat për personelin kryesor;<br>kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit. | | |
| 29 (2) | Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar nga autoriteti kontraktor pas | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>44 (3) | Në procedurat konkurruese me negocim mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shqyrtimit të informacionit të dhënë mund të paraqesin ofertë fillestare që shërben si bazë për negociatat vijuese. Autoritetet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me nenin 65. | | | është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>50 (4)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>50 (5) | Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla.<br><br>Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.<br><br>Autoriteti mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.<br><br>Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 50 (6) | kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.<br><br>Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat tekniko-ekonomiko. Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar nga autoriteti ose enti kontraktor mund të paraqesin ofertë fillestare, e cila shërben si bazë për negocimet vijuese. | | |
| 29 (3) | Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 4, autoritetet kontraktore negociojnë me ofertuesit ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>44 (5) | Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në pikën 7, autoritetet kontraktore negociojnë me ofertuesit ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata kanë dorëzuar, me qëllim përmirësimin e tyre në përmbajtje, me | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kanë dorëzuar, përveç ofertave përfundimtare sipas kuptimit të paragrafit 7, për të përmirësuar përmbajtjen e tyre. Kërkesat minimale dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk janë objekt negocimi. | | | përjashtim të ofertave përfundimtare. Kërkesat minimale dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk janë objekt negocimi. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 50 (7) | Autoriteti kontraktor mund të negociojë individualisht me secilin nga ofertuesit e përzgjedhur deri në përcaktimin e ofertës fituese sipas parashikimit në LPP. Nuk ka një limit për numrin e fazave të njëpasnjëshme të negocimit, me kusht që autoriteti ose kontraktor të ketë publikuar informacionin ose të njoftojë rregullisht të gjithë ofertuesit për cdo fazë të negocimit sipas përcaktimit në nenin 44 të LPP. | | |
| 29 (4) | Autoritetet kontraktore mund të japin kontrata mbi bazën e ofertave fillestare pa negocim kur ata kanë treguar, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për të shprehur interesin, se atyre u rezervohet mundësia për ta bërë diçka të tillë. | | 4 **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”** 4 (6) | Autoritetet kontraktore mund të japin kontrata mbi bazën e ofertave fillestare pa negocim kur në njoftimin e kontratës ose në ftesën për të shprehur interesin, është bërë e ditur se u rezervohet mundësia për ta bërë diçka të tillë. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 (5) | Autoritetet kontraktore sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit gjatë negocimit. Në veçanti, ato nuk duhet t'i bëjnë të ditura informacionet në mënyrë diskriminuese, që mund t'u sjellë avantazhe disa ofertuesve mbi të tjerët. Ata informojnë me shkrim të gjithë ofertuesit, ofertat e të cilëve nuk janë shkualifikuar sipas paragrafit 6, për çdo ndryshim në specifikimet teknike ose në dokumente të tjera të prokurimit, përveç atyre që përcaktojnë kërkesat minimale. Pas këtyre ndryshimeve autoritetet kontraktore parashikojnë një kohë të mjaftueshme që ofertuesit të modifikojnë dhe të dorëzojnë përsëri | | 44 (7) | Autoritetet kontraktore sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit gjatë negocimit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve. Ata informojnë me shkrim të gjithë ofertuesit, ofertat e të cilëve kalojnë në fazën tjetër, për çdo ndryshim në specifikimet teknike ose në dokumente të tjera të tenderit, përveç atyre që përcaktojnë kërkesat minimale. Pas këtyre ndryshimeve autoritetet kontraktore parashikojnë një një afat jo më pak se 5 ditë,që ofertuesit të modifikojnë dhe të dorëzojnë përsëri ofertat e ndryshuara, sipas rastit.<br><br>Autoritetet kontraktore nuk u tregojnë pjesëmarrësve të tjerë informacionin konfidencial të komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ofertat e ndryshuara, sipas rastit.<br>Në përputhje me nenin 21 autoritetet kontraktore nuk u tregojnë pjesëmarrësve të tjerë informacionin konfidencial të komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në negociata, pa pëlqimin e këtij të fundit. Kjo marrëveshje nuk bëhet në formën e një heqje dorë të përgjithshme por bëhet duke iu referuar komunikimit të synuar të informacionit specifik. | | | negocime, pa pëlqimin e këtij të fundit. | | |
| 29 (6) | Procedurat konkurruese me negocim mund të zhvillohen në fazat të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen, duke përdorur kriteret e shpalljes së kontratës fituese, të specifikuara në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose në | | 44 (8) | Procedurat konkurruese me negocim mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen. Autoriteti kontraktor bën me dije nëse do ta përdorë këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | një dokument tjetër prokurimi. Autoriteti kontraktor tregon nëse do ta përdorë këtë mundësi në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose në një dokument tjetër prokurimi. | | | | | |
| 29 (7) | Kur autoriteti kontraktor synon të mbyllë negociatat, ai informon ofertuesit që kanë mbetur dhe cakton një afat të përbashkët për të dorëzuar çdo ofertë të re ose të rishikuar. Ai verifikon që ofertat përfundimtare janë në pajtim me kërkesat minimale dhe me nenin 56, paragrafi 1, vlerëson ofertat përfundimtare mbi bazën e kritereve për shpalljen e kontratës fituese dhe në përputhje me nenin 66 deri në 69 jep kontratën. | | 44 (9) | Kur autoriteti kontraktor synon të mbyllë negociatat, ai informon ofertuesit që kanë mbetur dhe cakton një afat të përbashkët për të dorëzuar çdo ofertë të re ose të rishikuar. Autoriteti kontraktor vlerëson ofertat përfundimtare dhe verifikon në rast se ato janë në përputhje me kërkesat minimale dhe me parimet e përgjithshme të përzgjedhjes, dhe shpall fituesin sipas parashikimeve në këtë ligj. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dialogu konkurrues 30 (1) | Në dialogët konkurrues çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit të kontratës duke dhënë informacionin për përzgjedhjen cilësore që kërkohet nga autoriteti kontraktor. Afati minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës. Në dialog mund të marrin pjesë vetëm operatorët ekonomikë që ftohen nga autoriteti kontraktor, pasi ky i fundit ka shqyrtuar informacionin e dhënë. Autoritetet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me nenin 65. Kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi në | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”** Dialogu konkurrues 45 (1) | Dialogu konkurrues është procedurë që zhvillohet në tre faza, faza parakualifikuese, faza e dialogut dhe faza e paraqitjes së ofertës përfundimtare, ku çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit të kontratës apo edhe të njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi në rastin e kontratave sektoriale, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti ose enti kontraktor.<br><br>Kushtet e përdorimit të dialogut konkurues nga autoritetet kontraktore, përcaktohen në nenin 51 të këtij ligji. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përputhje me nenin 67, paragrafi 2. | | 45 (3)<br><br>45 (4)<br><br>45 (5) | Për kontratat sektoriale, kur si mënyrë për të bërë ftesën për konkurrim përdoret një njoftim periodik informacioni, ky afat në çdo rast nuk është më pak se 15 ditë.<br><br>Në procedurën e dialogut konkurues, ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati kohor minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është 20 ditë nga data, në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.<br><br>Në fazën e dialogut mund të marrin pjesë vetëm operatorët ekonomikë që ftohen nga autoriteti ose enti kontraktor, pasi ky i fundit i ka kualifikuar në fazën e parë. Autoritetet ose entet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi, sipas parashikimeve në këtë ligj. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Dialogu konkurrues<br>51 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>51 (2)<br><br><br><br><br><br>51 (3) | Dialogu konkurrues, është procedura e prokurimit me tre faza, faza parakualifikuese, faza e dialogut dhe faza e paraqitjes së ofertës përfundimtare, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor vetëm në rastet e parashikuara në nenin 51 të LPP.<br><br>Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 78 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.<br><br>Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | <br><br><br><br><br><br>51 (4)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>51 (5) | shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit.<br><br>Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 45 të LPP. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.<br><br>Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit<br>16 (1)<br><br>16 (2) | synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.<br><br>Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.<br><br>Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:<br>- njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit<br>- njoftimin e kontratës;<br>- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);<br>- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;<br>- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/ pjesëmarrjes; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;<br>- deklaratën e konfliktit të interesit;<br>- deklaratën e informacionit konfidencial;<br>- formular i ofertës ekonomike;<br>- sigurimin e ofertës;<br>- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;<br>- njoftimin e fituesit;<br>- formularin e ankesës;<br>- modelin e marrëveshjes kuadër;<br>- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;<br>- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;<br>- sigurimin e kontratës; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 16 (3) | - njoftimin e lidhjes së kontratës;<br>- njoftimin e anulimit të procedurës;<br><br>Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.<br>j) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:<br>- projektin dhe specifikimet;<br>- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;<br>- grafikun e zbatimit;<br>- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>k) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:<br>- specifikimet teknike;<br>- grafikun e lëvrimit; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>l) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:<br>- termat e referencës;<br>- grafikun e ekzekutimit;<br>- kërkesat për personelin kryesor;<br>kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit. | | |
| 30 (2) | Autoritetet kontraktore përcaktojnë nevojat dhe kërkesat e tyre në njoftimin e kontratës dhe i përcaktojnë këto nevoja dhe kërkesa në këtë njoftim dhe/ose në një dokument përshkrues. Njëkohësisht në po këto dokumente, ata përcaktojnë dhe përkufizojnë edhe kriteret e përzgjedhura për shpalljen e kontratës fituese dhe | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>45 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor përcakton nevojat dhe kërkesat e tyre në njoftimin e kontratës dhe/ose në ftesën për ofertë. Njëkohësisht, në këto dokumente, përcaktojnë edhe kriteret e përzgjedhura për përcaktimin e ofertës fituese, si dhe caktojnë një periudhë kohore, brenda së cilës duhet të përfundojë ky proces. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>51 (3) | Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | caktojnë një afat simbolik. | | | elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. | | |
| 30 (3) | Autoritetet kontraktore fillojnë dialogun me pjesëmarrësit e përzgjedhur në përputhje me dispozitat përkatëse të neneve 56 deri 66, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojave të tyre. Ata mund t'i diskutojnë të gjitha aspektet e prokurimit me pjesëmarrësit e përzgjedhur, gjatë këtij dialogu.<br>Gjatë dialogut, autoritetet kontraktore sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Ato sidomos nuk japin informacione në | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>45 (6) | Autoriteti ose enti kontraktor fillon dialogun me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në këtë ligj, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Ata mund t'i diskutojnë të gjitha aspektet e prokurimit me pjesëmarrësit e përzgjedhur, gjatë këtij dialogu.<br><br>Gjatë dialogut, autoriteti ose enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mënyrë diskriminuese, të cilat mund t'u sjellin më tepër avantazhe disa pjesëmarrësve krahasuar me të tjerët. Në përputhje me nenin 21, autoritetet kontraktore nuk u tregojnë pjesëmarrësve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në dialog, pa pëlqimin e këtij të fundit. Kjo marrëveshje nuk bëhet në formën e një heqje dorë të përgjithshme por bëhet duke iu referuar komunikimit të synuar të informacionit specifik. | | | Autoriteti ose enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në dialog, pa pëlqimin e këtij të fundit. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>51 (7)<br><br>51 (8) | Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur në fazën e dialogut. Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar nga autoriteti ose enti kontraktor mund të marrin pjesë në këtë fazë.<br><br>Në këtë procedurë, kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi, sipas parashikimeve në LPP.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor fillon dialogun individual | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 51 (9) | me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në LPP, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Ata mund t'i diskutojnë të gjitha aspektet e prokurimit me pjesëmarrësit e përzgjedhur, gjatë këtij dialogu.<br><br>Dialogu mund të zhvillohet në disa faza për të ulur numrin e zgjidhjeve që do të diskutohen në fazat pasardhëse të dialogut, kur autoriteti/enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë. Autoriteti/enti kontraktor nëse nuk bie dakord me të gjithë pjesëmarrësit për afatin ndërmjet fazave, cakton një afat të arsyeshëm dhe njofton pjesëmarrësit në kohë. Autoriteti/enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve. Autoriteti/enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në dialog, pa pëlqimin e këtij të fundit. | | |
| 30 (4) | Dialogët konkurrues mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e zgjidhjeve që do të diskutohen gjatë fazës dialogut, duke përdorur kriteret për shpalljen e kontratës fituese, të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në dokumentin përshkrues. Autoriteti kontraktor e cilëson në njoftimin e kontratës ose në dokumentin përshkrues nëse do ta përdorë këtë mundësi. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** 45 (7) | Dialogu mund të zhvillohet në faza të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e zgjidhjeve që do të diskutohen gjatë fazës së dialogut bazuar në kriteret e përzgjedhjes. Autoriteti ose enti kontraktor e cilëson në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë, nëse do ta përdorë këtë mundësi. | E plotë | |
| | | | **VKM nr. 285, datë 19.05.2021** 51 (9) | Autoriteti/enti kontraktor fillon dialogun individual me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në LPP, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Ata mund t'i diskutojnë të gjitha aspektet e prokurimit me pjesëmarrësit e përzgjedhur, gjatë këtij dialogu.<br><br>Dialogu mund të zhvillohet në disa faza për të ulur numrin e zgjidhjeve që do të diskutohen në fazat pasardhëse të dialogut, kur autoriteti/enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë. | | |
| 30 (5) | Autoriteti kontraktor e vazhdon dialogun deri në identifikimin e zgjidhjes ose zgjidhjeve, që mund të plotësojnë nevojat e tij. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>45 (8) | Autoriteti ose enti kontraktor e vazhdon dialogun deri në identifikimin e zgjidhjes ose zgjidhjeve, që mund të plotësojnë nevojat e tij. | E plotë | |
| | | | **VKM nr. 285, datë 19.05.2021**<br>51 (10) | Gjatë fazës së dialogut, autoriteti/enti kontraktor, synon që ofertat të qartësohen, specifikohen dhe të përshtaten sipas kërkesës dhe nevojës së autoritetit/entit kontraktor. Megjithatë, ky qartësim, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | specifikim, përshtatje ose informacion shtesë nuk duhet të përfshijë ndryshime në aspektet kryesore të ofertës, duke përfshirë nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues.<br><br>Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohej një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit. | | |
| 30 (6) | Pasi të kenë deklaruar mbylljen e dialogut dhe pasi të kenë informuar pjesëmarrësit që kanë mbetur, autoritetet kontraktore i kërkojnë secilit prej tyre, të paraqesin ofertat përfundimtare në bazë | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>45 (9) | Pasi të ketë deklaruar mbylljen e dialogut dhe pasi të kenë informuar pjesëmarrësit që kanë mbetur, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon secilit prej tyre, të paraqesë ofertat përfundimtare në bazë të zgjidhjes ose zgjidhjeve të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të zgjidhjes ose zgjidhjeve të paraqitura dhe të specifikuara gjatë dialogut. Këto oferta përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar dhe të nevojshëm për realizimin e projektit. Këto oferta mund të qartësohen, specifikohen dhe të rregullohen sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Megjithatë, ky qartësim, specifikim, rregullim ose informacionet shtesë mund të mos përfshijnë ndryshime në aspektet kryesore të ofertës ose të prokurimit publik, duke përfshirë nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose dokumentin përshkrues, kur ndryshime të këtyre aspekteve, nevojave dhe kërkesave kanë gjasa të shtrembërojnë konkurrencën ose të | | | paraqitura dhe të specifikuara gjatë dialogut. Këto oferta përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar dhe të nevojshëm për realizimin e projektit.<br><br>Këto oferta mund të qartësohen, specifikohen dhe të përshtaten sipas kërkesës së autoritetit ose entit kontraktor. Megjithatë, ky qartësim, specifikim, përshtatje ose informacion shtesë nuk mund të përfshijë ndryshime në aspektet kryesore të ofertës, duke përfshirë nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues. | | |
| | | | **VKM nr. 285, datë 19.05.2021** 51 (11) | Pasi të ketë arritur në një zgjidhje të kënaqshme, autoriteti/enti kontraktor deklaron mbylljen e dialogut dhe informon pjesëmarrësit që kanë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kenë efekt diskriminues. | | 51 (12) | mbetur për përfundimin e kësaj faze.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor i kërkon secilit prej pjesëmarrësve të mbetur në garë, të paraqesin ofertat përfundimtare në bazë të zgjidhjes ose zgjidhjeve të paraqitura dhe të specifikuara gjatë dialogut. Këto oferta përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar dhe të nevojshëm për realizimin e projektit. | | |
| 30 (7) | Autoritetet kontraktore shqyrtojnë ofertat e marra mbi bazën e kritereve për shpalljen e kontratës fituese, të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në dokumentin përshkrues.<br>Me kërkesë të autoritetit kontraktor, ofertuesit që ka dorëzuar ofertën me raportin më të mirë çmim-cilësi, në përputhje me nenin 67, mund t'i kërkohet, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>45 (10) | Autoriteti ose enti kontraktor shqyrton dhe vlerëson ofertat e marra mbi bazën e kritereve të përzgjedhjes, të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë.<br><br>Me kërkesë të autoritetit ose entit kontraktor, ofertuesit që ka dorëzuar ofertën me raportin më të mirë çmim-cilësi, sipas parashikimeve në këtë ligj, mund t'i kërkohet, përmes negociatave, të konfirmojë angazhimet financiare ose | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmes negociatave, të konfirmojë angazhimet financiare ose kushtet e tjera që përmban oferta, duke finalizuar kushtet e kontratës, nëse kjo nuk ndikon në ndryshimin e aspekteve thelbësore të ofertës ose të prokurimit publik, duke përfshirë nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në dokumentin përshkrues dhe nuk rrezikon shtrembërimin e konkurrencës ose nuk shkakton diskriminim. | | | kushtet e tjera që përmban oferta, duke finalizuar kushtet e kontratës, nëse kjo nuk ndikon në ndryshimin e aspekteve thelbësore të ofertës, nevojave dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 51 (13) | Autoriteti/enti kontraktor shqyrton dhe vlerëson ofertat e marra dhe mund t'i kërkojë ofertuesit që ka dorëzuar ofertën me raportin më të mirë çmim-cilësi, sipas parashikimeve në LPP, përmes negociatave, të konfirmojë angazhimet financiare ose kushtet e tjera që përmban oferta, duke finalizuar kushtet e kontratës, nëse kjo nuk ndikon në ndryshimin e aspekteve thelbësore të ofertës, nevojave dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë, të cilat mund të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues. | | |
| 30 (8) | Autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë çmimet ose pagesat për pjesëmarrësit në dialog. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>45 (11) | Autoriteti ose enti kontraktor mund të parashikojë pagesa për pjesëmarrësit në dialog, në varësi të natyrës dhe kostos që ka objekti i prokurimit. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>51 (11) | Nëse autoriteti/enti kontraktor ka parashikuar pagesa për pjesëmarrësit në dialog, në varësi të natyrës dhe kostos që ka objekti i prokurimit, kur një gjë e tillë është njoftuar në njoftimin e kontratës dhe/ose ftesën për ofertë, do ta kryejë pagesën pas nënshkrimit të kontratës me ofertuesin fitues. | | |
| Partneritet për novacion<br>31 (1) | Në partneritetet për novacion çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit të kontratës, duke dhënë informacionin për përzgjedhjen cilësore | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Partneriteti për inovacion<br>46 (1) | Partneriteti për inovacion është procedurë me faza, ku çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit të kontratës, duke dhënë informacionin që kërkohet nga autoriteti ose enti kontraktor. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | që kërkohet nga autoriteti kontraktor.<br>Në dokumentet e prokurimit, autoriteti kontraktor identifikon nevojën për një produkt, shërbim ose punë novatore, e cila nuk mund të përmbushet duke blerë produktet, shërbimet ose punët që gjenden në treg. Aty tregohet se cilët elemente të përshkrimit përcaktojnë kërkesat minimale që duhet të plotësojnë të gjitha ofertat.<br>Informacioni i dhënë duhet të jetë aq i saktë sa t'i mundësojë operatorëve ekonomikë që të identifikojnë natyrën dhe objektin e zgjidhjes së kërkuar dhe të vendosin nëse do paraqesin kërkesë për pjesëmarrje në procedurë.<br>Autoriteti kontraktor mund të vendosë që të krijojë partneritet për novacion me një | | | Në dokumentat e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor identifikon nevojën për një produkt, shërbim ose punë inovatore, e cila nuk mund të përmbushet duke blerë produktet, shërbimet ose punët që gjenden në treg.<br>Në dokumentat e tenderit përcaktohen kërkesat minimale që duhet të plotësojnë të gjitha ofertat.<br>Informacioni i dhënë duhet t'i mundësojë operatorëve ekonomikë që të identifikojnë natyrën dhe objektin e zgjidhjes së kërkuar dhe të vendosin nëse do paraqesin kërkesë për pjesëmarrje në procedurë.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë që të krijojë partneritet për inovacion me një partner ose disa partnerë që kryejnë veprimtari të veçanta kërkimi dhe zhvillimi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | partner ose disa partnerë që kryejnë veprimtari të veçanta kërkimi dhe zhvillimi<br>.<br>Afati minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data në të cilën dërgohet njoftimi i kontratës. Në procedurë mund të marrin pjesë vetëm operatorët ekonomikë që ftohen nga autoriteti kontraktor, pasi ky i fundit ka shqyrtuar informacionin e dhënë. Autoritetet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me nenin 65. Kontratat jepen vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi në përputhje me nenin 67. | | 46(2)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>46 (3) | Në procedurën e partneritetit për inovacion, mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data, në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.<br>Për kontratat sektoriale, kur si mënyrë për të bërë ftesën për konkurrim përdoret një njoftim periodik informacioni, ky afat në çdo rast nuk është më pak se 15 ditë.<br><br>Në procedurën e partneritetit për inovacion, ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, afati kohor minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është 20 ditë nga data, në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi.<br><br>Ofertë fillestare mund të paraqesin vetëm operatorët ekonomikë që ftohen nga | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 46 (4) | autoriteti ose enti kontraktor, pasi ky i fundit i ka kualifikuar në fazën e parë. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, sipas parashikimeve të këtij ligji.<br><br>Kontratat jepen vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi, sipas parashikimeve në këtë ligj. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Partneritet për novacion<br>52 (1) | Partneriteti për inovacion, është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor vetëm në rastet e parashikuara në nenin 46 të LPP, kur si rregull mallrat, punët ose shërbimet që kërkohen të prokurohen nuk janë produkte të gatshme në treg dhe produkti i përfituar në përfundim të kontratës është një inovacion.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor duhet të bëjë të qartë në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 52 (2) | dokumentet e tenderit, faktin që partneriteti për inovacion ka si qëllim zhvillimin e një produkti, shërbimi apo pune inovatore dhe blerjen më pas të mallrave, shërbimeve ose punëve që rezultojnë prej tyre nëse ato përkojnë me nivelet e performancës dhe kostot minimale të dakordësuara ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe pjesëmarrësve. Në këtë kuadër, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë edhe objektiva të ndërmjetme, të cilat duhet të arrihen nga partnerët/kontraktuesit dhe pagesat përkatëse që do të bëhen sipas një plani të caktuar.<br><br>Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 78 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.<br><br>Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 52 (3)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>52 (4) | sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, në përgjigje të njoftimit të kontratës apo edhe të njoftimit periodik të informacionit në rastin e kontratave sektoriale, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti/enti kontraktor.<br><br>Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 46 të LPP. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit<br>16 (1)<br><br>16 (2) | prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.<br><br>Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.<br><br>Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:<br>- njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit<br>- njoftimin e kontratës;<br>- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);<br>- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;<br>- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/ pjesëmarrjes; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;<br>- deklaratën e konfliktit të interesit;<br>- deklaratën e informacionit konfidencial;<br>- formular i ofertës ekonomike;<br>- sigurimin e ofertës;<br>- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;<br>- njoftimin e fituesit;<br>- formularin e ankesës;<br>- modelin e marrëveshjes kuadër;<br>- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;<br>- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;<br>- sigurimin e kontratës; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 16 (3) | - njoftimin e lidhjes së kontratës;<br>- njoftimin e anulimit të procedurës;<br><br>Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve.<br>m) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:<br>- projektin dhe specifikimet;<br>- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;<br>- grafikun e zbatimit;<br>- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>n) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:<br>- specifikimet teknike;<br>- grafikun e lëvrimit; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.<br>o) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:<br>- termat e referencës;<br>- grafikun e ekzekutimit;<br>- kërkesat për personelin kryesor;<br>kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit. | | |
| 31 (2) | Partneriteti për novacion ka si qëllim zhvillimin e produktit, shërbimit ose punëve novatore dhe blerjen më pas të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që rezultojnë prej tyre nëse ato përkojnë me nivelet e realizimit dhe kostot minimale të rëna dakord ndërmjet autoriteteve kontraktore dhe pjesëmarrësve. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>46 (5) | Partneriteti për inovacion ka si qëllim zhvillimin e një produkti, shërbimi apo pune inovatore dhe blerjen më pas të mallrave, shërbimeve ose punëve që rezultojnë prej tyre nëse ato përkojnë me nivelet e performancës dhe kostot minimale të dakordësuara ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe pjesëmarrësve. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** | Autoriteti/enti kontraktor duhet të bëjë të qartë në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Partneriteti për novacion strukturohet në faza të tjera pas ndjekjes së hapave në fazën e kërkimit dhe novacionit, të cilat mund të përfshijnë prodhimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose përfundimin e punëve. Partneriteti për novacion vendos objektiva të ndërmjetme të cilat duhet të arrihen nga partnerët dhe siguron që pagesa të bëhet sipas késteve të përshtatshme. Bazuar mbi këto objektiva, autoriteti kontraktor mund të vendosë pas çdo faze që ta përfundojë partneritetin për novacion, ose në rastin e partneritetit për novacion midis disa partnerëve, të ulë numrin e partnerëve duke zgjidhur kontratat individuale, me kusht | | 52 (1) | dokumentet e tenderit, faktin që partneriteti për inovacion ka si qëllim zhvillimin e një produkti, shërbimi apo pune inovatore dhe blerjen më pas të mallrave, shërbimeve ose punëve që rezultojnë prej tyre nëse ato përkojnë me nivelet e performancës dhe kostot minimale të dakordësuara ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe pjesëmarrësve. Në këtë kuadër, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë edhe objektiva të ndërmjetme, të cilat duhet të arrihen nga partnerët/kontraktuesit dhe pagesat përkatëse që do të bëhen sipas një plani të caktuar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | që autoriteti kontraktor të ketë cilësuar në dokumentet e prokurimit, këto mundësi dhe kushtet për përdorimin e tyre. | | | | | |
| 31 (3) | Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë nen, autoritetet kontraktore negociojnë me ofertuesit, ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata kanë dorëzuar, përveç ofertës përfundimtare, për të përmirësuar përmbajtjen e tyre. Kërkesat minimale dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk janë objekt negocimi. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”** 46 (7) | Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor negocion me ofertuesit, ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata kanë dorëzuar për të përmirësuar përmbajtjen e tyre, përveç ofertës përfundimtare.<br><br>Kërkesat minimale dhe kriteret e përzgjedhjes nuk janë objekt negocimi. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 52 (9) | Autoriteti/enti kontraktor zhvillon faza të njëpasnjëshme me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në LPP, bazuar në hapat e procesit të kërkimit dhe zhvillimit me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Fazat e njëpasnjëshme mund të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përfshijnë prodhimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose përfundimin e punëve.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor negocion me ofertuesit, sipas parashikimeve në LPP, ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata kanë dorëzuar për të përmirësuar përmbajtjen e tyre, përveç ofertës përfundimtare.<br>Kërkesat minimale dhe kriteret e përzgjedhjes nuk janë objekt negocimi.<br>Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohej një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit. | | |
| 31 (4) | Autoritetet kontraktore sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit gjatë negocimit. Në veçanti, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>46 (8) | Autoriteti ose enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit gjatë negocimit, dhe në asnjë rast nuk jep | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ato nuk duhet t'i bëjnë të ditura informacionet në mënyrë diskriminuese, që mund t'u sjellë avantazhe disa ofertuesve mbi të tjerët.<br>Informojnë me shkrim të gjithë ofertuesit, ofertat e të cilëve nuk janë shkualifikuar sipas paragrafit 5, për çdo ndryshim në specifikimet teknike ose dokumente të tjera të prokurimit, përveç atyre që përcaktojnë kërkesat minimale. Pas këtyre ndryshimeve, autoritetet kontraktore parashikojnë një kohë të mjaftueshme që ofertuesit të modifikojnë dhe të dorëzojnë përsëri ofertat e ndryshuara, sipas rastit.<br>Në përputhje me nenin 21, autoritetet kontraktore nuk u tregojnë pjesëmarrësve të tjerë informacionin | | | informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve.<br>Autoriteti ose enti kontraktor informon me shkrim të gjithë ofertuesit, të cilët kalojnë në fazësn tjetër, për çdo ndryshim në specifikimet teknike ose dokumente të tjera të tenderit, përveç atyre që përcaktojnë kërkesat minimale. Pas këtyre ndryshimeve, autoriteti ose enti kontraktor parashikon një kohë të mjaftueshme që ofertuesit të modifikojnë dhe të dorëzojnë përsëri ofertat e ndryshuara, sipas rastit.<br><br>Bazuar mbi parimet e konfidencialitetit të parashikuara në këtë ligj, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'u tregojë pjesëmarrësve të tjerë informacionin konfidencial të komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | konfidencial të komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në negociata, pa pëlqimin e këtij të fundit. Kjo marrëveshje nuk bëhet në formën e një heqje dorë të përgjithshme por bëhet duke iu referuar komunikimit të synuar të informacionit specifik. | | | negociata, pa pëlqimin e këtij të fundit. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 52 (10) | Autoriteti/enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve. Autoriteti/enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në negociata, pa pëlqimin e këtij të fundit. | | |
| 31 (5) | Negociatat gjatë procedurave të partneritetit për novacion mund të zhvillohen në fazat të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen, duke përdorur kriteret e shpalljes së kontratës fituese, të specifikuara në njoftimin e | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** 46 (9) | Negociatat gjatë procedurave të partneritetit për inovacion mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen bazuar në kriteret e përzgjedhjes. Autoriteti ose enti kontraktor e cilëson në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose në dokumentet e prokurimit. Autoriteti kontraktor e cilëson në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose në dokumentet e prokurimit, nëse do ta përdorë këtë mundësi. | | | nëse do ta përdorë këtë mundësi. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 52 (10) | Negociatat gjatë procedurave të partneritetit për inovacion mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen bazuar në kriteret e përzgjedhjes, kur autoriteti/enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë. | | |
| 31 (6) | Për përzgjedhjen e kandidatëve, autoritetet kontraktore përdorin veçanërisht ato kritere që lidhen me kapacitetin e kandidatëve në fushën e kërkimit dhe zhvillimit dhe në krijimin dhe zbatimin e zgjidhjeve novatore. Vetëm ata operatorë ekonomikë që ftohen nga autoriteti kontraktor, pasi ky i fundit ka vlerësuar informacionin e kërkuar, mund të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** 46 (10) | Për përzgjedhjen e kandidatëve, autoriteti ose enti kontraktor përdor kritere që lidhen me kapacitetin e tyre në fushën e kërkimit dhe zhvillimit dhe në krijimin dhe zbatimin e zgjidhjeve inovatore.<br><br>Vetëm ata operatorë ekonomikë që ftohen nga autoriteti ose enti kontraktor, pasi ky i fundit ka vlerësuar informacionin e kërkuar, mund të dorëzojnë projekte kërkimi dhe inovacioni, që kanë si | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dorëzojnë projekte kërkimi dhe novacioni, që kanë si qëllim të përmbushin nevojat e identifikuara nga një autoritet kontraktor dhe nuk mund të përmbushen nëpërmjet zgjidhjeve ekzistuese. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e prokurimit, rregullat e zbatueshme për të drejtat e pronësisë intelektuale. Në rastin e një partneriteti për novacion me disa partnerë, në përputhje me nenin 21, autoriteti kontraktor nuk duhet t'u tregojë partnerëve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacione të tjera konfidenciale të komunikuara nga një partner në kuadrin e partneritetit, pa pëlqimin e atij partneri. Kjo marrëveshje nuk bëhet në formën e një heqje dorë të | | | qëllim përmbushjen e nevojave të një autoriteti ose enti kontraktor, të cilat nuk mund të përmbushen nëpërmjet zgjidhjeve ekzistuese.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor përcakton rregullat e zbatueshme për të drejtat e pronësisë intelektuale në dokumentat e tenderit. Në rastin e një partneriteti për inovacion me disa partnerë, bazuar mbi parimet e konfidencialitetit të parashikuara në këtë ligj, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'u tregojë partnerëve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacione të tjera konfidenciale të komunikuara nga një partner në kuadrin e partneritetit, pa pëlqimin e tij. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>52 (9) | Autoriteti/enti kontraktor zhvillon faza të njëpasnjëshme me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përgjithshme por bëhet duke iu referuar komunikimit të synuar të informacionit specifik. | | | LPP, bazuar në hapat e procesit të kërkimit dhe zhvillimit me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Fazat e njëpasnjëshme mund të përfshijnë prodhimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose përfundimin e punëve.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor negocion me ofertuesit, sipas parashikimeve në LPP, ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata kanë dorëzuar për të përmirësuar përmbajtjen e tyre, përveç ofertës përfundimtare.<br>Kërkesat minimale dhe kriteret e përzgjedhjes nuk janë objekt negocimi.<br>Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohej një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | realizuar procedura e prokurimit. | | |
| 31 (7) | Autoriteti kontraktor garanton që struktura e partneritetit dhe, në veçanti, kohëzgjatja dhe vlera e fazave të ndryshime të pasqyrojë nivelin e novacionit të zgjidhjes së propozuar dhe rendin e veprimtarive të fit dhe novacionit që kërkohen për zhvillimin e një zgjidhjeje novatore ende të padisponueshme në treg. Vlera e parashikuar e furnizimeve, shërbimeve ose punëve duhet të jetë proporcionale me investimin që kërkohet për realizimin e tyre. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** 46 (11) | Autoriteti ose enti kontraktor garanton që struktura e partneritetit dhe, në veçanti, kohëzgjatja dhe vlera e fazave të ndryshme të pasqyrojë shkallën e inovacionit të zgjidhjes së propozuar dhe rendin e veprimtarive të kërkimit dhe inovacionit të nevojshme për zhvillimin e një zgjidhjeje inovatore ende të padisponueshme në treg. Vlera e parashikuar e mallrave, shërbimeve ose punëve duhet të jetë në proporcion me investimin që kërkohet për realizimin e tyre. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 52 (11) | Autoriteti/enti kontraktor garanton që struktura e partneritetit dhe, në veçanti, kohëzgjatja dhe vlera e fazave të ndryshme të pasqyrojë shkallën e inovacionit të zgjidhjes së propozuar dhe rendin e veprimtarive të kërkimit dhe inovacionit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nevojshme për zhvillimin e një zgjidhjeje inovatore ende të padisponueshme në treg. Vlera e parashikuar e mallrave, shërbimeve ose punëve duhet të jetë në proporcion me investimin që kërkohet për realizimin e tyre. | | |
| Përdorimi i procedurës me negocim pa shpallje paraprake<br>32 (1) | Në rastet specifike dhe rrethanat e përcaktuara në paragrafët 2 deri në 5, shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore të mund të japin kontrata publike nëpërmjet një procedure me negocim pa shpallje paraprake. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës<br>47 (1) | Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës mund të përdoret për kontratat publike të punëve, mallrave apo shërbimeve, në secilin nga rastet e mëposhtme:<br><br>a) kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës, ose procedurës së kuafizuar apo në përgjigje të një procedure te publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas Kreut X të këtij ligji, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | papërshtatshme. Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br><br>Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës me shpallje paraprake të njoftimit, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br><br>Një ofertë konsiderohet si e papërshtatshme, kur ajo nuk ka lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | specifikuara në dokumentet e tenderit.<br><br>Kërkesa për pjesëmarrje konsiderohet si e papërshtatshme, kur operatori ekonomik në fjalë ndodhet në kushtet e skualifikimit sipas nenit 76 ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor sipas nenit 77.<br><br>b) kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar, për një nga arsyet e mëposhtme:<br><br>i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose performance artistike unike;<br>ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;<br>iii.për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.<br><br>c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti ose enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negocim, ose procedurat me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti ose enti kontraktor.<br><br>Për kontratat e nënshkruara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj gërme, nuk mund të përdoret procedura me negocim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** | Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës<br>53 (1) | njoftimit të kontratës, është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47 të LPP, kur:<br>a) kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës, ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure te publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas Kreut VIII të LPP, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br><br>Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës negocim me shpallje paraprake të njoftimit, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br>Ofertat dhe kërkesa për pjesëmarrje, konsiderohen si të papërshtatshme, kur mangësitë nuk kanë lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojnë, pa pësuar ndryshime thelbësore, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, të specifikuara në dokumentet e tenderit, si edhe kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit sipas nenit 76 të LPP, ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor sipas nenit 77 të LPP.<br>Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte apo kërkese për pjesëmarrje nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit/entit kontraktor.<br>b) kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar, për një nga arsyet e mëposhtme:<br>i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | performance artistike unike;<br>ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;<br>iii. për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.<br>Përjashtimet e përcaktuara në paragrafët (ii) dhe (iii) zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm, dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i kufizimit të kërkesave që autoriteti/enti kontraktor përcakton për objektin e prokurimit. Ekzistenca e këtyre kushteve duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet ose entet kontraktore.<br>c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nga autoriteti/enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negocim, ose procedurat me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit në kontratat sektoriale, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti/enti kontraktor.<br>Në këtë rast, duhet të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>i. Konstatimi i një ngjarjeje të paparashikuar; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ii. Autoriteti/enti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;<br>iii. Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë;<br>iv. Nuk është e mundur të ndiqen procedurat konkuruese mbi ose nën kufirin e ulët monetar.<br>Në të gjitha rastet, autoriteti/enti kontraktor duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme e konstatuar, nuk është shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij. Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.<br>Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme.<br>Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.<br>Për kontratat e nënshkruara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj gërme, nuk mund të përdoret procedura me negocim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen.<br>d) Kjo procedurë, mund të përdoret për kontratat publike të mallrave:<br>i. kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kontratat që jepen në zbatim të kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare, ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit.<br>ii. për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat janë ose një zëvendësim i pjesshëm i mallrave apo instalimeve ose si shtesë e mallrave apo instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin ose entin kontraktor të marrë mallra me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike joproporcionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje.<br>Kontrata, në këtë rast, duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor brenda tre viteve nga lidhja e kontratës fillestare dhe vlera e këtyre furnizimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale.<br>Situata e parashikuara në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj mallrash, për të cilat autoriteti/enti kontraktor ka nevoja të vazhdueshme.<br>iii. për mallrat e kuotuara dhe të blera në bursë;<br>iv. për blerjet e mallrave me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kushte veçanërisht të favorshme, nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e tij tregtare, është në proces falimenti, nga një marrëveshje me kreditorët ose sipas një procedure të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br>e) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të shërbimit kur kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me LPP dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të ftohen të marrin pjesë në negociata.<br>f) Procedura me negocim, pa shpallje paraprake mund të përdoret për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti/enti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është lidhur kontrata fillestare mbi bazën e një procedure konkuruese. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve ose | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimeve shtesë dhe kushtet, sipas të cilave ato do të jepen.<br>Situata e parashikuara në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj shërbimesh, për të cilat autoriteti kontraktor ka nevoja të vazhdueshme.<br>Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të bëhet i ditur që në momentin e shpalljes së procedurës së parë, dhe autoriteti ose enti kontraktor, gjatë përllogaritjes së fondit limit duhet të marrë parasysh edhe një kosto të përgjithshme të punëve ose shërbimeve shtesë.<br>Kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda tre viteve nga data e lidhjes së kontratës fillestare, dhe vlera nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale. | | |
| 32 (2) | Procedura me negocim pa shpallje paraprake mund të përdoret për | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës mund | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kontratat publike të punëve, kontratat publike të furnizimit dhe kontratat publike të shërbimit, në secilin nga rastet e mëposhtme:<br>(a) kur në përgjigje të procedurës së hapur ose procedurës se kufizuar nuk është dorëzuar asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të përshtatshme, dhe për sa kohë që në kushtet fillestare të kontratës të mos jetë bërë asnjë ndryshim thelbësor dhe Komisionit i është dërguar raport, kur është kërkuar prej tij;<br>Një ofertë konsiderohet si e papërshtatshme kur ajo nuk ka lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit kontraktor, të | | 47 (1) | të përdoret për kontratat publike të punëve, mallrave apo shërbimeve, në secilin nga rastet e mëposhtme:<br><br>a) kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës, ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure te publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas Kreut X të këtij ligji, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br><br>Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | specifikuara në dokumentet e prokurimit. Kërkesa për pjesëmarrje konsiderohet si e papërshtatshme kur operatori ekonomik në fjalë do të përjashtohet ose mund të përjashtohet sipas nenit 57 ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti kontraktor sipas nenit 58;<br>(b) kur punët, furnizimet ose shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i veçantë, për një nga arsyet e mëposhtme:<br>(i) qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose performance artistike unike;<br>(ii) për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;<br>(iii) mbrojtja e të drejtave ekskluzive, | | | të procedurës me shpallje paraprake të njoftimit, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br><br>Një ofertë konsiderohet si e papërshtatshme, kur ajo nuk ka lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, të specifikuara në dokumentet e tenderit.<br><br>b) kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar, për një nga arsyet e mëposhtme:<br><br>i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale;<br>Përjashtimet e përcaktuara në pikat (ii) dhe (iii) zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i ngushtimit artificial të parametrave të prokurimit.<br>(c) për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e kufizuara ose procedurat konkurruese me negocim, nuk mund të respektohen.<br>Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë | | | vepre arti ose performance artistike unike;<br>ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;<br>iii.për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.<br><br>c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti ose enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negocim, ose procedurat me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit, nuk mund të respektohen.<br>Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti ose enti kontraktor. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | rast nga autoriteti kontraktor. | | | Për kontratat e nënshkruara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj gërme, nuk mund të përdoret procedura me negocim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 53 (1) | Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47 të LPP, kur:<br>a) kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës, ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure te publikuar për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas Kreut VIII të LPP, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br><br>Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës negocim me shpallje paraprake të njoftimit, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.<br>Ofertat dhe kërkesa për pjesëmarrje, konsiderohen si të papërshtatshme, kur mangësitë nuk kanë lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojnë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, të specifikuara në dokumentet e tenderit, si edhe kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit sipas nenit 76 të LPP, ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor sipas nenit 77 të LPP.<br>Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte apo kërkese për pjesëmarrje nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit/entit kontraktor. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | b) kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar, për një nga arsyet e mëposhtme:<br>iv. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose performance artistike unike;<br>v. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;<br>vi. për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.<br>Përjashtimet e përcaktuara në paragrafët (ii) dhe (iii) zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm, dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i kufizimit të kërkesave që autoriteti/enti | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kontraktor përcakton për objektin e prokurimit. Ekzistenca e këtyre kushteve duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet ose entet kontraktore.<br>c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti/enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negocim, ose procedurat me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit në kontratat sektoriale, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti/enti kontraktor.<br>Në këtë rast, duhet të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>v. Konstatimi i një ngjarjeje të paparashikuar;<br>vi. Autoriteti/enti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;<br>vii. Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë;<br>viii. Nuk është e mundur të ndiqen procedurat konkuruese mbi ose nën kufirin e ulët monetar.<br>Në të gjitha rastet, autoriteti/enti kontraktor duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dokumentojë se nevoja ekstreme e konstatuar, nuk është shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij.<br>Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.<br>Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme.<br>Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.<br>Për kontratat e nënshkruara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj gërme, nuk mund të përdoret procedura me negocim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 32 (3) | Procedura me negocim, pa shpallje paraprake, mund të përdoret për kontratat publike të furnizimit:<br>(a) kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi; megjithatë, kontratat që jepen në zbatim të kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit;<br>(b) për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat janë menduar qoftë si një zëvendësim i pjesshëm i furnizimeve ose instalimeve, ose si zgjatim i furnizimeve ose instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>47 (3) | Procedura me negocim, pa shpallje paraprake, mund të përdoret për kontratat publike të mallrave:<br><br>a) kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Kontratat që jepen në zbatim të kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare, ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit.<br><br>b) për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat janë ose një zëvendësim i pjesshëm i mallrave apo instalimeve ose si shtesë e mallrave apo instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin ose entin kontraktor të marrë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në papërputhshmëri ose në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | autoritetin kontraktor të marrë furnizime me karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike joproporcionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje; kohëzgjatja e kontratave të tilla si edhe e ndonjë kontrate tjetër si rregull i përgjithshëm nuk i tejkalon tre vjet;<br>(c) për furnizimet e kuotuara dhe të blera në tregun e artikujve për përdorim të gjerë;<br>(d) për blerjet e furnizimeve ose shërbimeve me kushte veçanërisht të favorshme, qoftë nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e tij tregtare, qoftë nga një administrator i procedurës së falimentimit, nga një marrëveshje me | | | vështirësi teknike joproporcionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>51 (1) | d) Kjo procedurë, mund të përdoret për kontratat publike të mallrave:<br>v. kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Kontratat që jepen në zbatim të kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare, ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit.<br>vi. për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kreditorët ose sipas një procedure të ngjashme, në përputhje me legjislacionin ose rregullat e brendshme; | | | janë ose një zëvendësim i pjesshëm i mallrave apo instalimeve ose si shtesë e mallrave apo instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin ose entin kontraktor të marrë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike joproporcionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje. | | |
| 32 (4) | Procedura me negocim, pa shpallje paraprake mund të përdoret për kontratat publike të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>47 (4) | Procedura me negocim, pa shpallje paraprake mund të përdoret për kontratat publike të shërbimit kur | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shërbimit kur kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me këtë direktivë dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të ftohen të marrin pjesë në negociata. | | | kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me këtë ligj dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të ftohen të marrin pjesë në negociata. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 51 (1) | e) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të shërbimit kur kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me LPP dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ftohen të marrin pjesë në negociata. | | |
| 32 (5) | Procedura me negocim, pa shpallje paraprake mund të përdoret për punët ose shërbimet të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është dhënë kontrata fillestare sipas procedurës në përputhje me nenin 26, paragrafi 1. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve ose shërbimeve shtesë dhe kushtet sipas të cilave ato do të jepen.<br>Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>47 (5) | Procedura me negocim, pa shpallje paraprake mund të përdoret për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti ose enti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë për të cilin është lidhur kontrata fillestare mbi bazën e një procedure konkuruese. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve ose shërbimeve shtesë dhe kushtet, sipas të cilave ato do të jepen.<br><br>Situata e parashikuara në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj shërbimesh, për të cilat autoriteti kontraktor ka nevoja të vazhdueshme. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të shpallet sapo projekti i parë të vendoset në prokurim, dhe autoriteti kontraktor, kur zbaton nenin 4, duhet të marrë parasysh koston e përgjithshme të përllogaritur të punëve ose shërbimeve vijuese. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm gjatë tre viteve që pasojnë lidhjen e kontratës fillestare. | | | Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të bëhet i ditur që në momentin e shpalljes së procedurës së parë dhe autoriteti ose enti kontraktor, gjatë përllogaritjes së vlera e kontratës duhet të marrë parasysh edhe një kosto të përgjithshme të punëve ose shërbimeve shtesë.<br><br>Kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda tre viteve nga data e lidhjes së kontratës fillestare, dhe vlera nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** 51 (1) | f) Procedura me negocim, pa shpallje paraprake mund të përdoret për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ekonomik, të cilit autoriteti/enti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është lidhur kontrata fillestare mbi bazën e një procedure konkuruese. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve ose shërbimeve shtesë dhe kushtet, sipas të cilave ato do të jepen.<br><br>Situata e parashikuara në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj shërbimesh, për të cilat autoriteti kontraktor ka nevoja të vazhdueshme.<br><br>Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të bëhet i ditur që në momentin e shpalljes së procedurës së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | parë, dhe autoriteti ose enti kontraktor, gjatë përllogaritjes së fondit limit duhet të marrë parasysh edhe një kosto të përgjithshme të punëve ose shërbimeve shtesë.<br><br>Kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda tre viteve nga data e lidhjes së kontratës fillestare, dhe vlera nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale. | | |
| Marrëveshjet kuadër<br>33 (1) | Autoritetet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër, nëse zbatojnë procedurat që parashikohen në këtë direktivë.<br>Marrëveshja kuadër është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë autoriteteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Marrëveshjet kuadër<br>52 (1) | Marrëveshja kuadër është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i të cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e | E pjesshme | Duke pasur parasysh kontekstin shqiptar te zbatimit te ligjit dhe per te siguruar pjesemarrjen ne procedurat e prokurimit te nje numri me te madh operatoresh pa e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ekonomikë, qëllimi i të cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara.<br>Afati i një marrëveshjes kuadër nuk është më i gjatë se katër vjet, përveç rasteve të jashtëzakonshme, plotësisht të justifikueshme, sidomos nga objekti i marrëveshjes kuadër. | | | përshtatshme, me sasitë e parashikuara.<br><br>Afati i marrëveshjes kuadër nuk është më i gjatë se 4 vjet.<br><br>Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektorale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 vjet. | | mbyllur tregun per nje kohe te gjate, kohezgjatja maksimale e marreveshjes kuader eshte lene deri ne 4 vjet pa mundesi shtyrje te metejshme. |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Perkufizimi i Marrëveshjes kuadër<br>60 (1) | Autoriteti/enti kontraktor përdor marrëveshjen kuadër për punë/mallra/ shërbime, për të arritur një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve/enteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë.<br><br>Qëllimi i një marrëveshje kuadër është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara, sipas përcaktimit në nenin 52 të LPP. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Kohezgjatja e nje marreveshje kuader<br>64 (1)<br><br>64 (2) | Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se katër vjet.<br><br>Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektorale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 vjet. | | |
| 33 (2) | Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashtruara në këtë paragraf ose në paragrafët 3 dhe 4. Këto procedura mund të zbatohen vetëm ndërmjet atyre autoriteteve kontraktore që janë identifikuar qartë për këtë qëllim në ftesën për konkurrim ose në ftesën për shprehje interesi dhe atyre operatorëve ekonomikë që janë palë të marrëveshjes kuadër që është lidhur. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>52 (2) | Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.<br><br>Këto kontrata mund të zbatohen vetëm ndërmjet atyre autoriteteve ose enteve kontraktore që janë identifikuar qartë për këtë qëllim në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, dhe atyre operatorëve ekonomikë që janë palë të marrëveshjes kuadër që është lidhur.<br><br>Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër në asnjë rrethanë nuk mund të përfshijnë ndryshime thelbësore të kushteve të | E pjesshme | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër në asnjë rrethanë nuk mund të përfshijnë ndryshime thelbësore të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e përmendur në paragrafin 3. | | | përcaktuara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e përmendur në pikën 3 të këtij neni. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>60 (2) | Në njoftimin e procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore përfituese. Nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj.<br>Pas nënshkrimit të marrëveshjes, nuk lejohet të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë, të cilët nuk janë palë në këtë marrëveshje. | | |
| 33 (3) | Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve dhe kushteve të | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>52 (3) | Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | parashtruara në marrëveshjen kuadër. Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet kontraktore mund të këshillohen me shkrim me operatorin ekonomik palë në marrëveshjen kuadër, duke i kërkuar atij të plotësojë ofertën, sipas nevojës. | | | Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër, ofertën e tij, sipas nevojës. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** Llojet e marreveshjes kuader 65 (2) | Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër.<br><br>Nëse nevojat e autoritetit/entit kontraktor ndryshojnë, atëherë do të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatisë ofertën e tij për kontratën bazuar në marëveshjen kuadër vetëm në lidhje me kushtet, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër. | | |
| 33 (4) | Kur marrëveshja kuadër lidhet me më shumë se një operator ekonomik, atëherë kjo marrëveshje kuadër zbatohet në një nga mënyrat e mëposhtme:<br>(a) sipas kushteve të marrëveshjes kuadër, pa rihapur konkurrimin, ku përcaktohen të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë dhe kushtet objektive për të përcaktuar se cili | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>52 (4) | Kur marrëveshja kuadër lidhet me më shumë se një operator ekonomik, atëherë kjo marrëveshje kuadër zbatohet në një nga mënyrat e mëposhtme:<br><br>a) nëpërmjet zbatimit të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimi<br><br>b) kur marrëveshja kuadër përcakton të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë, pjesërisht pa rihapur | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | operator ekonomik, palë e marrëveshjes kuadër, do t'i kryejë ato; kushti i fundit cilësohet në dokumentet e prokurimit për marrëveshjen kuadër;<br>(b) kur marrëveshja kuadër përcakton të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë, pjesërisht pa rihapur konkurrimin në përputhje me germën a dhe pjesërisht me rihapjen e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër në përputhje me germën c, kur kjo mundësi është parashikuar nga autoritetet kontraktore në dokumentet e prokurimit për marrëveshjen kuadër. Zgjedhja nëse punët, furnizimet ose shërbimet specifike blihen pas rihapjes së | | | konkurrimin në përputhje me germën a dhe pjesërisht me rihapjen e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër në përputhje me germën "c", kur kjo mundësi është parashikuar nga autoritetet ose entet kontraktore në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Zgjedhja, nëse punët, furnizimet ose shërbimet specifike blihen pas rihapjes së konkurrimit ose direkt sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër, bëhet në përputhje me kritere objektive, të cilat përcaktohen në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Në këto dokumente duhet, gjithashtu, të specifikohet se, cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit.<br><br>Mundësitë që parashikohen në paragrafin e parë të kësaj gërme, gjithashtu, zbatohen për çdo lot të marrëveshjes | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | konkurrimit ose direkt sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër, bëhet në përputhje me kritere objektive, të cilat përcaktohen në dokumentet e prokurimit për marrëveshjen kuadër. Në këto dokumente prokurimi duhet gjithashtu të specifikohet se cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit. Mundësitë që parashikohen në paragrafin e parë të kësaj germe gjithashtu zbatohen për çdo lot të marrëveshjes kuadër për të cilët të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë përcaktohen në marrëveshjen kuadër, pavarësisht nëse janë përcaktuar ose jo të gjitha kushtet që | | | kuadër, për të cilët të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë përcaktohen në marrëveshjen kuadër, pavarësisht nëse janë përcaktuar ose jo të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e këtyre punëve, shërbimeve dhe furnizimeve për lote të tjera.<br><br>c) kur në marrëveshjen kuadër, nëpërmjet rihapjes së konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, nuk janë përcaktuar të gjithë kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>65 (3) | Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të lidhura me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | rregullojnë ofrimin e këtyre punëve, shërbimeve dhe furnizimeve për lote të tjera.<br>(c) kur në marrëveshjen kuadër, nëpërmjet rihapjes së konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, nuk janë përcaktuar të gjithë kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve. | | | marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.<br><br>Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.<br>Kjo lloj marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përcaktohet një operator ekonomik fitues. Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë. Në rast të kundërt, autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy. | | |
| 33 (5) | Konkurrimet e përmendura në germat b dhe c të paragrafit 4 bazohen në të njëjtat kushte që zbatohen për dhënien e marrëveshjes kuadër dhe, kur është e nevojshme, në kushte të formuluara më saktë, dhe, sipas rastit, në kushte të tjera të përmendura në dokumentet e prokurimit për marrëveshjen kuadër, në përputhje me procedurën e mëposhtme: | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** 52 (5) | Konkurrimet e përmendura në gërmat "b" dhe "c" të pikës 4, bazohen në të njëjtat kushte që zbatohen për dhënien e marrëveshjes kuadër dhe, nëse është e nevojshme, në bazë të kushteve të formuluara më saktësisht dhe sipas rastit, në kushte të tjera të përcaktuara në dokumentat e tenderit , në përputhje me procedurën në vijim:<br><br>a) për çdo kontratë, që do të prokurohet, autoritetet ose entet kontraktore komunikojnë me shkrim | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (a) për çdo kontratë që do të jepet, autoritetet kontraktore duhet të këshillohen, me shkrim, me operatorët ekonomikë që janë në gjendje të zbatojnë kontratën;<br>(b) autoritetet kontraktore caktojnë një afat kohor të mjaftueshëm për dorëzimin e ofertave, për secilën kontratë specifike, duke marrë parasysh faktorë si kompleksiteti i objektit të kontratës dhe kohën e nevojshme për të dorëzuar ofertat;<br>(c) ofertat dorëzohen me shkrim dhe përmbajtja e tyre nuk hapet derisa afati i përcaktuar kohor për përgjigje të ketë skaduar;<br>(d) autoritetet kontraktore ia japin secilën kontratë ofertuesit që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të | | | ose me mjete elektronike, me palët në marrëveshjen kuadër;<br><br>b) autoritetet ose entet kontraktore duhet të caktojnë një afat jo më pak se 2 ditë për dorëzimin e ofertave, për secilën kontratë specifike, duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit, që do të prokurohet, dhe kohën e nevojshme për të dorëzuar ofertat;<br><br>c) ofertat do të dorëzohen me shkrim ose me mjete elektronike dhe përmbajtja e tyre duhet të mbetet konfidenciale, derisa kufiri i përcaktuar kohor për përgjigje të ketë skaduar;<br><br>ç) autoritetet ose entet kontraktore do t’i japin kontratën ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kritereve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në dokumentat e tenderit të marrëveshjes kuadër. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kritereve për shpalljen e fituesit, të përcaktuara në dokumentet e prokurimit për marrëveshjen kuadër. | | | mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit. Kriteret për shpalljen e ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër, ose autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë kritere të tjera, me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër. Këto kritere mund të jenë çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulencat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike.<br>Komunikimi ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, për përzgjedhjen e fituesit për kontratat bëhet në formë të shkruar ose elektronike dhe, në çdo rast, duhet të dokumentohet dhe të bëhet | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pjesë e dosjes së procedurës.<br>Forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti/enti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës.<br>Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre.<br>Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.<br>Kjo lloj marrëveshjeje kuadër nuk është e zbatueshme në rastet e kontratave sektoriale | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>65 (4) | Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohen kontrata, sipas LPP. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin. Autoriteti/enti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret për shpalljen e ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave. Në këto dokumente duhet, gjithashtu, duhet të specifikohet se, cilat kushte | | |
| Sistemet dinamike të blerjes 34 (1) | Autoritetet kontraktore mund të përdorin një sistem dinamik blerjeje për blerjet e zakonshme, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | "Sistem dinamik blerjeje" është një procedurë, tërësisht elektronike, blerjeje mallrash, punwsh apo shërbimesh të | E plote | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | karakteristikat e të cilave, të disponueshme gjerësisht në treg, plotësojnë kërkesat e autoriteteve kontraktore. Sistemi dinamik i blerjes funksionon si një proces tërësisht elektronik dhe është i hapur gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së sistemit të blerjes, për çdo operator ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes. Ai mund të ndahet në kategori produktesh, punësh ose shërbimesh, që përcaktohen objektivisht në bazë të karakteristikave të prokurimit që do të kryhet sipas kategorive përkatëse. Këto karakteristika mund të përfshijnë madhësinë maksimale të lejueshme të kontratave specifike vijuese ose zonën gjeografike | | Përkufizime 4(40)<br><br>Sistemi dinamik i blerjes dhe Ankandi elektronik 54 (1) | zakonshme në treg, që përmbushin kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, me afat të kufizuar dhe e hapur për çdo operator ekonomik, që përmbush kriteret e përzgjedhjes e që paraqet një ofertë në përputhje me specifikimet.<br><br>1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të përdorë sistemin dinamik të blerjes për blerjen e punëve, mallrave apo shërbimeve të zakonshme në treg, duke pasur parasysh sa më poshtë:<br><br>a) Për sistemin dinamik të blerjes përdoren rregullat e procedurës së kufizuar duke përfshirë në sistem të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes. Kufizimi i numrit të kandidatëve sipas nenit 85 të këtij ligji nuk mund të aplikohet në rastin e sistemit dinamik të blerjes. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | specifike ku do të realizohen kontratat specifike pasuese. | | | b) Autoriteti ose enti kontraktor publikon thirrjen për konkurim ku përcaktohet përdorimi i sistemit dinamik të blerjes dhe përcakton në dokumentat e tenderit të gjithë informacionin e nevojshëm për sistemin dinamik, përfshirë të dhënat teknike mbi funksionimin e sistemit dinamik.<br><br>c) Autoriteti ose enti kontraktor mund të ndajë mallrat, punët apo shërbimet në kategori, duke përcaktuar për secilën prej tyre karakteristikat dhe kriteret e përzgjedhjes.<br><br>ç) Autoriteti ose enti kontraktor u jep akses të plotë dhe të pakufizuar të dokumentave të tenderit të gjithë operatorëve ekonomikë përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së sistemit dinamik.<br><br>d) Autoriteti ose enti kontraktor i jep mundësi çdo operatori ekonomik që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të bëhet pjesë e sistemit dinamik përgjatë kohës së vlefshmërisë së tij.<br><br>Rregullat e detajuara mbi mënyrën e funksionimit, afatet e vlerësimit dhe përzgjedhjen e fituesve për sistemin dinamik të blerjes do të përcaktohen nw rregullat e prokurimit publik. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Sistemi dinamiki blerjes<br>69 (1)<br><br><br><br><br>69 (2) | Sistemi dinamik i blerjes është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerje të përsëritura të punëve, mallrave apo shërbimeve të zakonshme në treg.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor publikon thirrjen për konkurim ku përcaktohet përdorimi i sistemit dinamik të blerjes dhe përcakton në dokumentat e tenderit të gjithë informacionin e nevojshëm për sistemin dinamik, përfshirë të dhënat teknike mbi funksionimin e sistemit dinamik. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 69 (3) | Njoftimi për sistemin dinamik të blerjes hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP dhe me parashikimin në këto rregulla për njoftimin e kontratës.<br><br>Ky njoftim përmban edhe informacionin për hapjen ose intervalet kohore të vlerësimit të kërkesave të reja të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për t´u përfshirë në sistemin dinamik të blerjes, përgjatë periudhës së vlefshmërisë së tij.<br><br>Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë për t'u bërë pjesë e sistemit dinamik të blerjes përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së tij, në çdo kohë që operatori ka interes për këtë ose përmbush kushtet e vendosura nga autoriteti ose enti për t'u bërë pjesë e sistemit dinamik të blerjes. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që regjistrohen në sistemin e prokurimit elektronik dhe operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(18) | i) Në pikën 1, pas gërmes ”d”, shtohet gërma ”e”, ”f”,”g” me përmbajtje si më poshtë vijon:<br><br>„e)Autoriteti ose enti kontraktor përcakton kritere të thjeshtuara për kualifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronike.<br>f)Sistemi gjeneron ftesë automatike për të gjithë subjektet e regjistruara në SPE kodet e aktiviteteve të të veprimtarive të të cilëve (NACE) përputhen me objektin e procedurës së prokurimit sipas kodeve CPV.<br>g)Në përfundim të afateve kohore, Sistemi i Prokurimit Elektronike mbështetur në ndërveprimin me Sisteme të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tjera të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit kryen vlerësimin automatik të plotësimit të kritereve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të ofertuesve për fazën e parë të parakualifikimit.<br><br>h)Sistemi dinamik i blerjes dhe ankandi elektronik duhet të zhvillohen duke përdor teknologji të avancuar të Inteligjencës Artificiale dhe procese të robotizuara në në përputhje me parimet e përmendura në nenin 3 të këtij ligji dhe me standardet ndërkombëtare europiane“.<br><br>ii) pika 2, paragrafi i pestë ndryshon me këtë përmbajtje: “Rregullat për funksionimin e ankandit elektronik do të përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”. | | |
| 34 (2) | Për të prokuruar sipas një sistemi dinamik blerjeje, autoritetet kontraktore ndjekin rregullat për | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>54(1) | Autoriteti ose enti kontraktor mund të përdorë sistemin dinamik të blerjes për blerjen e punëve, mallrave apo shërbimeve të | E plote | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | procedurën e kufizuar. Të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret e përzgjedhjes pranohen në sistem dhe numri i kandidatëve që pranohen në sistem nuk është i kufizuar, në përputhje me nenin 65. Kur autoritetet kontraktore e kanë ndarë sistemin në kategori produktesh, punësh ose shërbimesh në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ata specifikojnë kriteret përzgjedhëse të zbatueshme për çdo kategori.<br>Pavarësisht nenit 28, zbatohen afatet kohore të mëposhtme:<br>(a) afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës ose, kur përdoret njoftimi paraprak i informacionit si një | | | zakonshme në treg, duke pasur parasysh sa më poshtë:<br><br>a) Për sistemin dinamik të blerjes përdoren rregullat e procedurës së kufizuar duke përfshirë në sistem të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes. Kufizimi i numrit të kandidatëve sipas nenit 85 të këtij ligji nuk mund të aplikohet në rastin e sistemit dinamik të blerjes.<br><br>b) Autoriteti ose enti kontraktor publikon thirrjen për konkurim ku përcaktohet përdorimi i sistemit dinamik të blerjes dhe përcakton në dokumentat e tenderit të gjithë informacionin e nevojshëm për sistemin dinamik, përfshirë të dhënat teknike mbi funksionimin e sistemit dinamik.<br><br>c) Autoriteti ose enti kontraktor mund të ndajë mallrat, punët apo shërbimet në kategori, duke | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mënyrë për të ftuar në konkurrim, ftesa për shprehje interesi. Pasi është dërguar ftesa për ofertë për prokurimin e parë specifik sipas sistemit dinamik të blerjes nuk zbatohet më asnjë afat kohor për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje;<br>(b) afati minimal për pranimin e ofertave është të paktën 10 ditë nga data e dërgimit të ftesës për ofertë. Sipas rastit, zbatohet neni 28, paragrafi 4. Nuk zbatohet neni 28, paragrafi 3 dhe 5. | | | përcaktuar për secilën prej tyre karakteristikat dhe kriteret e përzgjedhjes.<br><br>ç) Autoriteti ose enti kontraktor u jep akses të plotë dhe të pakufizuar të dokumentave të tenderit të gjithë operatorëve ekonomikë përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së sistemit dinamik.<br><br>d) Autoriteti ose enti kontraktor i jep mundësi çdo operatori ekonomik që të bëhet pjesë e sistemit dinamik përgjatë kohës së vlefshmërisë së tij.<br><br>Rregullat e detajuara mbi mënyrën e funksionimit, afatet e vlerësimit dhe përzgjedhjen e fituesve për sistemin dinamik të blerjes do të përcaktohen nw rregullat e prokurimit publik. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** | Për të patur një sistem dinamik të blerjes, autoriteti/enti kontraktor përdor rregullat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Sistemi dinamik i blerjes<br>69 (4)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>69 (5)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>69 (6) | procedurës së kufizuar, duke përfshirë në sistem të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.<br><br>Kufizimi i numrit të kandidatëve sipas nenit 85 të LPP nuk mund të aplikohet në rastin e sistemit dinamik të blerjes.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor mund të ndajë mallrat, punët apo shërbimet në kategori, duke përcaktuar për secilën prej tyre karakteristikat dhe kriteret e përzgjedhjes, duke krijuar kategoritë përkatëse të sistemit dinamik të blerjes.<br><br>Për t'iu krijuar mundësinë operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e sistemit dinamik të blerjes në çdo kohë, autoriteti/enti kontraktor u jep akses të plotë dhe të pakufizuar të dokumentave të tenderit të gjithë operatorëve ekonomikë përgjatë gjithë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 69 (7) | kohës së vlefshmërisë së sistemit dinamik.<br><br>Hapat për krijimin e sistemit dinamik të blerjes dhe shpalljen e fituesit në përfundim, janë:<br>a) Autoriteti/enti kontraktor publikon thirrjen për konkurim dhe sipas rastit specifikon nëse ka një ndarje në kategori të mallrave/ punëve/ shërbimeve;<br>b) Autoriteti/enti kontraktor vendos një afat të arsyeshëm, por jo më pak se 20 (njëzet) ditë, për paraqitjen e dokumentacionit për kualifikim nga ana e operatorëve ekonomikë;<br>c) Autoriteti/enti kontraktor vlerëson dokumentacionin për kualifikim të paraqitur nga operatorët ekonomikë brenda | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre dhe në përfundim të këtij afati, njofton për kualifikimin ose arsyet e skualifikimit nga sistemi dinamik i blerjes;<br>d) Pas përfundimit të afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor përfundon krijimin e sistemit dinamik të blerjes me operatorët e kualifikuar;<br>e) Autoriteti/enti kontraktor bën njoftime periodike, sipas përcaktimit në njoftimin për konkurim, për rifreskimin e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, pjesë e sistemit dinamik të blerjes, dhe zbaton të njëjtat rregulla dhe afate për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kualifikimin e operatorëve ekonomike të tjerë.<br>f) kur ka nevojë për punë/ mallra/ shërbime, sipas përcaktimeve për krijimin e sistemit dinamik të blerjes, autoriteti/enti kontraktor u dërgon ftesën për ofertë operatorëve ekonomikë në sistemin dinamik të blerjes, duke u lënë një afat të arsyeshëm, por jo më pak se 48 orë për paraqitjen e një oferte.<br>g) Autoriteti/enti kontraktor bën vlerësimin e ofertave sipas nenit 87 të LPP dhe përcaktimeve në ftesën për ofertë. Në përfundim të vlerësimit, fton ofertuesin e renditur i pari sa herë është e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mundur nënshkruan kontratë. | | |
| 34 (3) | I gjithë komunikimi në kuadër të sistemit dinamik të blerjes, mbahet vetëm nëpërmjet mjeteve elektronike, në përputhje me nenin 22, paragrafi 1, 3, 5 dhe 6. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Format e komunikimit<br>17 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>17 (2) | I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji, kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit. Pwrjashtimisht, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mund të kryhen në formë shkresore, sipas parashikimeve nw rregullat e prokurimit publik.Rastet kur mund tw pwrdoret komunikimi në rrugë shkresore, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.<br><br>Pa cënuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe parashikimet e këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si vijon:<br><br>a) informacionet, që lidhen me specifikimet e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (3) | nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, duhet të jenë në dispozicion të palëve të interesuara.<br><br>b) mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës.<br><br>Në rastet kur, autoriteti ose enti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese,të disponueshme dhe të ndëroperueshme me produkte te teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht.<br><br>Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (4) | përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.<br><br>Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje. Forma e përdorur për komunikim, shkëmbim dhe ruajtjen e informacionit duhet të garantojë se, autoriteti ose enti kontraktor mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor ligjor për dorëzimin e tyre, i përcaktuar nga ky ligj. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>69 (1) | Sistemi dinamik i blerjes është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerje të përsëritura të punëve, mallrave apo shërbimeve të zakonshme në treg. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(17) | Neni 53 “Blerja e përqendruar” ndryshon si më poshtë:<br>1. Këshilli i Ministrave vendos të krijojë organe qendrore blerëse, për kryerjen e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore si dhe për monitorimin e zbatimit të kontratave.<br><br>2. Këshilli i Ministrave mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës apo si ofrues i sherbimit të prokurimit që do të zhvillojë procedurën e prokurimit për objekte të caktuara.<br><br>3. Një autoritet ose ent kontraktor mund t’i kërkojë organit qendror blerës, kryerjen e veprimtarive | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ndihmëse sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 43/1 të këtij ligji.<br><br>4. Këshilli i Ministrave vendos aplikimin e një tarife për kryerjen e procedurave nga organi qendror blerës.<br><br>5. Pagesa për kryerjen e veprimtarive ndihmëse sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 43/1 të këtij ligji, mund të bëhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe/ose operatori ekonomik sipas rregullave që përcakton Këshilli i Ministrave, e cila, në çdo rast, nuk është më e madhe se 1% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.<br><br>6. Kur dy ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, puneve apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t'i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mallrave, puneve apo shërbimeve në emër të të tjerëve.<br><br>7. Kur një procedure prokurimi kryhet bashkërisht në emër dhe për llogari të të gjitha autoriteteve ose enteve kontraktore të interesuara, ato do të jenë bashkërisht përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të tyre në përputhje me këtë ligj. Kjo vlen edhe në rastet kur një autoritet ose ent kontraktor kryen procedurën, duke vepruar në emër të tij dhe për llogari të autoriteteve ose enteve të tjera kontraktore.<br><br>8. Kur zhvillimi i një procedure prokurimi nuk kryhet në tërësi në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore të interesuara, këto të fundit do të jenë bashkëpërgjegjëse vetëm për ato pjesë të kryera bashkërisht. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 9. Çdo autoritet ose ent kontraktor do të ketë përgjegjësinë e vetme për përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë ligj në lidhje me pjesët që ai kryen në emër të tij dhe për llogari të tij". | | |
| 37 (2) | Një autoritet kontraktor përmbush detyrimet e tij në zbatim të kësaj direktive kur ai merr furnizime dhe/ose shërbime nga një organ qendror blerës që ofron veprimtarinë e blerjes së përqendruar, që përmendet në germën a të pikës 14 të nenit 2, paragrafi 1. Gjithashtu, një autoritet kontraktor përmbush detyrimet e tij në zbatim të kësaj direktive kur merr punë, furnizime ose shërbime duke përdorur sistemet dinamike të blerjes që përdoren nga një organ qendror blerës ose, deri në masën e përcaktuar në nënparagrafin e dytë të | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>68 (4)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>68 (5) | Ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të prokurojnë në mënyrë të përqendruar për autoritetet kontraktore të varësisë.<br><br>Në këtë rast, ministrat ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të përdorin blerjen e përqendruar, duke nxjerrë udhëzimet e duhura për autoritetet kontraktore të varësisë.<br><br>Nëse disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë ose shërbim, ata mund të bien dakord t'i caktojnë njërit prej tyre rolin e organit qendror blerës për | E plote | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nenit 33 paragrafi 2, duke përdorur një marrëveshje kuadër të lidhur nga organi qendror blerës që ofron veprimtarinë e blerjes së përqendruar që përmendet në germën b të pikës 14 të paragrafit 1 të nenit 2. Megjithatë, ky autoritet kontraktor mban përgjegjësi për përmbushjen e detyrimeve në zbatim të kësaj direktive, në lidhje me pjesët që ai kryen vetë, si:<br>(a) dhënia e kontratës sipas sistemit dinamik të blerjes, që përdoret nga një organ qendror blerës;<br>(b) rihapjen e konkurrimit sipas një marrëveshjeje kuadër që është lidhur nga një organ qendror blerës;<br>(c) përcaktimi, sipas germës a dhe b të nenit 33, paragrafi 4, se cili nga operatorët ekonomikë, palë në | | 68 (6) | të prokuruar në emër të tyre.<br><br>Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakord të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër kontraktor për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit. Çdo autoritet tjetër kontraktor mund të kërkojë dhe, rrjedhimisht, të bjerë dakord me organin qendror blerës për kryerjen e prokurimit në emër të tij. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | marrëveshjen kuadër, kryen një detyrë të caktuar në zbatim të një marrëveshjeje kuadër që është lidhur nga një organ qendror blerës. | | | | | |
| 37 (3) | Të gjitha procedurat e prokurimit që kryhen nga një organ qendror blerës, kryhen duke përdorur mjetet elektronike të prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 22. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Blerja e përqendruar<br>53 (3)<br><br><br><br>Format e komunikimit<br>17 (1) | Në kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së fituesit, organi qendror blerës zbaton dispozitat e këtij ligji.<br><br>I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji, kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit. Pwrjashtimisht, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mund të kryhen në formë shkresore, sipas parashikimeve nw rregullat e prokurimit publik.Rastet kur mund tw pwrdoret komunikimi në rrugë shkresore, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. | E plotë | Ne kete kuptim, organi qendror bleres zbaton edhe rregullat mbi prokurimin elektronik te parashikuara ne nenin 17 |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(17) | Neni 53 "Blerja e përqendruar" ndryshon si më poshtë:<br>1. Këshilli i Ministrave vendos të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | krijojë organe qendrore blerëse, për kryerjen e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore si dhe për monitorimin e zbatimit të kontratave.<br><br>2. Këshilli i Ministrave mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës apo si ofrues i sherbimit të prokurimit që do të zhvillojë procedurën e prokurimit për objekte të caktuara.<br><br>3. Një autoritet ose ent kontraktor mund t’i kërkojë organit qendror blerës, kryerjen e veprimtarive ndihmëse sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 43/1 të këtij ligji.<br><br>4. Këshilli i Ministrave vendos aplikimin e një tarife për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kryerjen e procedurave nga organi qendror blerës.<br><br>5. Pagesa për kryerjen e veprimtarive ndihmëse sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 43/1 të këtij ligji, mund të bëhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe/ose operatori ekonomik sipas rregullave që përcakton Këshilli i Ministrave, e cila, në çdo rast, nuk është më e madhe se 1% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.<br><br>6. Kur dy ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, puneve apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t'i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, puneve apo shërbimeve në emër të të tjerëve.<br><br>7. Kur një procedure prokurimi kryhet | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bashkërisht në emër dhe për llogari të të gjitha autoriteteve ose enteve kontraktore të interesuara, ato do të jenë bashkërisht përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të tyre në përputhje me këtë ligj. Kjo vlen edhe në rastet kur një autoritet ose ent kontraktor kryen procedurën, duke vepruar në emër të tij dhe për llogari të autoriteteve ose enteve të tjera kontraktore.<br><br>8. Kur zhvillimi i një procedure prokurimi nuk kryhet në tërësi në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore të interesuara, këto të fundit do të jenë bashkëpërgjegjëse vetëm për ato pjesë të kryera bashkërisht.<br><br>9. Çdo autoritet ose ent kontraktor do të ketë përgjegjësinë e vetme për përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë ligj në lidhje me pjesët që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ai kryen në emër të tij dhe për llogari të tij”. | | |
| 37 (4) | Pa zbatuar procedurat e parashikuara në këtë direktivë, autoritetet kontraktore mund ti japin një organi qendror blerës kontratën publike të shërbimit për ofrimin e veprimtarive të blerjes së përqendruar.<br>Kjo kontratë publike për shërbime gjithashtu mund të përfshijë ofrimin e veprimtarive blerëse ndihmëse. | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>68 (7)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>68 (8) | Organi qëndror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.<br><br>Në bazë të një marrëveshjeje të shkruar ose të udhëzimeve administrative, organi qendror blerës kryen procedurën e prokurimit në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 68 (9) | emër të çdo autoriteti kontraktor, ndërsa ky i fundit përcakton specifikimet teknike, sasitë e punëve mallrave /shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe fondet përkatëse.<br><br>Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse organi qendror blerës vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPP ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor. Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me ekspertë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore kanë marrë për bazë çmime të ndryshme për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përllogarit të dhënat sasiore, sipas fondit përkatës. | | |
| | | | 68 (10) | Organi qendror blerës duhet të dakordësojë të dhënat sasiore me autoritetin kontraktor, para publikimit të procedurës së prokurimit. | | |
| | | | 68 (11) | Organi qendror blerës mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kontraktor, si dhe duhet t’i sigurojë këtij të fundit, sa herë që e kërkon, akses të plotë në çdo informacion për procedurën e prokurimit. | | |
| | | | 68 (12) | Ky nen nuk zbatohet në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale kur autoritetet kontraktore janë ente private. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(6) | Pas nenit 21, shtohen nenet 21/1 dhe 21/2 me këtë përmbajtje:<br><br>“Neni 21/1<br>Ofruesi i shërbimit të prokurimit<br><br>1. Ofruesi i shërbimit të prokurimit është subjekt publik ose privat, i cili mund të kontraktohet nga autoriteti ose enti kontraktor me qëllim realizimin e një veprimtarie ndihmëse për prokurimin publik sipas parashikimeve të nenit 4, pika 43/1 të këtij ligji.<br><br>Entet publike, vendase ose të huaja, që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre kryerjen e veprimtarive ndihmëse për prokurimin publik, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 43/1 të këtij ligji, mund të jenë ofrues i shërbimit të prokurimit.<br><br>2. Ofruesi i shërbimit të prokurimit, e ushtron | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | veprimtarinë e tij bazuar në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br><br>3. Në rastin kur, ofruesi i shërbimit të prokurimit kontraktohet për përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoritetit ose entit kontraktor në fjalë, ai do të sillet si autoritet ose ent kontraktor.<br><br>Neni 21/2<br>Përzgjedhja e Ofruesit të shërbimit të prokurimit<br><br>1. Kontraktimi i subjekteve, ofrues të shërbimeve të prokurimit vendoset nga autoriteti ose enti kontraktor rast pas rasti, për objekte, ku vlerësohet e rëndësishme marrja e një ekspertize të jashtme.<br><br>2. Në rast se, autoriteti ose enti kontraktor vendos të kontraktojë një subjekt | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | privat, për përzgjedhjen e tij duhet t'i referohet procedurave të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br><br>Përjashtimisht, kur vlera e përllogaritur e këtij shërbimi është nën kufirin e lartë monetar, autoritetet ose entet kontraktore nuk kanë detyrimin që të zbatojnë procedurat e parashikuara nga ky ligj. Në cdo rast, në dhënien e kontratave duhet të respektojnë parimet e përzgjedhjes të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji.<br><br>2. Tarifa për kryerjen e veprimtarive ndihmëse për prokurimin publik, nga ofruesi i shërbimit do të jetë deri ne 1 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që do të prokurohet.<br><br>Pagesa për kryerjen e veprimtarive ndihmëse | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 43/1 të këtij ligji, mund të bëhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe/ose operatori ekonomik, sipas rregullave që përcakton Këshilli i Ministrave”. | | |
| Prokurim i përbashkët rastësor<br>38 (1) | Dy ose më shumë autoritete kontraktore mund të bien dakord që të kryejnë disa prokurime specifike bashkërisht. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>Blerja e përqendruar<br>53 (1) | Kur një ose më shumë autoritet ose ent kontraktor ka nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t’i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, punimeve apo shërbimeve, në emër të të tjerëve. | E plotë | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(6) | 6. Kur dy ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, puneve apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t’i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, puneve apo | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimeve në emër të të tjerëve.. | | |
| 38 (2) | Kur një procedurë prokurimi kryhet në tërësinë e saj në emër të të gjithë autoriteteve kontraktore bashkërisht, ata mbajnë përgjegjësi të përbashkët për përmbushjen e detyrimeve të tyre në zbatim të kësaj direktive. Kjo zbatohet edhe për rastet kur procedura menaxhohet nga një autoritet kontraktor, i cili vepron në emër të tij dhe në emër të autoriteteve të tjera kontraktore në fjalë.<br>Kur një procedurë prokurimi nuk kryhet në tërësinë e saj në emër të të gjithë autoriteteve kontraktore në fjalë, ata mbajnë përgjegjësi të | | | | E paperputhur | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përbashkët vetëm për ato pjesë që janë kryer bashkërisht. Çdo autoritet kontraktor mban përgjegjësi individuale për përmbushjen e detyrimeve të tij, në zbatim të kësaj direktive, në lidhje me pjesët që ai kryen në emër të tij. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurimi që përfshin autoritetet kontraktore nga shtete anëtare të ndryshme<br>39 (1) | Pa cenuar nenin 12, autoritetet kontraktore nga shtete anëtare të ndryshme mund të veprojnë në bashkëpunim për dhënien e kontratave publike duke përdorur një nga mënyrat e parashikuara në këtë nen.<br>Autoritetet kontraktore nuk përdorin mënyrat e parashikuara në këtë nen me qëllim që të shmangin zbatimin e dispozitave detyruese të së drejtës publike në përputhje me të drejtën evropiane, të cilës ata i nënshtrohen në shtetin e tyre anëtar. | | | | E papërputhur | Ky nen i drejtohet specifikisht vendeve anetare te BE-se |
| 39 (2) | Një shtet anëtar nuk ndalon autoritetet e tij kontraktore që të përdorin veprimtaritë e blerjes së përqendruar që ofrohen nga organet qendrore blerëse që ndodhen në një shtet anëtar tjetër.<br>Në lidhje me veprimtaritë e blerjes | | | | E papërputhur | Ky nen i drejtohet specifikisht vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | së përqendruar që ofrohen nga një organ qendror blerës që ndodhet në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai i autoritetit kontraktor, shtetet anëtare mund të zgjedhin të specifikojnë që autoritetet e tyre kontraktore mund të përdorin vetëm veprimtaritë e blerjes së përqendruar që përcaktohen ose në germën a ose në germën b të pikës 14 të nenit 2, paragrafi 1. | | | | | |
| 39 (3) | Ofrimi i veprimtarive të blerjes së përqendruar nga një organ qendror blerës që ndodhet në një shtet tjetër anëtar kryhet në përputhje me dispozitat kombëtare të shtetit anëtar ku ndodhet organi qendror blerës. Dispozitat kombëtare të shtetit anëtar ku ndodhet organi qendror blerës zbatohen edhe për rastet e mëposhtme: | | | | E papërputhur | Ky nen i drejtohet specifikisht vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (a) dhënia e kontratës sipas sistemit dinamik të blerjes;<br>(b) rihapja e konkurrimit sipas një marrëveshjeje kuadër;<br>(c) përcaktimi, sipas germës a ose b të nenit 33, paragrafi 4, se cili nga operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, duhet të kryejë një detyrë të caktuar. | | | | | |
| 39 (4) | Disa autoritete kontraktore nga shtete anëtare të ndryshme munden që në bashkëpunim të japin një kontratë publike, të lidhin një marrëveshje kuadër ose të përdorin një sistem dinamik blerjeje. Ata gjithashtu, deri në masën e përcaktuar në nënparagrafin e dytë të nenit 33, paragrafi 2, mund të japin një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër ose në sistemin dinamik të blerjes. Me | | | | E papërputhur | Ky nen i drejtohet specifikisht vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përjashtim të rasteve kur elementet e nevojshme janë të rregulluar nga një marrëveshje ndërkombëtare që këto shtete anëtare kanë lidhur midis tyre, autoritetet kontraktore pjesëmarrëse lidhin një marrëveshje e cila përcakton:<br>(a) përgjegjësitë e palëve dhe dispozitat kombëtare që gjejnë zbatim;<br>(b) organizimin e brendshëm të procedurës së prokurimit, duke përfshirë menaxhimin e procedurës, shpërndarjen e punëve, furnizimeve ose shërbimeve që do të prokurohen dhe lidhjen e kontratave.<br>Një autoritet kontraktor pjesëmarrës përmbush detyrimet e tij në zbatim të kësaj direktive kur ai blen punë, furnizime ose | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shërbime nga një autoritet kontraktor që është përgjegjës për procedurën e prokurimit. Kur përcaktojnë përgjegjësitë dhe legjislacionin e brendshëm që zbatohet, siç përmendet në germën a, autoritetet kontraktore pjesëmarrëse mund të ndajnë disa përgjegjësi specifike midis tyre dhe mund të përcaktojnë dispozitat e zbatueshme të legjislacioneve të brendshme të secilit prej shteteve anëtare përkatëse. Ndarja e përgjegjësive dhe legjislacioni i brendshëm i zbatueshëm përmenden në dokumentet e prokurimit për kontratat publike që jepen në bashkëpunim. | | | | | |
| 39 (5) | Kur disa autoritete kontraktore nga shtete anëtare të ndryshme | | | | E papërputhur | Ky nen i drejtohet specifikisht |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kanë ngritur një subjekt të përbashkët, duke përfshirë Grupimet Evropiane të bashkëpunimit territorial, në zbatim të Rregullores (KE) nr. 1082/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (30), ose subjekte të tjera të krijuara në zbatim të së drejtës së Bashkimit Evropian, nëpërmjet një vendimi të organit kompetent të subjektit të përbashkët, autoritetet kontraktore pjesëmarrëse bien dakord për rregullat e brendshme të zbatueshme të prokurimit të njërit prej shteteve anëtare të mëposhtme:<br>(a) dispozitat e brendshme të shtetit anëtar, ku subjekti i përbashkët ka selinë e tij;<br>(b) dispozitat e brendshme të shtetit anëtar, ku subjekti i | | | | | vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përbashkët ushtron veprimtarinë e tij. Marrëveshja e përmendur në nënparagrafin e parë mund të zbatohet ose për një periudhë të papërcaktuar, kur kjo rregullohet në një akt konstitutiv të subjektit të përbashkët, ose mund të kufizohet në një periudhë kohore të caktuar, lloje të caktuar kontratash ose në një ose më shumë prokurime individuale të kontratës. | | | | | |
| Studimi paraprak i tregut 40 | Përpara se të nisin një procedurë prokurimi autoritetet kontraktore mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurimin. Për këtë qëllim autoritetet kontraktore, për shembull, mund të kërkojnë ose të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Studimi paraprak i tregut<br>35 (1) | Përpara se të nisin një procedurë prokurimi autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim..<br><br>Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | pranojnë këshilla nga ekspertë ose autoritete të pavarura ose nga pjesëmarrësit në treg. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse këto këshilla nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe nuk çojnë në një shkelje të parimeve të mosdiskriminimit dhe transparencës. | | 35 (2) | autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cënojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës.<br><br>Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Studimi paraprak i tregut<br>14 (1) | Përpara se të nisin një procedurë prokurimi autoriteti ose enti kontraktor duhet të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin, të përditësojnë të dhënat që kanë përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të realizimit, si dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kërkesat e tyre për prokurim. | | |
| | | | 14 (2) | Studimi i tregut ka për qëllim përllogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut. | | |
| | | | 14 (3) | Autoriteti ose enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit ngarkojnë me detyrë për studimin e tregut, një ose disa persona, që mund të jenë një grup pune i ngritur për këtë qëllim çdo fillim viti, ose rast pas rasti.. | | |
| | | | 14 (4) | Për studimin e tregut, autoriteti ose enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 14 (5) | mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cënojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës. Autoriteti ose enti kontraktor, duhet të kujdesen që konsultimi të jetë sa më gjithpërfshirës dhe të shmangë dhënien e çdo informacioni preferencial, që mund të favorizojë operatorë të caktuar në përgatitjen e ofertës për procedurën e prokurimit.<br><br>Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| Përfshirja paraprake e kandidatëve ose ofertuesve<br>41 | Kur një kandidat ose ofertues ose një sipërmarrje që lidhet me një kandidat ose ofertues e ka këshilluar autoritetin kontraktor, qoftë në kontekstin e nenit 40 ose jo, ose është përfshirë në një mënyrë tjetër në përgatitjen e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor merr masat e përshtatshme për t'u siguruar që konkurrenca nuk është shtrembëruar nga | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>35 (2)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>19 (4) | Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik.<br><br><br>Në rast se, gjatë fazës së studimit paraprak të treguat, të përgatitjes së dokumentave të tenderit, ose në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej kandidatëve/ofertuesve ndodhen në kushtet e | E plotë | Detaje te tjera mbi studimin e tregut, perfshirjen e kandidateve ose ofertuesve dhe shmangien e konfliktit te interesit do te percaktohen ne aktet nenligjore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | pjesëmarrja e atij kandidati ose ofertuesi. Këto masa përfshijnë përcjelljen, te kandidatët dhe ofertuesit e tjerë, të informacionit të rëndësishëm të shkëmbyer në kontekstin e përgatitjes së procedurës së prokurimit ose si rezultat i përfshirjes së tyre në të, si dhe caktimin e afateve kohore të përshtatshme për marrjen e ofertave. Kandidati ose ofertuesi përkatës përjashtohet nga procedura vetëm kur nuk ka mjete të tjera për të garantuar pajtueshmërinë me detyrimin për të respektuar parimin e trajtimit të barabartë. Përpara një përjashtimi të tillë, kandidatëve ose ofertuesve do t'u jepet mundësia që të vërtetojnë se pjesëmarrja e tyre në përgatitjen e | | | konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për studimin e tregut/përgatitjes së dokumentave të tenderit apo vlerësimin e kërkesave/ofertave, dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohej përpara këtij momenti, atëherë titullari i autoritetit kontraktor, në varësi të dëmit që mund të jetë shkaktuar, vendos nëse duhet të zëvendësohen anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit, e të vijojë procesin, apo të anullojë procedurën e prokurimit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | procedurës së prokurimit nuk mund të shtrembërojë konkurrencën. Masat e marra do të dokumentohen në raportin individual, që kërkohet nga neni 84 | | | | | |
| Specifikimet teknike<br>42 (1) | Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të shtojcës VII, duhet të shkruhen në dokumentet e prokurimit. Në specifikimet teknike parashtrohen karakteristikat e kërkuara të punëve, shërbimit ose furnizimit.<br>Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këto faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Specifikimet teknike<br>36 (1) | Specifikimet teknike siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.<br><br>Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këto faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.<br>Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.<br>Për të gjithë prokurimin, i cili parashikohet të përdoret nga personat fizikë, qofshin këta publiku i gjerë ose stafi i autoritetit kontraktor, specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit.<br>Kur kërkesat e detyrueshme të | | | Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.<br><br>Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | aksesueshmërisë miratohen nga një akt ligjor i Bashkimit Evropian, specifikimet teknike, për sa i përket kritereve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, përcaktohen duke iu referuar atyre. | | | | | |
| 42 (2) | Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për operatorët ekonomikë në procedurën e prokurimit dhe të mos shërbejnë si pengesa të pajustifikuara për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. | | 36 (2) | Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. | E plotë | |
| 42 (3) | Pa cenuar rregullat teknike kombëtare të detyrueshme, deri në masën që ato pajtohen me të drejtën e Bashkimit Evropian, specifikimet teknike formulohen në një nga mënyrat e mëposhtme: | | 36 (3) | 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:<br><br>a) kërkesave funksionale apo të performancës, përfshirë karakteristikave mjedisore, me kusht që | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (a) sipas kërkesave të zbatimit ose atyre funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore me kusht që parametrat të jenë aq të saktë sa t'i lejojnë ofertuesve që të përcaktojnë objektin e kontratës dhe t'i lejojnë autoriteteve kontraktore që të japin kontratën;<br>(b) duke iu referuar specifikimeve teknike dhe, sipas rendit të preferencës, standardeve kombëtare që transpozojnë standardet evropiane, vlerësimit teknik evropian, specifikimeve teknike të përbashkëta, standardeve ndërkombëtare, sistemeve të tjera teknike të referencës, të krijuara nga organe evropiane të standardizimit ose, kur këto nuk ekzistojnë, standardet kombëtare, | | | parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;<br><br>b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;<br><br>c) kërkesave në terma funksionalë, sipas shkronjës "a" referuar specifikimeve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | miratimet teknike kombëtare ose specifikimet teknike kombëtare që lidhen me projektimin, llogaritjen dhe kryerjen e punëve dhe përdorimin e furnizimeve; çdo referencë shoqërohet nga fjalët "ose e barasvlershme";<br>(c) sipas kërkesave të zbatimit ose atyre funksionale, që përmenden në germën a, duke iu referuar specifikimeve teknike të përmendura në germën b, si mjet për të prezumuar përputhshmërinë me këto kërkesa zbatimi ose funksionale;<br>(d) sipas specifikimeve teknike të përmendura në germën b, për karakteristika të caktuara dhe duke iu referuar kërkesave të zbatimit ose atyre funksionale të | | | teknike sipas shkronjës “b”, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;<br><br>d) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmendura në germën a, për karakteristika të tjera. | | | | | |
| 42 (4) | Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik, apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas paragrafit 3. Referime të tilla duhet të | | 36 (4) | Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik, apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente". | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shoqërohen nga fjalët "ose e barasvlershme" | | | | | |
| 42 (5) | Kur autoriteti kontraktor zgjedh t'u referohet specifikimeve teknike të përmendura në germën b të paragrafit 3, ai nuk mund të refuzojë një ofertë me arsyen se punët, furnizimet ose shërbimet e ofertuara nuk përputhen me specifikimet teknike te të cilat ai është mbështetur, nëse ofertuesi në ofertën e tij i provon me çdo mënyrë të përshtatshme, duke përfshirë mënyrat e vërtetimit të përmendura në nenin 44, se zgjidhjet e propozuara përmbushin në nivel të barasvlershëm kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike. | | 36 (5) | Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikes 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet, për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. | E plotë | Detaje te metejshme mbi specifikimet teknike do te parashikohen ne aktet nenligjore |
| 42 (6) | Nëse autoriteti kontraktor përdor mundësinë e parashikuar në germën | | 36 (6) | Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikes 3 të | E plotë | Detaje te metejshme mbi specifikimet teknike do te |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | a të paragrafit 3, për të formuluar specifikimet teknike që lidhen me zbatimin ose kërkesat funksionale, ai nuk refuzon një ofertë për punë, furnizime ose shërbime, të cilat përputhen me një standard kombëtar që transpozon një standard evropian, me një miratim teknik evropian, me një specifikim të përbashkët teknik, me një standard ndërkombëtar ose me një sistem reference teknike të krijuar nga një organ evropian standardizimi, nëse këto specifikime trajtojnë kërkesat e zbatimit ose ato funksionale që ai ka përcaktuar.<br>Ofertuesi, në ofertën e tij, duhet të vërtetojë me çdo mjet të përshtatshëm, duke përfshirë ato të përmendura në nenin | | | këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor. | | parashikohen ne aktet nenligjore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 44, se puna, furnizimi ose shërbimi sipas standardeve, plotëson kërkesat e zbatimit ose ato funksionale të autoritetit kontraktor. | | | | | |
| Etiketat<br>43 (1) | Kur autoritetet kontraktore synojnë të blejnë punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, ata mund të kërkojnë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, nëse përmbushen të gjithë kushtet e mëposhtme:<br>(a) kërkesat e etiketës përfshijnë vetëm kritere që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Etiketat<br>37 (1) | Kur autoritetet ose entet kontraktore prokurojnë punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, ata mund të kërkojnë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, nëse përmbushen të gjithë kushtet e mëposhtme:<br><br>a) kërkesat e etiketës përfshijnë vetëm kritere që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e punëve, furnizimeve ose | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e punëve, furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës;<br>(b) kërkesat e etiketës të bazohen mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese;<br>(c) etiketat të përcaktohen me një procedurë të hapur dhe transparente ku mund të marrin pjesë të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë organet qeveritare, konsumatorët, partnerët socialë, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat joqeveritare;<br>(d) etiketat të jenë të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara,<br>(e) kërkesat e etiketës të përcaktohen nga një palë e tretë, mbi të cilën operatori ekonomik që aplikon | | | shërbimeve që janë objekt i kontratës;<br><br>b) kërkesat e etiketës të bazohen mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese;<br><br>c) etiketat të përcaktohen me një procedurë të hapur dhe transparente ku mund të marrin pjesë të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë organet qeveritare, konsumatorët, partnerët socialë, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat joqeveritare;<br><br>d) etiketat të jenë të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;<br><br>e) kërkesat e etiketës të përcaktohen nga një palë e tretë, mbi të cilën operatori ekonomik që aplikon për etiketën nuk mund të ushtrojë ndikim vendimtar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për etiketën nuk mund të ushtrojë ndikim vendimtar.<br>Kur autoritetet kontraktore nuk kërkojnë që punët, furnizimet ose shërbimet të përmbushin të gjitha kërkesat e etiketës, ata tregojnë se cilave kërkesa të etiketës u referohen.<br>Autoritetet kontraktore që kërkojnë një etiketë specifike pranojnë të gjitha etiketat që konfirmojnë se punët, furnizimet ose shërbimet plotësojnë të gjitha kërkesat e barasvlershme të etiketës.<br>Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike të cilësuar nga autoriteti kontraktor ose një etiketë të barasvlershme, brenda afateve kohore | | | Kur autoritetet ose entet kontraktore nuk kërkojnë që punët, furnizimet ose shërbimet të përmbushin të gjitha kërkesat e etiketës, ata tregojnë kërkesat e etiketës, të cilave u referohen.<br><br>Autoritetet ose entet kontraktore që kërkojnë një etiketë specifike pranojnë të gjitha etiketat që konfirmojnë se punët, furnizimet ose shërbimet plotësojnë të gjitha kërkesat e barasvlershme të etiketës.<br><br>Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti ose enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuara nga autoriteti kontraktor. | | | nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuara nga autoriteti ose enti kontraktor. | | |
| 43 (2) | Kur një etiketë përmbush kushtet e parashikuara në germat b, c, d dhe e të paragrafit 1, por përcakton edhe kërkesa që nuk lidhen me objektin e kontratës, autoritetet kontraktore nuk e kërkojnë etiketën si të tillë por mund të përcaktojnë specifikimin teknik | | 37 (2) | Kur një etiketë përmbush kushtet e parashikuara në gërmat “b”, “c”, “d” dhe “e” të pikës 1, por përcakton edhe kërkesa që nuk lidhen me objektin e kontratës, autoriteti ose enti kontraktor nuk e kërkon etiketën si të tillë, por mund të përcaktojnë specifikimin teknik duke iu referuar specifikimeve të detajuara të asaj etikete, ose, kur | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | duke iu referuar specifikimeve të detajuara të asaj etikete, ose, kur është e nevojshme, pjesëve të tyre, që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e këtij objekti. | | | është e nevojshme, pjesëve të tyre, që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e këtij objekti. | | |
| Raportet e testimit, certifikimi dhe mënyra të tjera vërtetimi<br>44 (1) | Autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të paraqesin një raport testimi të hartuar nga një organ për vlerësimin e pajtueshmërisë ose një certifikatë të lëshuar nga ky organ, si një mënyrë për të vërtetuar pajtueshmërinë me kërkesat ose kriteret e përcaktuara në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose kushtet për zbatimin e kontratës.<br>Kur autoritetet kontraktore kërkojnë | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor.<br>79 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, e plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.<br><br>Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dorëzimin e certifikatave të hartuara nga një organ specifik për vlerësimin e pajtueshmërisë, ato pranojnë edhe certifikata nga organe të ngjashme për vlerësimin e pajtueshmërisë.<br>Për qëllimin e këtij paragrafi, organi për vlerësimin e pajtueshmërisë është një organ që kryen veprimtari të vlerësimit të pajtueshmërisë, duke përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin, i akredituar në përputhje me Rregulloren (KE) 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (31). | | | | | |
| 44 (2) | Autoritetet kontraktore pranojnë mënyra prove të përshtatshme, të ndryshme nga ato që përmenden në paragrafin 1, siç është dosja teknike e prodhuesit, kur | | 79 (3) | Në rastet kur, operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një çertifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë | E plotë | Detaje te metejshme do te percaktohen ne aktet nenligjore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | operatori ekonomik në fjalë nuk ka pasur akses në certifikatat ose në raportet e testimit që përmenden në paragrafin 1, ose nuk ka pasur asnjë mundësi për t'i marrë ato brenda afateve kohore përkatëse, nëse mungesa e aksesimit nuk është shkaktuar nga ky operator ekonomik dhe nëse ky operator ekonomik vërteton nëpërmjet tyre se punët, furnizimet ose shërbimet e ofruara nga ai përmbushin kërkesat ose kriteret e përcaktuara në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose kushtet për zbatimin e kontratës. | | | dokumenta të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. | | |
| 44 (3) | Shtetet anëtare u japin shteteve të tjera anëtare, me kërkesë të tyre, çdo informacion që lidhet me provat dhe dokumentet e dorëzuara në përputhje | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | me nenin 42, paragrafi 6, nenin 43 dhe paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku është themeluar operatori ekonomik, e ofrojnë këtë informacion në përputhje me nenin 86. | | | | | |
| Variantet<br>45 (1) | Autoritetet kontraktore mund të autorizojnë ose t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin variante. Ata e përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose, kur si mjet për të ftuar në konkurrim përdoret një njoftim paraprak informacioni, në ftesën për shprehje interesi, nëse ato autorizojnë ose kërkojnë variante. Variantet nuk autorizohen pa këtë përcaktim. Variantet lidhen me objektin e kontratës. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Alternativat<br>38 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor mund të autorizojnë ose t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin alternativa. Ata e përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose, kur si mjet për të ftuar në konkurrim përdoret një njoftim paraprak ose periodik informacioni, në ftesën për shprehje interesi, nëse autorizojnë ose kërkojnë alternativa, në të kundërt alternativat nuk do të lejohen. Në çdo rast, alternativat lidhen me objektin e kontratës. | E plotë | |
| 45 (2) | Autoritetet kontraktore që autorizojnë ose kërkojnë variante | | 38 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor që autorizon ose kërkon alternativa deklaron | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | deklarojnë në dokumentet e prokurimit kërkesat minimale që duhet të plotësojnë variantet dhe çdo kërkesë specifike për paraqitjen e tyre, në veçanti nëse variantet mund të dorëzohen vetëm pasi të jetë dorëzuar oferta, e cila nuk është një variant. Ata gjithashtu garantojnë që kriteret e përzgjedhura për shpalljen e kontratës fituese, të mund të zbatohen për variantet që përmbushin këto kërkesa minimale si edhe për ofertat e pajtueshme që nuk janë variante. | | | në dokumentet e tenderit kërkesat minimale që duhet të plotësojnë alernativat dhe çdo kërkesë specifike për paraqitjen e tyre, në veçanti nëse alernativat mund të dorëzohen vetëm pasi të jetë dorëzuar oferta, e cila nuk është një alternative. Ata, gjithashtu, garantojnë që kriteret e përzgjedhura për shpalljen e kontratës fituese, të mund të zbatohen për alternativat që përmbushin këto kërkesa minimale, si edhe për ofertat e pajtueshme që nuk janë alternativa. | | |
| 45 (3) | Merren parasysh vetëm ato variante që plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara nga autoritetet kontraktore. Në procedurat e prokurimit të kontratave publike për furnizime ose për | | 38 (3) | Në çdo rast, merren parasysh vetëm ato alternativa që plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktore.<br><br>Në procedurat e prokurimit të kontratave publike për furnizime ose për shërbime, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shërbime, autoritetet kontraktore që kanë autorizuar ose kërkuar variantet nuk mund ta refuzojnë një variant me arsyen e vetme që, nëse është i suksesshëm, do të çojë në një kontratë për shërbime në vend të një kontrate publike për furnizime ose në një kontratë për furnizime në vend të një kontrate publike për shërbime. | | | autoriteti ose enti kontraktor që ka autorizuar ose kërkuar alernativat nuk mund ta refuzojë një alternative me arsyen e vetme që, nëse është i suksesshëm, do të çojë në një kontratë për shërbime në vend të një kontrate publike për furnizime ose në një kontratë për furnizime në vend të një kontrate publike për shërbime. | | |
| Ndarja e kontratave në lote<br>46 (1) | Autoritetet kontraktore mund të vendosin të japin një kontratë në formën e loteve të veçanta dhe mund të përcaktojnë madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.<br>Autoritetet kontraktore, përveçse në lidhje me kontratat, ndarja e të cilave është bërë e detyrueshme në zbatim të paragrafit 4 të këtij neni, parashikojnë një përcaktim të arsyeve kryesore për vendimin e tyre për të mos e | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Ndarja e kontratave në lote<br>39 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.<br><br>Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ndarë atë në lote, i cili përfshihet në dokumentet e prokurimit ose në raportin individual të përmendur në nenin 84. | | | tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote<br>43 (1)<br><br><br><br>43 (2) | Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.<br><br>Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.<br><br>Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale. | | |
| 46 (2) | Autoritetet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>39 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | disa ose për të gjitha lotet.<br>Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoritetet kontraktore mund të kufizojnë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi. Kur zbatimi i kritereve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoritetet kontraktore përcaktojnë në dokumentet e prokurimit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar se cilat lote do të jepen. | | | një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.<br><br>Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.<br><br>Kur zbatimi i kritereve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>43 (3)<br><br><br><br><br>43 (4)<br><br><br><br><br>43 (5) | Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 43 (6) | në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.<br><br>Kur zbatimi i kritereve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kritere duhet të jenë në përputhje me LPP dhe me ato të përcaktuara në nenin 92 të këtyre rregullave. | | |
| 46 (3) | Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore të mund të japin kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>39 (3) | Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen. | | | dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>43 (7) | Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen. | | |
| 46 (4) | Shtetet anëtare mund të zbatojnë nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 duke e bërë të detyrueshme dhënien e kontratave në formën e loteve të veçanta, sipas kushteve që do të specifikohen në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe duke marrë në konsideratë të drejtën e Bashkimit Evropian. Në këto rrethana zbatohet nënparagrafi i parë i paragrafit 2 dhe, kur | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>39 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.<br><br>Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | është e nevojshme, paragrafi 3. | | | tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>43 (1)<br><br><br><br>43 (2) | Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.<br><br>Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.<br><br>Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale. | | |
| Caktimi i afateve kohore 47 (1) | Në përcaktimin e afateve kohore për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, autoritetet kontraktore marrin veçanërisht parasysh | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Caktimi i afateve kohore<br>40 (1) | Në përcaktimin e afateve kohore për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti ose enti kontraktor merr veçanërisht parasysh kompleksitetin e kontratës | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kompleksitetin e kontratës dhe kohën e nevojshme për hartimin e ofertave, pa cenuar afatet minimale të përcaktuara në nenet 27 deri në 31. | | | dhe kohën e nevojshme për hartimin e ofertave, pa cënuar afatet minimale të përcaktuara në këtë ligj. | | |
| 47 (2) | Kur ofertat mund të hartohen vetëm pas një vizite në terren ose pas një inspektimi në vend të dokumenteve që mbështesin dokumentet e prokurimit, atëherë afatet kohore për marrjen e ofertave caktohen më të gjata se afatet kohore minimale të përcaktuara në nenet 27 deri në 31, me qëllim që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për të përgatitur ofertat. | | 40 (2) | Kur autoriteti ose enti kontraktor parashikon mundësinë e një vizite në terren ose inspektim në vend të dokumenteve që mbështesin dokumentet e tenderit, duhet të mbajnë në konsideratë të caktojnë afatet kohore për marrjen e ofertave më të gjata se afatet kohore minimale të përcaktuara në këtë ligj, me qëllim që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për të përgatitur ofertat. | E plotë | |
| 47 (3) | Autoritetet kontraktore zgjasin afatet kohore për marrjen e ofertave, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të marrin të gjithë informacionin | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Sqarimet dhe ndryshimi në | Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me | E pjesshme | Ligji ne ndryshim nga direktiva parashikon shtyrjen e afatit te dorezimit te ofertave ne |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | e nevojshëm, për të përgatitur ofertat për rastet e mëposhtme:<br>(a) kur, për çfarëdo arsye, informacioni shtesë, edhe pse kërkohet në kohë nga operatori ekonomik, nuk jepet maksimumi gjashtë ditë përpara afatit kohor të përcaktuar për marrjen e ofertave. Në rastin e një procedure të përshpejtuar, siç përmendet në nenin 27, paragrafi 3 dhe nenin 28, paragrafi 6, kjo periudhë është katër ditë;<br>(b) kur në dokumentet e prokurimit bëhen ndryshime thelbësore.<br>Afati i shtyrjes është proporcional me rëndësinë e informacionit ose të ndryshimit.<br>Kur informacioni shtesë nuk është kërkuar në kohë ose kur rëndësia e tij në | | dokumentet e tenderit<br><br>75 (2) | nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce.<br><br>Nëse ndryshimi i dokumentave të tenderit, bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.<br><br>Nëse, ndryshimi i dokumentave të tenderit, bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës, me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar. | | varesi te kohes se kur eshte bere ndryshimi ne dokumentat e tenderit.<br><br>Kjo behet me qellim qe te lehtesohet biznesi vendas per t'u lene atyre mundesine e ofertimit dhe rritur shanset per te patur me shume konkurrence |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | funksion të përgatitjes së ofertave të kualifikuara është e papërfillshme, autoriteteve kontraktore nuk u kërkohet që të shtyjnë afatet kohore. | | | | | |
| Njoftimet paraprake të informacionit 48 (1) | Autoritetet kontraktore mund të bëjnë me dije synimet e tyre për prokurimet e planifikuara nëpërmjet shpalljes së një njoftimi paraprak të informacionit. Këto njoftime përmbajnë informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesa B seksioni I. Ato shpallen ose nga Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian ose nga autoritetet kontraktore në profilet e tyre të blerësit në përputhje me pikën 2 germa b të shtojcës VIII. Kur njoftimi paraprak i informacionit shpallet nga autoritetet kontraktore në profilet | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Njoftimi paraprak i informacionit<br>57 (1) | Autoritetet kontraktore mund të japin informacion për prokurimet e planifikuara nëpërmjet shpalljes së një njoftimi paraprak. Këto njoftime përmbajnë informacionin, i cili përcaktohet në rregullat e prokurimit publik dhe shpallen në sistemin e prokurimit elektronik, sipas parashikimeve në këtë ligj. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Njoftimi paraprak i informacionit<br>17 (1) | Pasi autoriteti kontraktor ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim paraprak të informacionit. Njoftimi paraprak i informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | e tyre të blerësit, ata dërgojnë një njoftim për shpallje në profilin e tyre të blerësit në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian në përputhje me shtojcën VIII. Këto njoftime përfshijnë informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesa A. | | 17 (2)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>17 (3) | Në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimet paraprake të të informacionit qëndrojnë të publikuara:<br>a) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;<br>b) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem dinamik blerjeje, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes.<br>Njoftimi paraprak i informacionit përmbantë paktën :<br>- emrin, adresën dhe kontaktet e autoritetit kontraktor;<br>- emrin dhe kontaktet e Personit përgjegjës të prokurimit;<br>- objektin e kontratës dhe kodi përkatës në Fjalorin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përbashkët të prokurimit (CPV);<br>- llojin e procedurës së prokurimit;<br>- tip i kontratës;<br>- vlerën limit të përllogaritur të kontratës; /vlerën limit të përllogaritur për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;<br>- kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;<br>- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;<br>- llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;<br>- kohën e përafërt të zhvillimit të procedurës së prokurimit;<br>- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (4) | autoriteti ose enti kontraktor.<br>Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negocim, kur autoritetet kontraktore e përdorin njoftimin paraprak të informacionit  si një ftesë për ofertë sipas parashikimeve në LPP, ky njoftim, veç informacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përmban edhe:<br>- Një përshkrim specifik për furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës;<br>- përcaktimin se, kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim, pa shpallje të mëtejshme të një ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (5) | shprehur interesin e tyre.<br>Autoriteti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim si njoftim paraprak të informacionit, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në LPP dhe në këtë nen, dhe është publikuar jo më larg se 12 muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj. | | |
| | | | 17(6) | Për njoftimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 57 të LPP-së dhe pikës 3 të këtij neni, afati i përcaktuar në pikën 5, përllogaritet nga data kur dërgohet ftesa për ofertë. | | |
| | | | 17 (7) | Nga afati i përcaktuar në pikën 5, bëjnë përjashtim njoftimet për kontratat për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, ku njoftimi paraprak i informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 muaj. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 48 (2) | Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negocim, autoritetet kontraktore nënqendrore mund të përdorin njoftimin paraprak të informacionit si një ftesë për konkurrim sipas nenit 26, paragrafi 5 nëse ky njoftim përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(a) ai përmend specifikisht furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës që do të jepet;<br>(b) ai përcakton se kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim pa shpallje të mëtejshme të një ftese për konkurrim dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>57 (2) | Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negocim, autoritetet kontraktore mund të përdorin njoftimin paraprak si një ftesë për ofertë sipas parashikimeve në këtë ligj, nëse ky njoftim përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:<br><br>a) përmend specifikisht furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës;<br><br>b) përcakton se, kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim, pa shpallje të mëtejshme të një ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të shprehur interesin e tyre;<br><br>c) përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik;<br><br>d) është shpallur nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shprehur interesin e tyre;<br>(c) ai përmban, përveç informacionit të përcaktuar në shtojcën V pjesa B seksioni I, edhe informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesa B seksioni II;<br>(d) është dërguar për shpallje nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës në të cilën është dërguar ftesa e përmendur në nenin 54, paragrafi 1.<br>Këto njoftime nuk shpallen në profilin e blerësit. Megjithatë, shpallja shtesë në nivel kombëtar sipas nenit 52, nëse ka, mund të bëhet në profilin e blerësit.<br>Periudha që mbulohet nga njoftimi paraprak i informacionit është maksimumi 12 muaj nga data kur njoftimi dërgohet për shpallje. Megjithatë, në rastet e kontratave për shërbime sociale dhe | | | datës, në të cilën është dërguar ftesa.<br><br>Periudha që mbulohet nga njoftimi paraprak i informacionit është maksimumi 12 muaj nga data e shpalljes së njoftimit. Megjithatë, në rastet e kontratave për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, njoftimi paraprak i informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 muaj. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Njoftimi paraprak i informacionit<br>17 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br>17 (2) | Pasi autoriteti kontraktor ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim paraprak të informacionit. Njoftimi paraprak i informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.<br><br>Në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimet paraprake të të informacionit qëndrojnë të publikuara: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shërbime të tjera specifike, njoftimi paraprak i informacionit që përmendet në germën b të nenit 75, paragrafi 1 mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 muaj. | | 17 (3) | c) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;<br>d) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem dinamik blerjeje, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes.<br>Njoftimi paraprak i informacionit përmbantë paktën :<br>- emrin, adresën dhe kontaktet e autoritetit kontraktor;<br>- emrin dhe kontaktet e Personit përgjegjës të prokurimit;<br>- objektin e kontratës dhe kodi përkatës në Fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV);<br>- llojin e procedurës së prokurimit;<br>- tip i kontratës; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (4) | - vlerën limit të përllogaritur të kontratës; /vlerën limit të përllogaritur për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;<br>- kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;<br>- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;<br>- llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;<br>- kohën e përafërt të zhvillimit të procedurës së prokurimit;<br>- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti ose enti kontraktor.<br>Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negocim, kur autoritetet kontraktore e përdorin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 17 (5) | njoftimin paraprak të informacionit si një ftesë për ofertë sipas parashikimeve në LPP, ky njoftim, veç informacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përmban edhe:<br>- Një përshkrim specifik për furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës;<br>- përcaktimin se, kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negocim, pa shpallje të mëtejshme të një ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të shprehur interesin e tyre.<br>Autoriteti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim si njoftim paraprak të informacionit, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | LPP dhe në këtë nen, dhe është publikuar jo më larg se 12 muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj. | | |
| | | | 17(6) | Për njoftimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 57 të LPP-së dhe pikës 3 të këtij neni, afati i përcaktuar në pikën 5, përllogaritet nga data kur dërgohet ftesa për ofertë. | | |
| | | | 17 (7) | Nga afati i përcaktuar në pikën 5, bëjnë përjashtim njoftimet për kontratat për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, ku njoftimi paraprak i informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 muaj. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Njoftimet e kontratës<br>49 | Njoftimet e kontratës përdoren si një mënyrë për të ftuar për konkurrim në lidhje me të gjitha procedurat, pa cenuar nënparagrafin e dytë të nenit 26, paragrafi 5 dhe nenin 32. Njoftimet e kontratës përmbajnë informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesa C dhe shpallen në përputhje me nenin 51. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Forma dhe mënyra e shpalljes së njoftimeve<br>56 (3)<br><br>56 (4) | Në njoftimet që publikohen sipas këtij ligji, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që i lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit.<br><br>Përmbajtja e njoftimeve përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Njoftimet për shpalljen e kontratës fituese 50 (1) | Jo më vonë se 30 ditë pas lidhjes së një kontrate ose një marrëveshjeje kuadër, pas vendimit për ta dhënë ose lidhur këtë kontratë, autoritetet kontraktore dërgojnë një njoftim për shpalljen e kontratës fituese mbi bazën e rezultateve të procedurës së prokurimit.<br>Këto njoftime përmbajnë informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesa D dhe shpallen në përputhje me nenin 51. | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Njoftimi i fituesit<br>33 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>33 (2)<br><br><br><br><br><br><br><br>33 (3) | Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, autoriteti ose enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.<br><br>Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të LPP dhe këtyre rregullave.<br><br>Njoftimi i fituesit për kontratën duhet të përmbajë të paktën:<br>- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 33 (4) | - referencën e procedurës;<br>- emrin, Nipt-in dhe adresën e ofertuesit të shpallur fitues;<br>- përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve;<br>- kohëzgjatjen e kontratës dhe çmimin/vlerën e kontratës;<br>- emrat, Nipt-et dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;<br>- emrat, Nipt-et e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;<br><br>Njoftimi i fituesit për marrëveshjen kuadër duhet të përmbajë të paktën:<br>- referencën e procedurës;<br>- emrin, Nipt-in dhe adresën e ofertuesit/ofertuesve të shpallur fitues;<br>- përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër;<br>- emrat, Nipt-et dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;<br>emrat, Nipt-et e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit. | | |
| 50 (2) | Kur ftesa për konkurrim për këtë kontratë është bërë në formën e një njoftimi paraprak të informacionit dhe autoriteti kontraktor ka vendosur se nuk do të japë kontrata të tjera gjatë periudhës që mbulohet nga njoftimi paraprak i | | | | E papërputhur | Detajet e metejshme do te percaktohen ne aktet nenligjore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | informacionit, njoftimi për shpalljen e kontratës fituese përmban një përcaktim specifik për këtë qëllim.<br>Në rastin e marrëveshjeve kuadër të lidhura në përputhje me nenin 33, autoritetet kontraktore nuk kanë detyrimin të dërgojnë njoftimin e rezultateve të procedurës së prokurimit për çdo kontratë të mbështetur në atë marrëveshje.<br>Shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore t'i grupojnë njoftimet e rezultateve të procedurës së prokurimit për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër, për çdo tre muaj. Në këto raste autoritetet kontraktore dërgojnë njoftimet e grupuara brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tre mujori. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 50 (3) | Autoritetet kontraktore dërgojnë njoftimin për shpalljen e kontratës fituese brenda 30 ditëve pas shpalljes fituese të çdo kontrate që bazohet mbi një sistem dinamik blerjeje. Megjithatë, ata mund t'i grupojnë njoftimet mbi bazë tre-mujore. Në këto raste ata i dërgojnë njoftimet e grupuara brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tre mujori. | | | | E papërputhur | |
| 50 (4) | Informacione të caktuara për shpalljen e kontratës fituese ose lidhjen e marrëveshjes kuadër mund të mos bëhen publike në rastet kur dhënia e tyre do të pengonte zbatimin e ligjit ose, në të kundërt, do të ishte në kundërshtim me interesin publik, do të dëmtonte interesat tregtare legjitime të një operatori ekonomik të caktuar, publik ose privat, ose do të mund | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>E drejta për informim<br>81 (3) | Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet ose entet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cënon interesin publik apo interesat ligjorë dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë. Nëse disa pjesë të ofertës së operatorëve | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të cenonte konkurrencën e ndershme midis operatorëve ekonomikë. | | | ekonomikë deklarohen si konfidenciale, atëherë këto dokumente nuk do të vihen në dispozicion të kërkuesve. | | |
| Forma dhe mënyra e shpalljes së njoftimeve<br>51 (1) | Njoftimet e përmendura në nenet 48, 49 dhe 50 përfshijnë informacionin e përcaktuar në shtojcën V në formularë standardë, duke përfshirë formularët standardë për korrigjimet.<br>Komisioni përcakton këto formularë standard, me anë të akteve zbatuese. Këto akte ligjore zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 89, paragrafi 2. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>Forma dhe mënyra e shpalljes së njoftimeve<br>56 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br>56 (2)<br><br><br><br><br><br><br><br>56 (3) | Njoftimet e procedurave të prokurimit sipas këtij ligji publikohen në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë ligj, në sistemin e prokurimit elektronik dhe në mënyrë të shkurtuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i cili përgatitet dhe publikohet periodikisht.<br><br>Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, njoftimet publikohen edhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, me përjashtim të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të procedurës së anuluar.<br><br>Në njoftimet që publikohen sipas këtij ligji, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që i lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 56 (4)<br><br>56 (5) | Përmbajtja e njoftimeve përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.<br><br>Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Buletini i Njoftimeve Publike<br>6 (1)<br><br>6 (2) | APP publikon Buletinin e Njoftimeve Publike çdo ditë të hënë. Në rastet kur, dita e hënë përkon ditë pushimi, publikimi bëhet ditën e nesërme të punës. APP publikon Buletinin e Njoftimeve Publike në çdo rast tjetër, të parashikuar në akte të tjera ligjore, ose me vendim të posaçëm të saj.<br><br>Në Buletinin e Njoftimeve Publike publikohen, në përputhje me LPP dhe rregullat e prokurimit publik:<br>a) njoftimi i shkurtuar i kontratës për procedurat e prokurimit me vlerë mbi dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nën kufijtë e ulët monetarë, sipas parashikimit të nenit 12, të këtyre rregullave;<br>b) njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur dhe njoftimi i anulimit;<br>c) lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik, nga koncesionet/partneriteti publik privat apo nga pjesëmarrja në ankandet publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë të nenit 78 të LPP-së;<br>d) çdo njoftim tjetër publik, informacion apo akt tjetër, që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve<br>7 (1)<br><br>7 (2) | duhet të publikohet në përputhje me LPP, dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br><br>Njoftimet e procedurave të prokurimit dhe konkursit të projektimit publikohen në përputhje me afatet e përcaktuara në LPP dhe në këto rregulla.<br><br>Njoftimet bëhen në sistemin e prokurimit elektronik dhe në mënyrë të shkurtuar në Buletinin e Njoftimeve Publike.<br><br>Njoftimet, sipas parashikimeve të nenit 56 të LPP, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, publikohen edhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.<br><br>Hedhja e njoftimit të kontratës dhe e dokumenteve të tenderit në sistemin elektronik bëhet | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 7 (3)<br><br>7 (4) | nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Në cdo rast, përmbajtja e njoftimit të kontratës dhe dokumentave të tenderit duhet të përputhen me versionin e miratuar nga autoriteti ose enti kontraktor. Shpallja e njoftimit në sistemin e prokurimit elektronik do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.<br><br>Në njoftimet që publikohen sipas LPP, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që i lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit. Në çdo rast, njoftimet do të bëhen sipas formatit, pjesë e dokumentave standarte të tenderit për çdo procedurë.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor dërgon për publikim, njoftimin e fituesit, në përputhje me parashikimet e nenit 97 të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 7 (5) | LPP, dhe njoftimin e lidhjes së kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.<br><br>Në rastin e prokurimit të përqendruar, autoritetet ose entet kontraktore përfituese duhet të dërgojnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë organit qendror blerës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Organi qendror blerës dërgon për publikim, njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti/ enti kontraktor.<br><br>Në rastin e delegimit të prokurimit, autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e duhet të dërgojë/jnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë autoritetit kontraktor, i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Ky i fundit dërgon për publikim | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 7 (6)<br><br>7 (7) | njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti kontraktor.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave, ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën.<br><br>Hedhja në sistemin elektronik të njoftimit të fituesit, njoftimit të anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Shpallja e njoftimit të fituesit, njoftimit të anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në faqen e internetit të APP-së do të bëhet publike ditën e nesërme të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | punës, nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem. | | |
| | | | 7 (8) | Në rast se, njoftimet e fituesit, njoftimet e anulimit dhe njoftimit e kontratës së lidhur nuk janë hartuar në përputhje me formën dhe mënyrën e përcaktuar në këto rregulla, APP kthen dhe këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tyre në përputhje me këto kërkesa. | | |
| | | | 7 (9) | Për të gjitha njoftimet që bëhen sipas LPP dhe këtyre rregullave në sistemin elektronik të prokurimit, afatet fillojnë të përllogariten nga dita pasardhëse e punës. | | |
| | | | 7 (10) | Afatet, kur nuk përcaktohet ndryshe në LPP dhe në këto rregulla, janë në ditë kalendarike, dhe përllogariten sipas përcaktimit në Kodin e Procedurave Administrative. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 7 (11) | Në rastin kur, procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të dërgojë në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar të njoftimit të kontratës dhe një kopje elektronike (CD) të të gjitha dokumenteve të tenderit. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për barazvlefshmërinë e kopjes së sipërpërmendur, së bashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga njësia e prokurimit dhe që administrohen prej tij.<br><br>APP-ja publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit. Ky Buletin publikohet në faqen e saj zyrtare të internetit. Njohja dhe shkarkimi elektronik i Buletinit të Njoftimeve Publike duhet të jetë lehtësisht i përdorshëm nga cdo operator ekonomik dhe cdo i interesuar. E njëjta procedurë publikimi, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njohje, shkarkimi dhe përdorimi do të ndiqet edhe në rastet e sqarimeve apo të ndryshimeve të dokumenteve të tenderit, të bëra pas publikimit të parë. Gjithashtu, në rastet kur, procedurat e prokurimit zhvillohet në formë shkresore, njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur dhe njoftimi i anulimit, dërgohen në APP me shkresë përcjellëse dhe në formë elektronike (CD), sipas udhëzimeve të APP. | | |
| 51 (2) | Njoftimet e përmendura në nenet 48, 49 dhe 50 hartohen, transmetohen nëpërmjet mjeteve elektronike në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian dhe shpallen në përputhje me shtojcën VIII. Njoftimet shpallen jo më vonë se pesë ditë pasi dërgohen. Kostot e shpalljes së njoftimeve nga Zyra e | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Publikimeve e Bashkimit Evropian merren përsipër nga Bashkimi Evropian. | | | | | |
| 51 (3) | Njoftimet që përmenden në nenet 48, 49 dhe 50 shpallen të plota në gjuhët zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian, që zgjidhen nga autoriteti kontraktor. Versioni i asaj gjuhe ose versionet e atyre gjuhëve përbëjnë tekstin e vetëm ose tekstet e vetme origjinale. Përmbledhja e elementëve të rëndësishme të secilit njoftim shpallet në gjuhët e tjera zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE-se |
| 51 (4) | Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian garanton që teksti i plotë dhe përmbledhja e njoftimeve paraprake të informacionit që përmenden në nenin 48, paragrafi 2 dhe ftesat për konkurrim që | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet zyres se publikimeve te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përcaktojnë një sistem dinamik blerjeje, siç përmendet në germën a të nenit 34, paragrafi 4 të vazhdojnë të publikohen:<br>(a) në rastin e njoftimeve paraprake të informacionit, për 12 muaj ose deri në marrjen e një njoftimi për dhënien e kontratës, siç parashikohet në nenin 50 duke përcaktuar se nuk do të jepet asnjë kontratë tjetër gjatë periudhës 12 mujore që mbulohet nga ftesa për konkurrim. Megjithatë, në rastin e kontratave publike për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, njoftimi paraprak i informacionit që përmendet në germën b të nenit 75 të paragrafit 1 vazhdon të shpallet deri në përfundim të periudhës së tij të vlefshmërisë të përcaktuar fillimisht | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ose deri në marrjen e një njoftimi për shpalljen e kontratës fituese, siç parashikohet në nenin 50, duke përcaktuar se nuk do të jepet asnjë kontratë tjetër gjatë periudhës që mbulohet nga ftesa për konkurrim;<br>(b) në rastet e ftesave për konkurrim që krijojnë një sistem dinamik blerjeje, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes. | | | | | |
| 51 (5) | Autoritetet kontraktore duhet të jenë në gjendje të japin prova të datave në të cilat janë dërguar njoftimet.<br>Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian i dërgon autoritetit kontraktor konfirmimin e marrjes së njoftimit dhe të shpalljes së informacionit të dërguar, duke treguar datën e kësaj shpalljeje. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare dhe zyres se publikimeve te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ky konfirmim shërben si provë e shpalljes. | | | | | |
| 51 (6) | Autoritetet kontraktore mund të shpallin njoftime për kontrata publike që nuk i nënshtrohen kërkesave për shpallje të përcaktuara në këtë direktivë, nëse këto njoftime dërgohen në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian, nëpërmjet mjeteve elektronike në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetimin, përcaktuar në shtojcën VIII. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare dhe zyres se publikimeve te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpallja në nivel kombëtar 52 (1) | Njoftimet e përmendura në nenin 48, 49 dhe 50 dhe informacioni që ata përmbajnë nuk shpallet në nivel kombëtar përpara shpalljes sipas nenit 51. Megjithatë, shpallja në çdo rast mund të kryhet në nivel kombëtar kur autoritetet kontraktore nuk janë njoftuar për shpalljen brenda 48 orëve nga konfirmimi i marrjes së njoftimit në përputhje me nenin 51. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE-se |
| 52 (2) | Njoftimet që shpallen në nivel kombëtar nuk përfshijnë asnjë informacion tjetër përveç informacionit të përfshirë në njoftimet që i janë dërguar Zyrës së Publikimeve të Bashkimit Evropian ose të shpallur në profilin e blerësit, por tregojnë datën e dërgimit të njoftimit në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare dhe zyres se publikimeve te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ose shpalljen e tij në profilin e blerësit. | | | | | |
| 52 (3) | Njoftimet paraprake të informacionit nuk shpalljen në profilin e blerësit përpara dërgimit në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian të njoftimit për shpalljen e tyre në këtë formë. Aty cilësohet data e dërgimit. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare dhe zyres se publikimeve te BE-se |
| Disponueshmëria e dokumenteve të prokurimit në formë elektronike<br>53 (1) | Autoritetet kontraktore, nëpërmjet mjeteve elektronike, ofrojnë liri shikimi të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të prokurimit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit në përputhje me nenin 51 ose nga data në të cilën është dërguar ftesa për shprehje interesi. Teksti i njoftimit ose ftesës për shprehje interesi specifikon adresën e internetit ku mund të gjenden | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Dokumentet e tenderit<br>74 (2) | Autoritetet ose entet kontraktore, nëpërmjet mjeteve elektronike, ofrojnë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi. Kur mënyra e thirrjes për konkurim është një njoftim për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, ky akses ofrohet jo më vonë nga momenti i dërgimit të ftesës për ofertë ose për të negociuar. Përmbajtja e njoftimit ose ftesës për | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dokumentet e prokurimit.<br>Kur nuk mund të ofrojnë liri shikimi të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të prokurimit, për një nga arsyet e përcaktuara në nënparagrafin e dytë të nenit 22, paragrafi 1, autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë në njoftim ose në ftesën për shprehje interesi, se këto dokumente prokurimi do të transmetohen nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Në këto raste, afati kohor për dorëzimin e ofertave shtyhet me pesë ditë, përveç rasteve të urgjencës së vërtetuar siç duhet, që | | 74 (3) | shprehje interesi specifikon adresën e internetit, ku mund të gjenden dok.<br><br>Kur nuk mund të ofrojnë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të tenderit, autoritetet kontraktore ose entet mund të përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, se këto dokumente tenderi do t’u vendosen në dispozicion nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike. Në këtë rast, afati për dorëzimin e ofertave zgjatet me 5 ditë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmenden në nenin 27 paragrafi 3, nenin 28 paragrafi 6 dhe nënparagrafin e katërt të nenit 29, paragrafi 1. Kur liria e shikimit e pakufizuar, e plotë dhe e drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, e disa dokumenteve prokurimi nuk mund të ofrohet sepse autoritetet kontraktore synojnë të zbatojnë nenin 21, paragrafi 2 të kësaj direktive, ata tregojnë në njoftimin ose ftesën për shprehje interesi, se çfarë masash për mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit kërkojnë ata dhe si mund të përfitohet liria e shikimit të këtyre dokumente. Në këto raste, afati kohor për dorëzimin e ofertave shtyhet me pesë ditë, përveç rasteve të urgjencës së vërtetuar siç duhet, që | | 74 (4) | Në rastet kur, objekti i prokurimit nuk zhvillohet me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor, me kërkesë të operatorëve ekonomikë, duhet të vërë në dispozicion të të interesuarëve dokumentet e tenderit, kundrejt pagesës, me një çmim i cili nuk duhet të tejkalojë atë që është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet për kopjimin e dokumenteve të tenderit Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmenden në nenin 27 paragrafi 3, nenin 28 paragrafi 6 dhe nënparagrafin e katërt të nenit 29, paragrafi 1. | | | | | |
| 53 (2) | Nëse kjo kërkohet brenda afatit të caktuar, autoritetet kontraktore u ofrojnë të gjithë ofertuesve që marrin pjesë në procedurën e prokurimit, informacione shtesë që lidhen me specifikimet dhe dokumentet shtesë, jo më vonë se gjashtë ditë përpara afatit të përcaktuar për pranimin e ofertave. Në rastin e një procedure të përshpejtuar, siç përmendet në nenin 27, paragrafi 3 dhe nenin 28 paragrafi 6, kjo periudhë është katër ditë. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit<br>75 (1) | Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.<br><br>Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. | E pjesshme | Parashikohet mundesia e dhenies se sqarimeve me kusht qe keto te jen kerkuar te pakten 5 dite para perfundimit te afatit per dorezimin e ofertave |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në çdo rast, sqarim i dokumentave të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim apo ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentat e tenderit. | | |
| Ftesat për kandidatët 54 (1) | Në procedurat e kufizuara, procedurat me dialog konkurrues, partneritetet për novacion dhe procedurat konkurruese me negocim, autoritetet kontraktore ftojnë njëherazi me shkrim kandidatët e përzgjedhur për të paraqitur ofertat e tyre ose në rastin e dialogut konkurrues, për të marrë pjesë në dialog. Kur një njoftim paraprak i informacionit përdoret si ftesë për konkurrim sipas nenit 48, paragrafi 2, autoritetet kontraktore ftojnë, njëherazi me shkrim, operatorët ekonomikë | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Ftesa për Ofertë 58 (1) | Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti ose enti kontraktor fton nëpërmjet një komunikimi me mjete elektronike ose shkrim me njëherësh të gjithë kandidatët e përzgjedhur për të vazhduar në fazën e dytë, për të dorëzuar ofertat ose për të negociuar e dialoguar. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Ftesa për Ofertë 22 (1) | Ftesa për ofertë u dërgohet vetëm kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë të kualifikimit në procedurënse prokurimit me faza. Ajo përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | që kanë shprehur interesin për të konfirmuar interesin e tyre të vazhdueshëm. | | | | | |
| 54 (2) | Ftesat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, përfshijnë një referencë për adresën elektronike ku dokumentet e prokurimit mund të gjenden drejtpërsëdrejti nëpërmjet mjeteve elektronike. Ftesat shoqërohen nga dokumentet e prokurimit, kur këto dokumente nuk kanë qenë objekt i lirisë së shikimit të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë, pa pagesë, për arsyet e përcaktuara në nënparagrafin e dytë ose të tretë të nenit 53 paragrafi 1, dhe nuk janë bërë të disponueshme deri më tani. Gjithashtu, ftesat e përmendura në paragrafin 1 të këtij | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>58(2) | Përmbajtja e Ftesës për Ofertë përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. | E plote | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>22 (2) | Ky informacion përfshin të paktën:<br>- një referencë për njoftimin e publikuar të kontratës;<br>- kriteret e shpalljes së fituesit;<br>- kushtet e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;<br>- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;<br>- gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;<br>- informacione të mëtejshme që autoriteti ose enti kontraktor i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | neni përfshijnë informacionin e përcaktuar në shtojcën IX. | | | vlerëson të nevojshme. | | |
| Informimi i kandidatëve dhe ofertuesve<br>55 (1) | Autoritetet kontraktore informojnë çdo kandidat dhe ofertues, sa më shpejt që të jetë e mundur, për vendimet e marra për lidhjen e një marrëveshjeje kuadër, dhënien e kontratës ose pranimin në një sistem dinamik blerjeje, duke përfshirë arsyet për çdo vendim për të mos lidhur një marrëveshje kuadër, për të mos dhënë një kontratë për të cilën ka pasur një ftesë për konkurrim, për të rinisur procedurën ose për të mos zbatuar sistemin dinamik të blerjes. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>E drejta për informim<br>81 (1) | Informacioni dhe dokumentacioni i administruar, sipas nenit 99 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. | E plotë | |
| 55 (2) | Autoriteti, me kërkesë të kandidatit ose ofertuesit të interesuar, informon, sa më shpejt të jetë e mundur dhe për çdo rast brenda 15 | | 81 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ditëve nga marrja e një kërkese me shkrim,:<br>(a) çdo kandidat të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të kërkesës së tij për pjesëmarrje,<br>(b) çdo ofertues të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të ofertës së tij, duke përfshirë, për rastet e përmendura në nenin 42, paragrafi 5 dhe 6, arsyet për vendimin e tij për mospërputhshmëri ose për vendimin e tij që punët, furnizimet ose shërbimet nuk përmbushin kërkesat për zbatim ose ato funksionale,<br>(c) çdo ofertues që ka bërë një ofertë të pranueshme për karakteristikat dhe avantazhet relative të ofertës së përzgjedhur, si dhe emrin e ofertuesit të suksesshëm ose të | | | a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në tender;<br><br>b) çdo kandidat, i cili nuk është renditur për në fazën e dytë, kur autoriteti ose enti kontraktor ka përdorur uljen e numrit të kandidatëve;<br><br>c) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;<br><br>ç) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për klasifikimin e ofertës së përzgjedhur. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | palëve në marrëveshjen kuadër,<br>(d) çdo ofertues që ka bërë një ofertë të pranueshme për zhvillimin dhe ecurinë e negociatave dhe dialogut me ofertuesit. | | | | | |
| 55 (3) | Autoritetet kontraktore mund të vendosin të mos publikojnë disa informacione që përmenden në paragrafët 1 dhe 2, të cilat lidhen me dhënien e kontratës, lidhjen e marrëveshjeve kuadër ose pranimin në një sistem dinamik blerjeje, kur publikimi i këtij informacioni do të pengonte zbatimin e ligjit, do të binte ndesh me interesin publik, do të cenonte interesat tregtare legjitime të një operatori ekonomik të caktuar, qoftë publik ose privat, ose mund të cenonte konkurrencën e ndershme ndërmjet këtyre operatorëve. | | 81 (3) | Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet ose entet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cënon interesin publik apo interesat ligjorë dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë. Nëse disa pjesë të ofertës së operatorëve ekonomikë deklarohen si konfidenciale, në përputhje me dispozitat e LPP-së, atëherë këto dokumente nuk do të vihen në dispozicion të kërkuesve. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Parime të përgjithshme 56 (1) | Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara në përputhje ne nenet 67 deri në 69, me kusht që autoriteti kontraktor të ketë verifikuar në përputhje ne nenet 59 deri në 61 që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi dhe në dokumentet e prokurimit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, nenin 45; .<br>Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara në përputhje ne nenet 67 deri në 69, me kusht që autoriteti kontraktor të ketë verifikuar në përputhje ne nenet 59 deri në 61 që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Parimet e procesit të përzgjedhjes<br>80 (1) | Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:<br><br>a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;<br><br>b) operatori ekonomik që ka dorëzuar ofertën përmbush kriteret e kualifikimit dhe të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** | Kriteret përgjithshme të kualifikimit/ pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (b) oferta vjen nga një ofertues që nuk është përjashtuar në përputhje me nenin 57 dhe përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 58 dhe, kur është e zbatueshme, rregullat dhe kriteret jodiskriminuese të përmendura në nenin 65.<br>Autoritetet kontraktore mund të vendosin të mos i japin një kontratë ofertuesit që paraqet ofertën ekonomikisht më të favorshme, kur ata kanë përcaktuar se oferta nuk përmbush detyrimet e zbatueshme të përmendura në nenin 18, paragrafi 2. | | Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes<br>26 | nenit 76 të LPP-së janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga cdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, apo legjislacionit të shtetit të origjinës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 56 (2) | Në procedurat e hapura autoritetet kontraktore mund të vendosin të shqyrtojnë ofertat përpara se të verifikojnë mungesën e arsyeve për përjashtim dhe përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes në përputhje me nenet 57 deri në 64. Kur shfrytëzojnë këtë mundësi, autoritetet | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>80 (4) | Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij, sipas parashikimeve në këtë ligj | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kontraktore sigurohen që verifikimi i mungesës së arsyeve për përjashtim dhe i përmbushjes së kritereve të përzgjedhjes të kryhet në një mënyrë të paanshme dhe transparente me qëllim që ofertuesit që duhet të ishte përjashtuar sipas nenit 57 ose që nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, të mos i jepet asnjë kontratë.<br>Shtetet anëtare mund të përjashtojnë përdorimin e procedurës së nënparagrafit të parë, ose ta kufizojnë përdorimin e saj vetëm për disa lloje prokurimi ose për rrethana specifike. | | | | | |
| 56 (3) | Kur informacioni ose dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomik | | | | E papërputhur | Direktiva e le në diskrecionin e vendeve anëtare aplikimin ose jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | është ose duket i paplotë ose me gabime ose kur mungojnë dokumente specifike, autoritetet kontraktore, përveçse kur legjislacioni i brendshëm në zbatim të kësaj direktivë e parashikon ndryshe, mund t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të interesuar që të dorëzojnë, plotësojnë ose të sqarojnë informacionin ose dokumentacionin përkatës brenda një afati kohor të përshtatshëm, me kusht që këto kërkesa të bëhen në pajtim të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. | | | | | të kësaj dispozite kur shprehet "*... përveçse kur legjislacioni i brendshëm në zbatim të kësaj direktivë e parashikon ndryshe, mund t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të interesuar që të dorëzojnë, plotësojnë ose të sqarojnë informacionin ose dokumentacionin përkatës brenda një afati kohor të përshtatshëm...*" Per kete arsye kjo dispozite nuk eshte perfshire ne ligj ne kete moment. |
| 56 (4) | Komisioni ka autoritetin të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 87 | | | | E papërputhur | Dispozita u referohetn Komisionit Europian |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për të ndryshuar listën në shtojcën X, kur është e nevojshme, për të shtuar marrëveshje ndërkombëtare të reja që janë ratifikuar nga të gjithë shtete anëtare ose kur marrëveshjet ndërkombëtare ekzistuese që përmenden nuk janë më të ratifikuara nga të gjithë shtetet anëtare, ose kanë ndryshuar në kushte të tjera, për shembull në lidhje me fushën e zbatimit, përmbajtjen ose emërtimin e tyre. | | | | | |
| Arsyet për përjashtim<br>57 (1) | Autoritetet kontraktore përjashtojnë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit kur ata kanë përcaktuar, duke verifikuar në përputhje me nenet 59, 60 dhe 61, ose janë vënë në dijeni në mënyra të tjera se operatori ekonomik ka marrë një dënim me një vendimi | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Kriteret detyruese për skualifikim<br>76 (1) | Skualifikohet nga e drejta për fitimin e kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:<br><br>a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të formës së prerë për një nga arsyet e mëposhtme:<br>(a) pjesëmarrje në organizatë kriminale, siç përcaktohet në nenin 2 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/841/DPB (32);<br><br>(b) korrupsioni, siç përkufizohet në nenin 3 të Konventës për luftën kundër korrupsionit ku janë përfshirë zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (33) dhe në nenin 2, paragrafi 1 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2003/568/DPB (34), si dhe korrupsioni siç përkufizohet në legjislacionin e brendshëm të autoritetit kontraktor ose të operatorit ekonomik;<br>(c) mashtrimi sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e interesave | | | terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi<br><br>b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;<br><br>c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;<br><br>ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;<br><br>d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;<br><br>e) falsifikim;<br><br>ë) puna e femijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | financiare të Komuniteteve Evropiane (35);<br><br>(d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, siç përcaktohet përkatësisht në nenet 1 dhe 3 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/ÇBD (36)ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale, siç përmenden në nenin 4 të këtij Vendimi Kuadër;<br>(e) pastrim parash ose financim i terrorizmit, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (37);<br><br>(f) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore, siç | | | Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administratimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përcaktohet në nenin 2 të Direktivës 2011/36/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (38);<br><br>Detyrimi për të përjashtuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij operatori ekonomik ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda atij operatori ekonomik. | | | | | |
| 57 (2) | Një operator ekonomik përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur autoriteti kontraktor ka dijeni se operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij që lidhen me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore | | 76 (2) | Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe kjo është vendosur nga një vendim gjyqësor ose administrativ i formës së prerë në përputhje me dispozitat ligjore të vendit ku ky vendim është dhënë ose me dispozitat ligjore të shtetit anëtar të autoritetit kontraktor. Gjithashtu, autoritetet kontraktore mund të përjashtojnë ose mund t'u kërkohet nga shtetet anëtare që të përjashtojnë nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi një operator ekonomik, kur autoriteti kontraktor mund të vërtetojë me çdo mjet të përshtatshëm se operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore. Ky paragraf nuk gjen më zbatim kur operatori ekonomik i | | | a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor, dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamat vonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore , duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpaljes së procedurës së prokurimit<br><br>c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla detyrimesh tatimore, deri në vlerën prej 10 000 lekë;<br><br>ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ka përmbushur detyrimet e tij duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamat vonesë ose gjobë. | | | pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës. | | |
| 57 (3) | Shtetet anëtare mund të parashikojnë një shmangie nga përjashtimi i detyrueshëm që parashikohet në paragrafët 1 dhe 2, mbi baza përjashtimore, për arsye madhore që lidhen me interesin e publikut, si shëndeti publik ose mbrojtja e mjedisit.<br>Shtetet anëtare gjithashtu mund të parashikojnë një shmangie nga përjashtimi detyrues që parashikohet në paragrafin 2 kur | | 76 (4) | Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përjashtimi do të ishte qartësisht joproporcional, në veçanti kur nuk janë paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore ose kur operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore në një kohë të tillë kur ai nuk ka pasur mundësi të marrë masat që parashikohen në nënparagrafin e tretë të paragrafit 2 përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje ose, në procedurat e hapura, afatin për dorëzimin e ofertës. | | | | | |
| 57 (4) | Autoritetet kontraktore mund të përjashtojnë ose shtetet anëtare mund t'i kërkojnë atyre | | 76 (3) | Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit, nëse është në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të përjashtojnë nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit çdo operator ekonomik në një nga situatat e mëposhtme:<br>(a) kur autoriteti kontraktor mund të vërtetojë me anë të çdo mjeti të përshtatshëm një shkelje të detyrimeve të zbatueshme që përmenden në nenin 18, paragrafi 2;<br>(b) kur operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedimeve të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme | | | një nga situatat e mëposhtme:<br><br>a) kur autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin mjedisor, social dhe të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare mjedisore, sociale dhe të punës ku Republika e Shqipërisë është palëi ;<br><br>b) kur operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në zbatim të legjislacionit dhe rregulloreve të brendshme;<br>(c) kur autoriteti kontraktor mund të vërtetojë me mjete të përshtatshme se operatori ekonomik është fajtor për një shkelje të rëndë profesionale që vë në pikëpyetje integritetin e tij;<br>(d) kur autoriteti kontraktor ka tregues të mjaftueshëm për të dalë në përfundimin se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;<br>(e) kur konflikti i interesit sipas kuptimit të nenit 24 nuk mund të korrigjohet siç duhet me anë të masave më pak shtrënguese;<br>(f) kur shtrembërimi i | | | nenin 47, pika 3, gërma "d" të këtij ligji;;<br><br>c) kur operatori ekonomik është shpallur fajtor, me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;<br><br>ç) kur autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;<br><br>d) kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;<br><br>dh) kur operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | konkurrencës nga përfshirja e mëparshme e operatorëve ekonomikë në përgatitjen e procedurës së prokurimit, siç përmendet në nenin 41 nuk mund të korrigjohet nëpërmjet masave të tjera më pak shtrënguese;<br>(g) kur operatori ekonomik ka treguar mangësi të mëdha ose të përsëritura në zbatimin e një kërkese thelbësore në zbatim të një kontrate publike të mëparshme, një kontrate të mëparshme me një subjekt kontraktor ose një kontratë koncesioni të mëparshme që kanë çuar në zgjidhjen e hershme të kontratës së mëparshme, në sanksione për dëmet ose sanksione të tjera të ngjashme;<br>(h) kur operatori ekonomik është | | | kusht zbatohet brenda një viti nga tërheqja.<br><br>e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate, , për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në gërmën “b”, të pikës 1, neni 78, i këtij ligji<br><br>ë)kur autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shpallur fajtor për deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për përjashtim ose për plotësimin e kritereve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet mbështetëse që kërkohen sipas nenit 59; ose<br>(i) kur operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor për të marrë informacion konfidencial që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim | | | mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin;<br><br>f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.<br><br>g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.<br>Pavarësisht germës b të nënparagrafit të parë, shtetet anëtare mund të kërkojnë ose të japin mundësinë që autoriteti kontraktor të mos përjashtojë një operator ekonomik i cili është në një nga situatat e përmendura në atë pikë, kur autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky operator ekonomik do të jetë në gjendje ta zbatojë kontratën, duke marrë në konsideratë rregullat dhe masat kombëtare të zbatueshme për vazhdimin e biznesit në rastin e situatave të përmendura në germën b. | | | vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij, persona, të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(21) | Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:<br><br>a) Në pikën 3, bëhen këto ndryshime:<br>i) Gërma „c“ ndryshon me këtë përmbajtje: „c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij".<br>ii) Gërma "e" me këtë përmbajtje: "operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji", shfuqizohet.<br>iii) Në gërmën "dh", në fund të fjalisë së parë, pas togfjalëshit "… nga vetë autoriteti ose enti kontraktor …", shtohet togfjalëshi "ose nuk i përgjigjet dy herë rradhazi | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ftesës së autoritetit ose entit kontraktor gjatë rihapjes së konkurimit”.<br><br>iv) Në gërmën “g”, togfjalëshi “…nga e drejta për të përfituar fonde publike” zëvendësohet me togfjalëshin “…nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik”.<br><br>v) Pas gërmës ”g” shtohet gërma “ gj” me këtë përmbajtje: “operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi”.<br><br>vi) Pas gërmës ”gj” shtohet gërma “ h” me këtë përmbajtje: “operatori ekonomik nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për pagat në fuqi”. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 57 (5) | Autoritetet kontraktore në çdo kohë gjatë procedurës përjashtojnë një operator ekonomik kur operatori ekonomik në fjalë, duke marrë në konsideratë veprat e kryera ose të pakryera qoftë përpara ose gjatë procedurës, ndodhet në një nga situatat e përmendura në paragrafin 1 dhe 2.<br>Në çdo kohë gjatë procedurës, autoritetet kontraktore mund të përjashtojnë, ose shtetet anëtare mund t'u kërkojnë atyre të përjashtojnë një operator ekonomik kur rezulton se operatori ekonomik, duke marrë në konsideratë veprat e kryera ose të pakryera qoftë përpara ose gjatë procedurës, gjendjet në një nga situatat e përmendura në paragrafin 4. | | 76 (5) | Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji. | E plotë | |
| 57 (6) | Çdo operator ekonomik që gjendet në një nga situatat e përmendura | | 76 (6) | 6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në paragrafët 1 dhe 4 mund të japë prova për të treguar se masat e marra nga operatori ekonomik janë të mjaftueshme për të vërtetuar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së arsyeve përkatëse për përjashtim. Nëse këto prova konsiderohen si të mjaftueshme, operatori ekonomik në fjalë nuk përjashtohet nga procedura e prokurimit. Për këtë qëllim, operatori ekonomik vërteton se ka paguar ose ka marrë përsipër të paguajë kompensimin në lidhje me çdo dëm të shkaktuar nga vepra penale ose shkelja, ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me autoritetet hetuese dhe ka marrë masa konkrete teknike, | | | parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.<br><br>Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë se ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për cdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, se ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe se ka marre masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.<br><br>Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posacme të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | organizative dhe në lidhje me personelin, që janë të përshtatshme për të parandaluar vepra penale ose shkelje të tjera.<br>Masat e marra nga operatorët ekonomikë, vlerësohen duke marrë në konsideratë shkallën dhe rrethanat e veçanta të veprës penale ose shkeljes. Kur masat konsiderohen se janë të pamjaftueshme, operatori ekonomik merr një deklaratë me arsyet për këtë vendim.<br>Operatori ekonomik që përjashtohet me vendim të formës së prerë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit ose nga dhënia e koncesionit nuk ka të drejtë të shfrytëzojë mundësinë që i jep ky paragraf, gjatë periudhës së përjashtimit që rezulton nga ky vendim në shtetet anëtare ku vendimi ka fuqi ligjore. | | 76 (7) | veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme,operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.<br><br>Operatori ekonomik i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim | | |
| | | | **5. Projektligj** (21) | Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:<br><br>b) Në pikën 7, togfjalëshi “…nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit …” zëvendësohet me togfjalëshin “…nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik“. | | |
| 57 (7) | Shtetet anëtare specifikojnë me ligj, rregullore ose dispozitë administrative dhe duke marrë në konsideratë të drejtën e Bashkimit Evropian, kushtet zbatuese të këtij neni. Ato, në veçanti, përcaktojnë periudhën maksimale të përjashtimit, nëse operatori ekonomik nuk ndërmerr asnjë nga masat e specifikuara në paragrafin 6, për të vërtetuar besueshmërinë e tij. Kur periudha e përjashtimit nuk është përcaktuar me vendim të formës së prerë, ajo periudhë nuk tejkalon pesë vjet nga data e dënimit me vendim të formës së prerë për rastet e përmendura në paragrafin 1 dhe tre vjet nga data e ngjarjes përkatëse për rastet e | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br>Përjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik 78 (1) | Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për:<br><br>a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi;<br><br>b) mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik ;<br><br>c) nëse është tërhequr, mbi pesë herë, nga nënshkrimi i kontratës në procedura prokurimi të ndryshme, të zhvilluara nga një ose disa autoritete ose ente të ndryshme kontraktore, brenda një viti kalendarik.<br><br>d) kur ka një vendim të formës së prerë të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmendura në paragrafin 4. | | 78 (2)<br><br>78 (3) | Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta.<br><br>2. Agjencia e Prokurimit Publik merr vendime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, duke mbajtur parasysh, parimet e paanshmërisë, ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.<br><br>3. Rregullat dhe afatet qe ndiqen në procesin e përjashtimit përcaktohen ne rregullat e prokurimit publik. | | |
| Kriteret e përzgjedhjes 58 (1) | Kriteret e përzgjedhjes mund të lidhen me:<br>(a) përshtatshmërinë për të vazhduar veprimtarinë profesionale<br>(b) gjendjen ekonomike dhe financiare;<br>(c) aftësinë teknike dhe profesionale<br>Autoritetet kontraktore mund të vendosin | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Kërkesat për kualifikim<br>77 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë, bazuar në:<br><br>a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;<br><br>b) gjendjen ekonomike dhe financiare; | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | vetëm kriteret e përmendura në paragrafin 2, 3 dhe 4 për operatorët ekonomikë, si kërkesa për pjesëmarrje. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike dhe financiare dhe aftësitë teknike dhe profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. | | | c) aftësinë teknike dhe profesionale.<br><br>Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. | | |
| 58 (2) | Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë që mbahen në shtetin anëtar të themelimit të tyre, siç | | 77 (2) | Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.<br><br>Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përshkruhet në shtojcën XI ose të përmbushin ndonjë kërkesë tjetër të përcaktuar në atë shtojcë.<br>Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtar të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. | | | nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtar të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. | | |
| 58 (3) | Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>77 (3) | Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | këtë qëllim autoritetet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar, duke përfshirë një xhiro minimale të caktuar në fushën që mbulon kontrata. Gjithashtu, autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet, për shembull, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Ato gjithashtu mund të kërkojnë një nivel të përshtatshëm të sigurimit të dëmshpërblimit profesional.<br>Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk tejkalon dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, përveç rasteve të justifikuara | | | Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar,. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit.<br><br>Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.<br><br>Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet në lidhje me çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | siç duhet, siç janë rastet që lidhen me rreziqe të veçanta që shoqërojnë natyrën e punëve, shërbimeve ose furnizimeve. Autoriteti kontraktor përcakton arsyet kryesore për një kërkesë të tillë në dokumentet e prokurimit ose në raportin individual të përmendur në nenin 84. Për shembull raporti ndërmjet aktivit dhe pasivit mund të merret në konsideratë kur autoriteti kontraktor specifikon metodat dhe kriteret për një konsiderim të tillë në dokumentet e prokurimit. Këto metoda dhe kritere janë transparente, objektive dhe jodiskriminuese. Kur një kontratë ndahet në lote ky nen zbatohet në lidhje me çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti kontraktor mund të caktojë xhiron vjetore minimale që u | | | që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.<br><br>Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë, ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare<br>44 (1)<br><br><br><br><br><br><br>44 (2) | Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në tre vitet e fundit financiare.<br><br>Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë, nuk mund të tejkalojë: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kërkohet operatorëve duke iu referuar grupeve të loteve në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.<br>Kontratat vjetore që bazohen në një marrëveshje kuadër duhet të jepen pas rihapjes së konkurrimit, kërkesa për xhiron maksimale vjetore që përmendet në nënparagrafin e dytë të këtij paragrafi llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë, ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.<br>Në rastin e sistemeve dinamike të blerjes, kërkesa për xhiron maksimale vjetore që përmendet në nënparagrafin e dytë | | 44 (3)<br><br>44 (4) | a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.<br>b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.<br>c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".<br><br>Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.<br><br>Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të pritshme të kontratave specifike që do të jepen në zbatim të këtij sistemi. | | 44 (5)<br><br>44 (6) | të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.<br><br>Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.<br><br>Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 58 (4) | Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Një autoritet kontraktor mund të supozojë se një operator ekonomik nuk zotëron aftësitë e nevojshme profesionale kur autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>77 (4) | Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.<br><br>Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.<br><br>Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ekonomik ka konflikte interesi që mund të kenë ndikim negativ në zbatimin e kontratës.<br><br>Në procedura prokurimi për furnizime të cilat kërkojnë punë vendosjeje ose instalimi, shërbime ose punime, aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin ose për të kryer instalimin ose punën mund të vlerësohet në lidhje me aftësitë e tyre, efikasitetin, përvojën dhe besueshmërinë. | | | nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. | | |
| 58 (5) | Autoritetet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen që mund të shprehen si nivele minimale të aftësisë, së bashku me | | 77 (5) | Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mënyrat e përshtatshme të vërtetimit. | | | | | |
| Dokumenti i Vetëm Evropian për Prokurimin 59 (1) | Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, Dokumentin e Vetëm Evropian të Prokurimit (ESPD), i cili përbëhet nga një vetëdeklarim i përditësuar, që konfirmon se operatori ekonomik në fjalë përmbush kushtet e mëposhtme:<br>(a) nuk gjendet në një nga situatat e përmendura në nenin 57 për të cilat operatorët ekonomikë duhet ose mund të përjashtohen;<br>(b) përmbush kriteret përkatëse të përzgjedhjes që janë | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Formulari përmbledhës i vetdeklarimit<br>82 (1) | Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.<br><br>Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës së të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, deklaratën e | E pjesshme | Formulari permbledhes i vetedeklarimit lidhet vetem me kriteret e detyrueshme per kualifikim, nderkohe qE plotësimi i kritereve te tjera do te vazhdoje te provohet nepermjet dokumentave. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përcaktuar sipas nenit 58;<br>(c) sipas rastit, përmbush rregullat dhe kriteret objektive që janë përcaktuar sipas nenit 65.<br>Kur operatori ekonomik mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas nenit 63, ESPD duhet të përmbajë edhe informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, në lidhje me këto subjekte.<br>ESPD përmban një deklaratë formale nga operatori ekonomik se nuk ekziston arsyeja përkatëse për përjashtim dhe/ose kriteri përkatës i përzgjedhjes është përmbushur, si dhe informacionin përkatës që kërkohet nga autoriteti kontraktor.<br>Në ESPD gjithashtu identifikohet autoriteti publik ose pala e tretë | | | nevojshme për dhënien e pëlqimit.<br><br>Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Formulari përmbledhës i vetdeklarimit<br>27 (1)<br><br>27 (2) | Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP-së dhe në këto rregulla.<br><br>Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përgjegjëse për krijimin e dokumenteve mbështetëse dhe aty përfshihet një deklaratë formale që tregon se operatori ekonomik do të jetë në gjendje që t'i ofrojë këto dokumente mbështetëse kur t'i kërkohen dhe pa vonesë.<br>Kur autoriteti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të dhënash sipas paragrafit 5, ESPD-ja përmban edhe informacionin që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës së të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.<br>Operatorët ekonomikë mund të përdorin sërish një ESPD që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të | | | informacion dhe deklarimin, si më poshtë:<br>a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, , ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e  një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së.<br>c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është  ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së. d) operatori | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mëparshme, me kusht që të vërtetojnë se informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë. | | | ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.<br>e) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi.<br>f) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të nenit 76/2 të LPP.g) operatori ekonomik ka shlye të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.gj) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi.h) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | legjislacionit mjedisor, social dhe të punës. n.<br>i) operatori ekonomik ka paraqitur ofertëtë pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.<br>j) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.<br>k) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit ose entit kontraktor (kur është rasti);<br><br>l) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritëe nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit ose entit kontraktor (kur është rasti).<br>ll) Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave operatori ekonomik do të mbështetet, (nëse është rasti) dhe nënkontraktorët e mundshëm (nëse është | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rasti).m) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. | | |
| 59 (2) | ESPD-ja hartohet mbi bazën e një formulari standard. Komisioni krijon këtë formular standard me anë të akteve zbatuese. Këto akte zbatuese përshtaten në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 89, paragrafi 3.<br>ESPD-ja ofrohet vetëm në formë elektronike. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Formulari përmbledhës i vetdeklarimit<br>82 (1) | Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.<br><br>Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e bazës së të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.<br><br>Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>27 (3) | Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash ku autoriteti ose enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacioni dhe /ose dokumentin, shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.<br><br>Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 27 (4) | ekonomikë mund të përdorin një formular vetdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 59 (3) | Pavarësisht nenit 92, Komisioni shqyrton zbatimin praktik të ESPD-së duke marrë në konsideratë zhvillimin teknik të bazave të të dhënave në shtetet anëtare dhe raportojnë për këto baza të dhënash në Parlamentin Evropian dhe në Këshill përpara datës 18 prill 2017. Komisioni, sipas rastit, bën propozime për zgjidhjet që optimizojnë aksesimin ndërkufitar të këtyre bazave të dhënash dhe përdorimin e certifikatave dhe vërtetimeve në tregun e brendshëm. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet Komisionit Europian |
| 59 (4) | Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve që të dorëzojnë të gjitha ose | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>82 (2) | Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve, sqarime dhe dokumenta mbështetëse për | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | një pjesë të dokumenteve mbështetëse, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës. Përpara se të japë kontratën autoriteti kontraktor, përveçse në lidhje me kontratat që bazohen në marrëveshjet kuadër kur këto kontrata lidhen në përputhje me nenin 33, paragrafi 3 ose germën a të nenit 33 paragrafi 4, mund t'i kërkojnë ofertuesit të cilit ka vendosur t'i japë kontratën që të dorëzojë dokumentet mbështetëse të përditësuara në përputhje me nenin 60 dhe, sipas rastit, me nenin 62. Autoriteti kontraktor mund t'i ftojë operatorët ekonomikë që të plotësojnë ose të sqarojnë certifikatat që kanë marrë sipas neneve 60 dhe 62. | | 82 (5) | këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.<br><br>Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:<br><br>a) dokumentet e paraqitura, si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor, duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre,<br><br>b) dokumentet mbështetëse, në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre, për vetdeklarimet e dhëna.<br><br>Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>27 (5) | Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 27 (6)<br><br>27 (7) | e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumenta mbështetëse për këto sqarime.<br><br>Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.<br><br>Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provues për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetdeklarimit, si dhe dokumentat e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal, ose kopje të noterizuar të tyre. Autoriteti ose enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.<br>Operatorët ekonomikë të huaj, duhet të paraqesin dokumentat në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi, për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.<br>Në rastin e dokumentave që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të provojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(23) | Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:<br>a) Pika 5, e nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, ndryshon si më poshtë:<br>“5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë:<br>1. Dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre”.<br>2. Dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetdeklarimet e dhëna.<br><br>b) Pas pikës 5 shtohen pika 6, 7, 8, 9 10,11 dhe 12 me përmbajtje:<br>”6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregëtar shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 7. Pavarësisht pikës 5, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregëtar shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si pjesë e Formularit Përmbledhës të Prokurimit, nga ndërveprimi me sisteme të tjera publike.<br>8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të kompanisë, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Publik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dojses virtuale të kompanisë duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.<br><br>Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike për aq sa është e mundur në dosjen virtuale të kompanisë.<br>9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimeve Elektronike verifikon automatikisht përmes ndërvperimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kritereve të vecanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.<br>10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimeve Elektronike përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të dhomës kombëtare të noterisë.<br>Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5, i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.<br>11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion mbi llojet dhe format e provave të përmendura në  këtë nen dhe për autoritetet kompetente që i lëshojnë ato në Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian”. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 12. Rregulla të posaçme për pikat 5 dhe 10 parashikohen në rregullat e prokurimit publik, brenda 6 muajve, nga hyrja në fuqi e kesaj dispozite”. | | |
| 59 (5) | Pavarësisht paragrafit 4, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet që të dorëzojnë dokumente mbështetëse ose dokumente provuese kur dhe për sa kohë që autoriteti kontraktor ka mundësi të marrë certifikatat ose informacionin përkatës duke hyrë direkt dhe pa pagesë në bazën kombëtare të të dhënave në çdo shtet anëtar, siç është regjistri kombëtar i prokurimeve, një dosje virtuale e kompanisë, një sistem elektronik për ruajtjen e dokumenteve ose një sistem parakualifikimi. Pavarësisht paragrafit 4, operatorëve ekonomikë nuk u | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””** 82 (1) | Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.<br><br>Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës së të dhënave, çdo e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.<br>Për qëllimin e nënparagrafit të parë, shtetet anëtare garantojnë që bazat e të dhënave që përmbajnë informacionin përkatës për operatorët ekonomikë dhe që mund të aksesohen nga autoritetet e tyre kontraktore, të mund të aksesohen, sipas të njëjtave kushte, edhe nga autoritetet kontraktore të shteteve të tjera anëtare. | | 82 (3) | dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.<br><br>Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.<br><br>Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. | | |
| 59 (6) | Shtetet anëtare vënë në dispozicion dhe përditësojnë në e-Certis një listë të plotë të bazave të të dhënave që përmbajnë informacionin përkatës për operatorët ekonomikë, të cilat | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mund të aksesohen nga autoritetet kontraktore të shteteve të tjera anëtare. Shtetet anëtare u komunikojnë shteteve të tjera anëtare, me kërkesën e këtyre të fundit, çdo informacion që lidhet me bazat e të dhënave që përmenden në këtë nen. | | | | | |
| Mënyrat e provës<br>60 (1) | Autoritetet kontraktore mund të kërkojnë certifikata, deklarata dhe mënyra të tjera prove, që përmenden në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni dhe në shtojcën XII, si provë për mungesën e arsyeve për përjashtim, siç përmendet në nenin 57, dhe për përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes në përputhje me nenin 58. Autoritetet kontraktore nuk kërkojnë mënyra prove të tjera përveç atyre që përmenden në këtë nen dhe në nenin 62. Në lidhje me nenin | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Kërkesat e cilësisë<br>45 (1) | Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në çdo rast, certifikatat duhet të jenë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. | E plote | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 63, operatorët ekonomikë mund të mbështeten në çdo mënyrë të përshtatshme për t'i vërtetuar autoritetit kontraktor se ata do të kenë në dispozicionin e tyre burimet e nevojshme. | | | | | |
| 60 (2) | Autoritetet kontraktore pranojnë sa më poshtë si prova të mjaftueshme që asnjë nga rastet e specifikuara në nenin 57 nuk zbatohet për operatorin ekonomik:<br>(a) nxjerrjen e ekstraktit nga regjistri përkatës, siç është regjistri gjyqësor, ose, në mungesë të tij, një dokument të barasvlershëm të lëshuar nga autoriteti kompetent gjyqësor ose administrativ në shtetin anëtar, në shtetin e origjinës ose në shtetin ku operatori ekonomik është themeluar, i cili tregon se ato kërkesa janë përmbushur, | | 45 (3)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>45 (4)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>45 (5) | Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.<br><br>Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.<br><br>Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga | E pjesshme | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | lidhur me paragrafin 1 të atij neni;<br>(b) një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent në shtetin anëtar ose në shtetin e përfshirë, lidhur me paragrafin 2 dhe germën b të paragrafit 4 të atij neni.<br>Nëse shteti anëtar ose shteti në fjalë nuk i lëshon këto dokumente ose certifikata, ose nëse këto nuk mbulojnë të gjitha rastet e specifikuara në paragrafët 1 dhe 2 dhe germën b të paragrafit 4 të nenit 57, ato mund të zëvendësohen me një deklaratë nën betim ose, në shtetet anëtare ku nuk parashikohen deklaratat nën betim, me një deklaratë solemne të bërë nga personi në fjalë përpara një autoriteti kompetent gjyqësor ose administrativ, një noteri ose organi kompetent profesional | | | autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuara nga autoriteti/enti kontraktor. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ose tregtar, në shtetin anëtar ose shtetin e origjinës ose në shtetin anëtar ose shtetin ku është themeluar operatori ekonomik. Një shtet anëtar, sipas rastit, jep një deklaratë zyrtare ku deklaron se dokumentet ose certifikatat e përmendura në këtë paragraf nuk lëshohen ose ato nuk mbulojnë të gjitha rastet e specifikuara në paragrafët 1 dhe 2 dhe germën b të paragrafit 4 të nenit 57. Këto deklarata zyrtare bëhen të disponueshme nëpërmjet një vendi të centralizuar dhe të sigurt për certifikatat (e-Certis), që përmendet në nenin 61. | | | | | |
| 60 (3) | Prova e gjendjes ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik, si rregull i përgjithshëm, mund të jepet me anë të një ose më shumë referencave | | 45 (2) | Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për | E pjesshme | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të renditura në shtojcën XII pjesa I.<br>Kur operatori ekonomik, për çdo arsye të vlefshme, nuk është në gjendje të japë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktor, ai mund të provojë gjendjen e tij ekonomike dhe financiare me një dokument tjetër të cilin autoriteti kontraktor e konsideron të përshtatshëm. | | | shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP.<br><br>Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. | | |
| 60 (4) | Prova për aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë mund të jepet me anë të një ose më shumë mënyrave të paraqitura në shtojcën XII pjesa II, në përputhje me natyrën, sasinë ose rëndësinë dhe përdorimin e punëve, furnizimeve ose shërbimeve. | | 45 (2) | Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP. | E pjesshme | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. | | |
| 60 (5) | Shtetet anëtare u vënë në dispozicion shteteve të tjera anëtare, me kërkesë të këtyre të fundit, çdo informacion që lidhet me arsyet për përjashtim, të renditura në nenin 57, përshtatshmërinë për të kryer veprimtari profesionale dhe kapacitetet financiare dhe teknike të ofertuesve që përmenden në nenin 58 dhe çdo informacion që lidhet me mënyrat e provës që përmenden në këtë nen. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare |
| Vend i centralizuar dhe i sigurt për certifikatat (e-Certis)<br>61 (1) | Me synimin për të lehtësuar tenderimin ndërkufitar, shtetet anëtare garantojnë që informacioni lidhur me certifikatat dhe forma të tjera të provave shkresore të paraqitura | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në e-Certis të ngritur nga Komisioni, të mbahet vazhdimisht i përditësuar. | | | | | |
| 61 (2) | Autoritetet kontraktore përdorin e-Certis dhe kërkojnë kryesisht ato lloj certifikatash dhe provash shkresore që mbulohen nga e-Certis. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare te BE-se |
| 61 (3) | Komisioni vë në dispozicion në e-Certis versionet e ESPD-së në të gjitha gjuhët | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet Komisionit Europian |
| Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor<br>62 (1) | Nëse autoritetet kontraktore kërkojnë certifikata të hartuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara të garantimit të cilësisë, duke përfshirë standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, ato i referohet sistemeve të garantimit të cilësisë që bazohen në serinë përkatëse të standardeve evropiane të certifikuara nga organe të akredituara. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor.<br>79 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, e plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ato njohin certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga organet e krijuara në shtete të tjera anëtare. Ata pranojnë edhe prova të tjera të masave të barasvlershme për garantimin e cilësisë, kur operatori ekonomik në fjalë nuk ka pasur mundësi t'i marrë këto vërtetime brenda afateve kohore përkatëse për arsye që nuk varen prej tij, me kusht që të vërtetojë se masat e propozuara për garantimin e cilësisë pajtohen me standardet e kërkuara të garantimit të cilësisë. | | | Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. | | |
| 62 (2) | Nëse autoritetet kontraktore kërkojnë certifikata të hartuara nga organet e pavarura, që vërtetojnë se operatori ekonomik pajtohet me sisteme ose standarde të caktuara të menaxhimit mjedisor, ato i referohen Skemës së Bashkimit Evropian | | 79 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve, dorëzimin e çertifikatave apo dokumentave të ngjashme të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për Eko-Menaxhim dhe Auditim (EMAS) ose sistemeve të tjera të njohura të menaxhimit mjedisor, në përputhje me nenin 45 të Rregullores (KE) nr. 1221/2009, ose standardeve të tjera të menaxhimit mjedisor që bazohen në standardet përkatëse evropiane ose ndërkombëtare nga organe të akredituara. Ato njohin certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga organet e krijuara në shtete të tjera anëtare.<br>Kur është e qartë se një operator ekonomik nuk ka pasur akses në këto certifikata, ose asnjë mundësi për t'i marrë ato brenda afateve kohore përkatëse, për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti kontraktor gjithashtu pranon prova të tjera për masat e menaxhimit mjedisor, me kusht që operatori | | 79 (3) | a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;<br><br>b) eficencës së energjisë;<br><br>c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.<br><br>Në rastet kur, operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një çertifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumenta të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ekonomik të vërtetojë se këto masa janë të njëjta me ato që kërkohen në zbatim të sistemit ose standardit të zbatueshëm të menaxhimit mjedisor. | | | | | |
| 62 (3) | Shtetet anëtare vënë në dispozicion të shteteve të tjera anëtare, me kërkesë të këtyre të fundit, në përputhje me nenin 86, çdo informacion që lidhet me dokumentet e nxjerra si provë e pajtueshmërisë me standardet e cilësisë dhe ato mjedisore, që përmenden në paragrafët 1 dhe 2. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet shteteve anëtare |
| Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera<br>63 (1) | Për sa u përket kritereve që lidhen me gjendjen ekonomike dhe financiare, siç përcaktohet në nenin 58, paragrafi 3 dhe kritereve që lidhen me aftësinë teknike dhe profesionale, siç përcaktohet në nenin 58, paragrafi 4, një operator ekonomik, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera 84 (1) | Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentat e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | sipas rastit dhe për një kontratë të veçantë, mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera pavarësisht natyrës ligjore të lidhjeve që ai ka me ta. Megjithatë, për sa u përket kritereve që lidhen me kualifikimet arsimore dhe profesionale, siç përcaktohen në germën f të shtojcës XII pjesa II, ose me përvojën profesionale përkatëse, operatorët ekonomikë mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera vetëm kur këta të fundit do të kryejnë punët ose shërbimet për të cilat kërkohen këto kapacitete. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke | | 84 (2)<br><br>84 (3)<br><br>84 (4) | juridike të lidhjeve që ai ka me ta.<br><br>Operatori ekonomik, mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet, për të cilat kërkohet aftësi e tillë.<br><br>Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.<br><br>Autoriteti kontraktor, në përputhje me nenet 59, 60 dhe 61, vërteton nëse subjektet mbi kapacitetin e të cilëve synon të mbështetet operatori ekonomik përmbushin kriteret përkatëse të përzgjedhjes dhe nëse ka arsye për përjashtim sipas nenit 57. Autoriteti kontraktor kërkon që operatori ekonomik të zëvendësojë një subjekt që nuk përmbush një kriter përkatës të përzgjedhjes, ose për të cilin ka arsye detyruese për përjashtim. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë ose atij mund t'i kërkohet nga një shtet anëtar që t'i kërkojë një operatori ekonomik që ky i fundit të zëvendësojë | | 84 (5) | ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.<br><br>Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera 91 (1) | Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentat e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | një subjekt për të cilin ekzistojnë arsye jodetyruese për përjashtim.<br>Kur një operator ekonomik mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për sa u përket kritereve që lidhen me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe këto subjekte të mbajnë përgjegjësi të përbashkët për zbatimin e kontratës.<br>Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë siç përmendet në nenin 19, paragrafi 2 mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera. | | 91 (2) | juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84 të LPP.<br><br>Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:<br>- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentat e ofertës;<br>- t´i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.<br>- t´i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 91 (3)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>91 (4)<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>91 (5) | Kur operatori ekonomik, kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.<br><br>Kur operatori ekonomik, kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.<br><br>Kur operatori ekonomik, kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. | | |
| 63 (2) | Në rastin e kontratave për punë, kontratave për shërbime dhe operacioneve të vendosjes ose të instalimit në kontekstin e një kontrate furnizimi, autoritetet mund të kërkojnë që disa detyra kritike të kryhen drejtpërsëdrejti nga vetë ofertuesi, ose, kur oferta dorëzohet nga një grup operatorësh ekonomikë, siç përmendet në nenin 19, paragrafi 2, nga një anëtar i atij grupi. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br>84 (7) | Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor, mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>91 (6) | Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Listat zyrtare të operatorëve ekonomikë të miratuar dhe vërtetimi nga organet e themeluara sipas të drejtës publike ose private<br>64 (1) | Shtetet anëtare mund të krijojnë ose të mirëmbajnë lista zyrtare të kontraktorëve, furnizuesve ose ofruesve të miratuar të shërbimit ose të parashikojnë certifikimin nga organe certifikuese në pajtim me standardet evropiane të certifikimit sipas kuptimit të shtojcës VII.<br>Ata informojnë Komisionin dhe shtetet e tjera anëtare për adresën e organit certifikues ose organit përgjegjës për listat zyrtare, në të cilën dërgohen aplikimet. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare |
| 64 (2) | Shtetet anëtare i përshtatin kushtet për regjistrim në listat zyrtare që përmenden në paragrafin 1 dhe për lëshimin e certifikatave nga organet e certifikimit, me | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dispozitat e këtij nënseksioni.<br>Shtetet anëtare gjithashtu i përshtatin ato me nenin 63, për sa u përket aplikimeve për regjistrim të paraqitura nga operatorët ekonomikë që i përkasin një grupi dhe që kanë burimet të cilat u janë vënë në dispozicion nga shoqëri të tjera në grup. Në këtë rast, këta operatorë i vërtetojnë autoritetit që përcakton listën zyrtare se do t'i kenë këto burime në dispozicion të tyre gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës, që vërteton regjistrimin e tyre në listën zyrtare dhe që gjatë kësaj periudhe këto shoqëri do të vazhdojnë të plotësojnë kërkesat e përzgjedhjes cilësore, të përcaktuara në listat zyrtare ose në certifikatën ku bazohen | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | operatorët për regjistrimin e tyre. | | | | | |
| 64 (3) | Operatorët ekonomikë të regjistruar në listat zyrtare ose që kanë një certifikatë për çdo kontratë mund t'i paraqesin autoritetit kontraktor një certifikatë regjistrimi të lëshuar nga autoriteti kompetent ose certifikatën e lëshuar nga organi kompetent i certifikimit.<br>Këto certifikata tregojnë referencat që u kanë mundësuar këtyre operatorëve ekonomikë të regjistrohen në listën zyrtare ose të marrin certifikimin dhe klasifikimin e dhënë në atë listë. | | | | E papërputhur | Detajet mbi dokumentat e kerkuara do te percaktohen ne aktet nenligjore |
| 64 (4) | Regjistrimi i vërtetuar në listën zyrtare nga organet kompetente ose një certifikatë e lëshuar nga një organ certifikimi përbën një prezumim të përshtatshmërisë në lidhje me kërkesat për | | | | E papërputhur | Detajet mbi dokumentat e kerkuara do te percaktohen ne aktet nenligjore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përzgjedhjen cilësore të përcaktuar nga lista zyrtare ose certifikata. | | | | | |
| 64 (5) | Informacioni që mund të nxirret nga regjistrimi në listat zyrtare ose certifikimi nuk mund të vihen në diskutim pa arsye. Sa herë që i jepet një kontratë, çdo operatori ekonomik të regjistruar mund t'i kërkohet një vërtetim shtesë në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave. Autoritetet kontraktore të shteteve të tjera anëtare zbatojnë paragrafin 3 dhe nënparagrafin e parë të këtij paragrafi vetëm në favor të operatorëve ekonomikë të themeluar në shtetin anëtar që mban listën zyrtare. | | | | E papërputhur | Detajet mbi dokumentat e kerkuara do te percaktohen ne aktet nenligjore |
| 64 (6) | Kërkesat e provës për kriteret për përzgjedhjen cilësore të përfshira në listën | | | | E papërputhur | Detajet mbi dokumentat e kerkuara do te |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | zyrtare ose në certifikatë janë në pajtim me nenin 60 dhe, sipas rastit, me nenin 62. Për çdo regjistrim të operatorëve ekonomikë të shteteve të tjera anëtare në një listë zyrtare ose për certifikimin e tyre, nuk kërkohet asnjë provë ose deklaratë tjetër përveç atyre që kërkohen nga operatorët ekonomikë kombëtarë. Operatorët ekonomikë mund të kërkojnë në çdo kohë regjistrimin e tyre në një listë zyrtare ose lëshimin e një certifikate. Ato njoftohen brenda një kohe të shkurtër të arsyeshme për vendimin e autoritetit që harton listën ose të organit kompetent të certifikimit. | | | | | percaktohen ne aktet nenligjore |
| 64 (7) | Operatorët ekonomikë nga shtetet e tjera anëtare nuk janë të | | | | E papërputhur | Detajet mbi dokumentat e kerkuara do te |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | detyruar t’i nënshtrohen këtij regjistrimi ose certifikimi për të marrë pjesë në një kontratë publike. Autoritetet kontraktore njohin certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga organet e themeluara në shtete të tjera anëtare. Gjithashtu ato pranojnë mjete të tjera të barasvlershme prove. | | | | | percaktohen ne aktet nenligjore |
| 64 (8) | Shtetet anëtare vënë në dispozicion të shteteve të tjera anëtare, me kërkesë të këtyre të fundit, çdo informacion që lidhet me dokumentet e paraqitura si provë që operatorët ekonomikë përmbushin kërkesat për t'u regjistruar në listën zyrtare të operatorëve ekonomikë të miratuar ose si provë që operatorët ekonomikë nga një shtet tjetër anëtar zotërojnë një certifikim | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të barasvlershëm. **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""** | | | | | |
| Ulja e numrit të kandidatëve të tjerë të kualifikuar që do të ftohen për pjesëmarrje<br>65 (1) | Në procedurat e kufizuara, procedurat konkurruese me negocim, procedurat e dialogut konkurrues dhe partneritetet për novacion, autoritetet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes, që ata do të ftojnë për të dhënë ofertë ose për të kryer një dialog, nëse është i disponueshëm, në përputhje me paragrafin 2, numrin minimal të kandidatëve të kualifikuar. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Ulja e numrit të kandidatëve të tjerë të kualifikuar që do të ftohen për pjesëmarrje<br>85 (1) | Në procedurat e prokurimit me faza, autoritetet ose entet kontraktore mund të kufizojnë numrin e kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes, që ata do të ftojnë për të dhënë ofertë ose për të kryer një dialog, nëse numri minimal i kandidatëve të aftë ka qenë i caktuar sipas parashikimeve të këtij neni. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen<br>92 (1) | Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve që ata do të ftojë për të dhënë ofertë ose për të kryer një dialog, pavarësisht numrit të kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes, nëse një gjë e tillë ka qenë e parashikuar dhe publikuar në dokumentet e tenderit. | | |
| 65 (2) | Autoritetet kontraktore tregojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br>85 (2) | Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kriteret ose rregullat objektive dhe jodiskriminuese që synojnë të zbatojnë, numrin minimal të kandidatëve që synojnë të ftojnë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.<br>Në procedurën e kufizuar, numri minimal i kandidatëve është pesë. Në procedurën konkurruese me negocim, në procedurën e dialogut konkurrues dhe në partneritetin për novacion numri minimal i kandidatëve është tre. Në çdo rast, numri i kandidatëve ose ofertuesve që ftohen duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një konkurrencë të drejtë. Autoriteti kontraktor fton një numër kandidatësh që është të paktën i barabartë me | | | kriteret ose rregullat objektive dhe jodiskriminuese që do të zbatojnë, numrin minimal të kandidatëve që synojnë të ftojnë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.<br><br>Në procedurën e kufizuar, numri minimal i kandidatëve është pesë. Në procedurën konkurruese me negocim, në procedurën e dialogut konkurrues dhe në partneritetin për inovacion, numri minimal i kandidatëve është tre.<br><br>Në rastin e kontratave sektorale, është e drejtë e entit kontraktor të përcaktojë numrin minimal të lejuar të kandidatëve.<br><br>Në çdo rast, numri i kandidatëve që ftohen duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një konkurrencë të drejtë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | numrin minimal. Megjithatë, nëse numri i kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes dhe nivelet minimale të aftësive, siç përmendet në nenin 58, paragrafi 5, është nën numrin minimal, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë procedurën duke ftuar kandidatët me aftësitë e kërkuara. Në kontekstin e të njëjtës procedurë, autoriteti kontraktor nuk përfshin operatorët ekonomikë që nuk kanë kërkuar të marrin pjesë ose kandidatët që nuk kanë aftësitë e kërkuara. | | | Autoriteti ose enti kontraktor fton një numër kandidatësh që është të paktën i barabartë me numrin minimal.<br><br>Megjithatë, nëse numri i kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes dhe nivelet minimale të aftësive, është nën numrin minimal, autoriteti ose enti kontraktor mund të vazhdojë procedurën, duke ftuar kandidatët me aftësitë e kërkuara.<br><br>Autoriteti ose enti kontraktor nuk përfshin operatorët ekonomikë që nuk kanë kërkuar të marrin pjesë ose kandidatët që nuk kanë aftësitë e kërkuara. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>92 (2) | Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë arsyen e aplikimit të mundësisë së uljes së numrit  numrit të operatorëve të kualifikuar që do të ftohen. Rastet kur ky kufizim mund të përdoret janë: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 92 (3) | - Numri i operatorëve në treg, që mund të kualifikohen është shumë i lartë;<br>- Operatorët e kualifikuar do kenë akses në dokumente me informacion konfidencial, të cilin autoriteti/enti kontraktor nuk mund ta shpërndajë tek shumë operatorë.<br>Për qëllim të zbatimit të nenit 85 të LPP, autoriteti/enti kontraktor duhet të ketë publikuar paraprakisht informacionin si vijon:<br>a) kriteret ose rregullat objektive dhe jodiskriminuese që do të zbatohen për uljen e numrit, të cilat duhet të jenë të lidhura me vlerësimin e ofertës ekonomikisht të favorshme (p.sh. kandidatët e kualifikuar me numrin më të lartë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të pikëve do të ftohen).<br>b) numrin minimal të kandidatëve që synojnë të ftojnë, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më pak se 5 (pesë) në procedurën e kufizuar dhe 3 (tre) në procedurën konkurruese me negocim, dialogun konkurrues dhe në partneritetin për inovacion. Në rastin e kontratave sektorale, është e drejtë e entit kontraktor të përcaktojë numrin minimal të lejuar të kandidatëve, por jo më pak se 2 (dy).<br>Pavarësisht numrit të përcaktuar sipas kësaj pike, nëse numri i kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes është nën numrin minimal të lejuar, autoriteti ose enti kontraktor mund të vazhdojë procedurën, duke | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ftuar vetëm kandidatët e kualifikuar.<br>c) numrin maksimal të kandidatëve, që synojnë të ftojnë. | | |
| Ulja e numrit të ofertave dhe zgjidhjeve<br>66 | Kur autoritetet kontraktore zgjedhin të ulin numrin e ofertave që duhet të negociohen, siç e parashikon neni 29, paragrafi 6 ose numrin e zgjidhjeve që do të diskutohen siç e parashikon neni 30, paragrafi 4, ata e bëjnë diçka të tillë duke zbatuar kriteret për shpalljen e kontratës fituese, që përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Në fazën e fundit, numri i arritur garanton konkurrencë të drejtë për sa kohë që ka oferta ose zgjidhje të mjaftueshme ose kandidatë të kualifikuar. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Ulja e numrit të ofertave dhe zgjidhjeve<br>86 (1)<br><br>86 (2) | Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, kriteret ose rregullat objektive dhe jodiskriminuese që do të zbatojnë për uljen e numrit të ofertave dhe zgjidhjeve.<br><br>Nëse autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë mundësinë e uljes së numrit të ofertave, që duhet të negociohen, ose mundësinë për zvogëlim të numrit të zgjidhjeve që do të dialogohen, duhet të zbatojnë kriteret për shpalljen e kontratës fituese, që përcaktohen në dokumentet e tenderit. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 86 (3) | Numri i zvogëluar i ofertave ose zgjidhjeve duhet të sigurojë konkurrencë të drejtë në fazën përfundimtare të negociatave ose dialogut. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Ulja e numrit të ofertave dhe zgjidhjeve<br>93 (1)<br><br>93 (2)<br><br>93 (3) | Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti/enti kontraktor, në fazën përfundimtare, mund të kufizojë numrin e ofertave dhe zgjidhjeve, nëse një gjë e tillë ka qenë e parashikuar dhe publikuar në dokumentet e tenderit.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë arsyen e aplikimit të mundësisë së uljes së numrit të ofertave dhe zgjidhjeve.<br><br>Autoriteti/enti kontraktor nuk mund të vendosë të përcaktojë numrin minimal të ofertave dhe zgjidhjeve në më pak se dy. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në cdo rast, numri i zvogëluar i ofertave ose zgjidhjeve duhet të sigurojë konkurrencë të drejtë në fazën përfundimtare të negociatave ose dialogut. **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””** | | |
| Kriteret për shpalljen e kontratës fituese<br>67 (1) | Pa cenuar ligjet dhe rregullat kombëtare ose dispozitat administrative në lidhje me çmimin e disa furnizimeve ose pagesën e disa shërbimeve, autoritetet kontraktore e bazojnë dhënien e kontratave publike në ofertën ekonomikisht më të favorshme. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Kriteret për shpalljen e ofertës fituese.<br>87 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Kriteret për shpalljen e ofertës fituese.<br>46 (1) | Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme. | | |
| 67 (2) | Oferta, që sipas këndvështrimit të autoritetit kontraktor ka përfitimin më të madh ekonomik, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br>87 (2) | Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 dhe mund të bazohet në raportin më të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | si p.sh. kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 68 dhe mund të përfshijë raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kritere të tilla mund të përfshijnë, për shembull:<br>(a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;<br>(b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur | | | mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.<br><br>Kritere të tilla mund të përfshijnë:<br><br>a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;<br><br>b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose<br><br>c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose<br>(c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.<br>Elementi i kostos gjithashtu mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.<br>Shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore nuk mund të përdorin vetëm çmimin ose vetëm koston si kriter për shpalljen e kontratës fituese ose të kufizojnë përdorimin e tyre për kategori të | | | e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.<br><br>Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit, operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>46 (2) | Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, sic janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | caktuara të autoriteteve kontraktore për lloje të caktuara kontratash. | | | | | |
| 67 (3) | Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:<br>(a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose<br>(b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor,<br>edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br>87 (3) | Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:<br><br>a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose<br><br>b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor,<br><br>edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021** | Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 46 (5) | lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:<br>a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose<br>b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore. | | |
| 67 (4) | Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br>87 (4) | Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen siç duhet për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet kontraktore verifikojnë siç duhet saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit. | | | verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>46 (6) | Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit. | | |
| 67 (5) | Autoriteti kontraktor specifikon në dokumentet e prokurimit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br>87 (5) | Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.<br>Kjo shkallë rëndësie mund të shprehet duke parashikuar një gjerësi variacioni të duhur maksimale.<br>Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës. | | | favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.<br><br>Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>46 (7)<br><br>46 (8) | Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.<br><br>Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.<br><br>Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit. | | |
| Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor 68 (1) | Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:<br>(a) kostot që mbulohen nga autoriteti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:<br>(i) kostot që lidhen me blerjen, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor 88 (1) | Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:<br><br>a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:<br><br>i. kostot që lidhen me blerjen, | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (ii) kostot e përdorimit, si p.sh. konsumi i energjisë dhe burime të tjera,<br>(iii) kostot e mirëmbajtjes,<br>(iv) kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.<br><br>(b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe verifikohet; këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik. | | | ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera,<br>iii. kostot e mirëmbajtjes,<br>iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.<br><br>b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe verifikohet; këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë, dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik. | | |
| 68 (2) | Kur autoritetet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur | | 88 (2) | Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e prokurimit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.<br>Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:<br>(a) ajo bazohet mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese. Sidomos kur nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, ajo nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;<br>(b) është e aksesueshme për të | | | metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor, për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.<br><br>Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:<br><br>a) bazohet mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese. Nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;<br><br>b) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjitha palët e interesuara;<br>(c) të dhënat e kërkuara të mund të jepen pa vështirësi nga operatorë ekonomikë, që tregojnë një kujdes normal, duke përfshirë operatorët ekonomikë nga shtete të treta palë të GPA-së ose marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare që janë detyruese për Bashkimin Evropian. | | | c) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë. | | |
| 68 (3) | Nëse ka një metodë të përbashkët për llogaritjen e kostove gjatë ciklit jetësor, të caktuar me detyrim nga një akt legjislativ i Bashkimit Evropian, atëherë pikërisht ajo metodë e përbashkët do të përdoret për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor.<br>Në shtojcën XIII është paraqitur një listë e këtyre akteve legjislative dhe, kur është e nevojshme, aktet e deleguara që i | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet institucioneve dhe vendeve anetare te BE-se |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | plotësojnë ato. Komisioni ka kompetenca të miratojë aktet e deleguara, në përputhje me nenin 87, në lidhje me përditësimin e asaj liste, kur nevojitet një përditësim i listës për shkak të miratimit të legjislacionit të ri që e bën të detyrueshme një metodë të përbashkët, ose të shfuqizimit ose modifikimit të akteve ligjore ekzistuese. | | | | | |
| Ofertat anomalisht të ulëta<br>69 (1) | Kur autoritetet kontraktore vërejnë se ofertat në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet janë anomalisht të ulëta, u kërkojnë operatorëve ekonomikë që të shpjegojnë çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Oferta anomalisht e ulët<br>93 (1) | Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tre ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. | E plotë | |
| 69 (2) | Shpjegimet e përmendura në paragrafin 1, jepen veçanërisht për:<br>(a) anën ekonomike të procesit | | 93 (2) | Shpjegimet e përmendura në pikën 1, jepen veçanërisht për:<br><br>a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;<br>(b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;<br>(c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;<br>(d) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 18, paragrafi 2;<br>(e) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 71;<br>(f) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. | | | shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;<br><br>b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;<br><br>c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;<br><br>d) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, social dhe të punës;<br><br>e) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. | | |
| 69 (3) | Autoriteti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë duke u konsultuar me | | 93 (3) | Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën vetëm kur provat e dhëna nuk përputhen në nivel të kënaqshëm me nivelin e ulët të çmimit ose të kostove të propozuara, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në paragrafin 2.<br>Autoritetet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme, të përmendura në nenin 18, paragrafi 2. | | | ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementët e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2.<br><br>Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme, nga legjislacioni në fushën e mjedisit, social dhe të punës dhe akteve të tjera. | | |
| 69 (4) | Nëse një autoritet kontraktor përcakton që një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një | | 93 (4) | Nëse një autoritet kontraktor konstaton se, një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se, ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | afati kohor të mjaftueshëm të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, që ndihma ishte në pajtim me tregun e brendshëm, sipas kuptimit të nenit 107 të TFBE-së. Nëse autoriteti kontraktor refuzon një ofertë në këto rrethana, ai e vë në dijeni Komisionin për këtë fakt. | | | duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi. | | |
| 69 (5) | Shtetet anëtare vënë në dispozicion të shteteve të tjera anëtare, me kërkesë të këtyre të fundit, nëpërmjet bashkëpunimit administrativ, çdo lloj informacioni që kanë në dispozicion, si p.sh. ligjet, rregulloret, kontratat kolektive që zbatohen në mënyrë universale ose standardet teknike kombëtare që lidhen me provat dhe dokumentet e përgatitura në lidhje me | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | detajet e paraqitura në paragrafin 2. | | | | | |
| Kushtet për zbatimin e kontratave<br>70 (1) | Autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, nëse ato kanë lidhje me objektin e kontratës, sipas kuptimit të nenit 67, paragrafi 3, dhe janë të përfshira në ftesën për konkurrim ose në dokumentet e prokurimit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me novacionin, faktorë mjedisorë, social ose që lidhen me punësimin. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Kushtet për zbatimin e kontratës<br>123 (1)<br><br>123 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë, ose që lidhen me punësimin.<br><br>Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës<br>35 (1)<br><br><br>35 (2) | Kushtet e përgjithshme të kontratës përcaktojnë kushtet e zbatueshme sipas tipit të kontratave për mallra, punë ose shërbime.<br><br>Kushtet e veçanta të kontratës përkufizojnë tërësinë e punëve që do të kryhen, të gjitha mallrat apo shërbimet që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës. | | |
| Neni 71<br>Nënkontraktimi<br>71 (1) | Respektimi i detyrimeve të përmendura në nenin 18, paragrafi 2 nga nënkontraktorët, garantohet nëpërmjet veprimit të përshtatshëm nga autoritetet kombëtare kompetente, që veprojnë brenda fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës së tyre. | | | | | Kjo dispozite jep qellimin kryesor te parashikimeve te perfshira ne pikat e meposhtme , te cilat jane transpozuar plotesisht ne ligj |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 71 (2) | Autoriteti kontraktor mund të kërkojë në dokumentet e prokurimit, ose një shtet anëtar mund t'u kërkojë atyre që t'i kërkojnë ofertuesit që të tregojë në ofertën e tij, çdo pjesë të kontratës që ai mund të synojë të nënkontraktojë te palët e treta dhe çdo nënkontraktor të propozuar. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Nënkontraktimi<br>126 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br><br>126 (2) | Autoriteti ose enti kontraktor, në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktojnë te palëte treta, si dhe nënkontraktorine propozuar.<br><br>Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 50 përqind të vlerës së përgjithshme të kontratës. | E pjesshme | Ligji parashikon se nënkontraktimi nuk mund të tejkalojë 50% të vlerës së përgjithshmne të kontratës.<br><br>Ky parashikim është bërë duke marrë në considerate mjedisin e zbatimit të ligjit ku mos parashikimi in jë kufizimi të tillë mund të bëhet abuziv nga operatorët ekonomikë. |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Nënkontraktimi<br>90 (1) | Autoriteti/enti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës sipas përcaktimit në nenin 126 të LPP. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t’ua transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti/enti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 90 (2)<br><br>90 (3) | operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë.<br><br>Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi, si dhe nëse autoriteti/enti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit.<br><br>Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 50% të vlerës së kontratës. | | |
| 71 (3) | Shtetet anëtare mund të parashikojnë që me kërkesën e nënkontraktorit dhe kur e lejon natyra e kontratës, autoriteti kontraktor të transferojë pagesat që duhen bërë drejtpërsëdrejti te kontraktori për shërbimet, furnizimet ose punët që i janë ofruar operatorit ekonomik të cilit i | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br>126 (5) | Autoriteti ose enti kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet, shërbimet, ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor. Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa. Rregullat që lidhen me këtë mënyrë pagese, përcaktohen në dokumentet e tenderit. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | është dhënë kontrata publike (ose kontraktorit kryesor). Këto masa mund të përfshijnë mekanizmat e përshtatshëm që i lejojnë kontraktorit kryesor të kundërshtojë pagesat e papërshtatshme. Rregullat që lidhen me këtë mënyrë pagese, përcaktohen në dokumentet e prokurimit. | | **VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>90 (9) | Autoriteti/enti kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet, shërbimet, ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor, kur një gjë e tillë është përcaktuar në dokumentet e tenderit.<br>Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa, të cilat janë të lidhura me faturat e pranuara nga autoriteti/enti kontraktor për llogari të ofertuesit kryesor. | | |
| 71 (4) | Paragrafët 1 deri në 3 nuk prekin përgjegjësitë e kontraktorit kryesor. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>126 (4) | Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit ose entit kontraktor, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët. | | |
| 71 (5) | Në rastin e kontratave të punëve dhe shërbimeve që do të ofrohen në mjedisin që mbikëqyret nga autoriteti kontraktor, pas dhënies së kontratës dhe maksimumi kur fillon zbatimi i kontratës, autoriteti kontraktor i kërkon kontraktorit kryesor që t'i tregojë autoritetit kontraktor emrin, të dhënat e kontaktit dhe përfaqësuesit ligjorë të nënkontraktorëve të tij të përfshirë në këto punë ose shërbime, nëse ato dihen deri në atë moment. Autoriteti kontraktor i kërkon kontraktorit kryesor që ta njoftojë atë për çdo ndryshim në këtë informacion, gjatë zbatimit të kontratës, si edhe për informacionin | | | | E papërputhur | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | e kërkuar për ndonjë nënkontraktor të ri që ai përfshin në vijim në këto punë ose shërbime. Pavarësisht nënparagrafit të parë, shtetet anëtare mund t'ia vendosin drejtpërsëdrejti kontraktorit kryesor detyrimin për të paraqitur informacionin e kërkuar. Nëse është e nevojshme për qëllimet e germës b, paragrafi 6 të këtij neni, informacioni i kërkuar shoqërohet nga vetëdeklarimet e nënkontraktorëve, siç parashikohet në nenin 59. Masat zbatuese sipas paragrafit 8 të këtij neni mund të parashikojnë që nënkontraktorët që paraqiten pas dhënies së kontratës, në vend të vetëdeklarimeve të paraqesin certifikatat | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe dokumente të tjera mbështetëse. Nënparagrafi i parë nuk zbatohet për furnizuesit. Autoritetet kontraktore mund të shtojnë, ose atyre mund t'u kërkohet nga shtetet anëtare që të shtojnë, detyrimet e parashikuara në nënparagrafin e parë, për shembull edhe për: (a) kontratat e furnizimit, kontratat e shërbimeve të ndryshme nga ato që lidhen me shërbimet që duhet të ofrohen në mjediset që mbikëqyren nga autoriteti kontraktor ose për furnizuesit e përfshirë në kontratat e punëve ose shërbimeve; (b)nënkontraktorët e nënkontraktorëve të kontraktorit kryesor ose dhe në hallka të tjera të zinxhirit të nënkontraktimit. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 71 (6) | Me qëllim shmangien e shkeljeve të detyrimeve të përmendura në nenin 18, paragrafi 2 mund të merren masat e përshtatshme, si për shembull:<br>(a) Kur legjislacioni i brendshëm i një shteti anëtar parashikon një mekanizëm të përgjegjësisë së përbashkët ndërmjet nënkontraktorëve dhe kontraktorit kryesor, shtetet anëtare në fjalë garantojnë zbatimin e rregullave përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 18, paragrafi 2.<br>(b) Autoritetet kontraktore, në përputhje me nenet 59, 60 dhe 61, mund të verifikojnë ose atyre mund t'u kërkohet nga shtetet anëtare që të verifikojnë nëse ka arsye për përjashtimin e nënkontraktorëve, sipas nenit 57. Në këto | | | | E papërputhur | Detajet e metejshme do te percaktohen ne aktet nenligjore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | raste, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik që të zëvendësojë një nënkontraktor për të cilin verifikimi ka treguar se ekzistojnë arsye detyruese për përjashtim. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë, ose atij mund t'i kërkohet nga një shtet anëtar që t'i kërkojë një operatori ekonomik zëvendësimin e një nënkontraktori për të cilin verifikimi ka treguar se ekzistojnë arsye jodetyruese për përjashtim. | | | | | |
| 71 (7) | Shtetet anëtare mund parashikojnë rregulla më të rrepta për detyrimet, në legjislacionin e brendshëm, ose të vazhdojnë me pagesat direkt te nënkontraktorët sipas po këtij legjislacioni, për shembull duke parashikuar pagesat e | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""** 126 (5) | Autoriteti ose enti kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet, shërbimet, ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor. Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa. Rregullat që lidhen me këtë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | drejtpërdrejta për nënkontraktorët pa qenë nevoja që ata ta kërkojnë këtë pagesë të drejtpërdrejtë. | | | mënyrë pagese, përcaktohen në dokumentet e tenderit. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>90 (9) | Autoriteti/enti kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet, shërbimet, ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor, kur një gjë e tillë është përcaktuar në dokumentet e tenderit.<br>Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa, të cilat janë të lidhura me faturat e pranuara nga autoriteti/enti kontraktor për llogari të ofertuesit kryesor. | | |
| 71 (8) | Shtetet anëtare që kanë zgjedhur të parashikojnë masa sipas paragrafëve 3, 5 dhe 6, me ligj, rregullore ose dispozita administrative dhe duke pasur parasysh të drejtën e Bashkimit Evropian, specifikojnë | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet vendeve anetare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kushtet zbatuese për këto masa. Duke vepruar kështu, shtetet anëtare mund të kufizojnë zbatueshmërinë e tyre, për shembull për disa lloje kontratash, disa kategori të autoriteteve kontraktore ose operatorëve ekonomikë ose në lidhje me shuma të caktuara. | | | | | |
| Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre<br>72 (1) | Kontratat dhe marrëveshjet kuadër mund të modifikohen pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në përputhje me këtë direktivë për secilin nga rastet e mëposhtme:<br>(a) kur modifikimet, pavarësisht vlerës së tyre monetare, janë parashikuar në dokumentet fillestare të prokurimit nëpërmjet klauzolave të qarta, të sakta dhe të caktuara për rishikimin, që mund të përfshijnë | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre<br>127 (1) | Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi, në rastet e mëposhtme:<br><br>a) Kur modifikimet, pavarësisht vlerës së tyre monetare, janë pasqyruar në mënyrë të saktë dhe të qartë në kontratën fillestare, sikurse janë klauzolat e rishikimit të çmimit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Të tilla klauzola duhet të deklarojnë qëllimin dhe natyrën e modifikimeve apo opsioneve të mundshme, si | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | klauzola për rishikimin e çmimit ose opsione. Në këto klauzola deklarohet objekti dhe natyra e modifikimeve ose opsioneve të mundshme si edhe kushtet në të cilat ato mund të përdoren. Ato nuk parashikojnë modifikime ose opsione që do të ndryshonin natyrën e përgjithshme të kontratës ose të marrëveshjes kuadër;<br>(b) për punë, shërbime ose furnizime shtesë nga kontraktori fillestar, që janë bërë të nevojshme dhe që nuk ishin përfshirë në prokurimin fillestar kur ndryshimi i kontraktorit:<br>(i) nuk mund të bëhet për arsye ekonomike ose teknike, siç janë kërkesat për zëvendësimin dhe ndërveprueshmërinë me pajisjet, shërbimet ose instalimet | | | dhe kushtet me anë të të cilave mund të përdoren, por me kusht që ato nuk mund të sjellin ndryshime të natyrës së kontratës apo të marrëveshjes kuadër.<br>b) Për furnizimin e mallrave, shërbimeve, apo kryerjen e punëve në një kontratë që eshtë ende në zbatim nga kontraktori fillestar, që nuk mbulohen nga kontrata fillestare, të cilat janë bërë të domosdoshme prej rrethanave të paparashikuara dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar:<br><br>i. Nuk është i mundur për arsye ekonomike, apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruara gjatë procedurës fillestare;<br>si dhe<br><br>ii. Do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ekzistuese të prokuruara në zbatim të prokurimit fillestar; dhe<br>(ii) do të shkaktonte vështirësi të konsiderueshme ose duplikim të konsiderueshëm të kostove për autoritetin kontraktor.<br>Megjithatë, ngritja e çmimit nuk tejkalon 50% të vlerës së kontratës fillestare. Kur bëhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim zbatohet për vlerën e secilit modifikim. Këto modifikime të njëpasnjëshme nuk kanë si qëllim anashkalimin e kësaj direktive;<br>(c) kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:<br>(i) nevoja për modifikim ka lindur nga rrethana të cilat nuk mund të parashikoheshin nga | | | rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.<br><br>c) Kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëvshjes kuadër.<br><br>ç) Kur kontraktori fillestar është zëvendësuar nga një operator ekonomik i ri, i cili përmbush të gjitha kërkesat fillestare të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së zhvilluar, dhe që është pasuesi i ligjshëm i kontraktuesit fillestar si rrjedhojë e ristrukturimit të kompanisë, përfshirë marrjen e pronësisë, ndarjen apo bashkimin e shoqërisë, apo falimentimin, me kusht që nuk sjell ndryshime të tjera thelbësore në kontratë dhe nuk ka për synim shmangien e këtij ligji. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | një autoritet kontraktor i kujdesshëm;<br>(ii) modifikimi nuk ndryshon natyrën e përgjithshme të kontratës;<br>(iii) çdo ngritje e çmimit nuk tejkalon 50% të vlerës së kontratës fillestare ose marrëveshjes kuadër. Kur bëhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim zbatohet për vlerën e secilit modifikim. Këto modifikime të njëpasnjëshme nuk kanë si qëllim anashkalimin e kësaj direktive;<br><br>(d) kur një kontraktor i ri zëvendëson kontraktorin të cilit autoriteti kontraktor i kishte dhënë kontratën fillimisht, si pasojë e:<br>(i) një klauzole rishikimi të caktuar ose | | | d) Kur modifikimi, pavarësisht vlerës së tij, nuk është thelbësor brenda kuptimit të pikës 4, të këtij neni. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(43) | Në nenin 127 “Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre” bëhen ndryshimet si më poshtë:<br>a) Në gërmën “a” të pikës 1, togfjalëshi “në kontratën fillestare” zëvendësohet me togfjalëshin “në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare”.<br>b) Gërma “b” e pikës 1, ndryshon si më poshtë:<br>“b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të domosdoshme dhe nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare, dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | opsioni, në përputhje me germën a;<br>(ii) zëvendësimit universal ose të pjesshëm të pozicionit të kontraktorit fillestar, në vijim të ristrukturimit të korporatës, duke përfshirë marrjen nën kontroll, shkrirjen, blerjen ose falimentimin, me një operator tjetër ekonomik që përmbush kriteret për përzgjedhjen cilësore që është vendosur në fillim, me kusht që kjo të mos përfshijë modifikime të tjera thelbësore të kontratës dhe të mos ketë si qëllim shmangien nga zbatimi i kësaj direktive; ose<br>(iii) në rastin kur vetë autoriteti kontraktor merr përsipër detyrimet e kontraktorit kryesor përkundrejt nënkontraktorëve të tij, | | | i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruara gjatë procedurës fillestare; si dhe<br>ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.<br><br>Në këtë rast, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një argumentim të të gjitha arsyeve se përse furnizimet, shërbimet ose punët janë të domosdoshme, arsyet përse ato nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare apo marrëveshja kuadër, si dhe arsyet ekonomike dhe teknike, prej të cilave nuk mund të zëvendësohet kontraktuesi fillestar.”<br><br>c) Në gërmën c, të pikës 1, shtohet një | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kur kjo mundësi parashikohet në zbatim të legjislacionit të brendshëm sipas nenit 71;<br><br>(e) kur modifikimet, pavarësisht vlerës së tyre, nuk janë thelbësore, sipas kuptimit të paragrafit 4. Pasi autoritetet kontraktore modifikojnë një kontratë, në rastet e përcaktuara në germën b dhe c të këtij paragrafi, shpallin njoftim për këtë qëllim në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Ky njoftim përmban informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesa G dhe shpallet në përputhje me nenin 51. | | | paragraf me këtë përmbajtje:<br>“c) Në këtë rast, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një përshkrim të ndryshimeve, arsyet dhe rrethanat të cilat autoriteti ose enti kontraktor nuk mund t’i parashikonte gjatë dhënies së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër, si dhe një shpjegim se përse këto modifikime nuk ndryshojnë natyrën e kontratës ose të marrëveshjes kuadër”.<br>d) Pika 3, ndryshon si më poshtë:<br>“3. Autoriteti ose enti kontraktor, pasi ka modifikuar kontratën apo marrëveshjen kuadër, në përputhje me pikën 1, shkronjat “b” dhe “c”, të këtij neni, duhet të dërgojë për publikim një njoftim për ndryshimin e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj, në Buletinin e Njoftimeve Publike brenda pesë ditëve, nga data në të cilën ka bërë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | modifikimin e kontratës fillestare.<br>e) Pikat 7 dhe 8 ndryshohen si më poshtë vijon:<br>7. Menaxhimi i kontratës së prokurimit publik dhe monitorimi i zbatimit të saj mbështetur në raportimin e zbatimit të kontratës, kryhet nga AK në Sistemin e Menaxhinit të Kontratave në ndërveprim me Sistemin e Prokurimit Elektronik.<br>Autoriteti kontraktor, në përputhje me natyrën e kontratës mund të përdorë procese të automatizuar dhe inteligjencën artificiale në procesin e monitorimit të zbatimit të kontratës.<br>8. Pagesat e operatorëve ekonomikë në zbatim të kontratës kryhen përmes sistemit të menaxhimit financiar pas miratimit të dokumentacionit përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi në Sistemin e Menaxhimit të Kontratatave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Sistemi gjeneron njoftime automatike mbi risqet për kryerjen e pagesave“. | | |
| 72 (2) | Gjithashtu, dhe pa qenë nevoja për të verifikuar nëse përmbushen ose jo kushtet e përcaktuara në germën a deri në d të paragrafit 4, kontratat po ashtu mund të modifikohen pa qenë nevoja për një procedurë të re prokurimi sipas kësaj direktive, kur vlera e modifikimit nuk tejkalon asnjërën nga vlerat e mëposhtme:<br>(i) kufijtë monetarë të përcaktuar në nenin 4; dhe<br>(ii) 10% të vlerës së kontratës fillestare për kontratat e shërbimit dhe furnizimit dhe nën 15% të vlerës së kontratës fillestare për kontratat për punë. Megjithatë, modifikimi nuk mund të ndryshojë natyrën e përgjithshme të kontratës ose të | | 127 (2) | Në rastet e referuara në gërmat “a”, “b” dhe “c” , të këtij neni, vlera totale e modifikimeve të kontratës apo marrëveshjes kuadër nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata publike përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar. | E pjesshme | Duke pasur parasysh qe nje parashikim i tille mund te perdoret ne menyre abuzive nga Autoritetet /entet kontraktore apo operatoret ekonomike, Neni 127 (2) parashikon qe modifikimi i kontrates pa qene nevoja per nje procedure te re prokurimi te behet vetem ne rast sE plotësohen kushtet e percktuara ne piken 1 dhe nuk duhet te kaloje 20% te vleres se kontrates fillestare. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | marrëveshjes kuadër. Kur bëhen disa ndryshime të njëpasnjëshme, vlera shqyrtohet mbi bazën e vlerës kumulative neto të modifikimeve të njëpasnjëshme. | | | | | |
| 72 (3) | Për qëllimin e llogaritjes së çmimit të përmendur në paragrafin 2 dhe germat b dhe c të paragrafit 1, çmimi i përditësuar është vlera referencë kur kontrata përfshin një klauzolë indeksimi. | | 127 (2) | Në rastet e referuara në gërmat “a”, “b” dhe “c” , të këtij neni, vlera totale e modifikimeve të kontratës apo marrëveshjes kuadër nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata publike përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar. | E plotë | Fjalia e fundit e kesaj pike reflekton plotesisht nenin 73 (2) te direktives |
| 72 (4) | Një modifikim i kontratës ose i | | 127 (4) | Modifikimi i një kontrate publike apo marrëveshje | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | marrëveshjes kuadër gjatë afatit të saj, konsiderohet se është thelbësor sipas kuptimit të germës e të paragrafit 1 kur ai e bën kontratën ose marrëveshjen kuadër në thelb të ndryshme nga ajo që është lidhur në fillim. Gjithsesi, pa cenuar paragrafët 1 dhe 2, modifikimi konsiderohet si thelbësor kur përmbushet një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:<br>(a) modifikimi paraqet kushte të cilat, po të kishin qenë pjesë e procedurës fillestare të prokurimit, do të kishin lejuar pranimin e kandidatëve të ndryshëm nga ata që u përzgjodhën fillimisht ose pranimin e një oferte të ndryshme nga ajo që u pranua fillimisht ose do të kishin tërhequr pjesëmarrës shtesë në | | | kuadër do të konsiderohet si thelbësor, atëherë kur kontrata publike apo marrëveshja kuadër hartohet thelbësisht ndryshe nga kontrata publike apo marrëveshja kuadër fillestare e nënshkruar, dhe në veçanti kur:<br><br>a) modifikimi sjell kushte, të cilat, në rast se do të kishin qenë pjesë e procedurës fillestare të prokurimit, do të kishin lejuar pjesëmarrjen e kandidatëve të tjerë përveç atyre që ishin ftuar, ose pranimin e ndonjë oferte tjetër, si ekonomikisht më e favorshme, nga ajo e përzgjedhur fillimisht, ose do të kishin lejuar pjesëmarrjen e kandidatëve shtesë në procedurën përkatëse të prokurimit publik;<br><br>b) modifikohet barazpesha ekonomike e kontratës publike apo e marrëveshjes kuadër, duke anuar për nga operatori ekonomik, në një | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | procedurën e prokurimit;<br>(b) modifikimi ndryshon balancën ekonomike të kontratës ose marrëveshjes kuadër në favor të kontraktorit, në një mënyrë që nuk ishte parashikuar në kontratën ose marrëveshjen kuadër fillestare;<br>(c) modifikimi zgjeron në mënyrë të konsiderueshme objektin e kontratës ose të marrëveshjes kuadër;<br>(d) kur një kontraktor i ri zëvendëson kontraktorin të cilit autoriteti kontraktor i kishte dhënë fillimisht kontratën, për raste të ndryshme nga ato që parashikohen në germën d të paragrafit 1. | | | mënyrë, e cila nuk ishte parashikuar në kontratën fillestare apo marrëveshjen kuadër;<br><br>c) modifikimi ndryshon objektin e kontratës publike apo marrëveshjes kuadër;<br><br>ç) kontraktori fillesta zëvendësohet nga një tjetër operator ekonomik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 1, gërma ”ç”, të këtij neni. | | |
| 72 (5) | Për modifikimin e dispozitave të një kontrate publike ose marrëveshjeje kuadër | | 127 (5) | Për modifikimin e dispozitave të kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër gjatë kohëzgjatjes së | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjatë afatit të saj, të ndryshme nga ato që parashikohen në paragrafin 1 dhe 2, në përputhje me këtë direktivë, kërkohet një procedurë e re prokurimi. | | | saj, të cilat nuk mbulohen nga pika 1, e këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor ka për detyrim të zhvillojë një procedurë të re prokurimi, në përputhje me këtë ligj. | | |
| Zgjidhja e kontratave<br>73 (1) | Shtetet anëtare garantojnë që autoritetet kontraktore të kenë mundësinë, të paktën në rrethanat e mëposhtme dhe sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm i zbatueshëm, që të zgjidhin një kontratë publike gjatë afatit të saj, nëse:<br>(a) kontrata i është nënshtruar një modifikimi thelbësor, që do të kërkonte një procedurë të re prokurimi sipas nenit 72;<br>(b) në kohën e dhënies së kontratës kontraktori ndodhej në një prej situatave të përmendura në nenin | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Zgjidhja e kontratave<br>128 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor zgjidh kontratën publike apo marrëveshjen kuadër gjatë kohëzgjatjes së saj, në rastet kur:<br>a) kontrata duhet të modifikohet në mënyrë thelbësore, gjë e cila lind detyrimin për zhvillimin e një procedure të re të prokurimit publik;<br>b)kontrata apo marrëveshja kuadër nuk duhej t'i ishte dhënë kontraktorit, për shkak të shkeljeve të rënda të këtij ligji, të cilat rrjedhin nga një vendim gjyqësor i formës së prerë, të dhënë nga një gjykatë kompetente. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 57, paragrafi 1 dhe për këtë arsye duhet të ishte përjashtuar nga procedura e prokurimit;<br>(c) kontrata nuk duhet t'i ishte dhënë kontraktorit për shkak të një shkeljeje të rëndë të detyrimeve në zbatim të traktateve dhe kësaj direktive, e cila është deklaruar nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në një procedurë sipas nenit 258 të TFBE-së. | | | | | |
| Dhënia e kontratave për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike 74 (1) | Kontratat publike për shërbime speciale dhe shërbime të tjera specifike të paraqitura në shtojcën XIV jepen në përputhje me këtë kapitull, nëse vlera e kontratave është e barabartë me ose më e madhe se sa kufiri monetar i përcaktuar në germën d të nenit 4. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Prokurimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera të veçanta 100 (1)<br><br>100 (2) | 1. Kontratat publike për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike,jepen në përputhje me këtë kre<br><br>Llojet e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, në kuptim të këtij ligji, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. | E plotë | |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Kufijtë Monetarë 5 (1) | Për efekt të zbatimit të këij vendimi kufiri monetar për kontratat e shërbimeve, është: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 5 (2) | a) për kontrata klasike 90,000,000 (nëntëdhjetë milion) lekë;<br><br>b) për kontratat sektoriale 120.000.000(njëqind e njëzet milion) lekë.<br><br>Për shërbimet objekt i këtij vendimi, vlera e përllogaritur e të cilave brenda një viti kalendarik nuk është me madhe se 500.000 (pesëqind mijë) lekë, autoritetiose enti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. | | |
| Shpallja e njoftimeve<br>75 (1) | Autoritetet kontraktore që synojnë të japin një kontratë publike për shërbimet e përmendura në nenin 74 bëjnë të ditur qëllimin e tyre nëpërmjet njërës prej mënyrave të mëposhtme:<br>(a) nëpërmjet njoftimit të kontratës, i cili përmban informacionin e | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Shpallja e njoftimeve<br>101 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore që synojnë të japin një kontratë publike për këto lloj shërbimesh bëjnë të ditur qëllimin e tyre, nëpërmjet njërës prej mënyrave të mëposhtme:<br>a) nëpërmjet njoftimit të kontratës;<br>b) nëpërmjet njoftimit paraprak të informacionit ose njoftimit periodik të informacionit, i cili i referohet në mënyrë | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përmendur në shtojcën V pjesa H, sipas formularëve standardë të përmendur në nenin 51; ose<br>(b) nëpërmjet njoftimit paraprak të informacionit, i cili shpallet vazhdimisht dhe përmban informacionin e përcaktuar në shtojcën V pjesa I. Njoftimi paraprak i informacionit i referohet në mënyrë specifike llojeve të shërbimeve që do të jenë objekt i kontratave që do të jepen. Aty përcaktohet që kontratat do të jepen pa shpallje të mëtejshme dhe ftohen operatorët ekonomikë të interesuar që të shprehin interesin e tyre me shkrim. Megjithatë, nënparagrafi i parë nuk zbatohet kur për dhënien e një kontrate publike për shërbim | | | specifike llojeve të shërbimeve që do të jenë objekt i kontratave që do të jepen. Në njoftim përcaktohet që, kontratat do të jepen pa shpallje të mëtejshme dhe ftohen operatorët ekonomikë të interesuar që të shprehin interesin e tyre.<br>c) nëpërmjet një njoftimi për ezkistencën e një sistemi kualifikimi, i cili shpallet vazhdimisht.<br>Kjo pikë nuk zbatohet kur për dhënien e një kontrate publike për shërbim mund të ishte përdorur procedura me negocim, pa shpallje paraprake. | | |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Njoftimet<br>2 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore, që synojnë të japin një kontratë publike për këto lloj shërbimesh, bëjnë të ditur qëllimin e tyre, nëpërmjet njërës prej mënyrave të mëposhtme:<br><br>a) nëpërmjet njoftimit të kontratës;<br><br>Ky njoftim duhet të përmbajë informacionin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mund të ishte përdorur procedura me negocim, pa shpallje paraprake në përputhje me nenin 32. | | | nevojshëm që i jep mundësi kandidatëve të interesuar, të përgatisin ofertat e tyre.<br><br>Ky njoftim përmban të paktën:<br>- emrin dhe adresën autoritetit/ ose entit kontraktor;<br>- emrin dhe kontaktet e Personit/ave Përgjegjës për procedurën;<br>- objektin e procedurës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);<br>- llojin e procedurës së prokurimit;<br>- vlerën limit të përllogaritur të kontratës dhe burimin e financimit;<br>- kohëzgjatjen e kontratës;<br>- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - Kushtet për pjesëmarrje, duke përfshirë<br>o sipas rastit, të tregohet nëse kontrata kufizohet në organizatat që punësojnë persona me aftësi të kufizuara ose nëse zbatimi i saj kufizohet në kuadrin e programeve të sigurisë në punë.<br>o sipas rastit, të tregohet nëse kryerja e shërbimit është e drejtë e rezervuar me ligj, rregullore ose dispozitë administrative për një | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | profesion të veçantë;<br>- kriteret e shpalljes së fituesit;<br>- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;<br>- gjuhën /gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;<br>- informacion nëse është përdorur njoftim paraprak/periodik i informacionit;<br>- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/ ose enti kontraktor.<br><br>b) nëpërmjet njoftimit paraprak të informacionit ose njoftimit periodik të informacionit, i cili, i referohet në mënyrë specifike llojeve të shërbimeve që do të jenë objekt i kontratave që do të jepen. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në rastin kur, autoritetet ose entet kontraktore vlerësojnë të përdorin njoftim paraprak/periodik ftojnë operatorët ekonomikë të interesuar që të shprehin interesin e tyre dhe përcaktojnë në këtë njoftim që kontratat do të jepen pa shpallje të mëtejshme.<br><br>Njoftimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, sipas gërmës “a” të këtij neni, i cili i jep mundësi operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre.<br><br>Njoftimi shpallet 35 (tridhjetë e pesë) ditë deri në 18 (tetëmbëdhjetë) muaj përpara datës, në të cilën është dërguar ftesa.<br><br>c) nëpërmjet një njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, i cili shpallet vazhdimisht.<br><br>Ky njoftim përmban të paktën:<br><br>- emrin dhe adresën e entit kontraktor; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - emrin dhe kontaktet e Personit/ave Përgjegjës të prokurimit;<br>- qëllimi i sistemit të kualifikimit;<br>- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të prokurimit (CPV);<br>- llojin e kontratës ose kategori sipas llojit të kontratës, kur ka një ndarje të tillë;<br>- llojin e procedurës së prokurimit që enti kontraktor planifikon të përdorë për dhënien e kontratave;<br>- periudhën e vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit;<br>- kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë;<br>- kriteret për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga sistemi i kualifikimit;<br>- kriteret për përzgjedhjen e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2 (2)<br><br>2 (3) | operatorëve ekonomikë të tjerë dhe përditësimin periodik të kualifikimeve;<br>- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga enti kontraktor.<br><br>Në njoftimin e kryer sipas pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor përcakton mundësinë për kontratën e rezervuar për organizata ose sipas parashikimeve të nenit 15 të LPP.<br><br>Detyrimi për publikimin e njoftimit sipas pikës 1, nuk zbatohet kur autoriteti ose enti kontraktor për dhënien e një kontrate publike për shërbime, objekt i këtij vendimi, ndodhet në një nga kushtet e përcaktuara në nenin 47 të LPP. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor do të ndjekë procedurat e nenit 47 të LPP. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 75 (2) | Autoritetet kontraktore që kanë dhënë një kontratë publike për shërbimet e përmendura në nenin 74 publikojnë rezultatet e procedurës së prokurimit nëpërmjet një njoftimi për dhënien e kontratës, i cili përmban informacionin e përmendur në shtojcën V pjesa J, sipas formularëve standardë të përmendur në nenin 51. Megjithatë, ata mund t'i grupojnë njoftimet mbi bazë tre-mujore. Në këto raste ata i dërgojnë njoftimet e grupuara brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tre mujori. | | 101 (2) | Autoritetet ose entet kontraktore që kanë dhënë një kontratë publike për shërbimet e përmendura në nenin 100 publikojnë rezultatet e procedurës së prokurimit, nëpërmjet një njoftimi për dhënien e kontratës, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. | E plotë | |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Njoftimi i fituesit 12 | Jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor dërgon për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe Sistemin e Prokurimit Elektronik, njoftimin e fituesit të procedurës. | | |
| 75 (3) | Komisioni përcakton formularët standardë të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nëpërmjet akteve ligjore zbatuese. Këto akte ligjore zbatuese miratohen në përputhje me | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet Komisionit Europian |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | procedurën këshillimore të përmendur në nenin 89, paragrafi 2. | | | | | |
| 75 (4) | Njoftimet e përmendura në këtë nen, shpallen në përputhje me nenin 51. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>101 (2) | Autoritetet ose entet kontraktore që kanë dhënë një kontratë publike për shërbimet e përmendura në nenin 100 publikojnë rezultatet e procedurës së prokurimit, nëpërmjet një njoftimi për dhënien e kontratës, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. | E plotë | |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Shpallja e procedurës<br>10 | Autoriteti ose enti kontraktor shpall një njoftim, sipas nenit 3, i cili publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe Sistemin e Prokurimit Elektronik. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Parimet për shpalljen e kontratave fituese<br>76 (1) | Shtetet anëtare vendosin rregulla kombëtare për shpalljen fituese të kontratave, që janë objekt i këtij kapitulli, për të garantuar që autoritetet kontraktore të veprojnë në pajtim me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Shtetet anëtare janë të lira të përcaktojnë rregullat procedurale që zbatohen, për sa kohë që këto rregulla u lejojnë autoriteteve kontraktore, të marrin në konsideratë specifikat e shërbimeve në fjalë. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Parimet për shpalljen e kontratave fituese<br>102 (1) | Për shpalljen fituese të kontratave, që janë objekt i këtij kreu, autoritetet ose entet kontraktore veprojnë në pajtim me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.<br>Rregullat procedurale që zbatohen, përcaktohen në rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që t'u lejojnë autoriteteve ose enteve kontraktore, të marrin në konsideratë specifikat e shërbimeve në fjalë. | E plotë | |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Dispozita të përgjithshme<br>1 (1) | Autoritetet ose entet kontraktore, në kryerjen e procedurave për shpalljen e fituesve të kontratave për shërbimet, objekt i këtij vendimi duhet të veprojnë në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1 (2) | ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës.<br><br>Autoritetet ose entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. | | |
| 76 (2) | Shtetet anëtare garantojnë që autoritetet kontraktore të mund të marrin në konsideratë nevojën për të garantuar cilësi, vazhdimësi, aksesueshmëri, kosto-efektivitet, disponueshmëri dhe gjithëpërfshirje në shërbime, nevojat specifike të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë njerëzit në nevojë dhe grupet vulnerabël, përfshirjen | | 102 (2) | Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin në konsideratë nevojën për të garantuar cilësi, vazhdimësi, aksesueshmëri, kosto-efektivitet, disponueshmëri dhe gjithëpërfshirje në shërbime, nevojat specifike të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë njerëzit në nevojë dhe grupet vulnerabël, përfshirjen dhe fuqizimin e përdoruesve dhe inovacionin.<br>Autoritetet ose entet kontraktore mund të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe fuqizimin e përdoruesve dhe novacionin. Shtetet anëtare gjithashtu mund të parashikojnë që zgjedhja e ofruesit të shërbimit të bëhet mbi bazën e ofertës që paraqet raportin më të mirë çmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale. | | | parashikojnë që zgjedhja e ofruesit të shërbimit të bëhet mbi bazën e ofertës që paraqet raportin më të mirë çmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale. | | |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Dispozita të përgjithshme<br>1 (3)<br><br>1 (4)<br><br>1 (5) | Në përgatitjen dhe kryerjen e procedurave të prokurimit për shërbimet objekt i këtij vendimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të garantojnë cilësi, vazhdimësi, aksesueshmëri, kosto-efektivitet, disponueshmëri dhe gjithëpërfshirje në shërbime.<br><br>Në hartimin e kërkesave për këto lloj shërbimesh, autoritetet soe entet kontraktore duhet te mbajnë në konsideratë gjithashtu, nevojat specifike të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë njerëzit në nevojë dhe grupet vulnerabël. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1 (6)<br><br>1 (7) | Përcaktimet e parashikuara në këtë vendim janë njësoj të zbatueshme për operatorët ekonomikë, si person fizik ose juridik apo atyre në cilësinë e organizatave jofitimprurëse, si dhe për bashkimet e tyre.<br><br>Për çdo fazë të procesit, që nuk gjen rregullim konkret në këtë vendim, zbatohen parashikimet e LPP dhe rregullave të prokurimit publik.<br><br>Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik, sipas parashikimeve të LPP zbatohen edhe për prokurimet në kategoritë e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike. | | |
| Kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara<br>77 (1) | Shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore mund t'u japin të drejtën organizatave që të marrin pjesë në procedurat për dhënien | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik””**<br><br>Kontrata të rezervuara për | Autoritetet ose entet kontraktore rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik, organizatave të caktuara, për dhënien e kontratave publike për | E plotë | Lista e shërbimeve të listuara në Shtojcën 2 të Projektvendimit është paraqitur |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | e kontratave publike ekskluzivisht për shërbimet shëndetësore, sociale dhe kulturore që përmenden në nenin 74, të cilat mbulohen nga kodet e FPP-së 75121000-0, 75122000-7, 75123000-4, 79622000-0, 79624000-4, 79625000-1, 80110000-8, 80300000-7, 80420000-4, 80430000-7, 80511000-9, 80520000-5, 80590000-6, nga 85000000-9 deri në 85323000-9, 92500000-6, 92600000-7, 98133000-4, 98133110-8. | | shërbime të caktuara<br>103 (1) | shërbime të veçanta, veçanërisht për shërbime shëndetësore, sociale dhe kulturore. Llojet e shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. | | në fund të tabelës |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara<br>3 (1) | Autoritetet/entet kontraktore u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik organizatave të caktuara për dhënien e kontratave publike për shërbime të veçanta, veçanërisht për shërbime shëndetësore, sociale dhe kulturore, sipas shtojcës 2 të këtij vendimi.<br><br>***KËSHILLI I MINISTRAVE***<br><br>***VENDOSI:***<br><br>*1. Përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *specifike, sipas ndarjeve të mëposhtme, të detajuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi*<br>*a) Shërbime rekreative, kulturore dhe sportive;*<br>*b) Shërbime të administrimit, mbrojtjes dhe sigurisë sociale;*<br>*c) Shërbime të hotelerisë dhe restoranteve ;*<br>*d) Shërbime të edukimit dhe trajnimit;*<br>*e) Shërbime të kujdesit shëndetësor dhe të kujdesit shoqëror;*<br>*f) Shërbime personale, sociale dhe në komunitet.* | | |
| 77 (2) | Organizata që përmendet në paragrafin 1 duhet të përmbushë një nga kushtet e mëposhtme:<br>(a) ka si objektiv përmbushjen e një misioni të shërbimit | | 103 (2) | Organizata, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:<br>a) qëllimi i saj është përmbushja e një misioni të shërbimit publik, që lidhet me ofrimin e shërbimeve të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | publik, që lidhet me lëvrimin e shërbimeve të përmendura në paragrafin 1;<br>(b) fitimet investohen përsëri me qëllim arritjen e objektivit të organizatës. Nëse fitimet shpërndahen ose rishpërndahen, kjo duhet të bazohet mbi konsiderime të pjesëmarrjes;<br>(c) strukturat e drejtimit ose pronësisë së organizatës që zbaton kontratën bazohen në pronësinë nga punonjësit ose parimet e pjesëmarrjes, ose kërkojnë pjesëmarrjen aktive të punonjësve, përdoruesve ose aktorëve të përfshirë; dhe<br>(d) gjatë tre viteve të fundit organizata nuk është shpallur fituese e një kontrate për shërbimet në fjalë nga | | | përmendura në pikën 1 të këtij neni;<br>b) fitimet investohen sërish, për përmbushjen e objektivave të organizatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi;<br>c) strukturat drejtuese ose të pronësisë së organizatës bazohen në parimet e pronësisë dhe pjesëmarrjes së punonjësve, ose kërkojnë pjesëmarrje aktive të punonjësve, përdoruesve, ose palëve të interesuara, dhe<br>d) gjatë tre viteve të fundit, organizata nuk është shpallur fituese e një kontrate për shërbimet e përcaktuara në këtë nen, nga autoriteti ose enti kontraktor që prokuron kontratën. | | |
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara<br>3 (2) | Organizata, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të plotësojë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:<br><br>a) Qëllimi i saj është përmbushja e një misioni të shërbimit publik, që lidhet me ofrimin e shërbimeve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | autoriteti kontraktor në fjalë sipas këtij neni. | | | përmendura në pikën 1, të këtij neni;<br><br>b) Përfitimet e krijuara investohen sërish, për përmbushjen e objektivave të organizatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi;<br><br>c) Strukturat drejtuese ose të pronësisë së organizatës bazohen në parimet e pronësisë dhe pjesëmarrjes së punonjësve ose kërkojnë pjesëmarrje aktive të punonjësve, përdoruesve ose palëve të interesuara; dhe<br><br>ç) gjatë tri viteve të fundit, organizata nuk është shpallur fituese e një kontrate për shërbimet e përcaktuara në këtë nen nga autoriteti ose enti kontraktor që prokuron kontratën. | | |
| 77 (3) | Kohëzgjatja maksimale e kontratës nuk është më e madhe se tre vjet. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>102 (3) | Kohëzgjatja e kontratës së lidhur sipas këtij neni, nuk mund të jetë më shumë se tre vjet. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara<br>3 (3) | Kohëzgjatja e kontratës së lidhur sipas këtij neni nuk mund të jetë më shumë se tre vjet. | | |
| 77 (4) | Në ftesën për konkurrim përmendet ky nen. | | **VKM nr. 768, date 15.12.2021i**<br><br>Njoftimet<br>2 (1) | Në njoftimin e kryer sipas pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor përcakton mundësinë për kontratën e rezervuar për organizata ose sipas parashikimeve të nenit 15 të LPP. | E plotë | |
| 77 (5) | Pavarësisht nenit 92, Komisioni shqyrton zbatimin e kësaj direktive dhe i raporton për këtë çështje Parlamentit Evropian dhe Këshillit përpara datës 18 prill 2019. | | | | E papërputhur | Kjo dispozite i referohet Komisionit Europian |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rregullat që rregullojnë konkurset e projektimit<br>Fusha e zbatimit<br>78 (1) | Ky kapitull gjen zbatim për:<br>(a) konkurset e projektimit të organizuara si pjesë e një procedure e cila çon në dhënien e një kontrate publike për shërbime;<br>(b) konkurse projektimi me çmime ose pagesa për pjesëmarrësit.<br>Për rastet e përmendura në germën a të paragrafit të parë të këtij neni, kufiri monetar që përmendet në nenin 4 llogaritet mbi bazën e vlerës së parashikuar pa TVSH të kontratës publike të shërbimit, duke përfshirë çdo çmim ose pagesë të mundshme për pjesëmarrësit.<br>Për rastet e përmendura në germën b të paragrafit të parë të këtij neni, kufiri monetar i referohet shumës totale të çmimeve dhe pagesave, | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Konkursi i projektimit<br><br>Zbatimi<br>104 (1)<br><br>104 (2) | Dispozitat e këtij Kreu zbatohen për:<br><br>a) konkurset e projektimit, me çmime ose pagesa të pjesëmarrësve;<br><br>b) konkurset e projektimit të organizuara si pjesë e një procedure e cila çon në dhënien e një kontrate publike për shërbime.<br><br>Në rastet e përmendura në shkronjën "a", të pikës 1 të këtij neni, vlera e përcaktuar e konkursit të projektimit bazohet në vlerën e përcaktuar pa TVSH të kontratës së shërbimit, duke përfshirë të gjitha çmimet ose pagesat e mundshme për pjesëmarrësit.<br>Në rastet e përmendura në shkronjë "b", të pikës 1 të këtij neni, vlera e konkursit të projektimit përcaktohet si shumë totale e çmimeve dhe pagesave, duke përfshirë edhe vlerën e parashikuar pa TVSH të kontratës publike të | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | duke përfshirë vlerën e parashikuar pa TVSH të kontratës publike të shërbimeve që mund të lidhet në vijim sipas nenit 32, paragrafi 4 nëse autoriteti kontraktor ka bërë të ditur qëllimin e tij për të shpallur fituesin e kësaj kontrate në njoftimin e konkursit. | | | shërbimit që mund të lidhet në vijim në përputhje me nenin 47, nëse autoriteti ose enti kontraktor ka bërë të ditur qëllimin e tij për të shpallur fituesin e kësaj kontrate në njoftimin e konkursit. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Konkursi i projektimit<br><br>Zbatimi<br>104 (1)<br><br><br><br><br><br><br><br>104 (2) | Dispozitat e këtij Kreu zbatohen për:<br><br>a) konkurset e projektimit, me çmime ose pagesa të pjesëmarrësve;<br><br>b) konkurset e projektimit të organizuara si pjesë e një procedure e cila çon në dhënien e një kontrate publike për shërbime.<br><br>Në rastet e përmendura në shkronjën "a", të pikës 1 të këtij neni, vlera e përcaktuar e konkursit të projektimit bazohet në vlerën e përcaktuar pa TVSH të kontratës së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimit, duke përfshirë të gjitha çmimet ose pagesat e mundshme për pjesëmarrësit.<br>Në rastet e përmendura në shkronjë “b”, të pikës 1 të këtij neni, vlera e konkursit të projektimit përcaktohet si shumë totale e çmimeve dhe pagesave, duke përfshirë edhe vlerën e parashikuar pa TVSH të kontratës publike të shërbimit që mund të lidhet në vijim në përputhje me nenin 47, nëse autoriteti ose enti kontraktor ka bërë të ditur qëllimin e tij për të shpallur fituesin e kësaj kontrate në njoftimin e konkursit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Njoftimet e konkursit te projektimit<br>21 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor që synon të zhvillojë një konkurs projektimi, njofton qëllimin e tij nëpërmjet njoftimit të konkursit. Njoftimi i konkursit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në konkurs. Informacioni i dhënë në njoftimin e kontratës duhet t'i referohet fazës së parë të kualifikimit të procedurës. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(30) | Në kreun III ”Konkursi i Projektimit”, neni 104 ”Zbatimi”, pika 1, ndryshon si më poshtë:<br><br>“1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për:<br>a) konkurset e projektimit, të organizuara si pjesë e një procedure, e cila çon në dhënien e një kontrate publike për shërbime<br>b) konkurset e projektimit, me çmime ose pagesa të pjesëmarrësve”. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Njoftimet<br>79 (1) | Autoritetet kontraktore që synojnë të zhvillojnë një konkurs projektimi, njoftojnë këtë synim të tyre nëpërmjet njoftimit të konkursit.<br>Nëse ata në vijim synojnë të japin një kontratë shërbimi sipas nenit 32, paragrafi 4, kjo përcaktohet në njoftimin e konkursit. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Njoftimet<br>105 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor që synon të zhvillojë një konkurs projektimi, njofton qëllimin e tij nëpërmjet njoftimit të konkursit. Në rast se, në vijim synohet lidhja e një kontrate shërbimi, sipas nenit 47, ky informacion përfshihet në njoftimin e konkursit. | E plotë | |
| 79 (2) | Autoritetet kontraktore që kanë organizuar një konkurs projektimi duhet të dërgojnë një njoftim të rezultateve të konkursit në përputhje me nenin 51 dhe të mund të vërtetojnë datën e dërgimit.<br>Nëse publikimi i informacionit për rezultatet e konkursit do të pengonte zbatimin e ligjit, do të ishte në kundërshtim me interesin publik ose do të cenonte interesat tregtare legjitime të një ndërmarrjeje të caktuar, qoftë publike ose | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br>105 (3) | Përjashtimisht, autoriteti ose enti kontraktor nuk është i detyruar të publikojë informacione për rezultatin e konkursit, nëse publikimi i tyre pengon zbatimin e ligjit, vjen në kundërshtim me interesin publik, cënon interesat tregtare legjitime të operatorëve ekonomikë, ose mund të cënojë konkurrencën e drejtë ndërmjet ofruesve të shërbimeve. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br>21 (5) | Kur autoriteti ose enti kontraktor gjykon se është në kushtet e parashikuara në pikën 4 të nenit 105 të LPP-së, duhet të argumentojë dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | private, ose do mund të cenonte konkurrencën e ndershme ndërmjet ofruesve të shërbimit, ky informacion mund të mos publikohet. | | | dokumentojë arsyet e mospublikimit të informacionit mbi rezultatet e konkursit të projektimit. | | |
| 79 (3) | Njoftimet e përmendura në paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni shpallen në përputhje me nenin 51, paragrafi 2 deri në 6 dhe nenin 52. Ato përfshijnë informacionet e përcaktuara përkatësisht në shtojcën V pjesët E dhe F në formatin e formularëve standardë.<br>Komisioni përcakton formularët standardë me anë të akteve zbatuese. Këto akte ligjore zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 89, paragrafi 2. | | 21 (2) | Ky informacion përfshin të paktën:<br>- Emrin dhe adresën e autoritetit ose entit kontraktor<br>- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;<br>- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV);<br>- referencën e njoftimit;<br>- numrin dhe vlerën e çmimeve;<br>- lloji i konkursit të projektimit (me ose pa reduktim të numrit të operatorëve);<br>- procedurën e prokurimit që do të ndiqet në rast se, në vijim synohet lidhja | E plote | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e një kontrate shërbimi, sipas përcaktimit në nenin 47 të LPP-së;<br>- në rastin e një konkursi projektimi pa reduktim umri të operatorëve, afati kohor për dorëzimin e projekteve<br>- kohëzgjatjen e kontratës;<br>- Në rastin e një konkursi projektimi me reduktim numri të operatorëve ekonomikë, sipas parashikimit në pikën 3 të nenit 106 të LPP-së, njoftimi duhet të përmbajë edhe: numrin e parashikuar të pjesëmarrësve; emrat e pjesëmarrësve të përzgjedhur, nëse ka; kriteret e qarta për përzgjedhjen e pjesëmarrësve; afati kohor për kërkesat për pjesëmarrje. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 21 (3) | - një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;<br>- kriteret e kualifikimit<br>- vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet;<br>- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe hapjen e tyre;<br>- gjuhën /gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;<br><br>Në rastet e konkursit të projektimit të rishpallur pas anulimit, njoftimi mbi ndryshimet dhe informacionet shtesë në një konkurs projektimi, njoftimi duhet të përmbajë të njëjtat të dhëna që parashikohen në nenin 20 të këtyre rregullave.<br>Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor respekton rregulla të njëjta si për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 21(4) | publikimin e njoftimit të kontratës dhe rregullat e përcaktuara në nenin 75 të LPP-së për shtyrjen e afateve për pritjen e ofertave, kur është rasti.<br><br>Njoftimi për rezultatet e konkursit publikohet sipas përcaktimit në pikën 3 të nenit 105 të LPP-së dhe përmban:<br>- emrin dhe adresën e autoritetit ose entit kontraktor;<br>- emrin dhe kontaktet e Personit për Përgjegjës;<br>- pbjektin e konkursit;<br>- një përshkrim të shkurtër të kontratës;<br>- referencën e njoftimit;<br>- numrin dhe vlerën e çmimeve;<br>- lloji i konkursit të projektimit (me ose pa reduktim të numrit të operatorëve ekonomikë); | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - kriteret që janë zbatuar për vlerësimin e projekteve;<br>- numri i pjesëmarrësve;<br>- data e vendimit të jurisë;<br>- emrat e fituesve të konkursit dhe identifikimi i tyre (NIPT, adrese, etj);<br>- data e dërgimit të njoftimit;<br>- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor. | | |
| Rregullat për organizimin e konkurseve të projektimit dhe përzgjedhjen e pjesëmarrësve 80 (1) | Gjatë organizimit të konkurseve të projektimit autoritetet kontraktore zbatojnë procedura që janë në pajtim me dispozitat e titullit I të këtij kapitulli. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik""**<br><br>Rregullat për organizimin e konkursit të projektimit<br>106 (1) | Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë organizimit dhe realizimit të konkursit të projektimit, zbaton procedurat në përputhje me dispozitat e përgjithshme të këtij ligji dhe dispozitat e këtij Kreu. | E plotë | |
| 80 (2) | Pranimi i pjesëmarrësve në konkurset e projektimit nuk mund të kufizohet: | | 106 (2) | Pranimi i pjesëmarrësve në konkurset e projektimit nuk mund të kufizohet: | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (a) për shkak të territorit ose një pjese të territorit të një shteti anëtar;<br>(b) me arsyen se, sipas ligjit të shtetit anëtar ku organizohet konkursi, ata duhet të jenë persona fizikë ose persona juridikë. | | | a) për shkak të shtetësisë, territorit, apo rezidencës;<br>b) për shkak të qenies person fizik apo juridik. | | |
| 80 (3) | Kur konkurset e projektimit janë të kufizuar për një numër të caktuar pjesëmarrësish, autoriteti kontraktor përcakton kritere përzgjedhjeje të qarta dhe jodiskriminuese. Në çdo rast, numri i kandidatëve që ftohen për të marrë pjesë duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një konkurrencë të drejtë.” | | 106 (3) | Në rastet kur, kufizohet numri i pjesëmarrësve në konkursin e projektimit, autoriteti ose enti kontraktor përcakton kritere përzgjedhëse të qarta dhe jodiskriminuese. Në çdo rast, numri i kandidatëve të zgjedhur duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u siguruar konkurrencë të drejtë. | E plotë | |
| Përbërja e jurisë 81 (1) | Juria përbëhet vetëm nga persona fizikë që janë të pavarur nga pjesëmarrësit në konkurs. Aty ku kërkohet që | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>Rregullat për organizimin e | Autoriteti ose enti kontraktor, gjatë organizimit dhe realizimit të konkursit të projektimit, zbaton procedurat në përputhje me dispozitat e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | pjesëmarrësit në një konkurs të kenë një formim profesional të caktuar, atëherë të paktën një e treta e anëtarëve të jurisë duhet ta ketë atë kualifikim ose një kualifikim të barasvlershëm. | | konkursit të projektimit<br>106 (1) | përgjithshme të këtij ligji dhe dispozitat e këtij Kreu. | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Konkursi i projektimit<br>58 (5) | Hapat e procedurës së konkursit të projektimit janë si më poshtë:<br><br>h)Juria e vlerësimit duhet të përbëhet nga një numër tek anëtarësh (të paktën tre), pjesëtarë ose jo të autoritetit/entit kontraktor. Nëse nga pjesëmarrësit në konkurs kërkohet kualifikim i posaçëm profesional, së paku një e treta e anëtarëve të komisionit të jurisë duhet të kenë kualifikime të njëjta ose të barazvlefshme profesionale si pjesëmarrësit, si dhe një përvojë 10 vjeçare në çështjet e projektit që do të prokurohet. | | |
| Vendimet e jurisë<br>82 (1) | Juria është e pavarur në vendimet ose opinionet e saj. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>Vendimet e jurisë<br>108 (2) | Juria është e pavarur në vendimet dhe opinionet e saj. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>Konkurset e projektimit<br>58 (5) | j)Juria është e pavarur në vendimet dhe opinionet e saj. Nëse është e nevojshme, juria fton kandidatët për t'ju përgjigjur pyetjeve që ka regjistruar në procesverbal, për të sqaruar çdo aspekt të planeve apo projekteve të paraqitura. Këto diskutime regjistrohen në një procesverbal. **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"** | | |
| 82 (2) | Juria shqyrton planet dhe projektet e dorëzuara nga kandidatët në mënyrë anonime dhe vetëm mbi bazën e kritereve të përcaktuara në njoftimin e konkursit. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br><br>108 (1) | Juria shqyrton projektet e paraqitura nga kandidatët, në mënyrë anonime dhe vetëm mbi bazën e kritereve të përcaktuara në njoftimin për konkurs. Anonimiteti i projekteve duhet të respektohet deri në momentin që juria merr vendimin e saj | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>58 (5) | i)Juria shqyrton projektet e paraqitura nga kandidatët, në mënyrë anonime dhe vetëm mbi bazën e kritereve të përcaktuara në njoftimin për konkurs. Anonimiteti i projekteve duhet të respektohet deri në momentin që juria merr vendimin e saj. | | |
| 82 (3) | Juria regjistron radhitjen e projekteve në një raport të nënshkruar nga anëtarët e saj, të përgatitur sipas cilësive të secilit projekt, së bashku me komentet dhe çdo pikë që mund të ketë nevojë për sqarime. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>108 (3) | Juria regjistron radhitjen e projekteve në një raport të nënshkruar nga anëtarët e saj, të përgatitur sipas cilësive të secilit projekt, së bashku me komentet dhe çdo pikë që mund të ketë nevojë për sqarime. | E plotë | |
| | | | **2. VKM nr.285, datë 19.05.2021**<br><br>58 (5) | k)Në vijim, juria harton një raport, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, ku pasqyrohet renditja sipas cilësisë të planeve ose projekteve dhe komentet apo vërejtjet konkrete. | | |
| 82 (4) | Anonimati ruhet derisa juria të ketë arritur në një opinion ose vendim të sajin. | | **1. Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”**<br><br>108 (1) | Juria shqyrton projektet e paraqitura nga kandidatët, në mënyrë anonime dhe vetëm mbi bazën e kritereve të përcaktuara në | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njoftimin për konkurs. Anonimiteti i projekteve duhet të respektohet deri në momentin që juria merr vendimin e saj | | |
| | | | **VKM nr. 285, datë 19.05.2021**<br><br>58 (5) | j)Juria është e pavarur në vendimet dhe opinionet e saj. Nëse është e nevojshme, juria fton kandidatët për t'ju përgjigjur pyetjeve që ka regjistruar në procesverbal, për të sqaruar çdo aspekt të planeve apo projekteve të paraqitura. Këto diskutime regjistrohen në një procesverbal. | | |
| 82 (5) | Nëse është nevoja, kandidatët mund të ftohen që t'u përgjigjen pyetjeve që juria ka regjistruar në procesverbal për të sqaruar çdo aspekt të projekteve. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>108 (4) | Nëse është e nevojshme, kandidatët mund të ftohen për t'ju përgjigjur pyetjeve që juria ka regjistruar në procesverbal, për të sqaruar çdo aspekt të planeve apo projekteve të paraqitura. | E plotë | |
| 82 (6) | Dialogu ndërmjet anëtarëve të jurisë dhe kandidatëve shënohet në një procesverbal të plotë. | | 108 (5) | Juria mban procesverbal për diskutimet e zhvilluara në përputhje me pikën 4, të këtij neni. | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zbatimi<br>83 (1) | Për të garantuar plotësisht zbatimin e saktë dhe efikas, shtetet anëtare sigurohen që të paktën detyrat e përcaktuara në këtë nen të kryhen nga një ose më shumë autoritete, organe ose struktura. Ata i bëjnë me dije Komisionit të gjitha autoritetet, organet ose strukturat kompetente për këto detyra. | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Agjencia e Prokurimit Publik<br>22 (1) | Agjencia e Prokurimit Publik mbikqyr sistemin e prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efiçencës e transparencës në procesin e prokurimit publik. Agjencia e Prokurimit Publik, është person juridik, institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë që financohet nga Buxheti i Shtetit. | E plotë | |
| 83 (2) | Shtetet anëtare garantojnë që të monitorohet zbatimi i rregullave të prokurimit publik.<br>Kur autoritetet ose strukturat monitoruese identifikojnë, me nismën e tyre ose pas marrjes së informacionit, shkelje specifike ose probleme sistematike, ata marrin kompetencën që t'ia bëjnë me dije këto probleme autoriteteve kombëtare të kontrollit, gjykatave ose trupave gjykuese ose | | **1. Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"**<br>Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik<br>23 | Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione:<br><br>d) verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore;<br>;<br><br>dh) monitoron nëse zbatimi i kontratave është bërë në përputhje me kushtet e | E plotë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | autoriteteve ose strukturave të tjera të përshtatshme, si p.sh. avokati i popullit, parlamentet kombëtare ose komitetet e tyre. | | | prokuruara bazuar në raportet periodike të autoriteteve ose enteve kontraktore. Në çdo rast, nëse vlerësohet për ushtrimin e këtij funksioni, kryhen verifikime në vend;<br><br>e) në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoba sipas parashikimeve të këtij ligji ose i propozon drejtuesit të autoritetit kontraktor ose entit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat e autoriteteve ose enteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje;<br><br>ë ) përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të përfituar kontrata publike, në përputhje me parashikimet në këtë ligj;<br><br>gj) harton dhe publikon Buletinin e Njoftimeve Publike, siç është përshkruar në rregullat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | prokurimit publik dhe aktet e tjera nënligjore;<br><br>k) paraqet një raport vjetor pranë Kryeministrit për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik. Raporti vjetor i Agjencisë së Prokurimit Publik publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni;<br><br>l) bashkëpunon me autoritetet kontraktore, Komisionin e Prokurimit Publik, institucione të tjera, si dhe organet audituese, nëpërmjet informacioneve të ndryshme, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik, në funksion të efikasitetit të këtij sistemi. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(4) | Në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik”, bëhen ndryshimet si më poshtë:<br><br>a) gërma “dh” riformulohet me këtë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përmbajtje: "dh) monitoron nëse zbatimi i kontratave është bërë në përputhje me kushtet e prokuruara;". | | |
| 83 (3) | Rezultatet e veprimtarive të monitorimit, sipas paragrafit 2, vihen në dispozicion të publikut nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të informimit. Këto rezultate i vihen në dispozicion edhe Komisionit. Për shembull, ato mund të përfshihen në raportet e monitorimit, sipas nënparagrafit të dytë të këtij paragrafi.<br>Deri më 18 prill 2017 dhe më pas çdo tre vjet në vijim, shtetet anëtare i dorëzojnë Komisionit raportin e monitorimit, i cili mbulon, sipas rastit, informacionin për burimet më të shpeshta të zbatimit të gabuar ose të pasigurisë juridike, duke përfshirë problemet strukturore | | Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik 23 | Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione:<br><br>d) verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, anulimit të procedurës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore;<br><br>dh) monitoron nëse zbatimi i kontratave është bërë në përputhje me kushtet e prokuruara bazuar në raportet periodike të autoriteteve ose enteve kontraktore. Në çdo rast, nëse vlerësohet për ushtrimin e këtij funksioni, kryhen verifikime në vend;<br><br>e) në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në | E plotë | APP publikon ne faqen e saj te internetit te gjitha te dhenat mbi vendimmarrjen e saj ne lidhje me procedurat e verifikuara apo perjashtimin e operatoreve ekonomike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ose të përsëritura në zbatimin e rregullave, për nivelin e pjesëmarrjes së SME-ve në prokurimin publik dhe për parandalimin, zbulimin dhe raportimin e përshtatshëm të rasteve të mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe parregullsive të tjera të rënda në prokurime. Komisioni mund t'u kërkojë shteteve anëtare, jo më shpesh se çdo tre vjet, që të japin informacion për zbatimin praktik të politikave strategjike kombëtare për prokurimin.<br>Për qëllime të këtij paragrafi dhe të paragrafit 4 të këtij neni, termi "SME" ka kuptimin që i është dhënë në Rekomandimin e Komisionit 2003/361/KE (39). | | | zbatim të tij, vendos gjoba sipas parashikimeve të këtij ligji ose i propozon drejtuesit të autoritetit kontraktor ose entit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat e autoriteteve ose enteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje;<br><br>ë ) përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të përfituar kontrata publike, në përputhje me parashikimet në këtë ligj;<br><br>f) menaxhon bazën e të dhënave të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.;<br><br>g) analizon të dhënat për prokurimin publik dhe përgatit raporte statistikore;<br><br>gj) harton dhe publikon Buletinin e Njoftimeve Publike, siç është përshkruar në rregullat e prokurimit publik dhe aktet e tjera nënligjore; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mbi bazën e të dhënave të marra, sipas këtij paragrafi, Komisioni lëshon rregullisht një raport për zbatimin dhe praktikat më të mira të politikave kombëtare të prokurimit në tregun e brendshëm. | | | k) paraqet një raport vjetor pranë Kryeministrit për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik. Raporti vjetor i Agjencisë së Prokurimit Publik publikohet në faqen e internetit të këtij institucioni;<br><br>l) bashkëpunon me autoritetet kontraktore, Komisionin e Prokurimit Publik, institucione të tjera, si dhe organet audituese, nëpërmjet informacioneve të ndryshme, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik, në funksion të efikasitetit të këtij sistemi. | | |
| | | | **5. Projektligj**<br><br>(4) | Në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik”, bëhen ndryshimet si më poshtë:<br><br>a) gërma “dh” riformulohet me këtë përmbajtje: “dh) monitoron nëse zbatimi i kontratave | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
